



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 102

Tiranë – E hënë, 18 maj 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 42/2026, datë 23.4.2026	Për lirinë e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë..... 8993
Dekret i President nr. 312, datë 13.5.2026	Për shpallje ligji..... 9016
Ligj nr. 43/2026, datë 23.4.2026	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore..... 9016
Dekret i President nr. 313, datë 13.5.2026	Për shpallje ligji..... 9022
Dekret i President nr. 301, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9022
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 93, datë 5.5.2026	Për transmetimin e të dhënave të udhëtimit në rastet e mosfunksionimit të sistemit kryesor të përpunimit të informacionit të udhëtimit..... 9023
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 94, datë 6.5.2026	Për miratimin e formatit dhe të përmbajtjes së certifikatës së regjistrimit për shtetas të vendeve të Bashkimit Evropian..... 9026
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 95, datë 6.5.2026	Për procedurën e lëshimit e refuzimit të lëshimit, e ripërtëritjes apo e anulimit të lejes së qëndrimit dhe lejes unike për të huajin..... 9029
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 96, datë 11.5.2026	Për informacionin që u jepet personave të cilët janë subjekt i verifikimeve në vijën e dytë në pikat e kalimit kufitar..... 9032
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 97, datë 11.5.2026	Për listën e pikave të kalimit kufitar dhe zonave transit në Republikën e Shqipërisë..... 9059

Udhëzim i ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 29.4.2026	Për të drejtën e damkimit, administrimin dhe mënyrën e përdorimit të çekiçdamkës.....	9062
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 110, datë 21.4.2026	Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2026–2027 në sistemin arsimor parauniversitar.....	9063
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 144, datë 29.4.2026	Për miratimin e modelit të vërtetimit të transportit të materialit drusor të papërpunuar, si dhe të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore	9064
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 145, datë 29.4.2026	Për miratimin e formatit të certifikatës së origjinës së produkteve pyjore drusore dhe jodrusore	9066
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 22, datë 3.3.2026	Me objekt konstatimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese të kërkuesit, përfshirë shkeljen e neneve 44 (e drejta për zhdëmtim), 42 (e drejta për një proces të rregullt ligjor) dhe 18 (barazia para ligjit). Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3708, datë 25.9.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë. Urdhërimin e organeve përkatëse të garantojnë shpërblimin e plotë për punën e kryer nga kërkuesi në përputhje me ligjin dhe vendimet përkatëse për periudhën 1.9.2001–30.3.2010, në përputhje me pagën minimale të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 25.3.2009, “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”	9068
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 17.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-975, datë 18.3.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për çështjen nr. 11216-01487-00-2018 regjistri, datë 3.5.2018, në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	9075
Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2025-4900 (621), datë 22.12.2025	Me objekt 1. Zgjidhjen e martesës ligjore me të paditurin A.V. 2. Lënien për rritje dhe edukim të tre fëmijëve A. V., E. V. dhe D. V. paditëses D. V. 3. Detyrimin ushqimor në shumën 600 (gjashtëqind) euro në muaj, 200 (dyqind) euro për fëmijë, për të paditurin A. V. për fëmijët A. V., E. V. dhe D. V. 4. Të drejtën e kthimit të mbiemrit të para martesës “Ç.” për paditësen D. V.	9081
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit nr. 21, datë 15.5.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9133
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit nr. 22, datë 16.5.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9134



LIGJ
Nr. 42/2026

PËR LIRINË E VENDOSJES DHE
OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj përcakton dispozitat e përgjithshme që lehtësojnë ushtrimin e lirisë së vendosjes nga ofruesit e shërbimeve dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve ndërkufitare, duke siguruar një cilësi të lartë të shërbimeve.

2. Ky ligj nuk rregullon:

a) liberalizimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, të rezervuara për subjekte publike ose private;

b) privatizimin e subjekteve publike që ofrojnë shërbime.

3. Ky ligj nuk rregullon heqjen e monopoleve në ofrimin e shërbimeve dhe as ndihmat e dhëna nga shteti, të cilat rregullohen nga legjislacioni për ndihmën shtetërore, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian. Ky ligj nuk cenon lirinë e shtetit për të përcaktuar në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian se cilat shërbime konsiderohen me interes të përgjithshëm ekonomik, mënyrën e organizimit dhe të financimit të tyre, si dhe detyrimet specifike që u vendosen këtyre shërbimeve.

4. Ky ligj nuk cenon masat e marra në nivel kombëtar, në përputhje me të drejtën e Bashkimit

Evropian, për mbrojtjen ose promovimin e diversitetit kulturor dhe gjuhësor ose të pluralizmit të medias.

5. Ky ligj nuk cenon rregullat e së drejtës penale. Autoritetet kompetente nuk mund të kufizojnë lirinë e ofrimit të shërbimeve duke zbatuar dispozita penale që rregullojnë ose ndikojnë posaçërisht në hyrjen në një veprimtari shërbimi ose ushtrimin e saj në kundërshtim me këtë ligj dhe me të drejtën e Bashkimit Evropian.

6. Ky ligj nuk cenon legjislacionin e punës, përfshirë çdo dispozitë ligjore ose kontraktore për kushtet e punësimit, kushtet e punës dhe marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe rregullat për shëndetin e sigurinë në punë. Po kështu, ky ligj nuk cenon legjislacionin për sigurimet shoqërore, të cilat zbatohen në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

7. Ky ligj nuk cenon ushtrimin e të drejtave themelore dhe të së drejtës për të negociuar, për të lidhur e për të zbatuar marrëveshje kolektive dhe për të ndërmarrë veprime sindikale në përputhje me ligjin dhe me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha shërbimet që ofrohen nga ofrues të vendosur në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, me përjashtim të:

a) shërbimeve joekonomike me interes të përgjithshëm;

b) shërbimeve financiare të tilla si: shërbimet bankare, shërbime kreditimi, sigurimi dhe risigurimi, pensionet profesionale ose personale, letrat me vlerë, fondet e investimeve, pagesat dhe këshillimi për investime, përfshirë shërbimet financiare sipas përkufizimit të këtij ligji;

c) shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, si dhe pajisjeve dhe shërbimeve të lidhura me to, vetëm për ato çështje që rregullohen nga legjislacioni për komunikimet elektronike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian;

¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 12 dhjetor 2006, “Për shërbimet në tregun e

brendshëm” Celex: 32006L0123, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 376, datë 27.12.2006, faqe 36–68.



c) shërbimeve në fushën e transportit, duke përfshirë transportin rrugor, hekurudhor, detar, shërbimet portuale dhe transportin ajror, në përputhje me përcaktimet e së drejtës së Bashkimit Evropian;

d) shërbimeve të agjencive të punësimit të përkohshëm;

dh) shërbimeve të kujdesit shëndetësor, pavarësisht mënyrës së organizimit dhe financimit të tyre, apo faktit nëse ofrohen nga subjekte publike ose private;

e) shërbimeve audiovizive, përfshirë shërbimet kinematografike, pavarësisht mënyrës së prodhimit, shpërndarjes apo transmetimit të tyre, si dhe transmetimet radiofonike;

ë) aktiviteteve të lojërave të fatit që përfshijnë vënien e një basti me vlerë monetare në lojëra të fatit, duke përfshirë lotaritë, lojërat e fatit në kazino dhe transaksionet e basteve;

f) aktiviteteve që lidhen me ushtrimin e autoritetit zyrtar sipas së drejtës së Bashkimit Evropian;

g) shërbimeve sociale sipas përkufizimit në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shërbimeve që lidhen me strehimin social, kujdesin për fëmijët dhe mbështetjen e familjeve dhe personave që janë në nevojë të përhershme ose të përkohshme, të cilat ofrohen nga shteti nga ofrues të mandatuar nga shteti ose nga organizata bamirëse të njohura si të tilla nga shteti;

gj) shërbimeve private të sigurisë;

h) shërbimeve të ofruara nga noterët apo përmbaruesit, të emëruar me një akt të autoritetit kompetent.

2. Ky ligj nuk zbatohet në fushën e tatimeve.

Neni 3

Marrëdhënia me legjislacionin e posaçëm

1. Kur ndonjë dispozitë e këtij ligji bie në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të posaçëm, që rregullon aspekte të veçanta të hyrjes në një veprimtari shërbimi ose ushtrimit të saj në sektorë ose profesione specifike, zbatohen dispozitat e legjislacionit të posaçëm. Ky parim zbatohet ndër të tjera për legjislacionin në fushat që lidhen me:

a) transferimin e përkohshëm të punëmarrësve në kuadër të ofrimit të shërbimeve;

b) koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar, të vetëpunësuar dhe anëtarët e familjes së tyre;

c) shërbimet e transmetimit audioviziv;

ç) njohjen e kualifikimeve profesionale.

Ky ligj dhe legjislacioni i posaçëm zbatohen në mënyrë plotësuese, përveç rasteve të konfliktit, kur përparësi kanë rregullat e posaçme, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

2. Ky ligj nuk zbatohet për rregullat e së drejtës ndërkombëtare private, në veçanti ato që përcaktojnë ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore, duke përfshirë ato që garantojnë mbrojtjen e konsumatorëve sipas legjislacionit përkatës.

3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në përputhje me parimet e lirisë së vendosjes dhe të lirisë së ofrimit të shërbimeve sipas së drejtës së Bashkimit Evropian.

Neni 4

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arsye madhore të lidhura me interesin publik” janë arsyet e njohura si të tilla nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Në kuptim të këtij ligji, këto arsye përfshijnë, ndër të tjera, rendin publik, sigurinë publike, shëndetin publik, mbrojtjen e konsumatorëve dhe të përfituesve të shërbimeve, mbrojtjen dhe mirëqenien sociale të punonjësve, ruajtjen e ekuilibrit financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore, parandalimin e mashtrimit dhe të konkurrencës së pandershme, mbrojtjen e mjedisit dhe të mjedisit urban, përfshirë planifikimin urban e territorial, mbrojtjen e kreditorëve, garantimin e administrimit të drejtë të drejtësisë, sigurinë rrugore, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, objektivat e politikës sociale e kulturore, si dhe ruajtjen e trashëgimisë kombëtare historike e artistike. Kjo listë nuk është shteruese dhe nuk përfshin arsye të natyrës thjesht ekonomike, të tilla si mbrojtja e konkurrencës, sigurimi i fitimeve të subjekteve ekonomike, ruajtja e strukturës së tregut apo të të ardhurave fiskale.

2. “Autoritet kompetent” është çdo organ ose autoritet që ka rol mbikëqyrës apo rregullator në një



veprimtari shërbimi, përfshirë, veçanërisht, organet administrative, gjykatat kur veprojnë si të tilla, organet profesionale dhe shoqatat ose organizatat e tjera profesionale, të cilat në ushtrim të autonomisë së tyre ligjore rregullojnë në mënyrë kolektive hyrjen në një veprimtari shërbimi ose ushtrimin e saj.

3. “Komision” është Komisioni Evropian.

4. “Komunikim tregtar” është çdo formë komunikimi, e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, që ka për qëllim të promovojë mallrat, shërbimet apo imazhin e një sipërmarrjeje, organizate ose personi të angazhuar në një veprimtari tregtare, industriale, zejtare apo në ushtrimin e një profesioni të rregulluar. Nuk përbëjnë komunikim tregtar në kuptim të këtij ligji:

a) informacioni që mundëson aksesin e drejtpërdrejtë në veprimtarinë e një sipërmarrjeje, organizate apo personi, si emri i *domain*-it në internet apo adresa e postës elektronike;

b) komunikimi lidhur me mallrat, shërbimet, imazhin e një sipërmarrjeje, organizate apo personi, i ofruar në mënyrë të pavarur dhe pa kundërshpërbim.

5. “Kriter” është çdo detyrim, ndalim, kusht ose kufizim, i përcaktuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi, në akte nënligjore ose akte administrative, ose që rrjedh nga praktika gjyqësore, praktika administrative, rregullat e organeve profesionale, si dhe nga rregullat e përbashkëta të shoqatave ose organizatave të tjera profesionale, të miratuara në ushtrimin e autonomisë së tyre ligjore. Rregullat e përcaktuara në marrëveshjet kolektive të negociuara nga partnerët socialë nuk konsiderohen si kritere në kuptim të këtij ligji.

6. “Legjislacion sektorial” është legjislacioni, përfshirë ligje, vendime, rregullore, udhëzime dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor, si dhe rregullat e parashikuara sipas akteve të urdhrave ose organizatave profesionale, që rregullojnë ushtrimin e veprimtarive në një sektor të caktuar.

7. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e ekonomisë dhe të tregtisë.

8. “Ofrues” është çdo person fizik, shtetas i Republikës së Shqipërisë, i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose i Zonës Ekonomike Evropiane ose çdo person juridik i vendosur në Republikën e Shqipërisë ose në një nga këto shtete, që ofron ose kryen një shërbim, sipas kuptimit të së drejtës së Bashkimit Evropian mbi lirinë e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve.

9. “Përfitues” është çdo person fizik, shtetas i Republikës së Shqipërisë, i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose i Zonës Ekonomike Evropiane, ose çdo person që përfiton nga të drejtat e parashikuara në aktet e Bashkimit Evropian, si dhe çdo person juridik i vendosur në Republikën e Shqipërisë ose në një nga këto shtete, i cili, për qëllime profesionale ose jo, përdor ose dëshiron të përdorë një shërbim.

10. “Profesion i rregulluar” është veprimtari profesionale ose grup veprimtarish profesionale, ushtrimi i të cilave sipas legjislacionit kombëtar u rezervohet mbajtësve të një kualifikimi profesional të caktuar, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian për njohjen e kualifikimeve profesionale.

11. “Sistemi i Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI)” është sistem informacioni shumëgjuhësh *online*, që lehtëson shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve publike të përfshira në zbatimin praktik të ligjit të Bashkimit Evropian, i rregulluar nga rregullorja (BE) nr. 1024/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 për bashkëpunimin administrativ përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm.

12. “Sistemi TRIS” është Sistemi i Transparencës për Informacionin mbi Rregullat Teknike dhe Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit, i administruar nga Komisioni Evropian në zbatim të direktivës (BE) 2015/1535, që përdoret për njoftimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet shteteve anëtare dhe Komisionit.

13. “Skemë autorizimi” është çdo procedurë apo akt administrativ, në bazë të të cilit një autoritet kompetent i jep ofruesit ose përfituesit të një shërbimi një vendim zyrtar ose të nënkuptuar për ofrimin e një shërbimi apo aksesin në një veprimtari shërbimi.

Në kuptim të këtij ligji, termat “licencë”, “leje”, “autorizim”, “certifikatë”, “pëlqim”, “regjistrim pranë një urdhri ose organizate profesionale”, “njoftim”, si edhe çdo term tjetër i ngjashëm me to në legjislacionin shqiptar në fuqi, nëpërmjet të cilit lejohet ushtrimi i një aktiviteti apo ofrimi i një shërbimi, konsiderohen si skemë autorizimi.

14. “Shërbim” është çdo veprimtari ekonomike e ushtruar në mënyrë të pavarur, që kryhet zakonisht kundrejt një shpërbimi sipas së drejtës së Bashkimit Evropian.

Ky përkufizim përfshin, ndër të tjera, veprimtaritë profesionale të rregulluara, shërbimet



tregtare, zejtare dhe ndërtimore, shërbimet në fushën e turizmit, argëtimit, energjisë dhe informacionit, si dhe shërbimet e arsimit dhe formimit kur ofrohen me karakter ekonomik.

15. “Shërbime ekonomike me interes të përgjithshëm” janë shërbime të ofruara për qëllime të interesit publik, të cilat kanë karakter ekonomik dhe ofrohen kundrejt një shpërblimi, pavarësisht nga forma juridike e ofruesit ose mënyra e organizimit të tyre. Këto mund të përfshijnë, ndër të tjera, shërbime në sektorin e energjisë elektrike, gazit, ujësjellësit, transportit ose sistemet kombëtare të pagesave, të cilat shteti mund t’i konsiderojë me interes të përgjithshëm dhe ndaj të cilave mund të vendosë detyrime specifike të shërbimit publik.

16. “Shërbime joekonomike me interes të përgjithshëm” janë veprimtari të ofruara nga shteti ose nga subjekte të ngarkuara nga shteti për qëllime të interesit publik, të cilat nuk kanë karakter ekonomik dhe nuk ofrohen kundrejt një shpërblimi. Këto përfshijnë, ndër të tjera, shërbime që ofrohen pa kundërvlerë ekonomike, si shërbimet në fushën e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm publik, si dhe shërbime të tjera që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian nuk përbëjnë “shërbim” në kuptim të nenit 57 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

17. “Shërbime financiare” janë të gjitha shërbimet që kanë karakter financiar, përfshirë shërbimet bankare, shërbimet e kredisë, shërbimet e sigurimeve dhe risigurimeve, shërbimet e pensioneve profesionale ose personale, shërbimet mbi letrat me vlerë dhe fondet e investimeve, si dhe çdo shërbim tjetër financiar i ngjashëm.

Kjo kategori përfshin, ndër të tjera, shërbimet e listuara në aneksin I të direktivës 2013/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të tilla si: kredia konsumatore, shërbimet e kredisë hipotekare, qiratë financiare, lëshimi dhe administrimi i mjeteve të pagesës, tregtimi i instrumenteve financiare, ruajtja dhe administrimi i letrave me vlerë, si dhe këshillimi për investime.

Nga fusha e këtij përkufizimi përjashtohen shërbimet që nuk përbëjnë shërbime financiare, si:

a) shërbimet e qirasë operationale që konsistojnë në dhënie me qira të mallrave;

b) shërbimet e menaxhimit të shoqërive ose të administrimit të korporatave;

c) këshillimi për strukturën e kapitalit ose strategjinë industriale të ndërmarrjeve, kur ky

këshillim nuk jepet në kontekstin e shërbimeve të investimeve ose të aktiviteteve që lidhen me instrumente financiare.

18. “Shtet anëtar” është çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose shtet kontraktues i Zonës Ekonomike Evropiane.

19. “Shteti i vendosjes” është Republika e Shqipërisë, çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose shtet kontraktues i Zonës Ekonomike Evropiane, në territorin e të cilit ofruesi i shërbimit është i vendosur në kuptim të së drejtës së Bashkimit Evropian mbi lirinë e vendosjes.

20. “Shteti ku ofrohet shërbimi” është Republika e Shqipërisë, çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose shtet kontraktues i Zonës Ekonomike Evropiane, ku shërbimi ofrohet nga një ofrues i vendosur në një shtet tjetër, sipas kuptimit të së drejtës së Bashkimit Evropian mbi lirinë e ofrimit të shërbimeve.

21. “Vendosje” është ushtrimi faktik i një veprimtarie ekonomike nga një ofrues sipas së drejtës së Bashkimit Evropian për një periudhë të pacaktuar dhe përmes një infrastrukture të qëndrueshme nga ku realizohet realisht veprimtaria e ofrimit të shërbimeve.

KREU II

E DREJTA E VENDOSJES DHE SKEMAT E AUTORIZIMIT

SEKSIONI 1

E DREJTA E VENDOSJES, PARIMET E PËRGJITHSHME TË SKEMAVE TË AUTORIZIMIT, KRITERET E NDALUARA DHE ATO OBJEKT VLERËSIMI

Neni 5

Parime të përgjithshme për vendosjen dhe skemat e autorizimit

1. E drejta për të ushtruar një veprimtari shërbimi ose ushtrimi i saj në territorin e Republikës së Shqipërisë nga ofruesit që synojnë vendosjen ose janë të vendosur në këtë territor nuk mund të kufizohet nga një skemë autorizimi, përveçse kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) skema e autorizimit nuk është diskriminuese ndaj ofruesit të shërbimit;



b) nevoja për vendosjen e një skeme autorizimi është e justifikuar nga një arsye madhore që lidhet me interesin publik;

c) qëllimi i ndjekur nuk mund të arrihet me masa më pak kufizuese, në veçanti sepse kontrolli pas ushtrimit të veprimtarisë do të ishte tepër i vonuar për të qenë realisht efektiv.

2. Autoritetet kompetente identifikojnë skemat e autorizimit ekzistuese dhe argumentojnë përputhshmërinë e tyre me kushtet e pikës 1 të këtij neni, duke u siguruar që kriteret e vendosjes, mënyra e funksionimit dhe efektet e tyre të jenë të justifikuar, proporcionale dhe në përputhje me këtë ligj.

3. Ky nen nuk zbatohet për ato aspekte të skemave të autorizimit që rregullohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga instrumente të posaçme të së drejtës së Bashkimit Evropian.

4. Autoritetet kompetente në ushtrimin e përgjegjësiave të tyre vlerësojnë legjislacionin sektorial ekzistues dhe projektaktet e reja që parashikojnë vendosjen ose funksionimin e skemave të autorizimit për të siguruar që çdo kërkesë e tillë të jetë në përputhje me parimet e pikës 1 të këtij neni.

Në rast se konstatohet mospërputhje, autoritetet kompetente marrin masa për përshtatjen ose shfuqizimin e dispozitave përkatëse.

5. Autoritetet kompetente njoftojnë ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë për çdo projektakt ligjor, nënligjor ose administrativ sektorial që parashikon krijimin, ndryshimin ose rishikimin e një skeme autorizimi, duke bashkëngjitur arsyetimin përkatës mbi domosdoshmërinë, proporcionalitetin dhe qëllimin e saj.

Ministria vlerëson përputhshmërinë e këtyre masave me këtë ligj dhe, sipas rastit, rekomandon mosmiratimin, rishikimin ose shfuqizimin e tyre.

6. Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë njofton Komisionin Evropian në përputhje me nenin 35 të këtij ligji për çdo skemë autorizimi ekzistuese apo të re, që kufizon të drejtën për të ushtruar një veprimtari shërbimi ose ushtrimin e veprimtarive të shërbimit, duke përfshirë informacion për përmbajtjen e saj dhe arsyet e justifikimit.

7. Këshilli i Ministrave me vendim përcakton metodologjinë, procedurat, afatet dhe formatet e vlerësimit, të shqyrtimit dhe të njoftimit të skemave të autorizimit, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, si

dhe rregullat për koordinimin ndërmjet ministrisë përgjegjëse për ekonominë e tregtinë dhe autoriteteve përkatëse, përfshirë regjistrat dhe formatet tip për dokumentimin e tyre.

Neni 6

Kriteret e ndaluara

E drejta për të ushtruar një veprimtari shërbimi ose ushtrimi i saj në territorin e Republikës së Shqipërisë nga ofruesit, që synojnë vendosjen ose janë të vendosur në këtë territor, nuk mund të kushtëzohet në asnjë rast nga:

a) zbatimi i kriterëve diskriminues, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me shtetësinë apo, në rastin e personave juridikë, me vendndodhjen e selisë apo të zyrës qendrore, përfshirë në mënyrë të veçantë:

i. kërkesën që ofruesi i shërbimit, personeli i tij, aksionarët, ortakët ose anëtarët e organeve drejtuese apo mbikëqyrëse të jenë shtetas shqiptarë;

ii. kërkesën që ofruesi i shërbimit, personeli i tij, aksionarët, ortakët ose anëtarët e organeve drejtuese apo mbikëqyrëse të kenë vendbanimin ose qëndrimin në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) ndalimi për të pasur vendosje në më shumë se një shtet anëtar ose për t'u regjistruar në regjistra apo për t'u anëtarësuar në organizata ose shoqata profesionale në më shumë se një shtet anëtar;

c) kufizime mbi lirinë e ofruesit për të zgjedhur ndërmjet vendosjes kryesore ose dytësore, përfshirë detyrimin për të pasur vendosjen kryesore në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose kufizime mbi formën e vendosjes, si agjenci, degë ose filial;

ç) kushte të reciprocitetit me shtetin anëtar në të cilin ofruesi tashmë ka vendosjen, me përjashtim të rasteve kur reciprociteti parashikohet në të drejtën e Bashkimit Evropian në fushën e energjisë;

d) kërkesa për paraqitjen, rast pas rasti, të testit ekonomik nga ofruesi i shërbimit, si kusht për pajisjen me autorizim për të vërtetuar një nevojë ekonomike apo kërkesë të tregut, për të vlerësuar efektet ekonomike të mundshme apo faktike të veprimtarisë, si dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e veprimtarisë në lidhje me objektivat e planifikimit ekonomik, të përcaktuar nga autoriteti kompetent. Ky ndalim nuk përfshin kërkesat e planifikimit që nuk ndjekin objektiva ekonomike, por shërbejnë për arsye madhore që lidhen me interesin publik;



dh) përfshirja në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e subjekteve konkurrense në dhënien e autorizimeve, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në organizmat konsultativë, me përjashtim të organizatave dhe shoqatave profesionale apo organizatave të tjera, që veprojnë si autoritet kompetent. Ky ndalim nuk ka të bëjë me konsultimin e organizatave të tilla si dhomat e tregtisë apo shoqatat e biznesit për çështje që nuk kanë lidhje me aplikime specifike për autorizim ose konsultimin e publikut;

e) detyrimi për të dhënë apo për të qenë pjesë e një garancie financiare ose për t'u siguruar nga një ofrues apo organizëm i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky detyrim nuk cenon mundësinë e kërimit të sigurimit ose garancive financiare si të tilla, as kërkesat për pjesëmarrje në fonde kompensimi kolektiv, si ato për anëtarët e organizatave profesionale;

ë) detyrimi që ofruesi të ketë qenë i regjistruar për një periudhë të caktuar në regjistrat e mbajtur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të ketë ushtruar më parë veprimtarinë në këtë territor.

Neni 7

Kritere që duhen vlerësuar

1. Kriteret që mund të kufizojnë të drejtën për të ushtruar një veprimtari shërbimi ose ushtrimin e saj dhe që duhet të vlerësohen nëse janë të domosdoshme dhe të justifikuara janë:

a) kufizimet sasiore apo territoriale, veçanërisht në formën e një numri të caktuar popullsie apo distance minimale ndërmjet ofruesve të shërbimit;

b) detyrimi i ofruesit për të pasur një formë të caktuar juridike;

c) kërkesa që lidhen me zotërimin e kuotave ose aksioneve të një shoqërie;

ç) kërkesa sipas të cilave e drejta e ofrimit të një shërbimi të caktuar u rezervohet ofruesve të posaçëm për shkak të natyrës së posaçme të veprimtarisë së shërbimit, përveç kërkesave që lidhen me çështje të mbuluara nga legjislacioni për profesionet e rregulluara, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian për njohjen e kualifikimeve profesionale ose të parashikuara në akte të tjera të Bashkimit Evropian;

d) ndalimi për të pasur më shumë se një zyrë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

dh) kërkesa për të pasur një numër minimal punonjësish;

e) vendosja e tarifave minimale dhe/ose maksimale, të cilave duhet t'u përmbahet ofruesi i shërbimit;

ë) detyrimi ndaj një ofruesi që bashkë me shërbimin e tij të ofrojë edhe shërbime të tjera specifike.

2. Kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni mund të ruhen ose të vendosen vetëm nëse ato plotësojnë në çdo rast këto kushte:

a) janë jodiskriminuese;

b) janë të justifikuara nga një arsye madhore që lidhet me interesin publik;

c) janë proporcionale me qëllimin përkatës të interesit publik, në mënyrë që ky qëllim të mund të mos arrihet me masa më pak kufizuese.

3. Autoritetet kompetente në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre vlerësojnë legjislacionin sektorial ekzistues dhe projektaktet e reja që rregullojnë të drejtën për të ushtruar një veprimtari shërbimi ose ushtrimin e saj, për të siguruar që çdo kriter i parashikuar të jetë në përputhje me parimet e pikës 2 të këtij neni.

Në rast se konstatohet mospërputhje, autoritetet kompetente marrin masa për përshtatjen ose shfuqizimin e dispozitave përkatëse.

Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë siguron përputhshmërinë e legjislacionit sektorial me këtë ligj dhe udhëzon autoritetet kompetente për zbatimin e prapimeve të tij.

4. Ndalohen kriteret e reja të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përveçse nëse ato plotësojnë tërësisht kushtet e pikës 2 të këtij neni, dhe janë të justifikuara nga një arsye madhore që lidhet me interesin publik.

5. Autoritetet kompetente njoftojnë ministrin për çdo projektakt ligjor, nënligjor ose administrativ sektorial, që parashikon kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, së bashku me arsyetimin përkatës që justifikon domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e tyre.

Ministria vlerëson përputhshmërinë e këtyre masave me këtë ligj dhe, sipas rastit, rekomandon mosmiratimin, rishikimin ose shfuqizimin e tyre.

6. Ministria njofton Komisionin Evropian sipas nenit 35 të këtij ligji për çdo projektakt ligjor, nënligjor ose administrativ të ri, që parashikon kriteret e pikës 1 të këtij neni, së bashku me arsyetimin përkatës.



Njoftimi nuk pengon miratimin e aktit, por akti nuk do të miratohet më tej ose do të shfuqizohet nëse Komisioni brenda tre muajve nga marrja e njoftimit, pas vlerësimit të përputhshmërisë, kërkon mosmiratimin ose shfuqizimin e tij.

Njoftimi i një projektakti në përputhje me procedurat e njoftimit të Bashkimit Evropian për rregullat teknike dhe shërbimet e shoqërisë së informacionit konsiderohet si përmbushje e detyrimit të njoftimit sipas kësaj pike.

7. Këshilli i Ministrave me vendim përcakton metodologjinë, procedurat, afatet dhe formatet e vlerësimit dhe të njoftimit të legjislacionit sektorial, sipas pikave 3 dhe 5 të këtij neni, kanalet e komunikimit, si dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

8. Ministria publikon dhe përditëson listën e kriterëve objekt vlerësimi dhe njoftimi, si dhe rezultatet e shqyrtimit të proporcionalitetit përmes Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK).

9. Dispozitat e këtij neni zbatohen për legjislacionin në fushën e shërbimeve të interesit të përgjithshëm ekonomik vetëm në masën që zbatimi i tyre nuk pengon përmbushjen në mënyrë ligjore ose faktike të detyrës së veçantë që u është caktuar ofruesve përkatës.

SEKSIONI 2 KRITERET DHE PROCEDURAT E SKEMAVE TË AUTORIZIMIT

Neni 8

Kushtet dhe kriteret për miratimin e skemës së autorizimit

1. Skemat e autorizimit bazohen në kriteret që përjashtojnë ushtrimin arbitrar të vlerësimit nga autoritetet kompetente, si:

- a) jodiskriminuese;
- b) të justifikuara nga një arsye madhore që lidhet me interesin publik;
- c) proporcionale me qëllimin përkatës të interesit publik;
- d) të qarta dhe të drejtpërdrejta;
- e) objektive;
- dh) të publikuara paraprakisht;
- e) transparente dhe të aksesueshme.

2. Skema e autorizimit miratohet dhe zbatohet vetëm nëse pas shqyrtimit të duhur konstatohet se

kërkuesi përmbush të gjitha kushtet për dhënien e saj.

Çdo vendim i autoritetit kompetent, përfshirë refuzimin ose revokimin e një skeme autorizimi, jepet i arsyetuar dhe është i ankimueshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Kushtet për miratimin e një skeme autorizimi për vendosje të re nuk duhet të përsërisin kërkesa ose kontrole që janë të barasvlershme ose në thelb të krahasueshme për nga qëllimi me ato që ofruesi i shërbimit i ka përmbushur më parë në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar.

Pikat e kontaktit, të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji, dhe ofruesi i shërbimit ndihmojnë autoritetin kompetent duke ofruar çdo informacion të nevojshëm në lidhje me këto kërkesa.

4. Skema e autorizimit i jep ofruesit të drejtën për të hyrë në një veprimtari shërbimi ose për ta ushtruar atë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë përmes ngritjes së agjencive, filialeve, degëve apo zyrave, përveç rasteve kur kërkohet një skemë e veçantë autorizimi për çdo vendosje ose kur kufizimi territorial justifikohet nga një arsye madhore që lidhet me interesin publik.

5. Ky nen nuk cenon ndarjen e kompetencave ndërmjet autoriteteve qendrore e vendore për dhënien e skemave të autorizimit.

Neni 9

Kohëzgjatja, njoftimi dhe revokimi i skemës së autorizimit

1. Skema e autorizimit jepet pa afat kohor, përveç rasteve kur:

- a) ajo rinovohet automatikisht ose i nënshtrohet përmbushjes së vazhdueshme të kërkesave të parashikuara në legjislacionin në fuqi;
- b) numri i skemave të autorizimit të disponueshme është i kufizuar për arsye madhore që lidhen me interesin publik;
- c) vlefshmëria e kufizuar e saj justifikohet nga një arsye madhore që lidhet me interesin publik.

2. Autoriteti kompetent mund të parashikojë një afat kohor brenda të cilit ofruesi i shërbimit duhet të fillojë ushtrimin efektiv të veprimtarisë pas marrjes së skemës së autorizimit.

3. Ofruesi i shërbimit njofton Pikën e Vetme të Kontaktit (PVK), të përcaktuar në nenin 15 të këtij ligji, për:



a) krijimin e filialeve, degëve ose zyrave që përfshihen në fushëveprimin e skemës së autorizimit;

b) çdo ndryshim në situatën e tij që sjell mospërbushjen e kushteve të skemës së autorizimit.

4. Autoriteti kompetent revokon skemën e autorizimit kur kushtet për dhënien e saj nuk përmbushen më.

Neni 10

Procedurat e autorizimit

1. Procedurat për dhënien e një skeme autorizimi duhet të jenë të qarta, transparente dhe të bëhen publike paraprakisht duke garantuar trajtim objektiv, të paanshëm dhe të barabartë të kërkesave.

2. Procedurat nuk duhet të jenë penguese, të komplikuar apo të shkaktojnë vonesa të panevojshme në ofrimin e shërbimit. Ato duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe çdo tarifë që lidhet me aplikimin duhet të jetë e arsyeshme, proporcionale me koston e procedurës dhe të mos e kalojë koston administrative të shërbimit.

3. Autoriteti kompetent e shqyrton kërkesën brenda një afati të arsyeshëm, të përcaktuar dhe të bërë publik paraprakisht. Afati fillon nga momenti i dorëzimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Në rastet e çështjeve të ndërlikuara, ai mund të shtyhet vetëm një herë për një periudhë të kufizuar, me vendim të arsyetuar që i njoftohet aplikuesit para mbarimit të afatit fillestar.

4. Në mungesë përgjigjeje brenda afatit të përcaktuar ose të zgjatur, skema e autorizimit konsiderohet e miratuar në heshtje. Nga ky rregull mund të bëhen përjashtime vetëm kur ato justifikohen nga arsye madhore që lidhen me interesin publik, përfshirë interesin legjitim të palëve të treta.

5. Autoriteti kompetent njofton menjëherë marrjen e kërkesës dhe në njoftim përcakton:

a) afatin e shqyrtimit sipas pikës 3 të këtij neni;

b) mjetet e ankimit në dispozicion;

c) kur është e zbatueshme, deklarin se në mungesë përgjigjeje brenda afatit skema e autorizimit do të konsiderohet e dhënë.

6. Në rast se kërkesa është e paplotë, autoriteti kompetent njofton menjëherë aplikuesin për dokumentet shtesë të nevojshme dhe për efektet që

kjo sjell mbi ecurinë dhe afatin e shqyrtimit të kërkesës.

7. Refuzimi i një kërkesë për shkak të mospërbushjes së procedurave ose formaliteteve të kërkuara njoftohet menjëherë dhe shoqërohet me arsyetimin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Përzgjedhja ndërmjet disa kërkesve

1. Në rastet kur numri i skemave të autorizimit në dispozicion është i kufizuar për shkak të mungesës së burimeve natyrore ose të kapaciteteve teknike, zhvillohet një procedurë përzgjedhëse ndërmjet kërkesve të mundshëm.

2. Procedura e parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jetë e paanshme, transparente dhe të bëhet publike në të gjitha fazat e procesit përzgjedhës.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, skema e autorizimit jepet për një periudhë të kufizuar të përshtatshme, pa të drejtë rinovimi automatik dhe pa dhënë përparësi për ofruesin, të cilit i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së autorizimit, ose për personat e lidhur me të.

4. Autoritetet kompetente në përcaktimin e rregullave për procedurën e përzgjedhjes marrin në konsideratë çështje që lidhen me shëndetin publik, objektivat e politikës sociale, shëndetin dhe sigurinë e punonjësve ose personave të vetëpunësuar, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe arsye të tjera madhore që lidhen me interesin publik, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

KREU III

LIRIA PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NDËRKUFITARE DHE PËRJASHTIMET

Neni 12

Liria për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare

1. Ofruesit të vendosur në një shtet anëtar i njihet e drejta për të ofruar shërbime në mënyrë të përkohshme në territorin e Republikës së Shqipërisë pa detyrimin për t'u vendosur në këtë territor. Autoritetet kompetente garantojnë ushtrimin e lirë të kësaj veprimtarie në përputhje me këtë ligj dhe me të drejtën e Bashkimit Evropian.



2. E drejta për të ushtruar një veprimtari shërbimi dhe ofrimi i saj në territorin e Republikës së Shqipërisë pa u vendosur mund t'u nënshtrohen vetëm kërkesave që në mënyrë kumulative:

a) nuk janë diskriminuese, as drejtpërdrejt as tërthorazi, për shkak të shtetësisë së ofruesit ose për personat juridikë të shtetit të vendosjes;

b) janë të domosdoshme dhe të justifikuar nga arsye madhore që lidhen me rendin publik, sigurinë publike, shëndetin publik ose mbrojtjen e mjedisit;

c) janë proporcionale me objektivin e ndjekur, të përshtatshme për arritjen e tij dhe nuk shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e tij.

3. Liria për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare nuk kufizohet nëpërmjet kërkesave të mëposhtme:

a) detyrimit për të pasur vendosje në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) detyrimit për të marrë autorizim nga autoritetet kompetente shqiptare, përfshirë regjistrimin në një regjistër ose pranë një organi apo shoqate profesionale, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj ose në legjislacionin sektorial të posaçëm, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian;

c) ndalimit për të ngritur një formë ose infrastrukturë të nevojshme për ofrimin e shërbimit, si zyra, ambiente këshillimore ose pajisje pune, për sa kohë që kjo nuk përbën vendosje të qëndrueshme në kuptim të këtij ligji;

ç) kërkesave për marrëveshje të posaçme kontraktore ndërmjet ofruesit dhe përfituesit që pengojnë ose kufizojnë ofrimin e shërbimeve nga persona të vetëpunësuar;

d) detyrimit për të pasur dokument identifikimi të posaçëm, të lëshuar nga autoritetet shqiptare për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit;

dh) kërkesave që, përveç atyre të nevojshme për shëndetin dhe sigurinë në punë, kufizojnë përdorimin e pajisjeve ose të materialeve që janë pjesë përbërëse e shërbimit të ofruar;

e) kufizimeve që cenojnë përfituesit në kundërshtim me nenin 20 të këtij ligji.

4. Përdorimi nga ofruesi i infrastrukturës së përkohshme ose pajisjeve të nevojshme për ofrimin e shërbimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa krijuar bazë të qëndrueshme ekonomike, nuk konsiderohet vendosje.

5. Autoritetet kompetente, përjashtimisht, mund të vendosin kërkesa për ofruesit ndërkufitarë vetëm kur ato justifikohen për arsye të rendit publik,

sigurisë publike, shëndetit publik ose mbrojtjes së mjedisit dhe përputhen me parimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. Ky nen nuk pengon zbatimin e rregullave për kushtet e punës dhe marrëdhëniet e punës, përfshirë ato të përcaktuara në marrëveshje kolektive, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

6. Autoritetet kompetente në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre vlerësojnë legjislacionin sektorial ekzistues dhe projektaktet e reja që rregullojnë të drejtën për të ushtruar një veprimtari shërbimi dhe ushtrimin e saj, për të siguruar që çdo kërkesë që kufizon të drejtën për të ofruar shërbime në mënyrë të përkohshme të jetë në përputhje me parimet e pikës 2 dhe të jetë e justifikuar sipas pikës 5 të këtij neni.

Në rast se konstatohet mospërputhje, autoritetet kompetente marrin masa për përshtatjen ose shfuqizimin e dispozitave përkatëse.

Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë siguron përputhshmërinë e legjislacionit sektorial me këtë ligj dhe udhëzon autoritetet kompetente për zbatimin e parimeve të tij.

7. Autoritetet kompetente njoftojnë ministrinë për çdo projektakt ligjor, nënligjor ose administrativ sektorial, që parashikon kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, së bashku me arsyetimin përkatës që i justifikon ato në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

Ministria vlerëson përputhshmërinë e këtyre masave me këtë ligj dhe, nëse konstaton mospërputhje, rekomandon rishikimin ose shfuqizimin e tyre.

8. Ministria njofton Komisionin Evropian, sipas nenit 35 të këtij ligji, për çdo kërkesë ekzistuese apo të re, që kufizon lirinë për të ofruar shërbime në mënyrë të përkohshme, së bashku me arsyetimin përkatës për përputhshmërinë me pikat 2 dhe 5 të këtij neni.

9. Këshilli i Ministrave me vendim përcakton metodologjinë, afatet dhe formatet e vlerësimit të njoftimit të kërkesave në legjislacionin sektorial, që kufizojnë lirinë për të ofruar shërbime në mënyrë të përkohshme, sipas pikave 6 dhe 7 të këtij neni, kanalet e komunikimit, si dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.



Neni 13

Përrjashtimet nga liria për të ofruar shërbime ndërkufitare

1. Dispozitat e nenit 12 të këtij ligji nuk zbatohen për kategoritë e mëposhtme të shërbimeve dhe çështjeve:

a) shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik, që ofrohen në zbatim të një detyre të posaçme në interes publik, të përcaktuar me akt të posaçëm të autoritetit kompetent, në përputhje me legjislacionin sektorial përkatës dhe me të drejtën e Bashkimit Evropian. Këto përfshijnë veprimtari në fushën e:

i. shërbimeve postare;

ii. shërbimeve në sektorin e energjisë elektrike;

iii. shërbimeve në sektorin e gazit natyror;

iv. shërbimeve për shpërndarjen dhe furnizimin me ujë të pijshëm dhe shërbimeve të ujërave të ndotura;

v. shërbimeve për trajtimin e mbetjeve;

b) çështjet e rregulluara nga legjislacioni për transferimin e përkohshëm të punonjësve në kuadër të ofrimit të shërbimeve ndërkufitare në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian;

c) çështjet e rregulluara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë rregullat për përpunimin dhe transferimin ndërkufitar të të dhënave, në zbatim e në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian;

ç) çështjet e rregulluara nga legjislacioni për ofrimin e shërbimeve nga avokatët për të lehtësuar ushtrimin efektiv të lirisë e për të ofruar shërbime në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian;

d) veprimtarinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të detyrimeve;

dh) çështjet e rregulluara nga legjislacioni për njohjen e kualifikimeve profesionale në rastin e ofrimit të shërbimeve ndërkufitare, si edhe kërkesat që rezervojnë ushtrimin e një veprimtarie për profesione të rregulluara, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian;

e) çështjet e rregulluara nga legjislacioni për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit, të vetëpunësuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian;

ë) formalitetet administrative lidhur me lirinë e lëvizjes dhe qëndrimin në vend të shtetasve të Bashkimit Evropian dhe familjarëve të tyre, në

përputhje me legjislacionin përkatës dhe me të drejtën e Bashkimit Evropian;

f) kërkesat për vizë ose leje qëndrimi, si dhe detyrimi për paraqitje apo raportim pranë autoriteteve kompetente për shtetasit e vendeve të treta, jo shtetas të Bashkimit Evropian, që lëvizin në Republikën e Shqipërisë në kuadër të ofrimit të një shërbimi dhe që nuk mbulohen nga regjimi i njohjes së ndërsjellë sipas legjislacionit përkatës, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian të zonës Shengen;

g) çështjet e rregulluara nga legjislacioni përkatës për transportimin e mbetjeve, në zbatim të legjislacionit të Bashkimit Evropian për transportimin e mbetjeve brenda Bashkimit Evropian, në hyrje apo dalje të tij;

gj) të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e lidhura me to, përfshirë mbrojtjen ligjore të topografive të produkteve gjysmëpërçuese, mbrojtjen e bazave të të dhënave, si edhe të drejtat e pronësisë industriale, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe të drejtën e Bashkimit Evropian;

h) veprimet që me ligj kërkojnë përfshirjen e noterit;

i) çështjet e rregulluara nga legjislacioni për auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian;

j) regjistrimin e mjeteve rrugore të marra me qira në një shtet tjetër anëtar;

k) dispozitat për detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore, përfshirë formën e kontratave, të përcaktuara sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

2. Përrjashtimet e parashikuara në këtë nen interpretohen ngushtë. Ato nuk sjellin zbatim automatik të të gjithë kuadrit ligjor kombëtar për veprimtaritë ose shërbimet përkatëse. Çdo kërkesë që vendoset në fushat e përrjashtuara duhet të jetë e justifikuar, e përshtatshme dhe proporcionale me objektivin e ndjekur, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Neni 14

Përrjashtimet në raste individuale

1. Si përrjashtim nga neni 12 i këtij ligji dhe vetëm në rrethana të jashtëzakonshme e në raste individuale, autoriteti kompetent mund të marrë masa të përkohshme në lidhje me sigurinë e një



shërbimi të ofruar nga një ofrues i vendosur në një shtet anëtar.

2. Masat sipas pikës 1 të këtij neni mund të merren vetëm pasi të jetë ndjekur procedura e bashkëpunimit administrativ, e përcaktuar në nenin 32 të këtij ligji, dhe kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) dispozitat kombëtare, në përputhje me të cilat merret masa, nuk i janë nënshtruar harmonizimit në nivel të Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë së shërbimeve;

b) masat sigurojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje të përfituesve sesa ai që do të zbatohet nga shteti i vendosjes së ofruesit në përputhje me dispozitat e ligjit të tij;

c) shteti i vendosjes nuk ka marrë asnjë masë ose ka marrë masa që konsiderohen të pamjaftueshme për mbrojtjen e përfituesve;

ç) masat janë proporcionale, të përshtatshme për arritjen e objektivit të tyre dhe nuk shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për ta arritur atë.

3. Ky nen nuk cenon zbatimin e akteve të Bashkimit Evropian që garantojnë lirinë për të ofruar shërbime ose lejojnë përjashtime nga ushtrimi i saj, të cilat kanë përparësi ndaj këtij neni.

KREU IV

THJESHTIMI I PROCEDURAVE DHE PIKA E VETME E KONTAKTIT

Neni 15

Pika e Vetme e Kontaktit (PVK)

1. Pika e Vetme e Kontaktit (PVK) është një portal elektronik nëpërmjet të cilit ofruesit e shërbimeve kanë mundësi të përfundojnë të gjitha procedurat dhe formalitetet:

a) për fillimin e veprimtarisë së tyre lidhur me deklaratimet, njoftimet apo kërkesat e nevojshme për pajisje me skemë autorizimi nga autoritetet kompetente, përfshirë edhe aplikimin, regjistrimin në një regjistër, listë apo bazë të dhënash ose për regjistrimin pranë një organi apo organizate profesionale;

b) për çdo aplikim për pajisjen me autorizimin e nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së tij të shërbimit.

2. PVK-ja nuk cenon kompetencat dhe funksionet e autoriteteve kompetente për kryerjen e këtyre procedurave të parashikuara me ligj.

3. PVK-ja është portali “e-Albania” që zhvillohet, administrohet e mirëmbahet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Neni 16

E drejta për informim përmes PVK-së

1. Npërmjet PVK-së autoritetet kompetente sigurojnë që informacioni vijues të jetë lehtësisht i aksesueshëm për ofruesit dhe përfituesit e shërbimeve për:

a) kërkesat që zbatohen për ofruesit e vendosur në territorin e tyre, në veçanti ato që lidhen me procedurat dhe formalitetet që duhen plotësuar për fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit;

b) të dhënat e kontaktit të autoriteteve kompetente, që mundësojnë kontaktimin e drejtpërdrejtë të këtyre të fundit, duke përfshirë detajet e autoriteteve përgjegjëse për çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarive të shërbimit;

c) mjetet dhe kushtet për hyrjen në regjistrat publikë e në bazat e të dhënave për ofruesit dhe shërbimet;

ç) mjetet e ankimit në dispozicion në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve kompetente dhe ofruesit apo përfituesit të shërbimit, ndërmjet një ofruesi dhe një përfituesi apo ndërmjet ofruesve;

d) kontaktet e shoqatave apo organizatave, të ndryshme nga autoritetet kompetente, të cilat mund të ndihmojnë ofruesit apo përfituesit.

2. Informacioni dhe ndihma e parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm në mënyrë elektronike, i përditësuar, i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i formuluar në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, në gjuhën shqipe dhe angleze.

3. Ofruesit dhe përfituesit e shërbimeve kanë të drejtë të kërkojnë nga autoritetet kompetente ndihmë dhe informacion për mënyrën sesi kërkesat e përmendura në pikën 1 të këtij neni interpretohen dhe zbatohen zakonisht. Kur është e përshtatshme, informacioni përfshin udhëzues të thjeshtë hap pas hapi për përmbushjen e kërkesave dhe procedurave përkatëse.

4. Autoritetet kompetente duhet të përgjigjen sa më shpejt të jetë e mundur ndaj çdo kërkesë për informacion apo ndihmë, sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni, dhe, në rastet kur kjo kërkesë ka të meta



apo është e pabazuar, të informojnë kërkuuesin pa vonesë.

5. Detyrimi i autoriteteve kompetente për të ndihmuar ofruesit dhe përfituesit e shërbimeve nuk nënkupton ofrimin e këshillimit ligjor për çështje të caktuara, por vetëm dhënien e informacionit të përgjithshëm për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të kërkesave ligjore.

Neni 17

Thjeshtimi i procedurave dhe i formaliteteve administrative

1. Autoritetet kompetente shqyrtojnë procedurat dhe formalitetet e zbatueshme për hyrjen në një veprimtari shërbimi dhe ushtrimin e saj. Kur ato nuk janë mjaftueshëm të thjeshta, autoritetet i thjeshtojnë.

2. Kur sipas legjislacionit përkatës të Bashkimit Evropian miratohen formularë të harmonizuar, këta formularë janë të barasvlershëm me certifikatat, vërtetimet dhe çdo dokument tjetër që kërkohej nga ofruesi.

3. Kur kërkohej nga një ofrues ose përfitues paraqitja e një certifikate, vërtetimi ose dokumenti tjetër që dëshmon përmbushjen e një kërkesë, autoritetet kompetente pranojnë çdo dokument të lëshuar nga një shtet anëtar, që shërben për një qëllim të barasvlershëm ose nga i cili rezulton qartë se kërkesa përkatëse është përmbushur.

4. Autoritetet kompetente nuk kërkojnë paraqitjen e dokumenteve në origjinal, në kopje të certifikuara ose të shoqëruara me përkthim të certifikuar, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni i posaçëm, në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian ose kur një kërkesë e tillë justifikohet nga një arsye madhore që lidhet me interesin publik, përfshirë rendin dhe sigurinë publike.

Pa cenuar sa më sipër, autoritetet mund të kërkojnë përkthime jo të certifikuara në gjuhën shqipe.

5. Në rast dyshimi për vërtetësinë ose vlefshmërinë e një dokumenti të paraqitur, autoritetet kompetente verifikojnë informacionin pranë autoritetit përkatës të shtetit të lëshimit nëpërmjet mekanizmave të bashkëpunimit administrativ të parashikuar në këtë ligj, pa ngarkuar ofruesin me formalitete të panevojshme.

6. Pa cenuar legjislacionin e posaçëm, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian, pika

3 e këtij neni nuk zbatohet për dokumentet e rregulluara nga:

a) legjislacioni për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe deklaratimet paraprake për ushtrimin e përkohshëm të profesioneve të rregulluara;

b) legjislacioni për prokurimin publik, përfshirë dëshmitë mbi gjendjen personale dhe përshtatshmërinë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, si dhe standardet e cilësisë e të menaxhimit mjedisor;

c) legjislacioni për ushtrimin e profesionit të avokatit dhe regjistrimin pranë autoritetit kompetent në shtetin pritës;

ç) legjislacioni i së drejtës së shoqërive tregtare për regjistrimin, publikimin dhe dokumentet e shoqërive tregtare dhe të degëve të shoqërive të huaja.

7. Këshilli i Ministrave me vendim përcakton metodologjinë, procedurat, afatet dhe formatet e vlerësimit për thjeshtimin e procedurave dhe të formaliteteve, sipas pikës 1 të këtij neni, kanalet e komunikimit, si dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij.

Neni 18

Procedurat në mënyrë elektronike

1. Të gjitha procedurat dhe formalitetet që lidhen me aksesin në një veprimtari shërbimi apo ushtrimin e saj kryhen lehtësisht, në distancë dhe në mënyrë elektronike, duke respektuar standardet e përbashkëta të ndërveprueshmërisë, të miratuara në nivel të Bashkimit Evropian, nëpërmjet PVK-së dhe pranë autoriteteve kompetente përkatëse.

2. Rregullat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohen në rastin e inspektimit të ambienteve ku ofrohet shërbimi dhe të pajisjeve të përdorura për këtë qëllim apo për këqyrjen fizike të aftësive profesionale apo të integritetit personal të ofruesit ose të personelit të tij përgjegjës.



KREU V
TË DREJTAT E PËRFITUESVE DHE
CILËSIA E SHËRBIMEVE

SEKSIONI 1
TË DREJTAT E PËRFITUESVE TË
SHËRBIMEVE

Neni 19

Mosdiskriminimi i përfituesve

1. Autoritetet kompetente garantojnë që përfituesit e shërbimeve të mos i nënshtrohen asnjë kërkesë apo mase që krijon diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të bazuar në shtetësi ose në vendbanim.

2. Ofruesit e shërbimeve sigurojnë që kushtet e përgjithshme të aksesit në shërbimet e tyre, të bëra publike për publikun e gjerë, të mos përmbajnë dispozita diskriminuese në lidhje me shtetësinë ose vendbanimin e përfituesit.

Dallime në kushte lejohet të bëhen vetëm kur janë drejtpërdrejt të justifikuara nga kritere objektive, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.

3. Kriteret objektive, në kuptim të këtij neni, janë rrethana të verifikueshme që kanë lidhje të ngushtë me mënyrën ose vendin e ofrimit të shërbimit dhe që janë të domosdoshme për arritjen e një qëllimi të ligjshëm.

Rrethana të tilla mund të përfshijnë ndër të tjera:

a) kosto shtesë të justifikuar nga distanca, logjistika, ose karakteristikat teknike të ofrimit të shërbimit;

b) detyrime të përcaktuara me ligj në territorin ku ofrohet shërbimi, përfshirë kërkesat e sigurisë, cilësisë ose mbrojtjes së konsumatorit;

c) mungesën e të drejtave të nevojshme të pronësisë intelektuale në territorin përkatës;

ç) kushte objektive të tregut, përfshirë kërkesën sezonale, periudhat e pushimeve apo çmimet e konkurrentëve;

d) shpenzime shtesë për transport ose shpërndarje që ndikojnë ndjeshëm në çmimin përfundimtar.

4. Shtetësia ose vendbanimi i përfituesit nuk përbëjnë në asnjë rast kriter objektiv.

5. Refuzimi për të ofruar shërbimin, kufizimi i aksesit në ofertë apo vendosja e kushteve dukshëm më të pafavorshme vetëm për këto arsye

konsiderohen si diskriminim nëse ofruesi nuk provon ekzistencën e një justifikimi objektiv, të bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

6. Ofruesit e shërbimeve, që zbatojnë dallime në kushte sipas këtij neni, duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë bazën objektive dhe proporcionale të tyre me elemente të matshme dhe të verifikueshme. Autoritetet kompetente vlerësojnë justifikimin e këtyre dallimeve, rast pas rasti, në përputhje me këtë ligj dhe me të drejtën e Bashkimit Evropian.

7. Dispozitat e këtij neni zbatohen pa cenuar rregullat e posaçme të Bashkimit Evropian, përfshirë ato për bllokimin gjeografik dhe legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit, në masën që ato parashikojnë standarde më të larta të mosdiskriminimit.

Neni 20

Kufizimet e ndaluara ndaj përfituesve

1. Autoritetet kompetente nuk vendosin kërkesa apo masa që kufizojnë përdorimin e një shërbimi të ofruar nga një ofrues i vendosur në një shtet anëtar ose për shkak të vendit ku ofrohet shërbimi.

Këto ndalohen pavarësisht nëse shërbimi ofrohet në distancë, përkohësisht ose fizikisht në territorin e një shteti anëtar.

2. Ndalohet në veçanti:

a) çdo kërkesë për marrjen e një autorizimi paraprak ose për dorëzimin e një deklarate përpara përdorimit të shërbimit, kur ky autorizim ose deklarim kërkohet vetëm për shkak se ofruesi është i vendosur në një shtet anëtar;

b) çdo kufizim apo përjashtim diskriminues në dhënien e ndihmës ose mbështetjes financiare, kur ndihma kufizohet vetëm për shërbime të ofruara nga ofrues të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose që ofrohen brenda këtij territori.

3. Kufizimet e ndaluara përfshijnë çdo masë ose praktikë që edhe në mënyrë të tërthortë e bën më të vështirë përdorimin e shërbimeve të ofruara nga ofrues të tjerë të vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë:

a) detyrimin për të përdorur vetëm ofrues vendas;

b) parashikimin e procedurave shtesë të verifikimit apo të raportimit vetëm për shërbime të huaja;



c) kushtëzimin e ndihmave ekonomike, subvencioneve apo lehtësive tatimore vetëm për shërbime kombëtare;

ç) refuzimin e njohjes së kontratave ose dokumenteve të barasvlershme, të lëshuara në shtetet anëtare, kur nuk ekziston arsye e justifikuar nga interesi publik të mbrojtur nga e drejta e Bashkimit Evropian.

4. Për qëllimet e këtij neni, mbështetja financiare përfshin çdo formë ndihme publike, që lidhet drejtpërdrejt me përdorimin e një shërbimi të caktuar, përfshirë subvencione, bonuse, kupona ose lehtësime fiskale.

Skemat e përgjithshme të mbështetjes, që nuk lidhen me përdorimin e një shërbimi të caktuar, nuk përfshihen në fushën e këtij neni.

5. Ky nen zbatohet pa cenuar rregullat e posaçme të legjislacionit kombëtar apo të Bashkimit Evropian, që parashikojnë trajtim më të favorshëm ose standarde më të larta për mbrojtjen e përfituesve.

Neni 21

Asistenca për përfituesit

1. Përfituesit kanë të drejtë të marrin në territorin e Republikës së Shqipërisë informacion të përgjithshëm për:

a) kërkesat e zbatueshme në shtetet anëtare për aksesin dhe ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve, veçanërisht ato për mbrojtjen e konsumatorëve;

b) mjetet e ankimit në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përfituesit;

c) të dhënat e kontaktit të shoqatave ose organizatave, përfshirë qendrat e Rrjetit Evropian të Qendrave të Konsumatorit (ECC-Net), prej të cilave mund të merret ndihmë praktike.

2. Informacioni dhe asistenca jepen në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të paanshme, janë lehtësisht të aksesueshme në distancë edhe me mjete elektronike dhe mbahen të përditësuara. Kur është e përshtatshme, autoritetet kompetente vënë në dispozicion udhëzues të thjeshtë hap pas hapi.

3. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim organet përgjegjëse për dhënien e informacionit dhe asistencës sipas këtij neni, përfshirë, sipas rastit, Pikën e Vetme të Kontaktit, qendrat e konsumatorëve, shoqatat përkatëse ose struktura të tjera, si dhe masat praktike dhe mekanizmat teknikë për zbatimin e tij, duke siguruar ndërveprueshmëri

të sistemeve të informacionit dhe përafrim me standardet e përbashkëta evropiane.

Emrat dhe kontaktet e këtyre organeve i komunikohen Komisionit Evropian në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

4. Organi i kontaktuar nga përfituesi, sipas nevojës, kontakton organin përkatës të shtetit anëtar të interesuar dhe i përcjell përfituesit, sa më shpejt të jetë e mundur, informacionin e marrë.

Autoritetet kompetente sigurojnë ndihmë të ndërsjellë dhe bashkëpunim efektiv me autoritetet e shteteve anëtare dhe me Komisionin Evropian në përputhje me parimin e ndihmës së ndërsjellë.

5. Dhënia e asistencës sipas këtij neni nuk përfshin ofrimin e këshillimit juridik individual, por vetëm informacion të përgjithshëm për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të kërkesave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve.

SEKSIONI 2

CILËSIA, TRANSPARENCA DHE SJELLJA PROFESIONALE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Neni 22

Informacion për ofruesit dhe shërbimet e tyre

1. Ofruesit e shërbimeve duhet të vënë në dispozicion të përfituesve, në mënyrë të qartë dhe transparente, informacionin si më poshtë:

a) emrin, statusin dhe formën juridike të ofruesit, adresën gjeografike të vendosjes, ku të jenë përcaktuar edhe të dhëna për kontaktim të shpejtë e komunikim të drejtpërdrejtë, sipas rastit, edhe në mënyrë elektronike, përfshirë adresën e postës elektronike dhe/ose faqen e internetit;

b) të dhënat e regjistrimit në regjistrin tregtar ose në një regjistër publik të ngjashëm në shtetin e vendosjes, duke përfshirë emrin e regjistrit dhe numrin e regjistrimit ose një mjet tjetër ekuivalent identifikimi në atë regjistër;

c) në rastin kur veprimtaria është objekt i një skeme autorizimi, të dhëna për autoritetin kompetent për këtë qëllim apo PVK-në;

ç) kur veprimtaria i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar, numrin e identifikimit për efekt tatimi mbi vlerën e shtuar sipas legjislacionit të



zbatueshëm e në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian;

d) në rastin e profesioneve të rregulluara, organin profesional apo ndonjë institucion të ngjashëm, ku ofruesi është regjistruar, titullin profesional dhe vendin ku e ka fituar këtë titull;

dh) kushtet dhe klauzolat e përgjithshme të kontratës, nëse ka, që përdor ofruesi;

e) klauzolat kontraktore, nëse ka, të përdorura nga ofruesi në lidhje me ligjin e zbatueshëm dhe/ose gjykatat kompetente;

ë) garancitë pas shitjes, nëse ka, të ndryshme nga garancitë e detyrueshme të parashikuara në këtë ligj;

f) çmimin e shërbimit kur për një shërbim të caktuar është paracaktuar një çmim nga ofruesi;

g) karakteristikat kryesore të shërbimit, nëse nuk janë të qarta nga konteksti;

gj) sigurimin ose garancitë e përgjegjësisë profesionale, kur zbatohen, duke përfshirë të dhënat e kontaktit të siguresit ose të garantuesit dhe mbulimin territorial të tyre.

2. Informacioni i parashikuar në pikën 1 të këtij neni duhet të sigurohet nga ofruesi sipas zgjedhjes së tij në një nga këto mënyra:

a) të jepet nga ofruesi me nismën e vet;

b) t'i vihet në dispozicion përfituesit në vendin e ofrimit të shërbimit apo ku lidhet kontrata;

c) t'i vihet në dispozicion përfituesit në mënyrë elektronike lehtësisht të aksesueshme nëpërmjet një adrese të vendosur nga ofruesi;

ç) të përfshihet në dokumentet informuese, ku jepet një përshkrim i detajuar i shërbimit që ofrohet dhe që i jepet përfituesit nga ofruesi.

Komunikimet tregtare të përgjithshme, përfshirë reklamën, njoftimet promovuese apo materiale të ngjashme nuk konsiderohen dokumente informuese në kuptim të shkronjës “ç” të kësaj pike.

3. Me kërkesë të përfituesve, ofruesit duhet të paraqesin informacionin e mëposhtëm shtesë:

a) çmimin në rastet kur për një shërbim të caktuar ky nuk është paracaktuar, ose, kur një çmim i saktë nuk mund të jepet, mënyrën e përlogaritjes së tij apo një vlerë të përafërt të detajuar në mënyrë të mjaftueshme;

b) rregullat profesionale të zbatueshme në shtetin e vendosjes sa u takon profesioneve të rregulluara dhe mënyrën se si aksesohen ato;

c) informacion për veprimtaritë shumë-disiplinore apo partneritetet, të cilat lidhen në

mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimin e ofruar dhe masat e marra për të shmangur konfliktin e interesit. Ky informacion duhet të përfshihet në çdo dokument informues, ku ofruesi jep një përshkrim të detajuar të shërbimit të tij;

ç) kodin e sjelljes mbi të cilin mbështetet ofruesi, si dhe adresën në të cilën këto kode mund të konsultohen në mënyrë elektronike me treguesin e versioneve gjuhësore të mundshme, nëse ka;

d) në rastet kur ofruesi është anëtar i ndonjë shoqate apo organizate profesionale, që ofron mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore, ofruesi duhet të specifikojë karakteristikat dhe kushtet e zbatimit të saj.

4. Informacioni i parashikuar në këtë nen:

a) u vihet në dispozicion përfituesve në kohë të mjaftueshme, përpara nënshkrimit të kontratës apo, në mungesë të një kontrate të shkruar, përpara ofrimit të shërbimit;

b) jepet dhe komunikohet në mënyrë të qartë dhe transparente;

c) plotëson kërkesat për informacion, të parashikuara në legjislacionin kombëtar përkatës, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe nuk pengon vendosjen e kërkesave shtesë për informacion ndaj ofruesve të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 23

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe garancitë

1. Për shërbimet që paraqesin rrezik të posaçëm dhe të drejtpërdrejtë, që rrjedh nga vetë ofrimi i shërbimit për shëndetin ose sigurinë e përfituesit të shërbimit ose të një pale të tretë, me qëllim parandalimin e vdekjes ose të dëmtimit të rëndë fizik ose për sigurinë financiare të përfituesit, me qëllim parandalimin e humbjeve të konsiderueshme monetare ose të rënies së vlerës së pasurisë së tij, autoriteti kompetent mund të kërkojë që ofruesi të lidhë dhe të mbajë të vlefshëm sigurimin e përgjegjësisë profesionale, që mbulon detyrimet e mundshme ndaj përfituesve të shërbimit dhe, sipas rastit, ndaj palëve të treta, që rrjedhin nga ofrimi i shërbimit, ose të ofrojë garanci ose mjet tjetër sigurimi, që është ekuivalent ose në thelb i krahasueshëm për nga qëllimi.



Sigurimi ose garancia duhet të jetë e përshtatur me natyrën dhe përmasën e rrezikut që synon të mbulojë.

2. Kur ofruesi vendoset në territorin e Republikës së Shqipërisë, autoriteti kompetent nuk kërkon sigurim ose garanci shtesë nëse ofruesi është tashmë i mbuluar në shtetin ku është vendosur nga një sigurim ose garanci që është ekuivalente ose në thelb e krahasueshme për nga qëllimi, rreziku i mbuluar, shuma e siguruar ose kufiri i garancisë, territori i mbulimit dhe përjashtimet nga mbulimi, përfshirë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në rast përputhshmërie të pjesshme, autoriteti kompetent mund të kërkojë mbulim shtesë vetëm për pjesët që nuk janë të mbuluara.

3. Dëshmia e mbulimit nga një kontratë sigurimi ose garancie, e lëshuar nga institucione krediti ose shoqëri sigurimi të vendosura në një shtet anëtar, pranohet si provë e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve sipas këtij neni.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen pa cenuar rregullimet për sigurimin ose garancitë profesionale të përcaktuara në legjislacionin e posaçëm në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

5. Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë mund të përcaktojë me udhëzim sektorët dhe veprimtaritë që konsiderohen me rrezik të posaçëm për qëllimet e këtij neni, kriteret minimale të mbulimit dhe kushtet e barasvlershmërisë së sigurimeve apo garancive.

6. Autoritetet kompetente, në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre, vlerësojnë legjislacionin sektorial ekzistues dhe projektaktet e reja që parashikojnë kërkesën për sigurim të përgjegjësive profesionale ose garanci ekuivalente, për të siguruar që çdo kriter i parashikuar të jetë në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë, si dhe me këtë ligj.

Në rast se konstatohet mospërputhje, autoritetet kompetente marrin masa për përshtatjen ose shfuqizimin e dispozitave përkatëse.

7. Autoritetet kompetente njoftojnë ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë për çdo projektakt ligjor, nënligjor ose administrativ sektorial, që parashikon kërkesën për sigurim ose garanci sipas këtij neni, duke paraqitur arsyetimin që justifikon domosdoshmërinë, proporcionalitetin dhe qëllimin e masës.

Ministria vlerëson përputhshmërinë e këtyre masave me këtë ligj dhe, sipas rastit, rekomandon mosmiratimin, rishikimin ose shfuqizimin e tyre.

8. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim metodologjinë, procedurat, afatet dhe formatet e vlerësimit dhe të njoftimit të legjislacionit sektorial, që përmban kërkesat e parashikuara në këtë nen, si dhe kanalet e komunikimit dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre, në kuadër të sistemit kombëtar të shqyrtimit dhe njoftimit të masave rregullatore për shërbimet.

Neni 24

Komunikimet tregtare nga profesionet e rregulluara

1. Ndalimet e përgjithshme dhe absolute të komunikimeve tregtare nga profesionet e rregulluara nuk lejohen pavarësisht nëse parashikohen me ligj ose nga rregullat e organeve profesionale përkatëse. Komunikimet tregtare nga profesionet e rregulluara duhet të jenë në përputhje me rregullat profesionale që lidhen sidomos me pavarësinë, dinjitetin, integritetin e profesionit dhe me sekretin profesional, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe duke marrë parasysh natyrën specifike të profesionit përkatës.

2. Rregullat profesionale për komunikimet tregtare duhet të jenë jodiskriminuese, të justifikuara nga arsye madhore që lidhen me interesin publik dhe proporcionale me qëllimin e ndjekur.

3. Autoritetet kompetente sigurojnë që legjislacioni dhe rregullat e organeve ose organizatave profesionale të jenë në përputhje me këtë nen.

4. Autoritetet kompetente në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre vlerësojnë legjislacionin sektorial ekzistues dhe projektaktet e reja që rregullojnë komunikimet tregtare të profesionistëve të rregulluar për të siguruar që çdo kufizim i parashikuar të jetë në përputhje me parimet e jodiskriminimit, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, si dhe me këtë ligj.

Në rast se konstatohet mospërputhje, autoritetet kompetente marrin masa për përshtatjen ose shfuqizimin e dispozitave përkatëse.

5. Autoritetet kompetente njoftojnë ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë për çdo projektakt ligjor, nënligjor ose administrativ sektorial, si dhe për çdo rregull profesional që



parashikon kufizime për komunikimet tregtare të profesionistëve të rregulluar, duke bashkëngjitur arsyetimin përkatës për domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave.

Ministria vlerëson përputhshmërinë e këtyre masave me këtë ligj dhe, sipas rastit, rekomandon mosmiratimin, rishikimin ose shfuqizimin e tyre.

6. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim metodologjinë, procedurat, afatet dhe formatet e vlerësimit e të njoftimit të legjislacionit sektorial dhe të rregullave profesionale që lidhen me komunikimet tregtare, kanalet e komunikimit dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre, në kuadër të sistemit kombëtar të shqyrtimit e të njoftimit të masave rregullatore për shërbimet.

Neni 25

Veprimtaritë shumëdisiplinore

1. Ofruesit nuk u nënshtrohen kërkesave që i detyrojnë ata të ushtrojnë ekskluzivisht një veprimtari të caktuar ose që kufizojnë ushtrimin e përbashkët apo në partneritet të veprimtarive të ndryshme.

Përbashkësisht, mund të vendosen kërkesa të tilla për:

a) profesionet e rregulluara, për aq sa është e justifikuar për të garantuar respektimin e rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale, që ndryshojnë sipas natyrës specifike të çdo profesioni dhe për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e ushtrimit të tyre;

b) ofruesit e shërbimeve të certifikimit, akreditimit, mbikëqyrjes teknike, testimit ose provës, për aq sa është e justifikuar për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.

2. Kur lejohet ushtrimi i aktiviteteve shumëdisiplinore ndërmjet ofruesve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të sigurohet:

a) parandalimi i konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ndërmjet veprimtarive;

b) ruajtja e pavarësisë dhe paanshmërisë për veprimtaritë përkatëse;

c) pajtueshmëria e ndërsjellë e rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale për veprimtari të ndryshme, veçanërisht në lidhje me ruajtjen e sekretit profesional.

3. Autoritetet kompetente sigurojnë që legjislacioni sektorial ekzistues dhe projektaktet e reja, që rregullojnë veprimtaritë shumëdisiplinore, të

jenë në përputhje me parimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Autoritetet kompetente, në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre, vlerësojnë legjislacionin sektorial ekzistues dhe projektaktet e reja që parashikojnë kufizime të veprimtarive shumëdisiplinore, për të siguruar që çdo kërkesë e tillë të jetë në përputhje me parimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Në rast se konstatohet mospërputhje, autoritetet kompetente marrin masa për përshtatjen ose shfuqizimin e dispozitave përkatëse.

5. Autoritetet kompetente njoftojnë ministrin e përgjegjës për ekonominë dhe tregtinë për çdo projektakt ligjor, nënligjor ose administrativ sektorial, që parashikon kufizime për ushtrimin e veprimtarive shumëdisiplinore, duke bashkëngjitur arsyetimin përkatës mbi domosdoshmërinë, proporcionalitetin dhe qëllimin e masës, në përputhje me parimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Ministria vlerëson përputhshmërinë e këtyre masave me këtë ligj dhe, sipas rastit, rekomandon mosmiratimin, rishikimin ose shfuqizimin e tyre.

6. Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë njofton Komisionin Evropian, në përputhje me nenin 35 të këtij ligji, për çdo kërkesë ekzistuese apo të re që kufizon ushtrimin e përbashkët të veprimtarive shumëdisiplinore, duke përfshirë informacion për përmbajtjen e kërkesës dhe arsyet e justifikimit të saj.

7. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim metodologjinë, procedurat, afatet dhe formatet e vlerësimit e të njoftimit të kërkesave në legjislacionin sektorial, që kufizojnë ushtrimin e veprimtarive shumëdisiplinore, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, kanalet e komunikimit, si dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Neni 26

Politikat për cilësinë e shërbimeve dhe kodet sjelljes

1. Autoritetet kompetente, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, marrin masa shoqëruese për të nxitur ofruesit e shërbimeve që në mënyrë vullnetare të ndërmarrin veprime për të siguruar cilësinë e ofrimit të shërbimeve, veçanërisht përmes:

a) certifikimit ose vlerësimit të veprimtarisë së tyre nga organe të pavarura ose të akredituara;



b) hartimit të kartave të cilësisë ose pjesëmarrjes në to apo në etiketa cilësie të hartuara nga organizata profesionale në nivel kombëtar ose evropian.

2. Autoritetet kompetente sigurojnë që informacioni mbi domethënien e etiketave të cilësisë dhe kriteret për vendosjen e tyre apo të çdo treguesi tjetër cilësie lidhur me shërbimet të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga ofruesit dhe përfituesit.

3. Autoritetet kompetente në bashkëpunim me Komisionin Evropian nxisin organizatat profesionale, dhomat e tregtisë, shoqatat e zejeve dhe ato të konsumatorëve, brenda territorit të tyre, që të bashkëpunojnë në nivel kombëtar dhe evropian për promovimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve, veçanërisht duke lehtësuar vlerësimin e aftësive të ofruesit.

4. Autoritetet kompetente në bashkëpunim me Komisionin Evropian marrin masa për të nxitur zhvillimin e vlerësimeve të pavarura, veçanërisht nga shoqatat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë dhe defektet në ofrimin e shërbimeve dhe, në veçanti, për zhvillimin e testeve të provave krahasuese në nivel Bashkimi Evropian dhe komunikimin e rezultateve përkatëse.

5. Autoritetet kompetente në bashkëpunim me Komisionin Evropian nxisin zhvillimin e standardeve vullnetare evropiane me qëllim lehtësimin e përputhshmërisë së shërbimeve të ofruara nga ofruesit në Republikën e Shqipërisë dhe ofruesve në shtete të ndryshme anëtare të informacionit për përfituesin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit.

6. Autoritetet kompetente në bashkëpunim me Komisionin Evropian marrin masa për të nxitur hartimin në nivel të Bashkimit Evropian, veçanërisht nga organet, shoqatat dhe organizatat profesionale, të kodeve të sjelljes që synojnë lehtësimin e ofrimit të shërbimeve ose të vendosjes së ofruesve në një shtet anëtar në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

7. Autoritetet kompetente sigurojnë akses në distancë, me mjete elektronike, në kodet e sjelljes, të përmendura në pikën 6 të këtij neni, përmes PVK-së dhe/ose faqeve zyrtare të autoriteteve kompetente, duke publikuar, sipas rastit, lidhje elektronike drejt burimeve përkatëse në nivel të Bashkimit Evropian dhe informacion shpjegues për fushëveprimin e tyre.

8. Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë mund të nxjerrë udhëzues për cilësinë e shërbimeve dhe kodet e sjelljes, me qëllim orientimin

e autoriteteve kompetente, organizatave profesionale dhe ofruesve të shërbimeve në zbatimin e praktikave të mira për sigurimin e cilësisë, transparencën dhe mbrojtjen e përfituesve të shërbimeve.

Udhëzuesit mund të përcaktojnë:

a) parimet dhe standardet orientuese për hartimin dhe zbatimin e kodeve të sjelljes;

b) kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe të informimit të përfituesve;

c) formatet dhe mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente, organizatave profesionale dhe palëve të interesuara për promovimin e cilësisë së shërbimeve.

Neni 27

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Autoritetet kompetente sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të vendosin në dispozicion të përfituesve, përfshirë atyre me vendbanim në një shtet anëtar, të dhëna të plota kontakti, duke përfshirë adresën postare, numrin e telefonit, adresën elektronike dhe, sipas rastit, numrin e faksit, ku mund të dërgohen ankesa ose kërkesa për informacion për shërbimin e ofruar.

Ofruesi deklaron adresën e tij të regjistruar ligjërisht, nëse kjo ndryshon nga adresa e zakonshme e korrespondencës.

Ofruesit duhet të përgjigjen ndaj ankesave në kohën më të shkurtër të mundshme dhe të bëjnë përpjekjet maksimale për të arritur një zgjidhje të kënaqshme.

2. Autoritetet kompetente sigurojnë që ofruesit të dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve në lidhje me dhënien e informacionit të përcaktuar në këtë ligj dhe të garantojnë saktësinë e informacionit të dhënë.

3. Kur kërkohet një garanci financiare për zbatimin e një vendimi gjyqësor, garancitë ekuivalente të dhëna nga institucione financiare ose shoqëri sigurimi të vendosura dhe të autorizuar përkatësisht në një shtet anëtar, pranohen si të vlefshme dhe të mjaftueshme në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

4. Autoritetet kompetente sigurojnë që ofruesit që i nënshtrohen një kodi etik ose që janë anëtarë të një shoqate tregtare apo organizate profesionale që ofron mekanizma jashtëgjyqësorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të informojnë përfituesit për



ekzistencën e këtyre mekanizmave dhe të tregojnë qartë mënyrën e aksesit dhe përdorimit të tyre.

KREU VI

BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Neni 28

Ndihma e ndërsjellë dhe bashkëpunimi administrativ me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Komisionin Evropian

1. Autoritetet kompetente japin ndihmë të ndërsjellë dhe ndërmarrin masa për bashkëpunim efektiv me autoritetet kompetente të shteteve anëtare dhe me Komisionin Evropian për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve dhe të shërbimeve që ata ofrojnë në përputhje me këtë ligj.

2. Bashkëpunimi zhvillohet përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI), sipas rregullores (BE) nr. 1024/2012, dhe, kur është e përshtatshme, përmes mjeteve të tjera elektronike të sigurta të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3. Për qëllimet e këtij kreu, autoritetet kompetente vendosin pika kontakti. Të dhënat e kontaktit të këtyre pikave u komunikohen shteteve anëtare dhe Komisionit Evropian dhe përditësohen pa vonesë.

4. Kërkesat për informacion për realizimin e kontrolleve, inspektimeve dhe hetimeve në bazë të këtij kreu duhet të jenë të motivuara, duke specifikuar arsyen e kërkesës dhe, sipas rastit, bazën ligjore të saj. Informacioni i shkëmbyer përdoret vetëm në lidhje me çështjen për të cilën kërkohet dhe trajtohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Kur autoritetet kompetente marrin kërkesë për asistencë nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar, ato sigurojnë që ofruesit e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë t'u vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Në rast vështirësish për përmbushjen e kërkesës për informacion apo për kryerjen e kontrolleve, inspektimeve ose hetimeve, autoriteti kompetent përgjegjës informon pa vonesë autoritetin kompetent kërkues me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët.

Në të tilla raste pikat e kontaktit lehtësojnë komunikimin ndërmjet autoriteteve kompetente përkatëse.

7. Informacioni i kërkuar u dërgohet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare ose Komisionit Evropian me mjete elektronike brenda afatit më të shkurtër të mundur përmes sistemit IMI ose mjeteve të tjera elektronike të sigurta.

8. Autoritetet kompetente sigurojnë që regjistrat, ku janë regjistruar ofruesit, të cilët mund të konsultohen nga autoritetet kompetente në territorin e Republikës së Shqipërisë, të jenë të aksesueshëm, me të njëjtat kushte, edhe për autoritetet kompetente homologe të shteteve anëtare.

9. Autoritetet kompetente informojnë Komisionin Evropian për çdo rast kur një shtet anëtar nuk përmbush detyrimet e tij për ndihmë të ndërsjellë dhe bashkëpunim administrativ.

Neni 29

Ndihma e ndërsjellë dhe detyrimet e përgjithshme për ofruesit e vendosur në Republikën e Shqipërisë

1. Për ofruesit e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët ofrojnë shërbime në një shtet anëtar, autoritetet kompetente japin, me kërkesë të autoriteteve kompetente të atij shteti, informacionin e nevojshëm, përfshirë konfirmimin nëse ofruesi është i vendosur në territorin shqiptar dhe, sipas njohurive të tyre, informacion për ligjshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë.

2. Autoritetet kompetente ndërmarrin kontrollet, inspektimet dhe hetimet e kërkuara nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare dhe i informojnë ato për rezultatet dhe, sipas rastit, për masat e marra brenda kompetencave të tyre ligjore.

Në ushtrimin e këtyre detyrave, autoritetet kompetente veprojnë në përputhje me kompetencat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe vendosin për masat më të përshtatshme në çdo rast individual për të përmbushur kërkesën e shtetit anëtar kërkues.

3. Kur autoritetet kompetente marrin dijeni për sjellje ose veprime specifike të një ofruesi të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili ofron shërbime në shtete anëtare, që mund të shkaktojnë dëm serioz për shëndetin ose sigurinë e personave apo për mjedisin, ato informojnë menjëherë të gjitha shtetet anëtare dhe Komisionin Evropian.



Neni 30

Mbikëqyrja nga autoritetet kompetente në rastin kur ofruesi i vendosur në Republikën e Shqipërisë ushtron përkohësisht veprimtarinë në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian

1. Autoritetet kompetente mbikëqyrin respektimin e kërkesave të këtij ligji nga ofruesit e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kompetencave të tyre.

2. Autoritetet kompetente nuk përjashtojnë marrjen e masave mbikëqyrëse, inspektuese ose administrative në territorin e Republikës së Shqipërisë për shkak se shërbimi është ofruar ose ka shkaktuar pasoja në një shtet anëtar, ku ofruesi i vendosur në Republikën e Shqipërisë ushtron përkohësisht veprimtarinë.

3. Autoritetet kompetente nuk kryejnë kontrolle apo verifikime faktike në territorin e shtetit anëtar ku ofrohet shërbimi. Këto kontrolle dhe verifikime kryhen nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës, me kërkesë të autoriteteve kompetente shqiptare, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji.

4. Në përputhje me kërkesat për bashkëpunim administrativ sipas këtij kreu, kur autoritetet kompetente të një shteti anëtar në të cilin ofruesi i vendosur në Republikën e Shqipërisë ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të përkohshme kërkojnë ndërmarrjen e masave të përkohshme në lidhje me sigurinë e shërbimit të ofruar, në rrethana të jashtëzakonshme e në raste individuale, autoritetet kompetente shqiptare verifikojnë sa më shpejt të jetë e mundur ligjshmërinë e veprimtarisë së ofruesit dhe faktet që qëndrojnë në bazë të kërkesës, si dhe informojnë pa vonesë autoritetin kërkuar për masat e marra ose të parashikuara, ose, sipas rastit, për arsyet e mosmarrjes së tyre.

Neni 31

Mbikëqyrja nga autoritetet kompetente në rastin e ushtrimit të përkohshëm të veprimtarisë nga ofruesit e shërbimeve të vendosur në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian

1. Autoritetet kompetente mbikëqyrin veprimtarinë e ofruesve që ushtrojnë përkohësisht veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë

në lidhje me kërkesat kombëtare të lejuara sipas neneve 12 dhe 13 të këtij ligji.

Në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, autoritetet kompetente:

a) marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ofruesit të respektojnë këto kërkesa lidhur me hyrjen në veprimtarinë e shërbimit dhe ushtrimin e saj;

b) kryejnë kontrollet, inspektimet dhe hetimet e nevojshme për mbikëqyrjen e shërbimeve të ofruara.

2. Për kërkesa të tjera, kur një ofrues i vendosur në një shtet anëtar ushtron përkohësisht veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, autoritetet kompetente marrin pjesë në mbikëqyrjen e tij në përputhje me pikat 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Me kërkesë të autoriteteve kompetente të shtetit të vendosjes së ofruesit, autoritetet kompetente kryejnë kontrollet, inspektimet dhe hetimet e nevojshme për të siguruar mbikëqyrjen efektive nga autoritetet e shtetit të vendosjes. Në këtë kuadër, autoritetet kompetente veprojnë në përputhje me kompetencat që u njeh legjislacioni në fuqi dhe vendosin masat më të përshtatshme për çdo rast individual.

4. Autoritetet kompetente, me nismën e tyre, mund të kryejnë kontrolle, inspektime dhe hetime në terren për ofruesit që ushtrojnë përkohësisht veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që këto masa të mos jenë diskriminuese, të mos jenë të motivuara nga fakti që ofruesi është i vendosur në një shtet anëtar dhe të jenë proporcionale.

Neni 32

Ndihma e ndërsjellë në rast të përjashtimeve individuale

1. Kur autoriteti kompetent synon të marrë një masë të përkohshme ndaj një ofruesi të vendosur në një shtet anëtar, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji, zbatohen procedurat e përcaktuara në këtë nen, pa cenuar procedurat gjyqësore, përfshirë procedurat paraprake, si dhe veprimet e ndërmarra në kuadër të një hetimi penal.

2. Përpara marrjes së çdo mase sipas nenit 14 të këtij ligji, autoriteti kompetent i kërkon autoritetit kompetent të shtetit të vendosjes të ndërmarrë masat përkatëse ndaj ofruesit, duke i vënë në



dispozicion të gjitha informacionet përkatëse për shërbimin dhe rrethanat e çështjes.

3. Pasi autoriteti kompetent të ketë marrë përgjigjen e autoritetit kompetent të shtetit të vendosjes, nëse vijon të synojë marrjen e masave sipas nenit 14 të këtij ligji, ai njofton menjëherë Komisionin Evropian dhe autoritetin kompetent të shtetit të vendosjes, duke specifikuar:

a) arsyet pse masat e marra ose të parashikuara nga shteti i vendosjes konsiderohen të pamjaftueshme;

b) arsyet pse masat e synuara përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji.

4. Masat sipas nenit 14 të këtij ligji nuk mund të ndërmerren para përfundimit të një periudhe prej pesëmbëdhjetë ditësh punë nga data e njoftimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Në rast urgjence, autoriteti kompetent mund të shmangë zbatimin e pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni. Në këto raste, masa u njoftohet menjëherë Komisionit Evropian dhe autoritetit kompetent të shtetit të vendosjes, duke përfshirë arsyet e urgjencës dhe rrethanat që e justifikojnë ndërhyrjen, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

6. Zbatimi i këtij neni bëhet në përputhje me parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe bashkëpunimit në mirëbesim, si dhe pa cenuar kompetencat e Komisionit Evropian për të vlerësuar pajtueshmërinë e masave me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Neni 33

Mekanizmi i paralajmërimit

1. Kur një autoritet kompetent vihet në dijeni të akteve ose rrethanave të lidhura me një veprimtari shërbimi, që mund të shkaktojnë dëm të rëndë për shëndetin, sigurinë e personave ose mjedisin në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në territorin e një ose më shumë shteteve anëtare, ai njofton, brenda afatit më të shkurtër të mundur, autoritetet kompetente të shtetit të vendosjes, shtetet anëtare përkatëse dhe Komisionin Evropian.

2. Autoritetet kompetente marrin pjesë në rrjetin evropian të autoriteteve të shteteve anëtare, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, për zbatimin e mekanizmit të paralajmërimit sipas pikës 1 të këtij neni, në përputhje me rregullat e hollësishme për menaxhimin e rrjetit, të përcaktuara nga Komisioni Evropian.

Neni 34

Informacion për reputacionin e ofruesve të shërbimeve

1. Me kërkesë të arsyetuar të një autoriteti kompetent të një shteti anëtar, autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi, japin informacion për masat disiplinore ose administrative, sanksionet penale, si dhe vendimet për paaftësi paguese ose falimentim që përfshin mashtrimin, të marra ndaj një ofruesi, kur këto masa janë drejtpërdrejt të rëndësishme për aftësinë ose besueshmërinë e tij profesionale.

Autoriteti kompetent që jep informacionin njofton edhe ofruesin për informacionin e përcjellë.

2. Sanksionet dhe masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni komunikohen vetëm kur është marrë një vendim përfundimtar.

Për vendimet e tjera të zbatueshme të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kompetent që jep informacionin specifikon nëse vendimi është përfundimtar apo ndaj tij është paraqitur ankimi. Në rast ankimi, autoriteti kompetent njofton se çështja është ende objekt ankimi.

3. Autoriteti kompetent specifikon dispozitat e legjislacionit kombëtar mbi bazën e të cilave ofruesi është shpallur fajtor ose është sanksionuar.

4. Zbatimi i pikave 1 dhe 2 të këtij neni kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me të drejtat e garantuara për personat e shpallur fajtorë ose të sanksionuar në Republikën e Shqipërisë, përfshirë nga organet profesionale.

Kur informacioni është publik, ai vihet në dispozicion të konsumatorëve.

Neni 35

Raportimi, njoftimi dhe vlerësimi i përbashkët me Komisionin Evropian

1. Ministria përgjegjëse në bashkëpunim me autoritetet kompetente në nivel qendror, vendor dhe rregullator harton dhe paraqet në Komisionin Evropian raporte dhe njoftime për këto çështje:

a) skemat e identifikuar të autorizimit sipas nenit 5 të këtij ligji;

b) kërkesat që duhet të vlerësohen, sipas nenit 7 të këtij ligji, pa cenuar parashikimet e pikës 6 të nenit 7 të këtij ligji;



c) kufizimet mbi aktivitetet shumëdisiplinore, sipas pikës 6 të nenit 25 të këtij ligji;

ç) kërkesat që kufizojnë ofrimin e shërbimeve ndërkufitare, sipas pikave 2 dhe 5 të nenit 12 të këtij ligji;

d) emrat dhe kontaktet e organeve përgjegjëse për dhënien e informacionit dhe asistencës, sipas nenit 21 të këtij ligji.

2. Raportet dhe njoftimet përmbajnë informacion që dëshmon:

a) mosdiskriminimin e masave të vendosura;

b) ekzistencën e arsyes madhore të interesit publik që justifikon masën;

c) proporcionalitetin e masës dhe shqyrtimin e alternativave më pak kufizuese.

3. Për kërkesat që bien në fushën e nenit 12 të këtij ligji justifikimi bazohet vetëm në një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme:

a) rendi publik;

b) siguria publike;

c) shëndeti publik;

ç) mbrojtja e mjedisit.

4. Njoftimet dhe raportet përgatiten dhe paraqiten në momentin para miratimit të masës së re, sa herë kjo është e mundur.

5. Raportet dhe njoftimet përcillen përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI) ose, sipas rastit, përmes Sistemit të Transparencës për Informacionin mbi Rregullat Teknike dhe Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit (TRIS), në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian përkatës.

6. Njoftimet e paraqitura përmes sistemit TRIS konsiderohen të barasvlershme me njoftimet përmes sistemit IMI, nëse përmbajtja dhe informacioni i raportuar janë të njëjtë dhe të aksesueshëm nga Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare.

7. Ministria koordinon dhënien e përgjigjeve ndaj çdo komenti ose kërkesë për sqarim të Komisionit Evropian ose të shteteve anëtare dhe përgatit raportin përmbledhës të vlerësimit të përbashkët në bashkëpunim me autoritetet kompetente.

Neni 36

Masa shoqëruese për zbatimin e këtij kreu

1. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) njësia kombëtare e koordinimit me sistemin IMI, përfshirë autoritetet përgjegjëse për ndërveprim me sistemin IMI dhe pikat kombëtare të kontaktit;

b) rregullat organizative dhe procedurale për bashkëpunimin ndëradministrativ dhe shkëmbimin e informacionit;

c) masat për trajnimin e nëpunësve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadrin e sistemit IMI;

ç) mënyra, afatet, forma dhe procedurat për hartimin, miratimin dhe dorëzimin e njoftimeve dhe raporteve, sipas nenit 35 të këtij ligji.

2. Dispozitat e këtij kreu zbatohen pa cenuar zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të rregullores (BE) nr. 1024/2012 dhe të akteve të saj zbatuese.

KREU VII

ZBATIMI, MONITORIMI, DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Zbatimi i ligjit

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë është autoriteti përgjegjës për zbatimin, koordinimin dhe monitorimin e këtij ligji, si dhe për raportimin periodik në Këshillin e Ministrave.

2. Të gjitha institucionet kompetente, sipas legjislacionit sektorial në fushat që mbulon ky ligj, janë përgjegjëse për zbatimin e tij në veprimtarinë e tyre, duke siguruar:

a) përputhjen e legjislacionit dhe praktikave administrative me parimet e këtij ligji dhe me direktivën 2006/123/KE;

b) shqyrtimin, njoftimin e skemave të autorizimit dhe kriteret për dhënien e tyre, si dhe thjeshtimin e procedurave sipas detyrimeve që rrjedhin nga nenet 5, 7, 12, 17, 23, 24 dhe 25 të këtij ligji.

3. Ministria bashkërendon funksionimin e PVK-së në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe institucionet kompetente.

Neni 38

Monitorimi dhe raportimi

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë përgatit raportin vjetor të monitorimit për zbatimin e këtij ligji, i cili përfshin:



a) ecurinë e shqyrtimit të legjislacionit sektorial dhe të njoftimeve të reja;

b) nivelin e përputhshmërisë me direktivën 2006/123/KE;

c) përparimin në thjeshtimin e procedurave të skemave të autorizimit dhe digjitalizimin e tyre;

ç) masat për asistencën ndaj përfituesve dhe bashkëpunimin administrativ ndërinstitucional.

2. Raporti miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe publikohet në portalin “e-Albania” dhe në faqen zyrtare elektronike të ministrisë.

Neni 39

Akte nënligjore

1. Këshilli i Ministrave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 7; 7, pika 7; 12, pika 9; 17, pika 7; 21, pika 3; 23, pika 8; 24, pika 6; 25, pika 7; 36 dhe 38 të këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për ekonominë dhe tregtinë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton udhëzimet sipas neneve 23, pika 5, dhe 26, pika 8, të këtij ligji.

3. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 66/2016, “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 5.4.2017, dhe nr. 300, datë 5.4.2017, vazhdojnë të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja sipas këtij ligji dhe shfuqizohen automatikisht në momentin e hyrjes në fuqi të tyre.

Neni 40

Përditësimi i shqyrtimit të legjislacionit sektorial dhe përafrimi i plotë me të drejtën e Bashkimit Evropian

1. Procesi i shqyrtimit të legjislacionit sektorial të zhvilluar gjatë viteve 2020–2023, në zbatim të udhëzimit të ministrit të Ekonomisë “Për planin e veprimit për përafrimin e legjislacionit sektorial me direktivën 2006/123/KE” vazhdon të zbatohet dhe të përditësohet në kuadër të këtij ligji.

2. Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë në bashkëpunim me institucionet kompetente sektoriale përditëson shqyrtimin dhe planin e veprimit për përafrimin e plotë të legjislacionit sektorial me kërkesat e këtij ligji dhe të direktivës 2006/123/KE brenda datës 31 dhjetor 2026.

3. Ministria përgjegjëse raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave për ecurinë e përditësimit dhe zbatimit të këtij procesi, duke reflektuar rezultatet në raportin vjetor të monitorimit sipas nenit 38 të këtij ligji.

Neni 41

Zbatimi i dispozitave të ligjit në faza

1. Dispozitat e mëposhtme të këtij ligji hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian ose më herët nëse parashikohet me marrëveshje ose sipas parimit të reciprocitetit me Bashkimin Evropian:

a) neni 5, pika 6, dhe neni 6, pika 6, të këtij ligji;

b) kreu III, nenet 12 deri 14, përveç neneve 12, pikat 6 e 7, dhe 12, pika 9, të këtij ligji;

c) neni 17, pikat 2, 3 dhe 5 të këtij ligji;

ç) pikat 3, fjalia e dytë, dhe 4 të nenit 21 të këtij ligji;

d) pikat 2 dhe 3 të nenit 23 të këtij ligji;

dh) pika 6 e nenit 25 të këtij ligji;

e) neni 26 vetëm për aspektet që kërkojnë bashkëpunim me Komisionin Evropian;

ë) pika 3 e nenit 27 të këtij ligji;

f) kreu VI, nenet 28 deri 35 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse, mund të përcaktojë hyrjen në fuqi të pjesshme të dispozitave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, nëse niveli i përputhshmërisë ligjore dhe teknike e bën këtë të mundur.

Neni 42

Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji nr. 66/2016, “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj.

2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit të përmendur në pikën 1 të këtij neni vazhdojnë të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja sipas këtij ligji dhe shfuqizohen automatikisht me hyrjen në fuqi të akteve të reja të nxjerra sipas nenit 39 të këtij ligji.



Neni 43
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.4.2026.

Shpallur me dekreten nr. 312, datë 13.5.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 312, datë 13.5.2026
PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 42/2026, “Për lirinë e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ
Nr. 43/2026

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË SHËRBIMEVE
ARSIMORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është krijimi dhe përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të

Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore (në vijim “Agjencia”).

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i kushteve për ofrimin e shërbimeve arsimore në përputhje me legjislacionin përkatës të secilit prej shërbimeve, duke siguruar cilësi, transparencë, eficiencë dhe efikasitet të vlerësimeve në interes të publikut.

Neni 3
Misioni i Agjencisë

Agjencia ka si mision garantimin e interesit publik në ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit, të profesioneve të rregulluara, të vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arsimit, si dhe nxitjen e përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe krijimin e kushteve të favorshme në interes të publikut.

Neni 4
Parimet e veprimtarisë së Agjencisë

Për arritjen e qëllimeve dhe për përmbushjen e kompetencave të parashikuara në këtë ligj, përgjatë veprimtarisë së saj Agjencia ndjek e zbaton parimet e mëposhtme:

- a) parimin e ligjshmërisë;
- b) parimin e objektivitetit;
- c) parimin e bashkëpunimit ndërinstitucional;
- ç) parimin e proporcionalitetit;
- d) parimin e transparencës;
- dh) parimin e paanësisë në ushtrimin e veprimtarisë, duke respektuar çështjet e konfliktit të interesave;
- e) parimin e administrimit me eficiencë, efektivitet dhe transparencë të fondeve financiare.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
AGJENCISË KOMBËTARE
TË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Neni 5
Fusha e veprimrit

Agjencia ushtron veprimtarinë e saj për të gjithë territorin e vendit në fushën e shërbimeve të arsimit,



të profesioneve të rregulluara, si dhe të administrimit të vlerësimeve kombëtare e ndërkombëtare në fushën e arsimit. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës e rekomandues të politikave arsimore, duke zbatuar standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 6

Statusi i Agjencisë

1. Agjencia është person juridik publik në formën e agjencisë autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për arsimin dhe funksionon si institucion publik me vetëfinancim.

2. Agjencia ofron shërbime arsimore në përputhje me legjislacionin përkatës të secilit prej shërbimeve që ofron.

Neni 7

Selia, stema dhe vulat

1. Selia e Agjencisë ndodhet në Tiranë. Agjencia mund të krijojë edhe degë territoriale me vendim të organeve të saj drejtuese.

2. Stema e Agjencisë përbëhet nga stema shtetërore e Republikës së Shqipërisë, me shënimin “Republika e Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Shërbimeve Arsimore”.

3. Vulat e Agjencisë propozohen nga drejtori ekzekutiv dhe miratohen nga këshilli drejtues.

Neni 8

Përgjegjësitë funksionale dhe detyrat e Agjencisë

1. Agjencia, në përmbushje të funksioneve të saj për ushtrimin e veprimtarisë për ofrimin e shërbimeve arsimore, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të secilit prej shërbimeve që ofron, ka përgjegjësitë funksionale dhe detyrat si më poshtë:

a) mbështet ministrinë përgjegjëse për arsimin në hartimin e politikave arsimore e të strategjive në zbatim të tyre nëpërmjet analizave dhe studimeve që kryen;

b) zhvillon provimet kombëtare dhe kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve;

c) përpunon e analizon rezultatet e provimeve kombëtare e të vlerësimeve të provimeve të shtetit

sipas standardeve bashkëkohore dhe publikon raportet vjetore;

ç) kryen e administron vlerësime të jashtme kombëtare e ndërkombëtare dhe/ose sipas rastit për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar apo edhe testime ndërkombëtare të certifikuara;

d) kryen procedurat e njëvlershmërisë/njësimi të dëftesave/diplomave të arsimit parauniversitar të fituara jashtë vendit;

dh) lëshon diplomën, certifikatën e maturës shtetërore dhe diplomën, certifikatën e maturës shtetërore profesionale, të cilat janë dokumente të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë;

e) kryen regjistrimin e formës së diplomës ose të certifikatës për çdo program studimi në regjistrin shtetëror dhe lëshon aktin përkatës të regjistrimit;

ë) pajis çdo student të regjistruar në një institucion të arsimit të lartë me numrin unik të matrikullimit;

f) kryen procedurat e njohjes e të njësimi të diplomave të arsimit të lartë, të certifikatave, të gradave shkencore, si dhe shërben si sekretariat teknik i komisioneve, të njohjes së titujve akademikë të fituar jashtë vendit, në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin;

g) organizon e administron provimin e shtetit për profesionet e rregulluara në bashkëpunim me autoritetet kompetente përkatëse;

gj) koordinon me institucionet e tjera proceset e aplikimit e të pranimit të studentëve në institucionet e arsimit të lartë për ndjekjen e programeve të studimit;

h) administron bazën e të dhënave shtetërore për arsimin parauniversitar;

i) administron bazën e të dhënave shtetërore për arritjet e nxënësve në provimet, vlerësimet kombëtare, i përpunon ato dhe informon ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe të interesuarit për rezultatet e arritjeve;

j) krijon e administron regjistrin kombëtar të studentëve të të gjitha cikleve të studimit dhe një bazë të dhënash për institucionet e arsimit të lartë lidhur me programet e studimit, diplomat apo certifikatat që ato lëshojnë;

k) mban bazën e të dhënave kombëtare të diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njohur në Republikën e Shqipërisë;

l) administron bazën e të dhënave shtetërore për provimet e shtetit dhe provimet e tjera të digjitalizuara;



ll) ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin.

2. Detyrat e përcaktuara në shkronjat “b”, “ç”, “dh” dhe “ll” të pikës 1 të këtij neni financohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet fondeve të miratuara për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

3. Agjencia shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC (Rrjeti Evropian i Qendrave Kombëtare të Informacionit) për informimin e publikut dhe të të interesuarve lidhur me procesin e njohjes e të njësimit të diplomave brenda dhe jashtë vendit.

Neni 9

Buxheti i Agjencisë

1. Burimet e financimit të Agjencisë përfshijnë:

a) të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së Agjencisë në zbatim të këtij ligji;

b) të ardhurat e krijuara nga burime të tjera të ligjshme.

2. Të ardhurat që do të rezultojnë të papërdorura në fund të vitit financiar mund të përdoren për nevoja të institucionit deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës, ndërsa pjesa e parashikuar dhe e papërdorur për investime në vitin ushtrimor trashëgohet në buxhetin e vitit ushtrimor pasardhës me të njëjtin destinacion dhe pasqyrohet në buxhetin e institucionit për vitin e ardhshëm. Tepërcia e të ardhurave të vitit ushtrimor, e mbetur pas kësaj periudhe, derdhet në buxhetin e shtetit.

Në rast se rezulton se tepërcia e të ardhurave vijon në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë 3-vjeçare, Agjencia i propozon Këshillit të Ministrave rishikimin e tarifave të shërbimeve që kryen për uljen e tyre.

3. Për shërbimet që ofrohen në mënyrë ekskluzive vetëm nga Agjencia në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, llojet e tarifave dhe niveli i tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, pas propozimit të këshillit drejtues të Agjencisë, ndërsa për shërbimet e tjera të ofruara nga Agjencia, me vendim të këshillit drejtues të Agjencisë.

4. Përjashtohen nga tarifat kategoritë e veçanta sipas përcaktimeve të ligjeve të posaçme në fuqi. Rimbursimi i tarifës për këto shërbime sigurohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet fondeve të miratuara për

ministrinë përgjegjëse për arsimin, nëse nuk parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

5. Buxheti i Agjencisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, pas miratimit të këshillit drejtues.

6. Buxheti vjetor i Agjencisë hartohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për menaxhimin buxhetor e financiar.

7. Agjencia përgatit çdo vit pasqyrat financiare vjetore në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, si dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar. Pasqyrat financiare vjetore i paraqiten këshillit drejtues si pjesë e raportit të veprimtarisë vjetore dhe mbulojnë një periudhë njëvjeçare kalendarike.

Neni 10

Drejtimi i Agjencisë

1. Struktura drejtuese e Agjencisë përbëhet nga këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv.

2. Drejtori ekzekutiv është titullari i Agjencisë dhe emërohet nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e këshillit drejtues të Agjencisë.

3. Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv janë si më poshtë:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të ketë diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave” ose “Master profesional” të përfituar në fund të ciklit të dytë të studimeve, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike, ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

dh) ndaj tij të mos jenë marrë masa disiplinore, që nuk janë shuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë lirohet nga detyra në këto raste:

a) humbet shtetësinë shqiptare;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni përgjegjës mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

c) plotëson kushtet për pension pleqërie;



ç) paraqet dorëheqjen me shkrim;
d) vërtetohet pamundësia për të ushtruar detyrën;

dh) i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

e) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

ë) ristrukturohet institucioni.

5. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë shkarkohet nga detyra në këto raste:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose të një kundërvajtjeje penale me dashje;

b) kryen shkelje të rënda gjatë ushtrimit të detyrës;

c) nuk përmbush objektivat e institucionit;

ç) kryen veprimtari që krijon konflikt interesi në përputhje me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesave;

d) mungon në detyrë pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë radhazi.

6. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë ushtron detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

a) harton dhe i paraqet për miratim këshillit drejtues dokumentet strategjike dhe të planifikimit për ofrimin e shërbimeve arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare;

b) harton metodologjinë e ofrimit të shërbimeve arsimore dhe propozon ndryshimin e mëtejshëm të kësaj metodologjie në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi;

c) mbikëqyr zbatimin e rregullave e të procedurave për parandalimin e konfliktit të interesit;

ç) përgjigjet për hartimin e sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm në përputhje me praktikën më të mira në fushën e kompetencave që mbulon;

d) monitoron sistemet e qeverisjes e të kontrollit të brendshëm për të siguruar që këto sisteme të funksionojnë në mënyrë efektive;

dh) harton raportin vjetor të veprimtarisë, i cili mbulon aktivitetet e Agjencisë gjatë vitit raportues dhe përfshin raportimin për funksionimin efektiv të sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm dhe pas miratimit nga këshilli drejtues e paraqet në ministrinë përgjegjëse për arsimin;

e) përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët;

ë) paraqet projektbuxhetin vjetor pranë këshillit drejtues të Agjencisë;

f) i propozon këshillit drejtues strukturën dhe organikën e Agjencisë, si dhe elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të personelit të Agjencisë, referuar elementeve dhe vlerave të të punësuarve të institucioneve të tjera të administratës shtetërore;

g) kryen vlerësimin e performancës së personelit;

gj) paraqet për miratim të këshilli drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit dhe administrimit të Agjencisë;

h) propozon përshkrimet dhe kërkesat për çdo pozicion pune, si dhe kriteret e punësimit të personelit në përputhje me Kodin e Punës dhe me rregulloren e tij të brendshme, të cilat ia paraqet për miratim këshillit drejtues;

i) emëron personelin e nevojshëm administrativ sipas kriterëve të përcaktuara dhe mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit;

j) ushtron detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

7. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë mbështetet nga dy zëvendës drejtore, të cilët emërohen nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e këshillit drejtues të Agjencisë, me të njëjtat kriteret dhe procedura sikurse edhe drejtori ekzekutiv.

8. Këshilli drejtues përbëhet nga 6 anëtarë të emëruar për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje nga ministri përgjegjës për arsimin, nga të cilët 1 përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për arsimin profesional, pa të drejtë vote, dhe 5 anëtarë me të drejtë vote, të propozuar sipas procedurës së mëposhtme:

a) 3 përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

b) 2 përfaqësues të propozuar nga donatorë/partnerë zhvillimorë të përzgjedhur me të cilët ministria përgjegjëse për arsimin ka lidhur marrëveshje të posaçme bashkëpunimi për rritjen e kapaciteteve të Agjencisë.

9. Donatorët/partnerët zhvillimorë janë organizatat publike apo private, me status jofitimprurës, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbështesin projekte arsimore për realizimin e qëllimeve të këtij ligji dhe për zbatimin e projekteve, që përmirësojnë fushat e veprimtarive që ushtrohen nga agjencia, me të cilat ministria ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

10. Këshilli drejtues merr vendime me 4/5 e të gjithë anëtarëve lidhur me këto kompetenca:



a) i propozon ministrit përgjegjës për arsimin projektbuxhetin vjetor të Agjencisë;

b) i propozon ministrit përgjegjës për arsimin strukturën dhe organikën e Agjencisë, që miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;

c) i propozon ministrit përgjegjës për arsimin llojet e shërbimeve publike dhe masat e tarifave përkatëse që ofron Agjencia për miratimin e tyre me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) i propozon ministrit përgjegjës për arsimin emërimin e shkarkimin e drejtorit ekzekutiv dhe të zëvendës drejtoreve;

d) i propozon ministrit përgjegjës për arsimin elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të personelit të Agjencisë, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi për kompetencat për caktimin e pagave.

11. Këshilli drejtues merr vendime me 3/5 e të gjithë anëtarëve lidhur me këto kompetenca:

a) miraton programet e punës vjetore dhe strategjike të Agjencisë;

b) miraton, pas propozimit të drejtorit ekzekutiv të Agjencisë, përshkrimet dhe kërkesat për çdo pozicion pune, si dhe kriteret e punësimit të personelit;

c) monitoron efikasitetin dhe eficiencën e shërbimeve të ofruara nëpërmjet raportimeve periodike nga drejtori ekzekutiv i Agjencisë;

ç) merr vendime për çështje të tjera në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi;

d) miraton raportin vjetor dhe raporte të tjera sipas rastit.

12. Në mungesë të donatorëve/partnerëve zhvillimorë, përzgjedhja e të gjithë anëtarëve të këshillit drejtues të Agjencisë bëhet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

13. Anëtarët e këshillit drejtues shkarkohen nga ministri përgjegjës për arsimin sipas rregullave të hollësishme për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të strukturave drejtuese të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

14. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të anëtarëve të zgjedhur të organeve, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur të këshillit drejtues është plotësues.

15. Këshilli drejtues kryen funksionin dhe detyrat e përcaktuara në këtë ligj pa shpërblim.

Neni 11

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë

1. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë rregullohen nga Kodi i Punës, rregullorja e brendshme e funksionimit dhe administrimit të Agjencisë, si dhe aktet e brendshme të saj.

2. Punonjësit e Agjencisë ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, Kodin e Punës, rregulloren e brendshme të institucionit, standardet e ofrimit të shërbimeve arsimore dhe Kodin e Etikës së institucionit të miratuar nga këshilli drejtues.

Neni 12

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Për arritjen e qëllimeve dhe ushtrimin e suksesshëm të funksioneve të saj, Agjencia bashkëpunon, bashkërendon dhe e harmonizon veprimtarinë e saj me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, me institucionet publike dhe private të arsimit, si dhe me institucionet e tjera shtetërore.

2. Agjencia bashkëpunon me partnerët, donatorët, organizatat homologe të huaja, me organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e arsimit për shkëmbimin e informacionit dhe të përvojave, për zbatimin e modeleve të suksesshme, për zgjerimin e veprimtarisë dhe të shërbimeve të ofruara prej saj, me synimin për të qenë një qendër reference kombëtare për administrimin e vlerësimit e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare e ndërkombëtare në fushën e arsimit.

3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Agjencia ka të drejtë të kërkojë nga organet e tjera shtetërore, qendrore dhe vendore ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për realizimin e funksioneve të saj. Organet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Agjencinë, të shkëmbejnë informacion e të sigurojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme për përmbushjen e kompetencave dhe detyrimeve të Agjencisë.

4. Në zbatim të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar, Agjencia bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si autoriteti përgjegjës për ndërtimin, zhvillimin, mirëmbajtjen, sigurinë,



standardizimin dhe ndërveprueshmërinë e sistemeve elektronike shtetërore dhe bazave të të dhënave shtetërore që përdoren nga Agjencia.

Agjencia ushtron administrimin funksional dhe përdorimin institucional të sistemeve elektronike shtetërore në fushën e arsimit pa cenuar kompetencat ligjore të AKSHI-t si autoritet rregullator e teknik. Çdo zhvillim i ri, zgjerim, modifikim, integrim, migrim apo ndërhyrje teknike mbi sistemet elektronike shtetërore kryhet në koordinim dhe me miratim paraprak teknik të AKSHI-t.

Agjencia mbulon kostot financiare që lidhen me zhvillimet funksionale dhe mirëmbajtjen e sistemeve që përdor, në përputhje me planifikimin buxhetor dhe legjislacionin për financat publike, duke garantuar qëndrueshmëri financiare dhe shmangie të dublikimeve të investimeve publike në TIK.

KREU III MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

Neni 13 Mbikëqyrja e veprimtarisë së Agjencisë

1. Veprimtaria e Agjencisë mbikëqyret nga ministria përgjegjëse për arsimin, e cila verifikon zbatimin korrekt të politikave dhe të strategjive kombëtare në fushën e arsimit.

2. Për qëllimet e mësipërme të lidhura me mbikëqyrjen dhe kontrollin, Agjencia i dorëzon ministrit përgjegjës për arsimin raportin vjetor për veprimtarinë e saj brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

3. Agjencia raporton vullnetarisht te ministria përgjegjëse për arsimin, sa herë që e shih të nevojshme, lidhur me analizën e rezultateve, problematikat dhe çdo informacion tjetër të dobishëm për përmirësimin e shërbimeve arsimore.

4. Agjencia ka detyrimin të raportojë, kur i kërkohet nga ministria përgjegjëse për arsimin, edhe për çështje të tjera apo për çdo të dhënë të kërkuar nga ministria.

Neni 14 Kontrolli i Agjencisë

Ministria ka të drejtë të ushtrojë kontroll për respektimin e niveleve dhe të standardeve të shërbimeve që ofrohen nga Agjencia në çdo kohë.

Kontrollet janë me natyrë tematike, rastësore, ligjshmërie dhe financiare. Raportet e kontrollit dhe rekomandimet e nxjerra janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga Agjencia.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 15 Dispozita kalimtare

Qendra e Shërbimeve Arsimore vijon veprimtarinë e saj deri në riorganizimin e plotë të Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore.

Neni 16 Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, pikat 3 e 5, dhe 10, pika 13, të këtij ligji.

2. Ngarkohet këshilli drejtues i Agjencisë që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin e parashikuar në nenin 11, pika 1, të këtij ligji.

Neni 17 Ndryshime në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

1. Kudo në përmbajtje të ligjit nr. 80/2015 emërtesa “Qendra e Shërbimeve Arsimore” zëvendësohet me emërtesën “Agjencia Kombëtare e Shërbimeve Arsimore” dhe shkurtesa “QSHA” zëvendësohet me shkurtesën “AKSHA”.

2. Nenet 9 dhe 10 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 9 Agjencia Kombëtare e Shërbimeve Arsimore

1. Agjencia Kombëtare e Shërbimeve Arsimore organizohet dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me ligjin e saj të krijimit si institucion i administratës shtetërore.



2. Ofrimi i shërbimeve në fushën e arsimit të lartë dhe përcaktimi i tarifave të tyre bëhet në përputhje me përcaktimet në ligjin e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë.

Neni 10
**Funksionet e Agjencisë Kombëtare të
Shërbimeve Arsimore**

Agjencia Kombëtare e Shërbimeve Arsimore kryen detyrat dhe funksionet e përcaktuara në ligjin e krijimit.”.

3. Pikat 3, 5 dhe 7 të nenit 92 ndryshohen si më poshtë:

“3. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar në Republikën e Shqipërisë të certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore është Agjencia Kombëtare e Shërbimeve Arsimore.

...

5. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të titujve akademikë të lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces kryhet nga njësia përgjegjëse e njësimit të diplomave nëpërmjet komisioneve përkatëse. Sekretariati teknik për këtë shërbim ndodhet pranë Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore.

...

7. Baza e të dhënave kombëtare e diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njësuar apo të njohur në Republikën e Shqipërisë mbahet e administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.”.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.4.2026.

**Shpallur me dekretin nr. 313, datë 13.5.2026,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

DEKRET

Nr. 313, datë 13.5.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 43/2026, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET

Nr. 301, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Silvana Avni Guddat
2. Eleni Thanasi Papa
3. Raimonda Jakup Kupe

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 93, datë 5.5.2026

PËR TRANSMETIMIN E TË DHËNAVE
TË UDHËTIMIT NË RASTET E
MOSFUNKSIONIMIT TË SISTEMIT
KRYESOR TË PËRPUNIMIT TË
INFORMACIONIT TË UDHËTIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 5, pika 9, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

1. QËLLIMI

Qëllimi i këtij udhëzimi është:

a) Të përcaktojë rregullat, procedurat dhe masat e standardizuara për transmetimin, marrjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të udhëtimit nga transportuesit ajrorë, tokësorë dhe detarë drejt Sektorit të Inteligjencës së Udhëtimit (SIU), në rastet kur sistemi kryesor i transmetimit të të dhënave të udhëtimit nuk funksionon, duke garantuar vazhdimësinë e përpunimit të të dhënave, nivel të përshtatshëm mbrojtjeje dhe përdorim të kontrolluar të aplikacionit alternativ;

b) Të sigurojë funksionimin e pandërprerë, të sigurt dhe të kontrolluar të procesit të shkëmbimit të të dhënave të udhëtimit, edhe në rastet kur sistemi kryesor pëson mangësi ose avari teknike;

c) Të garantojë që SIU-ja të ketë akses në kohë dhe në mënyrë të strukturuar tek të dhënat e udhëtimit, për qëllime të parandalimit, zbulimit, analizimit dhe profilizimit të rreziqeve të sigurisë që lidhen me krimin e organizuar, terrorizmin, migracionin e paligjshëm dhe veprimtari të tjera penale në fushën e kompetencave ligjore të Policisë së Shtetit;

d) Të harmonizojë proceset e transmetimit të të dhënave nga transportuesit me kërkesat teknike dhe operacionale të sistemit të ngritur pranë SIU-ve, duke garantuar cilësinë, integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e të dhënave të administruara;

e) Të sigurojë që çdo përpunim i të dhënave nga SIU-të të kryhet në përputhje me parimet themelore

të ligjshmërisë, transparencës, minimizimit, proporcionalitetit, kufizimit të ruajtjes dhe përgjegjshmërisë sipas Rregullores për Mbrojtjen e të dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR) dhe të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

f) Të përcaktojë detyrime të qarta për transportuesit dhe për strukturat përgjegjëse të SIU-të, lidhur me përdorimin e aplikacionit alternativ, regjistrimin, auditimin, transferimin dhe fshirjen e të dhënave të grumbulluara gjatë periudhës së mosfunksionimit të sistemit kryesor;

g) Të krijojë një bazë të qartë operacionale dhe ligjore, që i mundëson SIU-së të ndërtojë analiza inteligjence, profile rreziku, sinjalizime operacionale, si dhe të rrisë efikasitetin në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

2. FUSHA E ZBATIMIT

2.1 Në rast shfaqjeje të një problemi apo mangësie teknike të sistemit, të tilla si probleme teknike të infrastrukturës përkatëse dhe linjës së transmetimit, transportuesit ajrorë, ujorë dhe tokësorë, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të tyre, do të dërgojnë të dhënat e udhëtimit, sipas formatit të përcaktuar, në përputhje me nevojat e sistemit të ngritur, në një aplikacion alternativ për përpunimin e të dhënave të udhëtimit.

2.2 Udhëzimi zbatohet plotësisht në rastet kur transportuesit apo SIU-të hasin:

a) avari teknike;

b) mungesë të lidhjes së sistemit kryesor të përpunimit të informacionit të udhëtimit;

c) dështime të përkohshme të infrastrukturës teknologjike.

Në këto raste përdoret aplikacioni alternativ, duke respektuar të gjitha kërkesat e privatësisë dhe sigurisë.

3. APLIKACIONI ALTERNATIV

Aplikacioni alternativ për përpunimin e të dhënave të udhëtimit është një mjet rezervë (*fallback system*) i vënë në dispozicion nga SIU-ja, i destinuar të përdoret vetëm në rastet kur sistemi kryesor elektronik i transmetimit dhe përpunimit të të dhënave të udhëtimit nuk është operacional për shkak të një defekti, avarie teknike, mungese lidhjeje ose situatë tjetër të papritur teknologjike.

Aplikacioni alternativ garanton vazhdimësinë e përpunimit të të dhënave dhe parandalon vonesat në analizën e rrezikut, duke siguruar që funksionet e



sigurisë kombëtare dhe kontrollit kufitar të mos ndërpriten.

3.1 Qëllimi i aplikacionit alternativ

Aplikacioni alternativ, synon:

a) të mundësojë transmetimin e pandërprerë të të dhënave të udhëtimit dhe të dhënave të tjera të udhëtimit drejt SIU-së;

b) të sigurojë redundancë operative në rast dështimi të sistemit primar;

c) të garantojë që SIU-ja të ketë akses në kohë reale në të dhënat kritike për analizën e rrezikut;

d) të mbajë standardet e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave në nivel të barabartë me sistemin kryesor.

3.2 Aktivizimi i aplikacionit alternativ

Aplikacioni alternativ përdoret vetëm në rastet, kur:

a) transportuesi nuk mund të transmetojë të dhëna në sistemin kryesor për shkak të defekteve teknike;

b) sistemi kryesor i SIU-së ka ndërprerje, ngadalësim serioz ose avari;

c) infrastruktura e komunikimit është e pamundur ose e pasigurt;

d) ka mangësi të përkohshme të serverëve të Policisë së Shtetit.

SIU-ja njofton transportuesit kur sistemi primar ka kaluar në gjendjen “jo operacionale”.

3.3 Procedurat e transmetimit në aplikacionin alternativ

Transportuesit janë të detyruar që:

a) të transmetojnë ndërmjet mjeteve rezervë të autorizuara nga SIU-ja (aplikacion *web*, API alternative, format të siguruar *fallback*);

b) të dërgojnë të dhënat në të njëjtin nivel cilësie dhe saktësie si në sistemin kryesor;

c) të përditësojnë të dhënat e udhëtimit sipas afateve ligjore edhe gjatë funksionimit të aplikacionit alternativ (48–24 orë, 180 minuta, 60 minuta, pas imbarkimit).

3.4 Administrimi i të dhënave në aplikacionin alternativ nga SIU-ja

SIU-ja kryen këto veprime:

a) regjistrimin e çdo transmetimi të kryer në aplikacionin alternativ;

b) verifikimin e saktësisë së të dhënave të dërguara;

c) krahasimin e tyre me strukturat e të dhënave të sistemit kryesor;

d) monitorimin e performancës teknike të aplikacionit rezervë;

e) garantimin e aksesit të kufizuar dhe të gjurmueshëm nga personeli i SIU-së.

f) verifikon automatikisht çdo të dhënë të marrë për integritet, plotësi dhe përputhshmëri.

3.5 Transferimi i të dhënave në sistemin kryesor

Sapo sistemi kryesor rikthehet në funksion:

a) të dhënat e regjistruara në aplikacionin alternativ transferohen automatikisht në sistemin primar;

b) SIU-ja verifikon përputhshmërinë dhe integritetin e të dhënave;

c) dokumentohet çdo hap i procesit të transferimit.

Ky proces garantohej nga strukturat e teknologjisë së informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

3.6 Fshirja e të dhënave nga aplikacioni alternativ

Pasi të dhënat janë transferuar me sukses:

a) ato fshihen menjëherë nga aplikacioni alternativ;

b) fshirja regjistrohet dhe dokumentohet në *log*-et e auditimit;

c) SIU-ja siguron që asnjë kopje e të dhënave të mos mbetet në sistemin rezervë.

Kjo procedurë është e detyrueshme për të përmbushur parimin e minimizimit, kufizimit të ruajtjes dhe integritetit, sipas GDPR-së dhe ligjit nr. 124/2024.

3.7 Masat e sigurisë në aplikacionin alternativ

Aplikacioni alternativ është i ndërtuar mbi të njëjtat standarde sigurie si sistemi kryesor:

a) enkriptim në transmetim dhe ruajtje (TLS 1.2+/AES-256);

b) kontroll aksesesh me autentikim shumëfaktorësh;

c) logim të detajuar të çdo veprimi;

d) auditim periodik të funksionalitetit dhe sigurisë;

e) izolim të mjedisit rezervë nga sistemet e tjera të PSH-së (*network segmentation*).

4. MBROJTJA E TË DHËNAVE

Sektori i Inteligjencës së Udhëtimit (SIU), transportuesit dhe strukturat teknike të Policisë së Shtetit janë të detyruara të sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale të udhëtarëve gjatë të gjithë ciklit të përpunimit të tyre, në përputhje me parimet e privatësisë dhe kërkesat ligjore në fuqi.



Mbrojtja e të dhënave bazohet në katër elemente themelore: konfidencialiteti, integriteti, disponueshmëria dhe akses i kufizuar.

4.1 Konfidencialiteti i të dhënave

Të dhënat API/PNR dhe të dhënat e tjera të udhëtimit trajtohen vetëm nga personeli i autorizuar, brenda roleve të përcaktuara qartë.

Personeli merr qasje vetëm në të dhënat që i nevojiten për të kryer detyrat funksionale.

Ndalohen reptësisht:

a) shpërndarja e të dhënave tek persona të paautorizuar;

b) kopjimi, ruajtja ose transferimi i të dhënave në pajisje të paautorizuara;

c) përdorimi i të dhënave për qëllime personale.

Çdo shkelje e konfidencialitetit përbën shkelje administrative dhe penale, sipas ligjeve në fuqi.

4.2 Integriteti i të dhënave

Të dhënat ruhen dhe përpunohen në mënyrë të tillë që të jenë të plota, të sakta dhe të pandryshuara në mënyrë të paautorizuar. Çdo ndryshim, korrigjim ose rifreskim i të dhënave regjistrohet automatikisht në *log*-et e sistemit.

SIU-ja kryen verifikime periodike të integritetit për:

a) parandalimin e manipulimit;

b) identifikimin e anomalive;

c) përputhshmërinë e të dhënave midis sistemit kryesor dhe aplikacionit alternativ.

4.3 Akses i kufizuar dhe i kontrolluar

Akresi ndaj sistemeve të SIU-ve bëhet vetëm me kredenciale të personalizuar dhe autentikim shumëfaktorësh (MFA). Parimi i qasje minimale (*least privilege*) zbatohet për çdo rol dhe funksion.

Çdo qasje regjistrohet në mënyrë të plotë në *log*-et e auditimit, duke përfshirë:

a) identitetin e përdoruesit;

b) datën dhe orën;

c) të dhënat e aksesit;

d) veprimet e kryera.

Qasja në qendrën fizike të të dhënave lejohet vetëm për personel me autorizim të posaçëm.

4.4 Disponueshmëria dhe vazhdimësia e shërbimit

Sistemet e përpunimit të informacionit të udhëtimit kanë mekanizma sigurie që garantojnë funksionimin e pandërprerë të shërbimit (*High Availability*). Në rast ndërprerjesh, aktivizohet aplikacioni alternativ, i cili siguron vazhdimësinë e procesit.

Rezervat (*backups*) kryhen rregullisht dhe testohen periodikisht për rikuperim.

4.5 Mbrojtja ndaj aksesit të paautorizuar dhe sulmeve kibernetike

SIU-ja dhe transportuesit zbatojnë masa për:

a) *firewalls* dhe IDS/IPS të avancuara;

b) enkriptim të plotë të trafikut të të dhënave;

c) kontroll të integritetit të sistemeve;

d) detektim dhe sinjalizim të menjëhershëm të tentativave të aksesit të paautorizuar;

e) vlerësime të rregullta të cenueshmërisë dhe testime të penetrimit.

4.6 Përdorimi i parimit “*Privacy by Design & by Default*”

Të gjitha procedurat dhe sistemet:

a) ndërtohen duke integruar mbrojtjen e të dhënave që në fazën e projektimit;

b) përdorin konfigurime të paracaktuara të sigurta;

c) minimizojnë të dhënat që përpunohen;

d) sigurojnë konfigurim të qartë të të drejtave të aksesit.

4.7 Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së të dhënave

Në rast incidenti me ndikim tek të dhënat personale:

a) SIU-ja kryen vlerësimin e menjëhershëm të incidentit;

b) DPO-ja njoftohet menjëherë;

c) në incidentet që përbëjnë rrezik për subjektet, njoftohet Komisioneri sipas afateve të ligjit;

d) përgatitet raporti i incidentit dhe masat e ndërmarra (*post-incident report*);

e) zbatohen masa parandaluese për të shmangur përsëritjen.

4.8 Detyrimi për dokumentim dhe auditim

SIU-ja mban dokumentacion të përditësuar, për:

a) masat e sigurisë të zbatuara;

b) procedurat e përpunimit të të dhënave;

c) *log*-et e auditimit;

d) evidencat e qasjes dhe veprimeve të personelit.

Komisioneri, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës, ka të drejtën të kontrollojë zbatimin e këtyre masave.

5. VLERËSIMI I PASOJAVE NË PRIVATËSI (DPIA)

5.1 DPIA-ja është një proces i detyrueshëm dhe thelbësor për SIU-në në rastet kur përpunimi i të dhënave të udhëtimit ose të dhënave të tjera të udhëtimit paraqet rrezik të lartë për të drejtat dhe



liritë e individëve, në kuptim të ligjit nr. 124/2024 dhe GDPR (neni 35).

5.2 Monitorimi dhe përditësimi i DPIA-së

SIU-ja duhet të:

a) përditësojë DPIA-në çdo herë që ndryshon sistemi, teknologjia, procedura ose rritet volumni i të dhënave;

b) rishikojë DPIA-në të paktën një herë në vit;

c) dokumentojë çdo ndryshim dhe matje të re të rrezikut;

d) sigurojë që proceset e reja API/PNR të mos nisnin pa një DPIA të përditësuar.

5.3 Evidencat dhe dokumentimi

SIU-ja mban:

a) DPIA-të e kryera;

b) raportet e analizës së rrezikut;

c) matricat e rrezikut;

d) masat e zbatuara;

e) rekomandimet e DPO-së;

f) komunikimet me Komisionerin;

g) evidencat e auditimeve lidhur me DPIA-në.

6. SANKSIONET

Çdo person që përdor të dhënat dhe informacionet e bazës së të dhënave të udhëtimit të aplikacionit alternativ dhe nuk i fshin të dhënat sapo të jetë përmbushur qëllimi i mbledhjes së tyre, ndëshkohet me masa administrative dhe disiplinore sipas akteve normative në fuqi.

7. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Udhëzimi i përbashkët nr. 464, datë 10.12.2020, “Për transmetimin e të dhënave të pasagjerit te Njësia e Informacionit të Pasagjerit”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDASHME
Besfort Lamallari

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

URDHËR

Nr. 94, datë 6.5.2026

PËR MIRATIMIN E FORMATIT DHE TË PËRMBAJTJES SË CERTIFIKATËS SË REGJISTRIMIT PËR SHTETAS TË VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 13, të nenit 33/1, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit dhe përmbajtjes së certifikatës së regjistrimit për shtetas të vendeve të Bashkimit Evropian, sipas përcaktimeve në aneksin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Ngarkohet Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe drejtoritë vendore të kufirit dhe migracionit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDASHME
Besfort Lamallari



ANEKS 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
GENERAL DIRECTORATE OF STATE POLICE
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DEPARTMENT FOR BORDER AND MIGRATION
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

QCode

CERTIFIKATË REGJISTRIMI
PËR SHTETAS TË VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN
REGISTRATION CERTIFICATE
FOR CITIZENS OF EUROPEAN UNION COUNTRIES

Nr. i dokumentit: _____

Document Number:

Foto:

Photo:

Data e lëshimit: _____

Date of Issue:

Në përputhje me nenin 33/1, “Mbi të drejtën e shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe banuar lirisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, vërtetohet se:

In accordance with Article 33/1 "On the right of citizens of European Union countries and their family members to move and reside freely within the territory of the Republic of Albania," of Law No. 79/2021 "On Foreigners," as amended, it is certified that:

1. Të dhënat e personit të regjistruar

Registered Person's Information:

• **Emri dhe mbiemri:** _____

First and Last Name:



- **Data e lindjes:** _____

Date of Birth:

- **Vendbanimi në Republikën e Shqipërisë:** _____

Residence in the Republic of Albania:

- **Shtetësia:** _____

Nationality:

- **Numri i dokumentit të identifikimit:** _____

Identification Document Number:

2. Statusi i të drejtës së banimit

Residence Status

Kjo certifikatë vërteton se personi i mësipërm:

This certificate verifies that the above-mentioned person:

-ka paraqitur kërkesën për regjistrim brenda tre muajve nga hyrja në Republikën e Shqipërisë;

has submitted a registration application within three months of entering the Republic of Albania;

-ka paraqitur dokumentet e nevojshme;

has provided the necessary documents;

-plotëson kushtet për të ushtruar të drejtën e tij/saj të banimit sipas ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar.

meets the conditions to exercise his/her right of residence in accordance with Law No. 79/2021 "On Foreigners" as amended.

3. Motivi i banimit në Republikën e Shqipërisë

Reason for residence in the Republic of Albania

a) punëmarrës;

Employee;



b) i vetëpunësuar;

Self-employed;



c) disponon burime të mjaftueshme për veten dhe anëtarët e familjes së tij/saj që të mos bëhet barrë për sistemin e ndihmës sociale gjatë periudhës së qëndrimit dhe ka policë të sigurimit shëndetësor në Republikës së Shqipërisë;

Has sufficient resources for him/herself and his/her family members so as not to become a burden on the social assistance system during the period of stay and has health insurance coverage in the Republic of Albania;



ç) I regjistruar në një institucion privat ose publik të akredituar nga Republika e Shqipërisë, me qëllimin kryesor të ndjekjes së një programi studimi, që përfshin trajnimin profesional;

Enrolled in an accredited private or public institution in the Republic of Albania, with the primary purpose of following a study program, including vocational training;



d) anëtarë i familjes, shtetas i Bashkimit Evropian, që shoqëron ose bashkohet me një shtetas të Bashkimit Evropian.

Family member, citizen of the European Union, accompanying or joining an EU citizen.



**4. Afati i vlefshmërisë***Validity Period*

Kjo certifikatë është e vlefshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjet nga data e lëshimit, zëvendëson çdo certifikatë të mëparshme. Shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian, që kanë banuar ligjërisht për një periudhë të vazhdueshme prej pesë vjetësh në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtën e qëndrimit të përhershëm.

This certificate is valid for a period of 5 (five) years from the date of issue and replaces any previous certificate. Citizens of European Union countries who have legally resided continuously for a period of five years in the Republic of Albania are entitled to permanent residence.

Vula zyrtare e autoritetit*Official Seal of the Authority***(Firma e zyrtarit)***(Official's Signature)***UDHËZIM****Nr. 95, datë 6.5.2026****PËR PROCEDURËN E LËSHIMIT E
REFUZIMIT TË LËSHIMIT, E
RIPËRTËRITJES APO E ANULIMIT TË
LEJES SË QËNDRIMIT DHE LEJES
UNIKE PËR TË HUAJIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 4, të nenit 34, të pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, ministri i Punëve të Brendshme,

UDHËZON:**I. VERIFIKIMI I TË DHËNAVE,
REGJISTRIMI NË SISTEM, LËSHIMI I LEJES
PROVIZORE TË QËNDRIMIT DHE
ARKIVIMI I DOSJES**

1. Struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin kryen verifikimin dhe plotësimin e mangësive të konstatuara në aplikim, dhe i regjistron në sistemin FER “Moduli *e-leje* qëndrimi”. Nëse gjatë regjistrimit evidenton mospërputhje të dhënash (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, vendlindje, shtetësi, gjini etj.) ndërmjet të dhënave të deklaruara në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dokumentit

identifikues dhe atyre ekzistuese në sistemin TIMS, apo më shumë se një rekord për të njëjtin person, merr masa për korrigjimin e këtyre të dhënave në FER-TIMS.

2. Pas regjistrimit të saktë të aplikimit në sistemin FER-TIMS, gjenerohet akti i arkivimit të dokumenteve të depozituara *online* të të huajt. Brenda 1 (një) ditë pune, leja provizore e qëndrimit me vulë elektronike i përcillet të huajt në format elektronik, në formularin e aplikimit *online* në adresën e *email*-it të dhënë nga aplikuesi.

3. Refuzimi i aplikimit *online* për leje qëndrimi/unike, në fazën paraprake të shqyrtimit, kryhet nga struktura përgjegjëse pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin kur aplikimet për leje qëndrimi apo leje unike, nuk përmbushin kriteret ligjore.

**II. DHËNIA E AUTORIZIMIT PËR
LËSHIM TË LEJES SË QËNDRIMIT/LEJES
UNIKE OSE REFUZIMIN E SAJ**

1. Miratimi ose refuzimi i aplikimit për leje qëndrimi ose leje unike dhe dhënia e autorizimit për lëshimin apo refuzimin e tyre, bëhet nga struktura përgjegjëse pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, mbi bazën e vlerësimeve të bëra nga të gjitha strukturat që marrin pjesë në vlerësimin e aplikimit, në formën e një akti të miratuar dhe nëpërmjet shënimit në modulën *e-leje* qëndrimi.



2. Struktura përgjegjëse pranë autoritetit për kufirin dhe migracionin, sipas aktit të miratuar, autorizon për çdo aplikim autoritetin vendor të kufirit dhe migracionit përkatës për të vijuar me lëshimin ose refuzimin e lejes së qëndrimit/lejes unike.

III. LËSHIMI I LEJES SË QËNDRIMIT OSE LEJES UNIKE

1. Pas marrjes së autorizimit për lëshimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, struktura përgjegjëse pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, bën shënimin në rubrikën përkatëse për çdo aplikim të regjistruar në modulën *e-leje* qëndrimi dhe i përcjell të huajt në adresën e *email*-it të deklaruar në aplikimin *online*, njoftimin për miratimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku e informon, për:

a) miratimin e lejes së qëndrimit/lejes unike dhe pajisjen me nr. personal FID;

b) detyrimin për regjistrim pranë zyrës së gjendjes civile për regjistrimin e adresës së vendbanimit;

c) kryerjen e pagesës së vlerës së kartës biometrike, nëpërmjet mandatit të arkëtimit.

2. Procedura e aplikimit për dokument biometrik leje qëndrimi/leje unike për të huajt, bëhet në zyrën e migracionit, pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, nga vetë i huaji, ku dhe tërhiqet ky dokument pas prodhimit dhe aktivizimit të *CHIP*-it të trupëzuar në të.

3. Në momentin kur i huaji pajiset me dokumentin leje qëndrimi/leje unike, ai dorëzon pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin lejen e qëndrimit/lejen unike ekzistuese (në rast të kërkesës për ripërtëritjen e saj), e cila më pas ruhet në dosjen e të huajt.

4. Të huajt që janë pjesë e kategorive të përcaktuara në nenet 43, 52, 53 dhe shkronjës “dh”, të pikës 1, nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, pajisen me leje qëndrimi të tipit A, pika 8, shkronjat “b” dhe “c”, të seksionit A, të kreut III, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Miratimi dhe lëshimi i lejes së qëndrimit/lejes unike, nga autoriteti për kufirin dhe migracionin u njoftohet automatikisht Sistemit *e-Visa* (VISA) dhe Sistemit të Shërbimeve të Punësimit (SSHP).

IV. ANULIMI/REFUZIMI I LËSHIMIT APO RIPËRTËRITJES SË LEJES SË QËNDRIMIT OSE LEJES UNIKE

1. Për rastet e refuzimit të lëshimit apo ripërtëritjes së lejes së qëndrimit/lejes unike, të parashikuara në nenin 34, të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, i ndryshuar, kur konstatimi bëhet në fazën e aplikimit, strukturat përgjegjëse të autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin marrin masa për njoftimin e të huajt mbi refuzimin, si dhe vazhdimin e procedurave ligjore sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 89 dhe nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar.

2. Për rastet kur konstatimi bëhet në fazën e vlerësimit të aplikimit për leje qëndrimi/leje unike, autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin merr vendimin përfundimtar për refuzimin e lëshimit ose ripërtëritjes së lejes së qëndrimit/lejes unike dhe njofton autoritetin vendor me shkresë zyrtare dhe nëpërmjet shënimit në modulën *e-leje* qëndrimi mbi këtë refuzim, për të vijuar me procedurat ligjore, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 89 dhe nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar.

3. Në rast se autoritetet e përfshira në bashkëpunim për procedurën e lëshimit të lejes së qëndrimit/lejes unike, konstatojnë një nga rastet për të cilat bëhet anulimi i lejes së qëndrimit/lejes unike, i kërkojnë me shkresë/në rrugë elektronike autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, anulimin e autorizimit, për të cilën më parë mund të kenë dhënë aprovimin.

4. Kur autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin merr vendim për anulimin dhe bërjen të pavlefshme të lejes së qëndrimit/lejes unike të lëshuar, ky vendim i përcillet për zbatim autoritetit përgjegjës në nivel vendor me shkresë zyrtare, duke u pasqyruar i plotë në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt – FER.

5. Autoriteti përgjegjës në nivel vendor njofton të huajin për refuzimin/anulimin, si dhe për arsyen e këtij vendimi, sipas formatit të refuzimit/anulimit të modelit në aneksin nr. 2 të këtij udhëzimi. Refuzimi/anulimi i lejes së qëndrimit/lejes unike shënohet në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt – FER, së bashku me arsyetimin përkatës.

6. Për të huajt që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një format standard i refuzimit për qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohet formati i parashikuar në këtë marrëveshje.



7. Pas refuzimit ose anulimit të lejes së qëndrimit/lejes unike, referuar parashikimeve të neneve 34, 45, pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 72, neneve 89 dhe 94, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar, kur i huaji ndodhet në territor, autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin merr masa për largimin e të huajt nga territori i Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar, përjashtuar rastet e parashikuara në nenin 107.

8. Autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin, në rastet kur anulon/refuzon lejen e qëndrimit/unike të shtetasit të huaj në përmbushje të detyrimeve ligjore, i cili ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, njofton shtetasin e huaj në rrugë elektronike, në numrin e kontaktit, adresën e vendbanimit të vendosur në aplikim, për refuzimin/anulimin e lejes së qëndrimit/unike dhe detyrimin për lënien e territorit, si dhe njofton Drejtorinë për Menaxhimin e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave me shkresë, duke vënë në dijeni autoritetin qendror për kufirin dhe migracionin.

9. Refuzimi i aplikimeve për leje qëndrimi/leje unike, si dhe anulimi i lejeve të lëshuara u njoftohet automatikisht sistemeve VISA dhe SSHP.

V. LËSHIMI I LEJES UNIKE PËR KATEGORI TË VEÇANTA

1. Për kategoritë e shtetasve të huaj që trajtohen me leje unike për kategori të veçanta, të parashikuara në nenin 81, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar, aplikimi i dërgohet fizikisht autoritetit për kufirin dhe migracionin. Për rastet kur i huaji duhet të pajiset me vizë, aplikimi trajtohet fillimisht nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë për Evropën dhe Punët e jashtme.

2. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin e përcjell në formë shkresore aplikimin brenda 2 (dy) ditësh pune, pranë autoritetit qendror të kufirit dhe migracionit, i cili e shqyrton në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave pranë këtij autoriteti.

3. Komisioni pasi merr praktikën nga DVKM-ja, në rrugë elektronike njofton Sektorin e Arkivës Kriminale në DPK për verifikimin e shtetasit të huaj, i cili kthen përgjigje, brenda 2 (dy) ditë pune, në rrugë elektronike.

4. Komisioni vendos miratimin ose refuzimin e aplikimit për leje unike për kategori të veçanta dhe njofton autoritetin vendor mbi vendimin e marrë,

brenda 5 ditësh pune nga depozitimi i kërkesës pranë këtij institucioni.

5. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në bazë të vlerësimeve rast pas rasti, kërkon nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin verifikimin e përmbushjes së kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar. Vendimi i Komisionit merret brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, sipas parashikimeve të ligjit për të huajt, afat i cili llogaritet duke marrë në konsideratë kohën e nevojshme për përgjigjen e autoritetit vendor dhe plotësimin e dokumentacionit nga i huaji.

6. Pas miratimit të aplikimit, autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin ku i huaji ka vendqëndrimin e përkohshëm, pajis të huajin me dokumentin “Leje unike për kategori të veçanta” në formatin e miratuar me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 234, datë 13.12.2022.

VI. PËRLLOGARITJA E FILLIMIT TË AFATEVE TË LEJEVE TË QËNDRIMIT

1. Me qëllim unifikimin e procedurës për mënyrën e përllogaritjes së fillimit të afatit të lejes së qëndrimit/lejes unike, si datë fillimi, pas miratimit nga të gjitha strukturat përgjegjëse, do të jetë data e pajisjes së të huajt me leje provizore.

2. Për shtetasit e huaj që duhet të aplikojnë me vizë, si datë e fillimit të lejes së qëndrimit/lejes unike do të jetë data e pajisjes së të huajt me leje provizore.

3. Për procedurën e ripërtëritjes, afati i lejes së rinovuar do të fillojë një ditë pas skadimit të lejes së mëparshme të qëndrimit/lejes unike.

4. Lejet e përhershme të qëndrimit, të tipit C, në mbështetje të pikës 6, të nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar, do të lëshohen me afat 10-vjeçar (dhjetëvjeçar). Çdo ripërtëritje e lejes se përhershme të qëndrimit të tipit C, pas kalimit të afatit 10-vjeçar, do të pasqyrohet në komentet përkatëse në sistemin FER nga struktura përgjegjëse pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit/lejes unike, ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e kërkesës për pajisje për herë të parë, përjashtuar aplikimin për vizë për kategorinë e shtetasve të huaj që kërkojnë pajisjen me vizë të tipit D, kur aplikojnë për herë të parë.

2. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 114, datë 9.7.2024, “Për procedurën e lëshimit, e



refuzimit të lëshimit, e ripërtëritjes apo e anulimit të lejes së qëndrimit dhe lejes unike për të huajin”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

UDHËZIM
Nr. 96, datë 11.5.2026

**PËR INFORMACIONIN QË U JEPET
PERSONAVE TË CILËT JANË SUBJEKT
I VERIFIKIMEVE NË VIJËN E DYTË NË
PIKAT E KALIMIT KUFITAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 15, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Dokumenti informues që u vihet në dispozicion personave subjekt të verifikimit në vijën e dytë (në vijim “dokumenti”), titullohet “Formular informacioni për verifikim të detajuar në vijën e dytë”, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Dokumenti hartohet në përputhje me formatin e shkresave zyrtare të përdorura në pikën e kalimit kufitar dhe nënshkruhet e vuloet nga punonjësi i autorizuar për ushtrimin e së drejtës së firmës dhe vulës në këto pika të kalimit kufitar. Ky

dokument i dorëzohet personit, që është subjekt i verifikimit kufitar në vijën e dytë (në vijim “personi”).

3. Kur personi është shtetas i huaj, dokumenti lëshohet në gjuhën shqipe dhe në një nga gjuhët e përfshira në shtojcën nr. 1, sipas kërkesës së tij. Në mungesë të një kërkesë të tillë, dokumenti lëshohet në gjuhën që përkon me shtetësinë e personit, ose në gjuhën që ka arsye të besohet se personi e kupton.

4. Personat që nuk kuptojnë asnjë nga gjuhët e parashikuara në shtojcën nr. 1, pajisen me dokumentin në gjuhët shqipe dhe angleze.

5. Dokumenti i lëshuar në gjuhë të huaj ruan formatin e dokumentit të hartuar në gjuhën shqipe, duke plotësuar në gjuhë të huaj vetëm pjesën e përmbajtjes, përfshirë titullin, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1.

6. Në rast mosmarrëveshjeje mbi përmbajtjen e dokumentit, referencë merret versioni në gjuhën shqipe.

7. Pikat e kalimit kufitar duhet të disponojnë shtojcën nr. 1, në të gjitha gjuhët, në format të printuar ose elektronik, me qëllim pajisjen e personit me dokumentin në gjuhën e kërkuar.

8. Udhëzimi nr. 579, datë 20.10.2016, i Ministrit të Punëve të Brendshme, “Për informacionin që u jepet personave të cilët janë subjekt i verifikimeve në vijën e dytë në pikat e kalimit kufitar”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari



Shtojca nr. 1

Shtojca nr. 1/a: Formular informacioni për verifikim të detajuar në vijën e dytë, në gjuhën shqipe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____
Pika e Kalimit Kufitar _____

Nr. _____ Prot. _____, më _____.20__

Drejtuar: Z./Zj. _____

Formular informacioni për verifikim të detajuar në vijën e dytë

Në kuadër të verifikimit kufitar të personave që kalojnë kufirin, ju do t'i nënshtroheni tani, më datë _____, në PKK _____, një verifikimi të hollësishëm nga roja kufitare me numër identifikimi _____.

Ky verifikim mund të marrë kohë. Ju lutemi të jeni të përgatitur për këtë fakt.

Ky verifikim mund të përfshijë veçanërisht pikat e mëposhtme:

- Verifikimin e dokumenteve tuaja të udhëtimit për të vlerësuar origjinalitetin dhe vlefshmërinë e tyre;
- Verifikimin e vizës suaj ose dokumentit që mundëson qëndrimin tuaj, për të vlerësuar origjinalitetin dhe vlefshmërinë e tyre;
- Verifikimin e itinerarit, si dhe të qëllimit dhe të kohës së qëndrimit për udhëtimin e synuar nga ana juaj;
- Verifikimin e mjeteve të jetesës që zotëroni për të mbuluar shpenzimet që rrjedhin nga kohëzgjatja dhe qëllimi i udhëtimit të synuar nga ju;
- Verifikimin nëse ekziston ndonjë shënim ose njoftim;
- Verifikimin për t'u siguruar se nuk keni tejkaluar kohën maksimale të afatit të lejuar të qëndrimit në territor;
- Verifikimin e sendeve dhe mjetit tuaj të transportit;

Çdo udhëzim i dhënë nga rojet kufitare duhet të zbatohet në secilin hap.

(Detyra e firmuesit)
(Titull / Gradë Emër Mbiemër)
(Firmë)
(Vulë)

Adresa: _____



Shtojca nr. 1/b: Përmbytja e formularit në gjuhën angleze

Information sheet on thorough second line check

You shall now undergo a thorough check as part of a border check on persons conducted at the border crossing point _____, on _____, by the border guard with the service identification number _____.

This check could take quite some time. Please prepare yourself for this fact.

This check may include the following points in particular:

- Check on your travel documents to determine whether they are genuine and valid;
- Check on your visa or the document authorizing your stay to determine whether it is genuine and valid;
- Check on your travel route and on the purpose and duration of your intended trip;
- Check on the means of subsistence you have available to you to cover living expenses for the intended duration and purpose of your trip;
- Check whether an alert is issued;
- Check to be sure that you did not exceed the maximum duration of authorized stay in the territory;
- Check on your means of transport and belongings;

Any instruction issued by the border guards must be obeyed in each instance.



Shtojca nr. 1/c: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën bullgare

Информационна листовка относно извършването на контрол на втора гиния

В рамките на граничния контрол па лица на _____ (data), на Граничен контролно - пропускателен пункт _____ (РКК), Вие ще въдете подложен(-а) на цялостна проверка от страна на проверяващ граничен служител със служевна карта номер (nr)_____.

Молим на проявите разбиране относно това, че въпросната проверка ще отнеме известно време.

Тази проверка по-специално може да включка следните моменти:

- Проверка на документите за пътуване по отношение автентичността и валидността им;
- Проверка на автентичността и валидността на съответната виза или разрешително за пребиваване;
- Проверка на маршрута както и на целта и продължителността на иланирания престой;
- Проверка на наличните средства за издръжка за срока и целта на планирания престой;
- Проверка включваща справка относно евентуално подадени сигнали за издирване в масиви с данни;
- Проверка относна това, дали максималната продължителност на разрешен престой на територията не е вила просрочена;
- Проверка на вашите транспортни средства и вещи;

Указанията на проверяващите гранични служители следва да се съблюдават във всеки един случай.



Shtojca nr. 1/ç: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën çeke

Informační leták pro kontrolu ve druhém kontrolním pásmu

V rámci kontroly osob na hraničním přechodu budete dne (datum) na hraničním přechodu (místo) úředníkem (úředníky) hraniční kontroly s číslem služebního průkazu podroben(a) důkladné kontrole.

Prosím připravte se na to, že tato kontrola bude určitou dobu trvat.

Tato kontrola může obzvláště zahrnovat následující body:

- kontrola pravosti a platnosti cestovních dokladů
- kontrola pravosti a platnosti víza, resp. povolení k pobytu
- kontrola cestovní trasy, účelu a délky trvání předpokládané cesty
- проверка средств, které máte k dispozici к úhradě životních nákladů pro předpokládanou dobu trvání a předpokládaný účel cesty
- kontrola, zda po Vás není vyhlášeno pátrání
- kontrola překročení nejvyšší přípustné doby pobytu na území
- kontrola na svých dopravních prostředcích a majetku

V každém případě se musíte řídit pokyny kontrolujícího úředníka



Shtojca nr. 1/d: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën daneze

Informationsblad over en kontrol ved den anden kontrollinie

I forbindelse med kontrol af personer ved en grænsepassage bliver De den(dato) ved grænseovergangsstedet (sted) gennem grænsekontrolltjenestemændene med tjenestenummer underkastet en meget omfattende kontrol.

Vi beder Dem, at De indstiller Dem på, at denne kontrol kan tage ret lang tid.

Denne kontrol kan især omfatte følgende punkter:

- Kontrol af rejsedokumenter omfattende ægthed og gyldighed
- Kontrol af ægtheden og gyldigheden af visum og opholdstilladelse
- Kontrol af rejseruten såvel som årsagen og længden af den planlagte rejse
- Kontrol af de økonomiske midler som står til rådighed for bestridelsen af det personlige underhold i forbindelse med den planlagte længde og grund af rejsen
- Efterlysningskontrol
- Kontrol af overskridelse af det længst tilladte ophold i område
- Kontrol af dine stuff og transportkøretøjer

Anvisningerne fra grænsekontrolltjenestemændene skal i hvert tilfælde efterkommes.



Shtojca nr. 1/e: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën estoneze

Teabeleht teise astme kontrolli teostamise kohta

Piiril isikute kontrollimise korras (kuupäev) piiripunktis (asukoha nimi) teostab teie suhtes põhjalikku kontrolli piirivalveametnik ametimärgi numbriga

Palun arvestage sellega, et käesolev kontrollimine võtab aega.

Põhjalik kontroll hõlmab eelkõige järgmisi punkte:

- reisidokumentide ehtsuse ja kehtivuse kontrollimine;
- viisa või elamisloa ehtsuse ja kehtivuse kontrollimine;
- reisimarsruudi ning kavandatava reisi eesmärgi ja kestvuse kindlakstegemine;
- kavandatava reisi aja ning kavandatava reisi eesmärgi saavutamise jaoks piisavate elatusvahendite olemasolu kontrollimine;
- tagaotsitavate isikute andmebaasi kontrollimine;
- territooriumil lubatud viibimise maksimumkestvuse mitteületamise kontrollimine;
- transportivahendid ja asjad kontrollimine;

Piirivalveametnike korraldusi tuleb igal juhul järgida.



Shtojca nr. 1/ë: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën finlandeze.

Tiedotuslehti, joka koskee tarkastusta toisella linjalla

Henkilöiden rajanylitystarkastuksissa (päiväys) rajanylityspaikassa
.....(paikka) Teidät tarkastaa perusteellisesti
rajavartioviranomainen, jonka henkilöstönumero on

Pyydämme ottamaan huomioon, että tämä tarkastus kestää jonkin aikaa.

Tarkastus saattaa käsittää erityisesti seuraavat kohdat:

- Matkustusasiakirjojen aitouden ja voimassaolon tarkastus
- Viisumin tai oleskeluperusteen aitouden ja voimassaolon tarkastus
- Matkareitin sekä suunnitellun matkan tarkoituksen ja keston tarkastus
- Rahavarojen tarkastus, jotka on varattu toimeentuloon matkan suunnitelluksi ajaksi ja sen tarkoitukseen
- Etsintäkuulutusten tarkastus
- Tarkastus koskien sitä, onko oleskelun enimmäiskesto alueella ylitetty;
- Tarkastus koskien tavarat ja kulkuvälineet

Rajavartioviranomaisten ohjeita on noudatettava kaikissa tapauksissa.



Shtojca nr. 1/f: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën franceze

Feuille d'information concernant une vérification à la deuxième ligne de contrôle

Dans le cadre du contrôle des personnes aux points de passage frontalier vous êtes soumis(e) le (date) au point de passage frontalier (localité) à une vérification approfondie qui sera effectuée par l'officier de contrôle portant le document de service nr.

Vous êtes prié(e) de prendre en considération que cette vérification durera quelque temps.

Cette vérification peut comprendre en particulier les éléments suivants:

- Vérification de l'authenticité et de la validité des documents de voyage;
- Vérification de l'authenticité et de la validité du visa ou du titre de séjour;
- Vérification du trajet du voyage ainsi que de l'objet et de la durée du voyage envisagé;
- Vérification des moyens de subsistance à votre disposition pour la durée et l'objet du voyage envisagé;
- Vérification dans les fichiers de recherche;
- Vérification si vous n'avez pas dépassé la durée de séjour maximale autorisée sur le territoire;
- Vérification de vos moyens de transport et d'effets

Vous avez devoir de vous plier aux ordres des officiers de contrôle frontalier.



Shtojca nr. 1/g: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën greke

Πληροφορίες σχετικά με τους ελέγχους στα συνορα

Στα πλαίσια του συνοριακού ελέγχου των προσώπων, θα γινή ελεγχος (data)....., στα συνορα (PKK), θα γίνονται ελέγχοι απο ανωτερους υπαλληλους με τον αριθμο (nr).....

Οι έλεγχοι αυτοι θα διαρκεσουν για αρκετα μεγαλο χρονικο διαστημα.

Κατα τους ελεγχους θα εξεταζονται:

- Η γνησιότητα και η ισχύς των ταξιδιωτικων εγγραφων;
- Η γνησιότητα και η ισχύς της βίζας σας και την άδεια διαμονής σας;
- Η διαδρομη ο σκοπος και η διαρκεια του ταξειδιου;
- Η συντηρηση του προσωπου, κατα την διαρκεια του ταξειδιου;
- θα γινεται επαληθευση της διευθυνσης του ταξειδιωτη και οπον απαιτειται θα ελεγχεται η διαρκεια του ταξειδιου και απο τον τοπο διαμονης;
- Ελλεχος σε περιπτωση που καταζυτειται;
- Έλεγχος των μεταφορικών μέσων και των αντικειμένων

Θα πρεπει να συμμορφωνεστε προς της υποδειξεις των σινοριακων υπαλλιλων



Shtojca nr. 1/gj: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën gjermane

Informationsblatt betreffend eine Kontrolle in der zweiten Kontrolllinie

Im Rahmen der Grenzübertrettskontrollen von Personen werden Sie am (Datum) an der Grenzübergangsstelle (Örtlichkeit) durch den/die Grenzkontrollbeamten mit der Dienstaussweisnummer einer eingehenden Kontrolle unterzogen.

Bitte stellen Sie sich darauf ein, dass diese Kontrolle einige Zeit dauern wird.

Diese Kontrolle kann insbesondere folgende Punkte umfassen:

- Kontrolle der Reisedokumente auf Echtheit und Gültigkeit
- Kontrolle der Echtheit und der Gültigkeit des Visums bzw. des Aufenthaltstitels
- Kontrolle der Reiseroute sowie des Zwecks und der Dauer der beabsichtigten Reise
- Überprüfung der zur Verfügung stehenden Mittel zur Bestreitung des Lebensunterhalts für die beabsichtigte Dauer und den beabsichtigten Zweck der Reise
- Kontrolle auf eine Fahndungsausschreibung
- Kontrolle auf Überschreitung der zulässigen Höchstdauer des Aufenthaltes im Hoheitsgebiet;
- Kontrolle auf Ihrem Verkehrsmittel und Zubehör

Den Anweisungen der Grenzkontrollbeamten ist jedenfalls Folge zu leisten.



Shtojca nr. 1/h: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën holandeze

Informatieblad betreffende een controle bij de tweede controlelijn

Binnen het kader van controles van personen bij grensoverschrijding wordt U op
(datum) bij de grensdoorlaatpost (plaats) door de
grensbeëakingsambtenaar/ambtenaren met het dienstpasnummer aan een
grondige controle onderworpen.

Let op: deze controle kan enige tijd duren!

Deze controle kan in het bijzonder volgende punten omvatten:

- controle van de echtheid en de geldigheid van de reisdocumenten
- controle van de echtheid en de geldigheid van het visum of de verblijfsvergunning
- controle van de reisroute als ook het doel en de duur van de geplande reis
- controle van de voor de geplande duur en het geplande doel van de reis ter beschikking staande middelen van bestaan
- raadpleging van het opsporingsregister
- verificatie dat de maximale duur van het toegestane verblijf op het grondgebied niet werd overschreden
- Controle van uw Vervoermiddelen en bezittingen

De orders van de grensbeëakingsambtenaren moeten in ieder geval worden nagekomen.



Shtojca nr. 1/i: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën hungareze

Tájékoztató elkülönített helyen történő ellenőrzésről

Személyi határellenőrzés keretében -án /-én (dátum) (hely)
határátkelőhelyen a(z) igazolványszámmal rendelkező ellenőrző tisztviselő
részletes ellenőrzést végez Önnél.

Kérjük, készüljön fel arra, hogy az ellenőrzés időt vesz igénybe.

Az ellenőrzés különösen az alábbi szempontokra terjedhet ki:

- útiokmányok valódiságának és érvényességének ellenőrzése
- vízum és tartózkodási engedély valódiságának és érvényességének ellenőrzése
- a tervezett utazás útvonalának, valamint céljának és időtartamának ellenőrzése
- a utazás tervezett időtartamának és céljának megfelelő rendelkezésre álló fedezet vizsgálata
- körözési nyilvántartásban végzett ellenőrzés
- Ellenőrizze, hogy biztos benne, hogy nem lépte túl a maximális időtartamát engedélyezett tartózkodás területén;
- a közlekedési eszközök és a holmiját ellenőrzése

Az ellenőrző tisztviselő utasításainak köteles eleget tenni



Shtojca nr. 1/j: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën italiane

Foglio informativo riguardante un controllo nella seconda linea di controllo

Nell'ambito dei controlli del passaggio delle persone alla frontiera Lei verrà sottoposto a controllo il (Data) al posto di frontiera (località) dal/i funzionario/i addetto/i ai controlli delle frontiere col numero identificativo di servizio

La preghiamo di prendere in considerazione che per effettuare detto controllo sarà necessario del tempo.

Questo controllo potrà essere articolato come segue:

- Controllo dell'autenticità e della validità del documento di viaggio
- Controllo dell'autenticità e della validità del visto e/o del permesso di soggiorno
- Controllo del percorso del viaggio nonché del motivo e della durata dello stesso
- Controllo dei mezzi pecuniari a disposizione per il proprio mantenimento durante l'intero viaggio in relazione alla durata ed allo scopo dello stesso
- Controllo di eventuali segnalazioni esistenti sulla persona
- Controllo per verificare l'eventuale superamento dei limiti massimi del soggiorno che si desidera intraprendere e dunque della residenza permessa sul territorio.
- Controllo dei mezzi di trasporto e di roba

E' obbligatorio seguire quanto richiesto dai funzionari addetti al controllo della frontiera.



Shtojca nr. 1/k: Përmbytja e dokumentit në versionin e gjuhëve kroate / malazeze / serbe / boshnjake

Informacioni List u vezi kontrole u drugoj kontrolnoj liniji

U okviru granične prelanzne kontrole osoba bitčete (datum) na granično prelaznom mjestu od graničnog/ njih kontrolnih službenika sa službenim iskaznim brojem podvrgnuti detaljnoj kontroli.

Molimo Vas računajte sa time da će ta kontrola trajati izvjesno vrijeme.

Ta kontrola može prije svega sadržavati sljedeće točke:

- Kontrola putnih dokumenata, autentičnost i dali su još važeći
- Kontrola ispravnosti i dali je viza odnosno dozvola boravka još važeća
- Kontrola Vašeg plana putovanja kao i razlog i dužina planiranog putovanja
- Provjeravanje sredstava kojima raspolazete za Vaše životne potrebe, dužina i svrha Vašeg putovanja
- Kontrola u listi traženih osoba
- Provjeravanje dali ste prekoračili dozvoljenu maksimalnu dužinu boravka na području
- Kontrola vaše prijevozno sredstvo i stvari

U svakom slučaju se morate pridržavati uputa graničnokontrolnih službenika.



Shtojca nr. 1/I: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën letoneze

Informativs ziņojums par pārbaudi otrajā kontroles līnijā

Personu robežpārbaudes pasākumu ietvaros, , (datums) robežšķērsošanas vietā..... (vietas nosaukums), Jūs tiksiet pakļauts pilnai pārbaudei, kuru veiks robežkontroles ierēdne/īs, ar dienesta apliecības numuru.....

Lūdzu sagatavoties tam, ka šī pārbaude aizņems zināmu laiku.

Dotā pārbaude īpaši ietver sekojošus punktus:

- Ceļošanas dokumentu derīguma termiņa kontrole un pārbaude, vai tiem nav viltojuma pazīmju;
- Vīzas, uzturēšanās atļaujas jeb cita dokumenta, kas dod tiesības uzturēties valstī, derīguma termiņa kontrole un pārbaude, vai tam nav viltojuma pazīmju;
- Plānotā ceļojuma maršruta, kā arī tā mērķa un ilguma pārbaude;
- Pārlicināšanās par to, vai iecerētās uzturēšanās laikam un mērķim personas rīcībā ir pietiekami iztikas līdzekļi;
- Kontrole policijas izsludināto meklēšanu ietvaros;
- Pārlicināšanās par to, vai attiecīgās personas nav pārsniegušas maksimālo atļauto uzturēšanās ilgumu teritorijā;
- Kontrole par transportlīdzeklī un par sīkumi;

Robežkontroles ierēdņa norādījumu izpilde ir obligāta.



Shtojca nr. 1/m: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën lituaneze

Informacinis lapas dėl antros linijos patikrinimo

Vykdamt asmenų sienos perėjimo kontrolę, (data) sienos perėjimo punkte..... (vieta) Jus kruopščiai patikrins pasienio kontrolės pareigūnas/pareigūnė, pareigūno pažymėjimo numeris

Prašome nusiteikti, kad šis patikrinimas kurį laiką užtruks.

Šis patikrinimas gali ypač apimti šiuos punktus:

- Kelionės dokumentų patikrinimas dėl jų tikrumo ir galiojimo laiko
- Vizos arba leidimo gyventi patikrinimas dėl jų tikrumo ir galiojimo laiko
- Kelionės maršruto bei numatytos kelionės tikslo ir trukmės kontrolė
- Numatytam kelionės laikotarpiui ir numatytam kelionės tikslui skirtų pinigų turėjimo patikrinimas
- Patikrinimas dėl asmens paieškos paskelbimo
- Kontrolė dėl ilgiausiai leistino buvimo laikotarpio peržengimo teritorijoje;
- Kontrolė jūsų moyen de transportavimo ir daiktams

Taip pat privaloma vykdyti pasienio kontrolės pareigūnų nurodymus.



Shtojca nr. 1/n: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën maqedonase

Информативна брошура относно извършването на контрола на втора гиния

Во рамките на граничната контрола па лица на _____ (data), на граничен - премин _____ (РКК), Вие ќе вџдете подложен (-А) на сеопфатна проверка од страна на проверуваат граничен службеник со служевна карта број (nr) _____.

Молиме на пројавите разбиране за тоа дека предметната проверка ќе потрае известно време.

Оваа проверка особено може да вклучка следните моменти:

- Проверка на документите за патување по отношение автентичноста и валидноста им;
- Автентичност и валидноста на соодветната виза или разрешително за престој;
- Проверка на маршрутата како и целта и времетраењето на иланирания престој;
- Проверка на достапните средства за издрџка за рокот и целта на планираниот престој;
- Проверка вклучува референца за евентуално поднесени сигнали за издирване во низи со податоци;
- Проверка за тоа дали максималното времетраење на разрешен престој на територијата не е вила Неверојатната;
- Проверка на вашите транспортни средства и предмети;

Указанијата на проверуваат гранични службеници треба да се съблюдават во секој случај.



Shtojca nr. 1/nj: Përbajtja e dokumentit në gjuhën poloneze

Broszura informacyjna dotycząca kontroli 2 drugiej linii

W ramach odprawy granicznej osób zostaje Pan/ Pani z dnia(data) na przejściu granicznym.....(miejsce) poddany szczegółowej kontroli przez funkcjonariusza służby granicznej o numerze legitymacji

Proszę mieć na uwadze, że kontrola ta zajmie trochę czasu.

- Kontrola może obejmować 2 szczególności następujące punkty:
- kontrola dokumentów podróży pod kątem ich prawdziwości i ważności
- kontrola i ważność wizy lub dokumentu pobytowego
- weryfikacja posiadanych środków utrzymania na planowany okres i do celów podróży
- kontrola pod kątem wpisów do baz ściganych/ poszukiwanych
- kontrola pod kątem przekroczenia maksymalnego czasu dozwolonego pobytu na terytorium
- Kontrolę nad swoimi środkami transportu i rzeczy

W każdym przypadku należy stosować się do poleceń funkcjonariusza służby granicznej.



Shtojca nr. 1/o: Përbajtja e dokumentit në gjuhën portugeze

Folha de informação relativa a fiscalização na segunda fase do controle

No quadro de controle para a transposição da fronteira de pessoas, em (data)..... no posto de transito de fronteira (lugar)..... exercido pelo(a) funcionário(a) encarregado(a) do controle de fronteira, com número de identificação de serviço.....

Por favor, considere que dito controle demorará um pouco e poderá abranger especificamente os seguintes pontos:

- Verificação de autenticidade e validade do documento de viagem.
- Verificação de autenticidade e validade do visto, em particular do título relativo à permanência no País.
- Controle do itinerário de viagem, assim como o objetivo e a duração prevista de viagem em questão
- Verificação dos meios financeiros a disposição para a própria manutenção durante o período previsto e para o programado objetivo.
- Controle de eventual mandado de captura.
- Controle para verificar o eventual superamento do período máximo de permanência no território.
- controle de seus meios de transporte e pertences.

E' obrigatório seguir quanto solicitado dos funcionários encarregados do controle de fronteira.



Shtojca nr. 1/p: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën rumune

Informații privind efectuarea unui control în a doua linie de control

În cadrul controlului persoanelor la trecerea frontierei, sunteți supus unui control amănunțit, la data de (data), la punctul de trecere a frontierei (locul), de către ofițerul de control al frontierei, posesor al legitimației de serviciu nr.

Vă rugăm să țineți cont că acest control va dura ceva timp.

Controlul poate cuprinde în mod special următoarele puncte:

- documentele de călătorie vor fi controlate, pentru a se depista dacă sunt falsificate sau expirate.
- viza sau titlul de ședere vor fi controlate, pentru a se depista dacă sunt falsificate sau expirate.
- se vor verifica traseul, scopul și durata călătoriei intenționate.
- se va verifica dacă persoana controlată deține mijloacele de subzistență necesare scopului și duratei călătoriei intenționate de aceasta.
- se va verifica dacă persoana este dată în căutare.
- se va verifica dacă persoana a depășit perioada maximă de ședere pe teritoriul.
- verifica pe mijloacele de transport și a bunurilor.

Sunteți obligat să dați curs instrucțiunilor ofițerului de control al frontierei.



Shtojca nr. 1/q: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën ruse

Информационный листок о проверке на второй линии контроля

В рамках проверки лиц на пограничных контрольно-пропускных пунктах.

Вы будете подвержены обстоятельной проверке на (дата) на ограниченном контрольно-пропускном пункте (наименование) сотрудником/ сотрудниками службы пограничного контроля с номером служебного удостоверения

Учтите, пожалуйста, что данная проверка займет определенное время.

В центре внимания данной проверки могут стоять, в частности, следующие пункты:

- Проверка заграничных паспортов на предмет их подлинности и действительности
- Проверка визы или статуса пребывания на предмет их подлинности и действительности
- Проверка маршрута поездки, а также цели и продолжительности предполагаемой поездки
- Проверка наличия средств финансирования жизни на предполагаемый срок и в предполагаемых целях поездки
- Проверка на предмет наличия объявления в розыск
- Проверка на предмет превышения максимально допустимого срока пребывания на территории государств-членов
- Проверка на ваших транспортных средств и личных вещей

В любом случае Вы обязаны следовать указаниям сотрудников службы пограничного контроля.



Shtojca nr. 1/r: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën shqipe

Informačný leták ohľadne kontroly pri druholíniovej kontrole

Sa v rámci kontroly osôb pri prekračovaní štátnej hranice podrobíte dôkladnej kontrole dňa.....(dátum) na hraničnom priechode.....(územie), ktorú vykoná/vykonajú pracovník/pracovníci hraničnej kontroly so služobným číslom

Rátajte s tým, že táto kontrola bude nejaký čas trvať.

Táto kontrola môže predovšetkým zahŕňať nasledovné body:

- kontrola pravosti a platnosti cestovných dokladov
- kontrola pravosti a platnosti víza, resp. povolenia na pobyt
- overenie trasy cesty, ako aj účelu a dĺžky plánovanej cesty
- preskúmanie dostatočného množstva prostriedkov na živobytie na dĺžku a účel plánového pobytu
- kontrola v pátracom systéme, či nebolo vydané upozornenie
- kontrola prekročenia maximálne povolenej dĺžky pobytu na výsostnom území
- kontrola na svojich dopravných prostriedkoch a majetku

V každom prípade je potrebné sa riadiť pokynmi pracovníkov hraničnej kontroly.



Shtojca nr. 1/rr: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën shqipe

Informator glede kontrole v drugi kontrolni çrtri

V okviru kontrol oseb na mejnih prehodih Vas bo dne (datum) na mejnem prehodu (kraj) temeljito kontroliral uradnik mejne kontrole s številko službene izkaznice

Prosimo, da se pripravite na to, da bo kontrola trajala nekaj časa.

Kontrola lahko obsega posebej naslednje točke:

- kontrola potnih dokumentov glede na pristnost in veljavnost
- kontrola pristnosti in veljavnosti vizuma oz. dovoljenja za bivanje
- kontrola potovalne poti ter namena in trajanja nameravanega potovanja
- preverjanje sredstev, ki so na razpolago za preživljanje za nameravano trajanje in za nameravan namen potovanja
- kontrola glede tiralice
- kontrola glede prekoračitve dovoljenega maksimalnega trajanja bivanja na ozemlju
- kontrola na vaših prevoznih sredstvih in stvari

V vsakem primeru je treba ravnati po navodilih uradnika mejne kontrole.



Shtojca nr. 1/s: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën spanjolle

Hoja de información relativa a la fiscalización en la segunda fase del controle

En el ámbito del controle para la trasposición de frontera, en (fecha)..... en el puesto de tránsito de frontera (lugar) ejercido por el funcionario/a encargado/a del controle de frontera, con tarjeta de servicio número usted será submetido al siguiente controle:

Por favor, considere que el susodicho controle tardará un poco y podrá abarcar específicamente los siguientes asuntos:

- Verificación de la autenticidad y validez del documento de viaje.
- Verificación de la autenticidad y validez del visado, en particular del título relativo a la permanencia en el País.
- Controle del itinerario del viaje, como también del objetivo y la duración prevista del mismo viaje.
- Verificación de los medios financieros a disposición para la manutención durante el período previsto y para el programado objetivo.
- Controle en la lista de personas señaladas (para busca e/o captura)
- Controle de la eventualidad de haber excedido del periodo máximo de permanencia en el territorio.
- Controle de sus medios de transporte y sus pertenencias.

Las directivas de las Autoridades del Puesto fronterizo deberan ser obedecidas.



Shtojca nr. 1/sh: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën suedeze

Informationsblad beträffande en kontroll i det andra kontrolleret

Inom ramen av gränsövergångskontroller av personer måste du genomgå den(datum) en ingående kontroll vid gränsövergångsstället(ort) genom gränskontrolltjänstemannen med legitimationsnummret

Vänligen var beredd på att denna kontroll kan vara tidskrävande.

Denna kontroll kan huvudsakligen beröra följande punkter:

- kontroll av resedokumentens äkthet och giltighet
- kontroll av äkthet och giltighet av visum, respektive uppehållstillståndsärendet
- kontroll av reserutten, syfte och vistelsens längd av den planerade resan
- finansiella medel för levnadskostnader för planerad tid och syfte för resan
- kontroll om det finns en efterlysning
- kontroll av överstigande av det maximala uppehållstillståndet
- kontroll av dina transportmedel och tillhörigheter

Anvisningarna av gränskontrolltjänstemännen måste följas till fullo.



Shtojca nr. 1/t: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën turke

İkinci kontrol hattındaki kontrol ile ilgili bilgi formüleri

Kisilerin sınır geis kapılarında kontrolleri çerçevesinde, (data) tarihinde (PKK) sınır geis kapısında görev kimlik numarası olan sınır kontrol memuru tarafından geniş kapsamlı bir kontrole tabi tutulacaksınız.

Lütfen bu kontrolün belirli bir süre devam edeceğini göz önünde bulundurunuz.

Bu kontrol özellikle aşağıdaki hususları içerebilir:

- Seyahat belgelerinin gerçek olup olmadıklarının ve geçerlilik sürelerinin kontrolü
- Vizenin ya da oturma izninin gerçek olup olmadığının ve geçerlilik süresinin kontrolü
- Seyahat güzergahının ve öngörülen yolculuğun amacının ve süresinin kontrolü
- Yolcunun üzerindeki para ve diğer mali kaynakların yolculuğun amacı ve öngörülen süresi göz önünde bulundurulduğunda geçimini sağlamaya yeterli olup olmadığını kontrolü
- Yolcunun aranıp aranmadığının kontrolü
- İzin verilen azami ikamet süresinin asılıp asılmadığının kontrolü
- Ulaşım araçların ve eşyaların kontrolü

Her durumda sınır kontrol memurunun talimatlarına uyulması gerekmektedir



UDHËZIM
Nr. 97, datë 11.5.2026

PËR LISTËN E PIKAVE TË KALIMIT
KUFITAR DHE ZONAVE TRANSIT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Lista e pikave të kalimit kufitar dhe zonave të tranzitit në Republikën e Shqipërisë përcaktohet në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Në shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi përcaktohen:

- a) emërtimi i pikës së kalimit kufitar;
- b) lloji i pikës së kalimit kufitar;
- c) njësia e vetëqeverisjes vendore dhe qarku ku ndodhet pika e kalimit kufitar;
- ç) shteti fqinj;

SHTOJCA NR. 1

- d) kategoritë e personave që kalojnë kufirin;
- dh) kategoritë e mjeteve të transportit që kalojnë kufirin;

- e) orari zyrtar i lejueshëm për kalimin e kufirit.

3. Të dhënat mbi kufizimet dhe oraret e pikave të kalimit kufitar, të paraqitura në shtojcën nr. 1, pasqyrojnë kufizimet dhe oraret faktike të funksionimit të secilës pikë të kalimit kufitar.

4. Lista, sipas shtojcës nr. 1, hartohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

5. Udhëzimi nr. 469, datë 22.8.2016, i ministrit të Punëve të Brendshme, “Për listën e pikave të kalimit kufitar dhe zonave tranzit në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

Nr./ No.	Pika e kalimit kufitar/Zona transit <i>Border Check Point/ Transit area</i>	Lloji i PKK- së <i>Type of the BCP</i>	Njësia e vetëqeverisjes vendore/qarku <i>Local Self- Government Unit/District</i>	Shteti fqinj/ <i>Neighboring country</i>	Personat/ <i>Persons</i>	Mjetet e transportit/ <i>Means of transport</i>	Orari/ <i>Working hours</i>
1	PKK Aeroporti Rinas/ <i>BCP Rinas Airport</i>	Ajrore/ <i>Air</i>	Tiranë/ Tiranë	Ndërkombëtar <i>International</i>	Pa kufizime <i>No limitations</i>	Avionë, helikopterë/ <i>Airplanes, helicopters</i>	24 orë/ <i>24 hours</i>
2	Zona Transit e Aeroportit Rinas/ <i>Rinas Airport Transit Area</i>	Ajrore/ <i>Air</i>	Tiranë/ Tiranë	Ndërkombëtar/ <i>International</i>	Pasagjerët transit të linjave ajrore/ <i>Airlines transit passengers</i>	- -	24 orë/ <i>24 hours</i>
3	Aeroporti Kukës/ <i>Kukës Airport</i>	Ajrore/ <i>Air</i>	Kukës/ Kukës	Ndërkombëtar/ <i>International</i>	Pa kufizime/ <i>No limitations</i>	Avionë, helikopterë/ <i>Airplanes, helicopters</i>	24 orë/ <i>24 hours</i>
4	Aeroporti Vlorë/ <i>Vlora Airport</i>	Ajrore/ <i>Air</i>	Vlorë/ Vlorë	Ndërkombëtar/ <i>International</i>	Pa kufizime/ <i>No limitations</i>	Avionë, helikopterë/ <i>Airplanes, helicopters</i>	24 orë/ <i>24 hours</i>
5	PKK Porti i Durrësit/ 	Detare/ 	Durrës/ 	Ndërkombëtar/ 	Pa kufizime/ <i>No limitations</i>	Mjete lundruese, autovetura, autobusë,	24 orë/



	BCP Durrës Seaport	Seaport	Durrës	International		kamionë/ Sea vessels Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 hours
6	PKK Porti i Shëngjinit/ BCP Shëngjin Seaport	Detare/ Seaport	Shëngjin/ Lezhë	Ndërkombëtar/ International	Pa kufizime/ No limitations	Mjete lundruese, autovetura, autobusë, kamionë/ Sea vessels Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
7	PKK Porti i Vlorës/ BCP Vlorë Seaport	Detare/ Seaport	Vlorë/ Vlorë	Ndërkombëtar/ International	Pa kufizime/ No limitations	Mjete lundruese, autovetura, autobusë, kamionë/ Sea vessels Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
8	PKK Porti i Himarës/ BCP Himara Seaport	Detare/ Seaport	Himarë/ Vlorë	Ndërkombëtar/ International	Pa kufizime/ No limitations	Mjete lundruese Automjete/ Sea vessels Vehicles	24 orë/ 24 hours
9	PKK Porti i Sarandës/ BCP Saranda Seaport	Detare/ Seaport	Sarandë/ Vlorë	Ndërkombëtar/ International	Pa kufizime/ No limitations	Mjete lundruese, Autovetura/ Sea vessels, Light vehicles	24 orë/ 24 hours
10	PKK Porto Romano/ BCP Porto Romano	Detare/ Seaport	Durrës/ Durrës	Ndërkombëtar/ International	Pa kufizime/ No limitations	Mjete lundruese, Autovetura Sea vessels, Light vehicles	24 orë/ 24 hours
11	PKK Porti i Jahteve Orikum/ BCP Orikum Yacht Port	Detare/ Seaport	Orikum/ Vlorë	Ndërkombëtar/ International	Pa kufizime/ No limitations	Mjete lundruese, Jahte dhe anije me vela / Sea vessels Yachts and sailing boats	24 orë/ 24 hours
12	PKK Porti i Limionit/ BCP Limion Port	Detare/ Seaport	Sarandë/ Vlorë	Ndërkombëtar/ International	Ekuipazhe të mjeteve lundruese të Mallrave/ Crews of cargo vessels	Mjete lundruese Mallrash/ Cargo Sea vessels	24 orë 24 hours
13	PKK Qafë Botë/ BCP Qafë Bote	Tokësore/ Land	Konispol/ Vlorë	Greqi/ Greece	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, Kamionë/ Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
14	PKK Rips/ BCP Rips	Tokësore/ Land	Finik/ Vlorë	Greqi/ Greece	Banorët e zonës/ Local residents	Autovetura/ Light vehicles	24 orë 24 hours
15	PKK Kakavijë/ BCP Kakavije	Tokësore/ Land	Gjirokastër/ Gjirokastër	Greqi/ Greece	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, Kamionë/ Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
16	PKK Tre Urat/ BCP Tre Urat	Tokësore/ Land	Përmet/ Gjirokastër	Greqi/ Greece	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, Kamionë/ Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
17	PKK Sopik/ BCP Sopik	Tokësore/ Land	Gjirokastër/ Gjirokastër	Greqi/ Greece	Banorët e zonës/ Local residents	Autovetura/ Light vehicles	24 orë/ 24 hours
18	PKK Kapshticë/ BCP Kapshticë	Tokësore/ Land	Devoll/ Korçë	Greqi/ Greece	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, Kamionë/ Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
19	PKK Qafë Thanë/ BCP Qafë Thanë	Tokësore/ Land	Pogradec/ Korçë	Maqedoni e Veriut/ Korçë	Pa kufizime No limitations	Autovetura, autobusë, kamionë	24 orë/ 24 hours



				North Macedonia		Light vehicles, buses, heavy vehicles	
20	PKK Tushemisht/ BCP Tushemisht	Tokësore/ Land	Pogradec/ Korçë	Maqedoni e Veriut/ North Macedonia	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë/ Light vehicles, buses	24 orë/ 24 hours
21	PKK Gorricë/ BCP Gorrice	Tokësore/ Land	Pustec/ Korçë	Maqedoni e Veriut/ North Macedonia	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, kamionë Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
22	PKK Bllatë/ BCP Bllate	Tokësore/ Land	Peshkopi/ Dibër	Maqedoni e Veriut/ North Macedonia	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, kamionë Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
23	PKK Trebisht/ BCP Trebisht	Tokësore/ Land	Bulqizë/ Dibër	Maqedoni e Veriut/ North Macedonia	Banorët e zonës/ Local residents	Autovetura/ Light vehicles	08:00– 20:00
24	PKK Morinë/ BCP Morine	Tokësore/ Land	Kukës/ Kukës	Kosovë/ Kosovo	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, Kamionë/ Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
25	PKK Qafë Morinë/ BCP Qafe Morine	Tokësore/ Land	Bajram Curri/ Kukës	Kosovë/ Kosovo	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, kamionë Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
26	PKK Qafë Prush/ BCP Qafe Prush	Tokësore/ Land	Bajram Curri/ Kukës	Kosovë/ Kosovo	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura, autobusë, Kamionë/ Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
27	PKK Shishtavec/ BCP Shishtavec	Tokësore/ Land	Kukës/ Kukës	Kosovë/ Kosovo	Pa kufizime/ No limitations	Autovetura/ Light vehicles	08:00– 20:00
28	PKK Orgjost/ BCP Orgjost	Tokësore/ Land	Kukës/ Kukës	Kosovë/ Kosovo	Banorët e zonës/ Local residents	Autovetura/ Light vehicles	08:00– 20:00
29	PKK Borje/ BCP Borje	Tokësore/ Land	Kukës/ Kukës	Kosovë/ Kosovo	Banorët e zonës/ Local residents	Autovetura/ Light vehicles	08:00– 20:00
30	PKK Çerem/ BCP Çerem	Tokësore/ Land	Tropojë/ Kukës	Kosovë/ Kosovo	Banorët e zonës/ Local residents	Nuk lejohet automjete/ No vehicles allowed	Sezoni veror (1 maj–30 shtator)– me kërkesë/ Summer season (May 1st – September 30th) – on Request
31	PKK Hani i Hotit/ BCP Hani i Hotit	Tokësore/ Land	Malësi e Madhe/ Shkodër	Montenegro	Pa kufizime No limitations	Autovetura, autobusë, Kamionë/ Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours
32	PKK Muriqan/ BCP Muriqan	Tokësore/ Land	Shkodër/ Shkodër	Mali i Zi/ Montenegro	Pa kufizime No limitations	Autovetura, autobusë, Kamionë/ Light vehicles, buses, heavy vehicles	24 orë/ 24 hours



33	PKK Bashkim/ <i>BCP Bashkim</i>	Tokësore/ <i>Land</i>	Malësi e Madhe/ Shkodër	Montenegro	Pa kufizime/ <i>No limitations</i>	Autovetura, autobusë/ <i>Light vehicles, buses,</i>	24 orë/ <i>24 hours</i>
34	PKK Grabom/ <i>BCP Grabom</i>	Tokësore/ <i>Land</i>	Malësi e Madhe/ Shkodër	Mali i Zi/ <i>Montenegro</i>	Pa kufizime/ <i>No limitations</i>	Autovetura, autobusë/ <i>Light vehicles, buses,</i>	24 orë/ <i>24 hours</i>
35	PKK Stacioni i Trenit Bajzë/ <i>BCP Bajzë Train Station</i>	Hekurudhore/ <i>Railway</i>	Malësi e Madhe/ Shkodër	Mali i Zi/ <i>Montenegro</i>	Pa kufizime/ <i>No limitations</i>	Tren/ Train Pasagjerë dhe ekui pazh trenash / <i>Passengers and crews of trains</i>	24 orë/ <i>24 hours</i>
36	PKK Moli i Qytetit/ <i>BCP City Pier</i>	Liqenore/ <i>Lake</i>	Pogradec/ Korçë	Maqedoni e Veriut/ <i>North Macedonia</i>	Grupe turistike/ <i>Tourist groups</i>	Mjete lundruese Turistike/ <i>Tourist vessels</i>	Sezoni veror (1 maj – 30 shtator) – me kërkesë/ <i>Summer season (May 1st – September 30th) – on Request</i>

UDHËZIM

Nr. 2, datë 29.4.2026

PËR TË DREJTËN E DAMKIMIT,
ADMINISTRIMIN DHE MËNYRËN E
PËRDORIMIT TË ÇEKIÇDAMKËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025, “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor e të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet e tyre”,

UDHËZOJ:

1. Damkimi kryhet me çekiçdamkë nga specialistët e strukturave përgjegjëse për pyjet pranë bashkive, sipas kriterëve dhe pas plotësimit të kërkesave teknike të përcaktuara në pikat 4 dhe 6 të nenit 3, si dhe aneksin nr. 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025.

2. Forma dhe karakteristikat teknike të çekiçdamkës janë sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të nenit 2, dhe kreut III, të aneksit

nr. 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025.

3. Çekiçdamkat prodhohen dhe shpërndahen nga agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet që administrojnë edhe informacionin për numrin total të çekiçdamkave të shpërndarë, si dhe shenjat përkatëse sipas bashkive.

4. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, janë përgjegjëse për administrimin e çekiçdamkës dhe gjithë procesin e damkimit, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025.

5. Kryetari i bashkisë, ose i autorizuari prej tij, sipas rastit, nxjerr urdhrin me shkrim për organizimin e procesit të damkimit. Në urdhrin përcaktohet data e fillimit dhe e mbarimit të këtij procesi, e cila duhet të jetë brenda periudhës maj-korrik, specialistët e damkimit, sipas kriterëve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025, dhe ngastrat/nënngastrat ku do të damkosë secili prej tyre. Nuk lejohet që dy apo disa specialistë të damkosin në të njëjtën ngastër apo nënngastër pyjore.

6. Për procesin e damkosjes mbahen në konsideratë parashikimet e kreut III, të aneksit 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025.

7. Drurët shënohen me çekiçdamkë në pjesën e poshtme të tyre, sa më afër sipërfaqes së tokës. Krahës damkës, në lartësinë 1.5 m, drurit i bëhet një shenjë, duke hequr një pjesë të lëvores me



sëpatë. Damka dhe shenja vendosen në shpat nga lart poshtë.

8. Nuk lejohet damkimi i llojeve të listës së kuqe, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 4.12.2003, “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje”.

9. Ngarkohen bashkitë, struktura përgjegjëse për pyjet në ministri dhe agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet për zbatimin e këtij udhëzimi.

10. Ngarkohet struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, për njoftimin e këtij udhëzimi, institucioneve të parashikuara në pikën 9 të tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT

Sofjan Jaupaj

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 110, datë 21.4.2026

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2026–2027 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2026–2027 në sistemin arsimor parauniversitar të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:

a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2026 dhe mbarojnë më 18 qershor 2027.

b) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2026 dhe mbarojnë më 4 janar 2027.

c) Pushimet fillojnë më 29 mars 2027 dhe mbarojnë më 2 prill 2027.

ç) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 21–30 qershor 2027.

2. Në arsimin e mesëm të lartë:

a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2026 dhe mbarojnë më 18 qershor 2027.

b) Për maturat, mësimet fillojnë më 14 shtator 2026 dhe mbarojnë më 4 qershor 2027.

c) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2026 dhe mbarojnë më 4 janar 2027.

ç) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 7–28 qershor 2027.

3. Në arsimin profesional:

a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2026 për të gjitha strukturat arsimore referuar niveleve 2–4 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Për vitin I dhe II të arsimit pas të mesëm niveli V i KSHK-së, mësimet fillojnë jo më vonë se java e tretë e muajit tetor 2026 dhe mbarojnë duke respektuar volumin mësimor të parashikuar në planin mësimor në skeletkurrikulat zyrtare të miratuara nga MEI.

b) Për nxënësit klasave të 10-ta të strukturës arsimore 2+1+1, klasave të 10-ta dhe të 12-ta, të strukturës arsimore 2+2, klasave të 10-ta dhe të 11-ta të strukturës arsimore bllok 3-vjeçar, klasave të 10-ta, të 11-ta dhe të 12-ta të strukturës arsimore bllok 4-vjeçar, mësimet mbarojnë më 18 qershor 2027.

c) Për nxënësit klasave të 11-ta dhe të 12-ta të strukturës arsimore 2+1+1, klasave të 12-ta të strukturës arsimore bllok 3-vjeçar, klasave të 11-ta të strukturës arsimore 2+2, mësimet mbarojnë më 4 qershor 2027.

ç) Për të gjithë nxënësit e Maturës Shtetërore Profesionale të klasave të 13-ta për të gjitha strukturat arsimore, mësimet mbarojnë më 28 maj 2027.

d) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2026 dhe mbarojnë më 4 janar 2027.

dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të nivelit II të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) zhvillohen në periudhën 7–18 qershor 2027.

e) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të Nivelit IV të KSHK-së për të gjitha strukturat arsimore, zhvillohen në periudhën 31 maj–4 qershor 2027.

ë) Provimet e Maturës Shkollore Profesionale dhe të Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 7–28 qershor 2027.



4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë, dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 144, datë 29.4.2026

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË
VËRTETIMIT TË TRANSPORTIT TË
MATERIALIT DRUSOR TË
PAPËRPUNUAR, SI DHE TË
PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE
E JOPYJORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 27, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të vërtetimit të transportit të materialit drusor të papërpunuar, si dhe prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, përfshirë bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET) me përmbajtjen sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vërtetimi i transportit prodhohet në formën e bllokut me tri fletë vetëkopjuese të formatit B5 (JIS), me përmasa 182 mm gjerësi dhe 257 mm gjatësi.

3. Blloku i vërtetimeve të transportit ka 90 (nëntëdhjetë) fletë, me 30 (tridhjetë) numra serie, nga një për çdo tri fletë.

Faqe | 9064

4. Elementet e sigurisë për fletët e vërtetimit të transportit janë:

a) fleta e parë ka ngjyrë të bardhë dhe mbahet nga transportuesi;

b) fleta e dytë ka ngjyrë rozë dhe mbahet nga blerësi/subjekti pritës;

c) fleta e tretë ka ngjyrë të verdhë dhe mbahet nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki;

ç) në çdo faqe ka filigran ngjyrë jeshile e hapur, fluoreshente e pafotokopjueshme, në formë rrezore, që dalin nga logoja e vendosur në qendër të fletës;

d) numri i serisë ka ngjyrë të kuqe fluoreshente e pafotokopjueshme;

dh) kopja e tretë ka në pjesën djathtas lart një pullë metalike të pafotokopjueshme.

5. Në fletën e fundit të bllokut, e lidhur me të, është një fletë kartoni me dimensione sa gjerësia e bllokut, ndërsa gjatësia do të jetë 42 cm, ku gjatësia prej 21 cm do të kthehet dhe do të shërbejë për ta vendosur atë, në çdo përdorim, pas fletës së tretë të çdo numri serial, për të mos depërtuar shkrimi në fletët me numrin serial pasardhës.

6. Në pjesën e pasme të çdo flete shënohet kujtesa dhe udhëzuesi për mënyrën e administrimit, plotësimit dhe lëshimit të vërtetimit të transportit, sipas tekstit të shtojcës 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

7. Vërtetimet e transportit janë letra me vlerë që prodhohen dhe merren në dorëzim, duke respektuar të gjitha rregullat e administrimit të letrave me vlerë sipas legjislacionit në fuqi dhe ruhen për një afat 5-vjeçar.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, urdhri i ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 143, datë 20.7.2016, “Për miratimin e formatit dhe përmbajtjes së vërtetimit të transportit për lëvizjen e lëndës drusore”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet, bashkitë dhe pronarët e pyjeve private për zbatimin e këtij urdhri.

10. Ngarkohet struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, për njoftimin e këtij urdhri institucioneve të parashikuara në pikën 9 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj



SHTOJCA 1

Bashkia: _____
Stema e bashkisë

Seria Nr. **0000000**

VËRTETIM TRANSPORTI

Për material drusor të papërpunuar dhe prodhime të tjera pyjore e jopyjore

1	Lëshuar më: <i>data, muaji, viti, ora</i>	_____
2	I vlefshëm deri ¹ : <i>data, muaji, viti, ora</i>	_____
3	Origjina e materialit/prodhimit: <i>Bashkia, ekonomia pyjore, pronari privat</i>	_____
4	Certifikata e origjinës: <i>Seria, data, muaji, viti</i>	_____
5	Për llogari të subjektit (shitësi): Emri, NIPT-i / Nr. personal, adresa:	_____ _____
6	Subjekti pritës / blerësi: Emri, NIPT-i, adresa:	_____ _____
7	Vendi i ngarkimit <i>Ngastra, pika e grumbullimit/transportit</i>	_____
8	Vendi i shkarkimit/destinacioni <i>pika e grumbullimit/transportit/depozitimit</i>	_____
9	Lloji i produktit/prodhimeve <i>asortimenti</i>	_____
10	Sasia <i>m³ / mst / ton / copë</i>	_____
11	Mjeti i transportit <i>targa / numri i kontejnerit</i>	_____
12	Drejtuesi i mjetit <i>Emër, mbiemër / numri i ID/lejes së drejtimit</i>	_____
13	Kilometrazhi <i>Tahografi / numri i km në momentin e nisjes</i>	_____
14	Vonesa në transport ² <i>Arsyja, koha</i>	_____

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR PYJET NË BASHKI / PRONARI PRIVAT

SPECIALISTI/PRONARI

TITULLARI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Vula e
bashkisë

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

TRANSPORTUESI

SUBJEKTI PRITËS/ BLERËSI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

¹ Plotësohet duke marrë parasysh kohën e nevojshme për të mbërritur në vendin e shkarkimit, destinacion.

² Kjo rubrikë plotësohet nga transportuesi në rast se, për arsye të justifikuara, tejkalohet orari i caktuar në rubrikën 2.



SHTOJCA 2 KUJTESË DHE UDHËZUES

1. Vërtetimet e transportit janë letra me vlerë për të cilat respektohen të gjitha rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar.

2. Prodhimi dhe shpërndarja e vërtetimeve të transportit është e drejtë vetëm e bashkive.

Shtypja e paautorizuar, apo riprodhimi i vërtetimeve të transportit, është e ndaluar.

3. Vërtetimi i transportit lëshohet për dhe shoqëron çdo ngarkesë me material drusor të papërpunuar dhe prodhime të tjera pyjore e jopyjore, veçmas për çdo segment transporti, nga vendi i ngarkimit në vendin e shkarkimit.

4. Transporti i materialit drusor të pamarkuar konsiderohet i paligjshëm edhe nëse është i pajisur me vërtetim transporti.

5. Vërtetimi i transportit është akt zyrtar që lëshohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, ose edhe nga pronari privat, dhe plotësohet vetëm nga specialisti përkatës i strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, ose në prani të tij, i cili verifikon dhe konfirmon vërtetësinë dhe ligjshmërinë e të dhënave.

URDHËR

Nr. 145, datë 29.4.2026

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË CERTIFIKATËS SË ORIGINËS SË PRODUKTEVE PYJORE DRUSORE DHE JODRUSORE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 8, të nenit 3, neneve 26 dhe 27, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit nr. 614, datë 23.10.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor e të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimin e rrugëve autopjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të certifikatës së origjinës për produktet pyjore drusore dhe jodrusore, përfshirë bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere
Faqe | 9066

natyrore, sipas formatit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Certifikata e origjinës prodhohet në formën e bllokut me dy fletë vetëkopjuese të formatit B5 (JIS), me përmasa 182 mm gjerësi dhe 257 mm gjatësi.

3. Blloku i certifikatave të origjinës ka 100 (njëqind) fletë, me 50 (pesëdhjetë) numra serie, nga një për çdo dy fletë.

4. Elementet e sigurisë të certifikatës së origjinës janë:

a) fleta e parë ka ngjyrë të bardhë dhe shoqëron produktet pyjore drusore dhe jodrusore, përfshirë bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore, deri në destinacionin përfundimtar;

b) fleta e dytë ka ngjyrë të verdhë dhe mbahet nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki;

c) në çdo faqe ka filigran ngjyrë jeshile e hapur, fluoreshente, e pafotokopjueshme në formë rrezore që dalin nga logoja e vendosur në qendër të fletës;

ç) numri i serisë ka ngjyrë të kuqe fluoreshente, e pafotokopjueshme);

d) formati të ketë në pjesën djathtas lart një pullë metalike e pafotokopjueshme;

5. Në fletën e fundit të bllokut, e lidhur me të, është një fletë kartoni me dimensione sa gjerësia e bllokut, ndërsa gjatësia do të jetë 42 cm, ku gjatësia prej 21 cm do të kthehet dhe do të shërbejë për ta vendosur atë, në çdo përdorim, pas fletës së dytë të çdo numri serial, për të mos depërtuar shkrimi në fletët me numrin serial pasardhës.

6. Në pjesën e pasme të çdo flete shënohet kujtesa dhe udhëzuesi për mënyrën e administrimit, plotësimit dhe lëshimit të certifikatës së origjinës në gjuhët shqipe dhe anglisht sipas tekstit të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

7. Certifikatat e origjinës janë letra me vlerë që prodhohen dhe merren në dorëzim, duke respektuar të gjitha rregullat e administrimit të letrave me vlerë sipas legjislacionit në fuqi dhe ruhen për një afat 5-vjeçar.

8. Ngarkohen bashkitë dhe agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet zbatimin e këtij urdhri.

9. Ngarkohet struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, për njoftimin e këtij urdhri institucioneve të parashikuara në pikën 8 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj



Logo e institucionit/bashkisë

Nr. Serial/Serial No.: 000000000

Data / Date: ____ / ____ / ____

Pullë
sigurie**CERTIFIKATË ORIGINJE**
PËR PRODUKTE PYJORE
CERTIFICATE OF ORIGIN
FOR FOREST PRODUCTS**PRODUKTE**Drusore ☐ Jodrusore ☐
Wood Non-wood

Nr. Certifikatës / Certificate No. _____

1	Subjekti (Emri / Adresa / NIPT) Operator (Name / Address / TIN)	Emri: _____ Name	Adresa: _____ Address	NIPT: _____ TIN
2	Prodhuesi (Emri / Adresa) Producer (Name / Address)	Emri: _____ Name	Adresa: _____ Address	NIPT: _____ TIN
3	Produkti pyjor (Lloji / Kodi HS) Forest product (Type / HS code)	Lloji i produktit: _____ Type of product		Kodi HS: _____ HS Code:
4	Lloji / Specia (Emri latinisht / shqip) Species (Latin and common)	Latinisht: _____ Latin		Shqip: _____ Common
5	Origjina (Shteti / Bashkia / Ekonomia pyjore) Origin (Country, Municip., Forest management unit)	Shteti: _____ State	Bashkia: _____ Municipality	Ekonomia Pyjore: _____ Forest Management Unit
6	Vendi i shfrytëzimit (ngastra/nënngastra/koordinatat) Harvesting location (coordinates)	Ngastra/nënngastra _____ X (E): _____ Y(N): _____		
7	Metoda e shfrytëzimit Harvest method	Prerje kulturore ☐ Prerje rrah ☐ Prerje shfrytëzuese ☐ Tjetër _____ Cultural tending Clear cutting Final harvest cutting Other		
8	Certifikime (FSC / PEFC, etj.) Certifications (FSC / PEFC, etc.)	FSC: _____ PEFC: _____		Tjetër: _____ Other:
9	Leja e shfrytëzimit Nr. Harvest permit No.	Numri i lejes: _____ Permit No.		Data: ____ / ____ / ____ Date
10	Sasia / Njësia (m³ / mst / ton / copë) Quantity / Unit (m ³ / ton / pieces)	Sasia: _____ m ³ /mst ☐ _____ ton ☐ _____ copë ☐ Quantity m ³ ton pieces		
11	Mjeti i transportit / Targa Transport vehicle / Plate No.	Lloji i mjetit: _____ Vehicle type		Targa: _____ Plate No.
12	Destinacioni (Shteti / Qyteti) Destination (Country / City)	Shteti: _____ State		Qyteti: _____ City

Deklaratë / Declaration

Deklarojmë se produktet pyjore të përshkruara në këtë certifikatë kanë origjinë nga Republika e Shqipërisë dhe rrjedhin nga shfrytëzimi i ligjshëm dhe i qëndrueshëm i burimeve pyjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

We hereby declare that the forest products described in this certificate originate from the Republic of Albania and derive from lawful and sustainable harvesting of forest resources, in compliance with applicable legislation.

Autoriteti Lëshues / Issuing Authority

Emri dhe funksioni / Name position

Adresa / Address: _____

Tel/e-mail: _____

Vula/stamp

Nënshkrimi / Signature

Ky dokument është i vlefshëm vetëm me nënshkrim dhe vulë zyrtare. / This document is valid only with official signature and stamp.



SHTOJCA 1

KUJTESË DHE UDHËZUES

1. Certifikatat e Origjinës janë letra me vlerë, për të cilat respektohen të gjitha rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar.

2. Prodhimi dhe shpërndarja e certifikatave të origjinës është e drejtë vetëm e bashkive. Shtypja e paautorizuar apo riprodhimi i tyre është i ndaluar.

3. Certifikata e Origjinës lëshohet për dhe shoqëron çdo ngarkesë me lëndë drusore të papërpunuar dhe të përpunuar, si dhe prodhime të tjera pyjore drusore dhe jodrusore deri në destinacionin e tyre final.

4. Certifikata e Origjinës është akt zyrtar që lëshohet vetëm nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, plotësohet dhe nënshkruhet nga specialisti i strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, përgjegjës për shfrytëzimin e lëndës drusore, si dhe përgjegjës për bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, si në rastet kur materiali drusor ose prodhimet pyjore drusore e jodrusore vilen në ngastra/nënngastra në pronësi publike, ashtu edhe në rastet kur ato janë në pronësi private.

NOTICE AND GUIDANCE

1. Certificates of Origin constitute security documents and shall be subject to the provisions set forth in the Decision of the Council of Ministers No. 1497, dated 19 November 2008, “On the Printing of Security Documents”, as amended.

2. The production and distribution of Certificates of Origin shall fall under the exclusive competence of the Municipalities. Any unauthorized printing or reproduction of such certificates is prohibited.

3. The Certificate of Origin shall be issued for, and shall accompany, every consignment of unprocessed and processed timber, as well as other wood and non-wood forest products, throughout their transport until the final destination.

4. The Certificate of Origin is an official document issued exclusively by the municipal structure responsible for forests. It shall be duly completed and signed by the specialist of the municipal forest structure responsible for timber harvesting, as well as responsible for medicinal and aromatic plants, both in cases where timber or wood and non-wood forest products are harvested from parcels/sub-parcels under public ownership and in cases where they originate from privately owned forest areas.

VENDIM

Nr. 22, datë 3.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 3.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 3 (Gj) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Gjergj Luka, përfaqësuar nga avokati Ded Guri, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, Burrel, përfaqësuar nga drejtori Fari Dema.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, Klevis Qose.

Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore, Tiranë (në mungesë)

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së të drejtave kushtetuese të kërkuarit, përfshirë shkeljen e neneve 44 (e drejta për zhvendim), 42 (e drejta për një proces të rregullt ligjor) dhe 18 (barazia para ligjit).

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3708, datë 25.9.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si



i papajftueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Urdhërimi i organeve përkatëse të garantojnë shpërblimin e plotë për punën e kryer nga kërkuesi në përputhje me ligjin dhe vendimet përkatëse për periudhën 1.9.2001–30.3.2010, në përputhje me pagën minimale të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 25.3.2009, “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Gjergj Luka (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*), Burrel dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (*DPB*), që kërkuan rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 1995 kërkuesi është dënuar me 18 vjet burgim. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, kërkuesi ka qenë i punësuar fillimisht si furnitor kuzhine e më pas, për periudhën 1.9.2001–30.3.2010, si kaldajist në IEVP-në, Burrel.

2. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, administrata e IEVP-së, Burrel, bazuar në dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor nr. 7298, datë 8.4.1989, “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje të lirisë, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën” (*dekreti i vitit 1989*), ka përcaktuar

shpërblimin e punës së kryer nga kërkuesi në masën 90 lekë në muaj për një periudhë kohore pune prej 105 muajsh.

3. Pas rifitimit të lirisë, në datën 23.1.2014, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi kundër IEVP-së, Burrel dhe DPB-së, Tiranë, me pretendimin se shpërblimi për punën e kryer në burg nuk duhej llogaritur sipas dekretit të vitit 1989, por sipas ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (*ligji për trajtimin e të dënuarve*), të ndryshuar.

4. Në korrik të vitit 2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit, pasi ka përcaktuar se marrëdhënia e punës së kërkuesit me IEVP-në rregullohej nga ligji për trajtimin e të dënuarve, i cili në nenin 34, paragrafi 1 i tij, parashikonte se puna e të burgosurit shpërblehet sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe nga VKM-ja nr. 303, datë 25.3.2009, “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve” (*Rregullorja e Burgjeve*), e dalë në zbatim të tij. Sipas asaj gjykate, në nenin 84, paragrafi 1, të Rregullores së Burgjeve përcaktohej, se: “paga për punën e të burgosurit nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me VKM”, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është parashikuar, se: “paga e të burgosurit për punën e kryer është e përbërë nga: a) të ardhurat që i jepen periodikisht të burgosurit të punësuar nga administrata e IEVP-së për të mbuluar shpenzimet e zakonshme gjatë qëndrimit në burg; b) shuma që IEVP-ja ruan në llogarinë personale të të burgosurit të punësuar, e cila i jepet atij kur përfundon ekzekutimi i vendimit me burgim, shumë e cila përbëhet nga të paktën 10% e vlerës së pagës për punën; c) shuma që u përgjigjet detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimeve, si dhe detyrimeve dhe shpenzimeve që ka i burgosuri gjatë kohës së qëndrimit në burg, të cilat përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë”.

5. Pas përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar ekspert kontabël për të përlllogaritur vlerën takuese të shpërblimit për kërkuesin. Bazuar në nenin 84, paragrafi 1, të Rregullores së Burgjeve dhe në VKM-të që kishin caktuar pagën minimale në shkallë vendi ndër vite, eksperti kontabël arriti në përfundimin se IEVP-ja, Burrel i detyrohej



kërkuesit në shumën 147.637, lekë si vlerë e papaguar për punën e kryer për 105 muaj gjatë vuajtjes së dënimit (përfshirë kamatëvonesat deri ditën e ngritjes së padisë).

6. Kundër vendimit ka ushtruar ankim pala e paditur, IEVP-ja, Burrel dhe DPB-ja, Tiranë, që ka parashtruar 2 argumente në lidhje me masën e shpërblimit: i. ndonëse neni 34 i ligjit për trajtimin e të dënuarve ka përcaktuar, se: *“puna ... shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave”* dhe Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009 ka përcaktuar, se: *“paga për punën e të burgosurit nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me VKM”*, në 2 shkurt të vitit 2011 është miratuar VKM-ja nr. 73, datë 2.2.2011, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave” (VKM-ja nr. 73/2011)*, neni 95/1/1 i së cilës ka bërë disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren e Burgjeve të vitit 2009, duke përcaktuar, se: *“procedurat e punësimit të të burgosurve vihen në zbatim menjëherë pas ... miratimit të buxhetit për shpërblimin e punës së tyre”*, ndërkohë që ky buxhet nuk ishte miratuar ende nga Këshilli i Ministrave kur u llogarit shpërblimi; ii. Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009 nuk ka fuqi prapavepruese, për rrjedhojë akti i ekspertimit që ka përllogaritur shpërblimin e kërkuesit sipas asaj rregulloreje është i pasaktë dhe për pasojë vendimi gjyqësor i bazuar në të është i paligjshëm.

7. Në shtator të vitit 2015 Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se ligji për trajtimin e të dënuarve i vitit 1998 dhe Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009, e dalë në zbatim të tij, janë të zbatueshme në përcaktimin e masës së shpërblimit për punën e kryer në burg nga kërkuesi.

8. Në rekurs kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit, ndonëse kanë përcaktuar drejt ligjin e zbatueshëm, e kanë zbatuar gabim atë, pasi, ndryshe nga sa parashikojnë ligji i vitit 1998 për trajtimin e të dënuarve dhe Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009, sipas të cilave puna e të burgosurit paguhet jo më pak se paga minimale, ato gjykata i kanë caktuar si shpërblim kërkuesit vetëm 10% të pagës minimale (jo pagën e plotë), duke keqinterpretuar urdhërimin e nenit 84, paragrafi 2, të Rregullores së Burgjeve, i cili parashikonte se IEVP-ja duhet të ruajë në llogarinë personale të të burgosurit të punësuar të paktën 10% të vlerës së

pagës për punën e kryer, e cila i jepet atij në përfundim të ekzekutimit të vendimit me burgim. Po kështu, ka ushtruar kundërrekurs dhe pala e paditur, IEVP-ja, Burrel, duke parashtruar të njëjtat pretendime si në ankim.

9. Me vendimin nr. 00-2024-3708, datë 25.9.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursi, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

10. Në datën 25.2.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 16.4.2025, Kolegji i Gjykatës në datën 25.6.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazën e dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të parashtruar në rekurs se gjykatat e faktit, duke interpretuar gabim Rregulloren e Burgjeve të vitit 2009, i kanë kufizuar shpërblimin për punën e kryer në burg në masën 10% të pagës minimale, ndërkohë që duhet të kishte përfituar të plotë pagën minimale.

11.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18, pika 1, i Kushtetutës, pasi është trajtuar në mënyrë të ndryshme nga të dënuarit e tjerë që kanë kryer punë të ngjashme, të cilëve u është paguar paga minimale ose u është njohur ulje e dënimit për ditët e punës, sipas përcaktimeve të dekretit të vitit 1989.

11.3. *E drejta për rehabilitim dhe zhdëmtim*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi institucionet shtetërore i kanë shkaktuar një dëm të drejtpërdrejtë financiar duke mos i dhënë pagën minimale të përcaktuar në Rregulloren e Burgjeve të vitit 2009.

12. **Subjekti i interesuar, IEVP-ja, Burrel**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit nuk qëndrojnë, pasi: i. ligji i zbatueshëm për caktimin e masës së shpërblimit



për punën e kryer nga kërkuesi gjatë vuajtjes së dënimit është dekreti i vitit 1989 dhe bazuar në atë dekret kërkuesi është shpërblyer me 90 lekë në muaj për punën e kryer; ii. vërtet neni 34 i ligjit të vitit 1998 për trajtimin e të dënuarve ka përcaktuar, se: “puna ...shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave” dhe Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009 ka përcaktuar, se: “paga për punën e të burgosurit nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me VKM”, por në 2 shkurt 2011 është miratuar VKM-ja nr. 73/2011, neni 95/1/1 i së cilës ka bërë disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren e Burgjeve të vitit 2009, duke përcaktuar, se: “procedurat e punësimit të të burgosurve vihen në zbatim menjëherë pas ...miratimit të buxhetit për shpërblimin e punës së tyre”, ndërkohë që ky buxhet nuk ishte miratuar ende nga Këshilli i Ministrave në kohën e llogaritjes së shpërblimit.

13. **Subjekti i interesuar, DPB-ja**, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se përpara miratimit të VKM-së nr. 602, datë 13.10.2021, “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj” (VKM-ja nr. 602/2021), shpërblimi i punës së kryer nga të burgosurit është kryer sipas dekretit të vitit 1989. Për periudhën e punës të pretenduar prej kërkuesit si e papaguar, që daton nga 1.9.2001–25.3.2009, është zbatuar VKM-ja nr. 96, datë 9.3.2000, “Për miratimin e rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” (VKM-ja nr. 96/2000), e cila ka qenë në fuqi në momentin kur ka lindur marrëdhënia juridike mes punëmarrësit të dënuar dhe punëdhënësit, ndërsa Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009, të cilës i referohen gjykatat, i fillon efektet pas datës 25.3.2009, kur ka hyrë në fuqi, e si e tillë nuk mund të ketë efekte prapavepruese dhe të aplikohet për periudhën e pretenduar prej kërkuesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2,

të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore që pretendohet se janë cenuar, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor objekt kontrolli, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

16. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 09.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vet individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).



17. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të garantuar nga neni 18, pika 1, i Kushtetutës, pasi është trajtuar në mënyrë të ndryshme nga të dënuarit e tjerë që kanë kryer punë të ngjashme, të cilëve u është paguar paga minimale ose u është njohur ulje e dënimit për ditët e punës. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk e ka ngritur në rekursin në Gjykatën e Lartë, por vetëm në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, për këtë pretendim, ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion.

18. Për sa i takon pretendimit kryesor të kërkuesit lidhur me ligjin e zbatueshëm për llogaritjen e shpërblimit dhe, më tej, keqlllogaritjen e shpërblimit nga gjykatat e faktit, ndonëse kërkuesi nuk ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit (gjykimi në apel është vënë në lëvizje nga subjektet e interesuara, IEVP-ja, Burrel dhe DPB-ja, Tiranë), në kushtet kur objekt gjykimi në të gjitha shkallët e gjykimit ka qenë edhe çështja e ligjit të zbatueshëm, e cila merret në shqyrtim nga gjykatat edhe kryesisht, si dhe duke mbajtur parasysh se objekt i kërimit në Gjykatë është vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion për këtë kërkim dhe për pretendimet e tjera objekt kërrimi.

19. Gjithashtu, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 12.12.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 25.2.2025, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës.

20. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet të së drejtës së aksesit substancial, si dhe së drejtës për rehabilitim dhe zhdëmtim, të garantuara respektivisht nga nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës. Nisur nga përmbajtja e argumenteve të parashtruara, të cilat, në thelb, kanë të bëjnë me mosmarrjen përgjigje nga Gjykata e Lartë lidhur me keqinterpretimin e Rregullores së Burgjeve të vitit 2009 nga gjykatat e faktit në përlllogaritjen e masës së shpërblimit të punës së kryer në burg, si dhe duke mbajtur në konsideratë se çështja lidhet me shpërblimin e punës së kryer gjatë vuajtjes së

dënimit, në kuadër të funksionit rehabilitues dhe riedukues të tij, Gjykata çmon se pretendimet në thelb lidhen me garancitë që ofron neni 26 i Kushtetutës, i cili ndalon punën e detyruar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon t'i analizojë këto pretendime në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat e njohura me Kushtetutë nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

21. Për sa më sipër, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit në themel në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka refuzuar të shqyrtojë shkeljet e ligjit material dhe procedural, si dhe shkaqet e parashtruara në rekurs, duke mos i dhënë mundësinë kërkuesit të adresojë zbatimin e gabuar të Rregullores së Burgjeve të vitit 2009 nga gjykatat e faktit, të cilat kanë kufizuar shpërblimin e kërkuesit në masën 10% të pagës minimale, ndërkohë që duhet të kishte përfituar të plotë pagën minimale në shkallë vendi. Po sipas kërkuesit, duke mos i dhënë pagën minimale të përcaktuar në Rregulloren e Burgjeve, institucionet shtetërore i kanë shkaktuar një dëm të drejtpërdrejtë financiar.

23. Subjekti i interesuar, IEVP-ja, Burrel, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit nuk qëndrojnë, pasi bazuar në dekretin nr. 7289/1989 të Presidiumit të Kuvendit Popullor, deri në datën 25.10.2004 ai ka përfituar ulje dënimi 3.9 ditë në muaj dhe është shpërblyer me 90 lekë në muaj për punën e kryer. Me nxjerrjen e urdhrit të Prokurorisë së Rrethit Mat, bazuar në shkresën nr. 3223/2004 të Prokurorit të Përgjithshëm është urdhëruar korrigjimi i ditëve të punës gjatë vuajtjes së dënimit të kërkuesit, për shkak të praktikës së gabuar të njohjes së ditëve të punës për efekt të shlyerjes së dënimit. Neni 34 i ligjit të vitit 1998 për trajtimin e të dënuarve ka përcaktuar, se: “puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave”, ndërkohë neni 95/1/1 i VKM-së nr. 73/2011, me të cilin është miratuar Rregullorja e Burgjeve e vitit



2009, ka përcaktuar se procedurat e punësimit të të burgosurve vihen në zbatim menjëherë pas miratimit të strukturës organike të punës të të burgosurve dhe pas miratimit të buxhetit për shpërblimin e punës së tyre, ndërkohë që nuk kishte ende një miratim të tillë nga Këshilli i Ministrave.

24. Subjekti i interesuar, DPB-ja, ka prapësuar se para miratimit të VKM-së nr. 602/2021, shpërblimi i punës së kryer nga të burgosurit është kryer sipas dekretit të vitit 1989. Për periudhën e punës të pretenduar prej kërkuarit si e papaguar, që daton nga 1.9.2001–25.3.2009, është zbatuar VKM-ja nr. 96/2000, e cila ka qenë në fuqi në momentin kur ka lindur marrëdhënia juridike mes punëmarrësit të dënuar dhe punëdhënësit, ndërsa Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009, të cilës i referohen gjykatat, i fillon efektet pas datës 25.3.2009, kur ka hyrë në fuqi, e si e tillë nuk mund të ketë efekte prapavepruese dhe të aplikohet për periudhën e pretenduar prej kërkuarit.

25. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë*

23.3.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se kërkuari, me pretendimin se i janë cenuar të drejtat kushtetuese të mësipërme, ka kundërshtuar vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të tij. Në situatën kur rekursi nuk është shqyrtuar në themel dhe për të respektuar kufirin midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor, Gjykata për zgjidhjen e çështjes do t'i japë përgjigje pyetjes nëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm lidhur me të drejtën e kërkuarit për t'u shpërblyer sipas ligjit për punën e kryer në kushtet e vuajtjes së dënimit në burg. Me fjalë të tjera, Gjykata do të kontrollojë nëse Gjykata e Lartë, gjatë ushtrimit të funksionit rishikues për mënyrën e interpretimit të ligjit të zbatueshëm nga gjykatat e faktit, ka përmbushur rolin subsidiar të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të kërkuarit.

28. Duke mbajtur në konsideratë kuadrin ligjor të mësipërm, Gjykata vëren se pas shlyerjes së dënimit me burgim, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi kundër IEVP-së, Burrel dhe DPB-së, Tiranë, me pretendimin se shpërblimi për punën e kryer në burg duhej llogaritur sipas ligjit të vitit 1998 për trajtimin e të dënuarve, të ndryshuar. Ajo gjykatë i ka dhënë të drejtë kërkuarit, duke pranuar se ligji i zbatueshëm në marrëdhënien e punës ndërmjet kërkuarit dhe IEVP-së, Burrel është ligji i sipërpërmendur, i cili në nenin 34, paragrafi 1, të tij ka përcaktuar, se: “puna e të burgosurit shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave” dhe Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009 e dalë në zbatim të tij. Sipas asaj gjykate, në nenin 84, paragrafi 1, të Rregullores së Burgjeve është përcaktuar, se: “paga për punën e të burgosurit nuk mund të jetë



më e ulët se paga minimale e caktuar me VKM”, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është parashikuar, se: “paga e të burgosurit për punën e kryer është e përbërë nga: i. të ardhurat periodike që i jepen periodikisht të burgosurit të punësuar nga administrata e IEVP-së për të mbuluar shpenzimet e zakonshme gjatë qëndrimit në burg; ii. shuma që IEVP-ja ruan në llogarinë personale të burgosurit të punësuar, e cila i jepet atij kur përfundon ekzekutimi i vendimit me burgim, shumë e cila përbëhet nga të paktën 10% e vlerës së pagës për punën; iii. shuma që u përgjigjet detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimeve, si dhe detyrimeve e shpenzimeve që ka i burgosuri gjatë kohës së qëndrimit në burg, të cilat përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë”. Pas përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, ajo gjykatë ka caktuar ekspert kontabël për të përllogaritur vlerën takuese të shpërblimit për kërkuesin, i cili, bazuar në nenin 84, paragrafi 1, të Rregullores së Burgjeve të vitit 2009 dhe në VKM-të ndër vite që kishin caktuar pagën minimale në shkallë vendi, ka arritur në përfundimin se për 105 muaj punë, IEVP-ja, Burrel i detyrohej kërkuesit në shumën 147.637, lekë si vlerë e papaguar për punën e kryer gjatë vuajtjes së dënimit, përfshirë kamatëvonesat deri në ditën e ngritjes së padisë në datën 23.1.2014. Po kështu, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se ligji i vitit 1998 për trajtimin e të dënuarve dhe Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009 e dalë në zbatim të tij janë të zbatueshme në përcaktimin e masës së shpërblimit për punën e kryer në burg nga kërkuesi, si dhe se nuk mund të zbatohen më normat e sistemit të diktaturës së proletarietit.

29. Ndërkohë, megjithëse në rekurs kërkuesi ka pretenduar keqinterpretim të ligjit të zbatueshëm nga gjykatat e faktit në përllogaritjen e pagesës mujore në vlerën 10% të pagës minimale në shkallë vendi, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

30. Për sa më lart, Gjykata konstaton se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së parashtruar para gjykatave të faktit, këto të fundit, ndonëse kanë vlerësuar se marrëdhënia e punës së kërkuesit me IEVP-në, Burrel është rregulluar nga ligji për

trajtimin e të dënuarve dhe Rregullorja e Burgjeve e vitit 2009 e dalë në zbatim të saj, pasi kanë konstatuar se kërkuesi jo vetëm nuk ka përfituar ulje dënimi për punën e kryer, por as nuk ka marrë shpërblimin e caktuar sipas ligjit, i janë referuar në vendimmarrje përllogaritjes në aktin e ekspertimit, i cili ka rezultuar të jetë kryer duke iu referuar nenit 84, paragrafi 2, shkronja “b”, të Rregullores së Burgjeve, ku është përcaktuar, se: “*shuma që IEVP-ja ruan në llogarinë personale të të burgosurit të punësuar, e cila i jepet atij kur përfundon ekzekutimi i vendimit me burgim, shumë e cila përbëhet nga të paktën 10% e vlerës së pagës për punën*”, si dhe VKM-ve që për periudhën e kërkuar kanë përcaktuar pagën minimale në shkallë vendi, pra duke përcaktuar, se: IEVP-ja, Burrel i detyrohet kërkuesit një vlerë të barasvlershme me 10% të vlerës totale të përllogaritur mbi pagën e referencës sipas VKM-ve në fuqi gjatë periudhës së punës të kryer nga kërkuesi. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, megjithëse ndodhej përpara pretendimeve me natyrë kushtetuese, atë të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të interpretimit arbitrar të ligjit nga gjykatat e faktit, me pasojë, sipas kërkuesit, mbi të drejtën për rehabilitim dhe zhdëmtim, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, në ushtrim të funksionit të saj dhe të parimit të subsidiaritetit, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimeve të kërkuesit. Fakti nëse kërkuesit i përkiste, në interpretim të dispozitave të lartpërmendura, shuma prej 10% e vlerës totale ose vlera e plotë e saj është në kompetencë të Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji. Mospranimi nga kjo gjykatë i rekursit të kërkuesit, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese. Në këtë drejtim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se askush nuk mund të kryejë një punë të detyruar (*shih paragrafin 20 të vendimit*) vë në dukje se puna në burgje konsiderohet një mjet efektiv rehabilitimi vetëm nëse ajo shpërblehet në mënyrën e duhur (*shih vendimin 2 BvR 441/90, datë 1.7.1998, të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë*).



31. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të aksesit substancial lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3708, datë 25.9.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.3.2026.

Shpallur më 8.5.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 33, datë 17.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 17.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (Gj) 2025 të Regjistrat Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GJON SHKAMBI, përfaqësuar nga avokati Gjetan Gjetani, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-975, datë 18.3.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave për çështjen nr. 11216-01487-00-2018 regjistri, datë 3.5.2018, në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, pretendimet e kërkuarit Gjon Shkambi (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është pronar i një sipërfaqeje toke të fituar me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Shkodër. Sipas tij, kjo sipërfaqe ka qenë pjesërisht e zënë me objekte, si dhe pjesërisht e lirë dhe në lidhje me të, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, ka ushtruar pa pengesë të drejtën e parablerjes.

2. Në kushtet kur vendimi i KKKP-së kishte pasaktësi, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi për saktësimin e tij. Me vendimin nr. 119, datë 11.2.2002, kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke saktësuar vendimin e KKKP-së. Në vijim, me vendimin nr. 20, datë 28.6.2010 (*vendim nr. 20/2010*), Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

3. Në kushtet kur objekti në sipërfaqen e pronës së kërkuesit, konkretisht ish-Shkolla e Rezervave, Shkodër, ishte zënë nga posedues të paligjshëm, ai i është drejtuar përmbaruesit gjyqësor M.T. për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Bazuar në kërkesën e kërkuesit dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër nr. 20/2010, përmbaruesi gjyqësor M.T. u është drejtuar individëve që jetonin në pasurinë e kërkuesit për lirim vullnetarisht të banesave dhe ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv.

4. Në vijim, një grup banorësh të godinës së ish-Shkollës së Rezervave, Shkodër, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, vendimit nr. 34 prot., datë 21.1.2013 të përmbaruesit gjyqësor. Po kështu, një pjesë e tyre kanë paraqitur edhe kërkesë për sigurimin e padisë dhe pezullimin e këtyre veprimeve përmbarimore.

5. Me vendimin nr. 11, datë 7.2.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur sigurimin e padisë për një afat 6-mujor, duke pezulluar veprimet përmbarimore kundrejt pagesës së garancisë prej 20.000 lekësh në muaj secili kërkues për këtë afat. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuesi dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 52, datë 10.6.2013, ka vendosur lënien e tij në fuqi.

6. Po kështu, edhe disa nga të paditurit e tjerë në proces i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për sigurimin e padisë dhe pezullimin e veprimeve përmbarimore deri në përfundim të procesit gjyqësor. Me vendimin nr. 16, datë 21.2.2013, kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe sigurimin e padisë për një afat 6-mujor, duke pezulluar veprimet përmbarimore në emër të tyre kundrejt pagesës së garancisë prej 20.000 lekësh në muaj secili kërkues për këtë afat në shumën totale 360.000 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 56, datë 20.6.2013, ka vendosur lënien në fuqi të tij.

7. Ndërkohë lidhur me themelin e çështjes, me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 778, datë 27.3.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe heqjen e masës së sigurimit të padisë për pezullimin e veprimeve përmbarimore dhënë me vendimet nr. 11, datë 7.2.2013 dhe nr. 16, datë 21.2.2013 të kësaj gjykate. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 1073, datë 12.6.2014, ka vendosur lënien në fuqi të tij. Nga verifikimi në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë rezulton se me vendimin nr. 00-2023-4208, datë 25.10.2023, kjo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1073, datë 12.6.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

8. Në datë 26.6.2014 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me padi për detyrimin e të paditurve ta dëmshpërblejnë në vlerën e qerasë 20.000 lekë secili i paditur që nga dita 7.2.2013, kur është bërë kërkesa për sigurimin e padisë, deri ditën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës, bllokimin e shumës që i përket vendimit nr. 11, datë 7.2.2013, si dhe bllokimin e shumës 360.000 lekë që i përket vendimit nr. 16, datë 21.2.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në përfundim të gjykimit, kjo gjykatë, me vendimin nr. 809, datë 25.5.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

9. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 766, datë 6.11.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, çështje e cila



është regjistruar me nr. 11216-01487-00-2018, datë 3.5.2018.

10. Në pritje të shqyrtimit të çështjes së tij, në datën 10.2.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimit të gjykimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-975, datë 18.3.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se edhe pse çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete objekt gjykimi është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Sipas atij kolegji, mosveprimi i Gjykatës së Lartë nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar edhe kritere transparente për marrjen sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë caktuar në cilësinë e gjyqtarit relator. Në përfundim, Kolegji Civil ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme nga gjyqtari relator.

11. Në datën 25.8.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 29.10.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

12.1. *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak se çështja e kërkuetit edhe pse është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.5.2018 nuk është gjykuar ende, në kundërshtim me afatin për gjykimin e çështjeve në atë gjykatë, që është dy vjet sipas nenit 399 të KPC-së. Kjo çështje, megjithëse ka shumë palë të paditura, nuk është komplekse, dhe ai nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të gjykimit, pra nuk është bërë shkak për vonesat. Çështja në pritje të gjykimit ka rëndësi të veçantë, pasi ka për objekt të drejta që rrjedhin nga

prona, për të cilën janë zhvilluar një sërë procesesh që nga viti 1993 për ta marrë në posedim.

12.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme*, pasi Kolegji Penal i referohet në mënyrë të gabuar nenit 399/2, pika 3, të KPC-së, sipas të cilit nuk konsiderohet shkelje e afatit të arsyeshëm kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive në procedim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, në kuadër të të cilit ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pasi ka përdorur mjetin juridik parandalues/përsheptues të parashikuar nga KPC-ja. Ai i është drejtuar më parë Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe përsheptimit të gjykimit, në zbatim të neneve 399/5 dhe 399/6, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së, për të cilën ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ankohet për kohëzgjatjen e gjykimit në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, por edhe për mungesën e efektivitetit të mjeteve të



parashikuara nga KPC-ja për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

16. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pranuar se neni 13 i KEDNJ-së i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti “parandalues ose përsheptues”, të projektuar për të përsheptuar procedurat, në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti “riparues, kompensues ose monetar”, që parashikon korrigjimin *ex post facto* për vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë edhe nëse procedura është ende në shqyrtim. Ligjvënasi shqiptar ka parashikuar një zgjidhje të kombinuar përsheptuese/parandaluese dhe kompensuese në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së. Ky mekanizëm është vlerësuar, në parim, si efikas edhe nga GJEDNJ-ja, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës të individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur (*shih vendimet nr. 75, datë 20.11.2025; nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka përdorur mjetin parandalues/përsheptues, por kërkesa e tij është rrëzuar me vendimin e datës 18.3.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se tejzgjatja e gjykimit të çështjes ka ndodhur për shkaqe objektive të pavarura nga vullneti i gjyqtarit relator. Edhe aktualisht rezulton se ende nuk ka një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj nga Kolegji Civil i asaj gjykate. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mjetet juridike nuk kanë qenë efektive për përsheptimin e procedurave dhe kërkuesi nuk ka më mjete juridike efektive në dispozicion, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Gjykatës së Lartë objekt ankimi, referuar informacionit të marrë në rrugë elektronike nga ajo gjykatë, është bërë i disponueshëm për palët në datën 27.5.2025, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 25.8.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të

procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, si dhe në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vëren se ai është në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

20. Kërkuesi ka pretenduar se çështja e tij edhe pse është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.5.2018 nuk është gjykuar ende, në kundërshtim me afatin për gjykimin e çështjeve në atë gjykatë, që është dy vjet sipas nenit 399 të KPC-së. Sipas kërkuetit, kjo çështje, megjithëse ka shumë palë të paditura, nuk është komplekse, si dhe ai nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të gjykimit, pra nuk është bërë shkak për vonesat. Çështja në pritje të gjykimit ka rëndësi të veçantë, pasi ka për objekt të drejta të cilat rrjedhin nga prona, për të cilën janë zhvilluar një sërë procesesh që nga viti 1993 për ta marrë në posedim.

21. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret Gjykata vëren se çështja e kërkuetit është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.5.2018, me numër 11216-01487-00-2018, mbi bazën e rekursit të tij dhe lidhet me një mosmarrëveshje që rrjedh nga e drejta e pronës dhe ndonëse aktualisht kanë kaluar 7 vjet e 4 muaj që prej datës së regjistrimit, referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë në ditën e vendimmarrjes, rezulton se ende nuk ka një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj nga Kolegji Civil i asaj gjykate. Po kështu, sipas informacionit të datës 5.3.2026, të dërguar prej Gjykatës së Lartë përmes postës elektronike, rezulton se çështja e kërkuetit:



“ndodhet ende në fazë studimi dhe aktualisht nuk ka një datë të planifikuar nga Kolegji Civil i kësaj gjykate”. Për rrjedhojë, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuarit ka tejkaluar afatin 2-vjeçar, që sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së është parashikuar si afat i arsyeshëm për gjykimin civil në Gjykatën e Lartë. Gjykata vëren, gjithashtu, se kohëzgjatja tërësore e procesit gjyqësor deri në këtë fazë të tij është afërsisht 12 vjet, referuar datës së regjistrimit të padisë në gjykatën e shkallës së parë (data 28.6.2014).

23. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kriterëve: i. sjellja e kërkuarit; ii. kompleksiteti i çështjes; iii. sjellja e autoriteteve; iv. rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuar (shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese).

24. Në lidhje me këto kriterë, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të saj.

25. Sipas *njërit qëndrim*, për sa u përket kriterëve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuarit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të Gjykatës për vlerësimin e tyre (shih vendimet nr. 29, datë 10.3.2026; nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024, të Gjykatës Kushtetuese), konstatohet se ato nuk kanë përbërë shkak për tejzgjatjen e afatit të gjykimit të çështjes. Për më tepër, një fakt i tillë është vërejtur edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin objekt kundërshtimi, e cila ka pranuar se vonesa nuk ka ardhur si pasojë e kërkesave të palëve ose kompleksitetit të natyrës së çështjes. Për rrjedhojë, për të vlerësuar pretendimin e kërkuarit, në rastin konkret duhet ndalur vetëm në analizën e kriterit të asaj se çfarë rrezikon ai për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së tij në raport me kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjes².

26. Konkretisht, çështja gjyqësore e kërkuarit ka të bëjë me detyrimin e palëve të paditura, në cilësinë e poseduesve të një objekti në pronësi të kërkuarit,

për ta dëmshpërblyer atë me vlerën e qirasë dhe ndonëse kanë kaluar 12 vjet në pritje të zgjidhjes së saj, ende gjykatat nuk kanë disponuar një vendimmarrje përfundimtare. Kjo çështje, për nga natyra e saj, edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa “jetësorë”, që kërkojnë trajtim me përparësi, lidhet me të drejtën e pronës, konkretisht me vlerën e përdorimit të saj si një nga tagrat e pronësisë. Në rastin kur çështja gjyqësore ka në objektin e saj të drejtën e pronës private, Gjykata ka pohuar se përfshihet në listën e çështjeve me interes të rëndësishëm, pasi prona private përbën jo vetëm të drejtë themelore, por edhe një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit (shih vendimet nr. 2, datë 21.1.2025; nr. 1, datë 6.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese). Sipas Gjykatës, rëndësia e së drejtës kushtetuese të pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikon paditësi për shkak të tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese). Duke mbajtur në konsideratë këto standarde, Gjykata në jurisprudencën e saj, ka konstatuar shkelle të afatit të arsyeshëm në çështje të cilat kanë në objekt mosmarrëveshje që lidhen me të drejtën e pronës (shih vendimet nr. 30, datë 10.3.2026; nr. 75, datë 20.11.2025; nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese).

27. Për sa më lart, në referim të jurisprudencës kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe të rëndësisë që ka ushtrimi i së drejtës së pronës në përmbushjen e interesave jetësorë të individit, konstatohet se kohëzgjatja tërësore prej 12 vjetësh e procesit gjyqësor të nisur nga kërkuar përbën një periudhë relativisht të gjatë që nuk përmbush kriterin e “afatit të arsyeshëm”. Kjo periudhë e mosveprimit në rastin konkret, e justifikuar vetëm me arsye të natyrës së përgjithshme, si reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve, nuk përbën argument kushtetues për të përligjur një vonesë të tillë. Po kështu, kjo kohëzgjatje, *per se*, është tregues i mjaftueshëm se procesi gjyqësor në rastin konkret nuk ka respektuar garancitë kushtetuese dhe ligjore për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe efektiv. Në këto kushte, rezulton se gjykatat e zakonshme kanë dështuar të sigurojnë dhënien e

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Genti Ibrahimini dhe Marjana Semini.



drejtësisë pa vonesa, ndërkohë që mosmarrëveshja në fjalë ka mbetur në pritje për një periudhë të tejzgatur. Si rrjedhojë, nisur nga rrethanat e rastit në shqyrtim, kohëzgjatja prej 12 vjetësh përbënte shkak të mjaftueshëm që Gjykata e Lartë të konstatonte cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, prandaj pretendimi i kërkuarit në këtë drejtim është i bazuar.

28. Sipas *qëndrimit tjetër*, shkak determinant për kohëzgjatjen e gjykimit janë bërë kompleksiteti i çështjes dhe sjellja e kërkuarit.³

29. Për sa i takon kompleksitetit të çështjes, ashtu siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Çështja e kërkuarit ka natyrë civile, dhe lidhet me të drejtën e pronësisë. Konkretisht, kërkuari ka fituar të drejtën e pronësisë sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave për një ndërtesë në qytetin e Shkodrës, në të cilën banonin shumë familje. Këto të fundit kishin të drejtën e banimit me anë të vendimit të Këshillit Bashkiak të vitit 1992, për shkak të statusit “të pastrehë”. Kërkuari i është drejtuar gjykatave të zakonshme për të urdhëruar ekzekutimin e detyrueshëm të titullit të tij të pronësisë, por gjatë procedurave përmbarimore ka pasur disa konflikte gjyqësore për kundërshtimin e tyre me rezultate të ndryshme gjyqësore. Ndër të tjera, kërkuari ka paditur 22 prej banorëve, duke kërkuar të drejtën e shpërblimit në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë në muaj nga data 7.2.2013, si dhe bllokimin e shumave monetare si garanci nga banorët për të cilat ishte disponuar me dy vendime të tjera gjyqësore të datave 7.2.2013 dhe 21.2.2013. Nga këto të dhëna është e qartë që çështja paraqitet komplekse, në drejtim të palëve, ligjit të zbatueshëm, numrit të konsiderueshëm të çështjeve gjyqësore të hapura dhe provave.

30. Për *sjelljen e kërkuarit*, Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se vlerësimi i sjelljes është element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke

shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi vlerësohet se sjellja e kërkuarit ka qenë shkak për zvarritjen e gjykimit në disa drejtime, që përfshijnë një strategji mbrojtjeje të tillë që ka ndikuar në ecurinë e procesit. Hapja e një numri të konsiderueshëm procesesh gjyqësore për ekzekutimin e vendimeve është një faktor që duhet konsideruar, veçanërisht në kontekstin ku gjatë gjykimit të një prej këtyre çështjeve ka ndodhur edhe vrasja e një gjyqtari në sallën e gjyqit. Po ashtu, rezulton se me anë të proceseve gjyqësore është tentuar të risillen në fuqi efekte të zgjidhura më parë nga gjykatat. Kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e datës 27.3.2013, kishte vendosur heqjen e masës së sigurimit të padisë për pezullimin e veprimeve përmbarimore të dhënë me vendimet e datave 7.2.2013 dhe 21.2.2013 të kësaj gjykate, pra duke hequr detyrimin e banorëve për pagimin e garancisë. Pavarësisht kësaj, kërkuari i është drejtuar sërish gjykatës me çështjen konkrete, duke kërkuar të risillte në fuqi vendimet për detyrimin e garancisë.

31. Për sa më lart, duke vlerësuar dy faktorët e mësipërm, të cilët janë bërë shkak determinant për ecurinë e procesit, analiza e kritereve të tjera bëhet e panevojshme, ndaj kërkesa për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm është e pabazuar.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuarit konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 133, pika 2, shkronja “I” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

³ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Ilir Toska dhe Asim Vokshi.
Faqe | 9080



VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.3.2026.

Shpallur më 8.5.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Asim Vokshi

VENDIM

Nr. 00-2025-4900 (621), datë 22.12.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Artur Kalaja	kryesues;
Ervin Pupe	anëtar;
Enton Dhimitri	anëtar;
Margarita Buhali	anëtar;
Valbon Çekrezi	anëtar,

në seancën gjyqësore të datës 22.12.2025, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, mori në shqyrtim çështjen civile nr. 21001-00392-00-2025 akti, datë regjistrimi 30.6.2025, që i përket:

REKURSUESE: D.V

KUNDËR: Vendimit nr. 1459 (13-2024-5077), datë 22.4.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar).

BAZA LIGJORE: Neni 59 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen civile që i përket:

PADITËSE: D.V (përfaqësuar nga av. Kadri Isufaj)

I PADITUR: A.V (në mungesë)

OBJEKTI: 1. Zgjidhja e martesës ligjore me të paditurin A.V.

2. Lënien për rritje dhe edukim të tre fëmijëve A.V, E.V dhe D.V paditëses D.V.

3. Detyrimin ushqimor në shumën 600 (gjashtëqind) euro në muaj, 200 (dyqind) euro për fëmijë, për të paditurin A.V, për fëmijët A.V, E.V dhe D.V.

4. Të drejtën e kthimit të mbiemrit të para martesës “Ç” për paditësen D.V.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 153, 154, 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile.

Nenet 129, 139, 143, 144, 146 e vijues të Kodit të Familjes.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË,

- pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Artur Kalaja mbi vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare dhe shkaqet e rekursit të veçantë;

- dëgjoi përfaqësuesin e paditëses D.V, av. Kadri Isufaj, i cili kërkoi prishjen e vendimit nr. 1459 (13-2024-5077), datë 22.4.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe vazhdimin e gjykimit po në atë gjykatë, duke argumentuar rreth së drejtës për akses në gjykatë të garantuar nga neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

- dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Referuar rrethanave të faktit të pranuar nga gjykata në vendimmarrjen e saj, ka rezultuar se pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me padinë me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave në raport me bashkëshortët dhe fëmijët e mitur.

2. Në zbatim të nenit 134 të Kodit të Familjes, gjykata ka caktuar seancën e pajtimit, në të cilën janë paraqitur personalisht të dyja palët ndërgjyqëse. Pala paditëse ka pohuar se jeton në Greqi dhe fëmijët e tyre kanë lindur në Greqi. Shkak për zgjidhjen e martesës janë bërë grindjet e vazhdueshme me palën e paditur. Mosmarrëveshjet familjare kanë nisur që në vitin 2011, për shkak të sjelljeve të papërgjegjshme financiare të të paditurit, i cili nuk ka kontribuar materialisht për familjen, duke u përshkallëzuar deri në ushtrim të dhunës psikologjike në vitin 2022 dhe në episode të papranueshme dhune edhe ndaj fëmijës së mitur. Aktualisht, pala paditëse e ka ndërprerë jetesën e përbashkët me palën e paditur.

3. Ndërkohë, palët ndërgjyqëse kanë pretenduar se e kanë zgjidhur martesën në Greqi, duke rregulluar edhe pasojat e saj përpara një noteri



publik. Në këto rrethana, rezulton se bashkëjetesa ndërmjet palëve është tronditur në mënyrë të tillë, që nuk paraqet më mundësi reale pajtimi.

4. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka marrë në shqyrtim kryesisht çështjen e juridiksionit gjyqësor të gjykatave shqiptare, duke ftuar palët ndërgjyqëse të mbanin qëndrimin e tyre për këtë parakusht procedural civil.

Palët ndërgjyqëse kanë bërë me dije se jetojnë dhe punojnë në Greqi. Edhe fëmijët e tyre vazhdojnë shkollimin në Greqi. Po ashtu, martesë e tyre është zgjidhur me akt noterial, në përputhje me legjislacionin e shtetit grek.

5. Në seancën përgatitore, pala paditëse paraqiti dokumentacion që provon të ardhurat e saj për vitin 2023, si dhe vërtetime shkollore për tre fëmijët e mitur, të lëshuara nga shkolla fillore “M” në Greqi, si edhe dokumentacion lidhur me qiranë e një pasurie të paluajtshme.

Pala e paditur paraqiti dokumente që vërtetojnë të ardhurat e tij për vitin 2023 dhe deklarin e një pasurie të paluajtshme të dhënë me qira, të lëshuara nga autoritetet përkatëse në Greqi.

Ndërkohë, asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk paraqiti në cilësinë e provës shkresore aktin noterial për zgjidhjen e martesës në shtetin grek. Ndodhur në këto kushte, kur nga palët ndërgjyqëse nuk u paraqit asnjë akt noterial për të vërtetuar pretendimin e tyre për zgjidhjen e martesës në shtetin grek, një fakt i tillë mbeti i paprovuar në gjykim.

6. Gjykata ka marrë në shqyrtim kryesisht vetëm çështjen e juridiksionit të saj, pa u ndalur në analizën e parakushteve të tjera procedurale civile. Në vijim të verifikimeve të kryera nga gjykata, ka rezultuar se lidhja e vetme me Republikën e Shqipërisë e të miturve, palës paditëse, si dhe asaj të paditur, ishte shtetësia shqiptare dhe regjistrimi.

7. Me vendimin nr. 1459 (13-2024-5077), datë 22.4.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është vendosur:

-“Nxjerrja e çështjes civile me nr. 663 (21001-00052-13) në regjistrin themeltar, me datë regjistrimi 21.1.2025, jashtë juridiksionit gjyqësor të gjykatave shqiptare.

- Shpenzimet gjyqësore liben siç janë bërë.

- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs i veçantë”.

Në marrjen e vendimit për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar,

gjykata ka arsyetuar se palët dhe fëmijët, prej rreth 15 vitesh, jetojnë në Greqi, ku janë integruar ekonomikisht dhe shoqërisht, punojnë, banojnë me qira dhe fëmijët kanë lindur, janë shtetas dhe ndjekin shkollën atje. Për këtë arsye, gjykata vlerëson se vendqëndrimi i zakonshëm i tyre është në Greqi, si në aspektin objektiv ashtu edhe në atë subjektiv, duke e konsideruar të pabazuar pretendimin për vendqëndrim në Shqipëri vetëm mbi bazën e regjistrimit formal në gjendjen civile.

Sipas gjykatës, duke qenë se çështja paraqet elemente të huaja, juridiksioni rregullohet nga Konventa e Hagës e vitit 1996, e cila ka epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 10428/2011. Sipas kësaj Konvente, juridiksioni për çështjet e përgjegjësive prindërore i takon gjykatës së vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës, pasi ajo konsiderohet në pozitën më të mirë për të vlerësuar interesin më të lartë të tij, duke hetuar kushtet konkrete të jetesës dhe lidhjet faktike e shoqërore (*shih vendimin nr. 00-2025-225, datë 22.1.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Në nenin 10 të Konventës së Hagës është parashikuar edhe një përjashtim nga prezumimi i mësipërm, duke u përcaktuar se juridiksioni i gjykatave të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës mund të prorogohet në favor të gjykatave që kanë juridiksion për shqyrtimin e padive për zgjidhjen/pavlefshmërinë e martesës. Që ky prorogim të gjejë zbatim, duhet që të plotësohen disa kushte: i. ligji i brendshëm për të drejtën ndërkombëtare private duhet të ketë parashikuar se gjykatat që shqyrtojnë paditë për zgjidhjen ose pavlefshmërinë e martesës kanë juridiksion edhe për çështjet e përgjegjësive prindërore (neni 10, paragrafi 1); dhe ii. në kohën e fillimit të gjykimit, të paktën njëri nga prindërit që ushtron përgjegjësinë prindërore ndaj fëmijës duhet të ketë vendqëndrimin e zakonshëm në shtetin ku ushtrojnë juridiksionin e tyre këto gjykata (neni 10, paragrafi 1, germa “a”); dhe iii. juridiksioni i këtyre gjykatave duhet të jetë pranuar nga të dy prindërit (neni 10, paragrafi 1, germa “b”); dhe iv. gjykimi i çështjes nga këto gjykata duhet të jetë në interesin më të lartë të fëmijës (neni 10, paragrafi 1, germa “b”).

Kushtet e mësipërme janë kumulative, të tilla që mjafton mosplotësimi i vetëm njërit prej tyre, në mënyrë që neni 10, paragrafi 1 i Konventës së Hagës të mos gjejë zbatim për prorogimin e juridiksionit. Fakti se këto kushte janë kumulative del nga



interpretimi gramatikor i germave “a” dhe “b” të nenit 10, paragrafit 1 të Konventës së Hagës, të cilat nuk janë lidhur me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhëzës veçuese “ose”. Qëllimi për t’i klasifikuar këto kushte si kumulative del edhe nga Raporti Shpjegues i Konventës së Hagës, në lidhje me nenin 10 të saj, i cili i shërben interpretimit autentik të kësaj Konvente. Të njëjtën qasje ndjek edhe neni 10 i Rregullores Bruksel II, i cili përmban parashikime analoge me ato të nenit 10 të Konventës së Hagës.

Sa i përket rastit konkret, gjykata vë në dukje se fëmijët A.V, E.V dhe D.V kanë lindur dhe vazhdojnë të jetojnë në Greqi. Po ashtu, ata vazhdojnë shkollimin në institucionet arsimore të këtij shteti. Gjithashtu, palët ndërgjyqëse e kanë vendqëndrimin e zakonshëm në Greqi, duke qenë tërësisht të integruar në këtë shtet. Gjykata vëren se i vetmi element që i lidh palët ndërgjyqëse me Shqipërinë është shtetësia shqiptare, e cila vlerësohet e pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se interesi më i lartë i fëmijëve kërkon që gjykimi të zhvillohet në gjykatat shqiptare.

Gjykimi i kësaj mosmarrëveshjeje nga gjykatat greke do të ishte më i përshtatshëm, pasi gjykatat greke kanë mundësi të realizojnë në mënyrë më efektive intervistën e fëmijëve A.V, E.V dhe D.V, duke i pyetur drejtpërdrejt ose nëpërmjet psikologut, pa pasur nevojë që kjo pyetje të bëhet me mjete në distancë apo që fëmija të udhëtojë në shtetin shqiptar vetëm për këtë arsye, duke ndërprerë aktivitetet e përditshme që lidhen me shkollimin apo veprimtari të tjera sociale. Sipas praktikës së Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pyetja e fëmijës nga psikologu nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë bën që akti i ekspertimit psikologjik të jetë tërësisht i pavlefshëm, pasi në këtë situatë eksperti e ka të pamundur të hetojë mbi rrethanat faktike të kushteve të jetesës së fëmijëve dhe të prindërve (*shih vendimin nr. 00-2023-954 (132), datë 15.3.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Gjykata ka vlerësuar se kryerja e ekspertimit psikologjik me letërporsi do të ishte një proces i zgjatur dhe më pak efektiv sesa zhvillimi i gjykimit në Greqi. Verifikimi i kushteve familjare, sociale, arsimore dhe ekonomike të palëve dhe fëmijëve, si elemente thelbësore për përcaktimin e përgjegjësisë prindërore dhe detyrimit për ushqim, do të ishte më real, i saktë dhe praktik nëse do të kryhej nga gjykatat greke, të cilat janë më pranë realitetit të tyre. Po ashtu, sigurimi i provave mbi

gjendjen pasurore të palëve është më i lehtë në Greqi.

Gjykata thekson se çdo vendim mbi përgjegjësinë prindërore dhe detyrimin për ushqim do të ekzekutohej në Greqi, ku palët dhe fëmijët kanë vendqëndrimin e zakonshëm, ndaj, një vendim i dhënë nga gjykatat shqiptare do të kërkonte procedurë njohjeje nga gjykatat greke.

Referuar dispozitave të Kodit të Familjes, kërkimi për rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës, i cili ka të bëjë me çështjet e përgjegjësisë prindërore, nuk duhet interpretuar si aksesori në raport me padinë për zgjidhjen e martesës. Përkundrazi, ky kërkim duhet konsideruar si kryesor, së bashku me padinë për zgjidhjen e martesës, natyrisht të ndërvarur nga njëri-tjetri [...].

8. Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka paraqitur rekurs të veçantë pala paditëse, duke parashtruar shkaqet si në vijim:

- “[...] Së pari, gjykata ka gabuar, duke u shprehur në mënyrë të paqartë lidhur me nxjerrjen e çështjes civile jashtë juridiksionit, duke shprehur një qëndrim tjetër ligjor ndaj palëve ndërgjyqëse për të zgjidhur martesën e tyre, gjë e cila është një vullnet dhe mundësi që realizohet përmes një akti tjetër.

- Së dyti, referuar legjislacionit të Greqisë, zgjidhja e martesës për shtetasit jo grekë bëhet me marrëveshje para noterit publik, por kjo mund të mos njihet nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit përkatës (në rastin konkret për persona jo grekë), megjithëse ata mund të banojnë në territorin e Republikës së Greqisë. Në raste të tjera, kjo zgjidhje është bërë me një akt në Republikën e Shqipërisë dhe në këto kushte palët ndërgjyqëse mbeten të bllokuara juridikisht, të martuara vetëm në mënyrë formale, pa mundësi për të përdorur rrugët/mjetet ligjore për zgjidhjen e martesës. Kjo përbën shkelje të të drejtave të njeriut, pasi zgjidhja e martesës është një çështje që buron nga vullneti i lirë i palëve ndërgjyqëse dhe nuk mund të kufizohet apo pengohet nga procedura të paarsyeshme ligjore.

- Së treti, palët ndërgjyqëse, pavarësisht se jetojnë dhe punojnë në Greqi prej disa vitesh, kanë vetëm shtetësi shqiptare. Edhe tre fëmijët e tyre të mitur, megjithëse kanë lindur në Greqi, kanë shtetësi të dyfishtë (shqiptare dhe greke), por shtetësia shqiptare prevalon dhe ka përparësi kur bëhet vlerësimi krahasues dhe analizues i shtetësisë.



- Së katërti, në pjesën arsyetuese të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndër të tjera, thuhet se: *“Palët ndërgjyqëse bëjnë me dije se jetojnë dhe punojnë në Greqi. Edhe fëmijët e tyre vazhdojnë shkollimin në Greqi. Po ashtu, martesë e tyre është zgjidhur me akt noterial, në përputhje me legjislacionin grek”*. Këto deklarime mund të jenë thënë nga palët ndërgjyqëse gjatë seancës së pajtimit, pa praninë e mbrojtësve, ndryshe nga sa parashikon Kodi i Familjes. Nuk ka shumë rëndësi nëse deklaratat janë bërë nga njëra apo të dyja palët, por gjykata kishte detyrimin të konstatonte vërtetësinë apo pavërtetësinë e këtyre deklarimeve.

Nëse palët e kishin zgjidhur martesën në Greqi, nuk do të kishin asnjë arsye për të depozituar një kërkesëpadi për zgjidhje martese në Shqipëri, sepse do të ndodheshin përpara “gjësë së gjykuar” dhe gjykata do të duhej të pushonte gjykimin. Për më tepër, nëse vërtet martesë ishte zgjidhur me një akt noterial në Greqi, atëherë ky akt do të duhej të ishte regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile.

- Midis Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë është nënshkruar Konventa “Për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale”. Njohja e vendimeve gjyqësore, në zbatim të kësaj Konvente, është rregulluar nga kapitulli III, i titulluar “Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore”. Që nga ky titull dhe përmbajtja e të gjitha dispozitave të këtij kapitulli, kuptohet se rregullat e kësaj konvente vlejnë për njohjen e vendimeve të dhëna nga gjykatat dhe vendimeve të dhëna nga arbitrazhi (jo nga të tjerë).

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 153, datë 27.3.2024, vlerëson se martesë nuk konsiderohet një kontratë ligjore që mund të lidhet dhe të zgjidhet në çdo rast me vullnetin dhe kufijtë e palëve, por një institut bazë i krijimit të familjes, ku edukohet dhe zhvillohet jo vetëm individ, por së bashku me të edhe e gjithë shoqëria.

Zgjidhja e saj, sipas parimeve bazë të legjislacionit shqiptar, nuk mund të realizohet përmes noterit. Nëse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk do t'i jepte një zgjidhje përfundimtare e të qartë kësaj çështjeje, atëherë paditësja D.V dhe i padituri A.V, do të mbeteshin pa afat të përcaktuar të martuar jashtë çdo vullneti të secilit prej tyre.

II. Procedura para Gjykatës së Lartë dhe nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”), i përbërë nga një trupë gjykuese prej tre gjyqtarësh, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi

çështjen civile nr. 21001-00392-00-2025, me datë regjistrimi 30.6.2025, që ka për objekt rekursin e veçantë kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me të cilin është vendosur nxjerrja jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare e padisë për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave që rrjedhin prej saj (ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, e drejta e takimit dhe detyrimi ushqimor), në lidhje me fëmijët e mitur që kanë vendqëndrimin e zakonshëm jashtë Republikës së Shqipërisë.

10. Pasi vlerësoi vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shkaqet e rekursit të veçantë, Kolegji arriti në përfundimin se në rastin konkret shtrohej për zgjidhje një çështje ligjore me rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, lidhur me vlerësimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare për shqyrtimin e padive me objekt zgjidhjen e martesës, kur gjykata duhet të shprehet njëkohësisht edhe për pasojat që rrjedhin prej saj, përfshirë detyrimin ushqimor dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, në kushtet kur vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës së mitur ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Nevoja për njësim u diktua nga:

i. *pasiguria juridike në lidhje me raportin ndërmjet objektit të padisë për zgjidhjen e martesës dhe çështjeve të përgjegjësisë prindërore, si kërtime të ndërvarura;*

ii. *interpretimi dhe përcaktimi i nocionit “vendqëndrim i zakonshëm”, si kriter thelbësor për juridiksionin ndërkombëtar;*

iii. *zbatimi i instrumenteve ndërkombëtare përkatëse; dhe*

iv. *ekzistenca e praktikave të ndryshme gjyqësore, si në Kolegjin Civil ashtu edhe në gjykatat e shkallëve më të ulëta, çka kishte sjellë qasje jo të njëtrajtshme në adresimin e çështjeve të kësaj natyre.*

11. Rritja e migracionit dhe lidhjeve familjare me elemente ndërkombëtare në Shqipëri ka sjellë shtim të rasteve që përfshijnë mosmarrëveshje familjare ndërkufitare, kthimin e fëmijëve dhe kujdestarinë, ku gjykatat shqiptare vihen përpara dilemës për të përcaktuar juridiksionin. Zhvillimet e fundit në praktikën e Kolegjit për mosmarrëveshje të kësaj natyre nxjerrin në pah dy qasje të ndryshme lidhur me ekzistencën ose jo të juridiksionit të gjykatave shqiptare. Në veçanti, vendimmarrja për zgjidhjen e martesës ndërmjet shtetasve shqiptarë, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ka



ngritur pikëpyetje të rëndësishme lidhur me juridiksionin e gjykatave shqiptare për të shqyrtuar paditë për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave në raport me të miturit, të cilët gjenden në të tilla rrethana.

12. Sipas njërës prej qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për të shqyrtuar paditë me objekt zgjidhje martese dhe rregullimin e pasojave në raport me fëmijët e mitur, të cilët kanë vendqëndrimin e zakonshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në mbështetje të këtij qëndrimi, Kolegji ka argumentuar se elementi i huaj për çështjen konkrete i referohet vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës në një shtet të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë. Ky element ka relevancë për të përfshirur juridiksionin e gjykatës shqiptare në gjykimin e çështjeve me objekt “zgjidhje martese”, në rastin kur gjykata duhet të shprehet edhe për rregullimin e pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës, të tilla si: përcaktimi i mbiemrit të bashkëshortit që e ka ndryshuar atë me lidhjen e martesës, e drejta e përdorimit të banesës, detyrimi për ushqim për fëmijët e mitur, si dhe rregullimi i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për të miturit e ardhur në jetë nga martesa.

Sipas këtij qëndrimi të Kolegjit, mosmarrëveshja mes bashkëshortëve në padi të kësaj natyre nuk ka të bëjë kryesisht dhe vetëm me zgjidhjen e martesës, por me rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhjeje lidhur me fëmijët e tyre të mitur (*shih vendimet e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2025-225, datë 29.1.2025; nr. 00-2024-5194 (851), datë 23.12.2024; nr. 00-2024-1900, datë 9.5.2024; nr. 00-2022-1524, datë 4.4.2022 etj.*).

13. Në qëndrimin tjetër të mbajtur nga Kolegji, i njihet hapësirë juridiksionit të plotë të gjykatave shqiptare, që mbi bazën e kriterit të shtetësisë të njërës prej bashkëshortëve të vendosë si për zgjidhjen e martesës, ashtu edhe për të gjitha pasojat që lidhen me të, përfshirë detyrimin për ushqim dhe përgjegjësinë prindërore, pavarësisht nga vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës. Në kuadër të këtij qëndrimi, Kolegji argumenton kryesisht se në përputhje me nenin 10/2 të Konventës së Hagës, lejohet realizimi i zgjidhjes së martesës edhe pa u marrë masat mbrojtëse për fëmijën, që kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore.

Sipas këtij qëndrimi, zgjidhja e martesës përbën objektin kryesor të padisë, si pasojë e së cilës

shqyrtohen edhe çështjet e varura prej saj, siç është mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, detyrimi për ushqim etj. As në të drejtën procedurale civile shqiptare dhe as në atë ndërkombëtare nuk njihet që juridiksioni ose kompetenca e një çështjeje dytësore të jetë përcaktuese për kompetencën ose juridiksionin e gjykimit të çështjes kryesore. Përkundrazi, vlen parimi i kundërt, që gjykata kompetente ose juridiksioni i gjykatës për çështjen kryesore përfshin dhe atë të çështjeve dytësore të varura prej kësaj të fundit (*shih vendimet e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2025-2707, datë 9.7.2025; nr. 00-2025-2713, datë 2.7.2025; nr. 00-2025-2710, datë 2.7.2025; nr. 00-2024-5240, datë 23.12.2024; nr. 00-2023-2782, datë 31.5.2023 etj.*)...

14. Kolegji ka konstatuar se, deri përpara marrjes së vendimit për njësimin e praktikës, në Gjykatën e Lartë vijonin të paraqiteshin rekurse të veçanta ndaj vendimeve për nxjerrjen jashtë juridiksionit të çështjeve me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj edhe në raport me të miturit që kanë vendqëndrimin e zakonshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Duke pasur parasysh qëndrimet e ndryshme të Kolegjit dhe të gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me këtë aspekt, si dhe problematikat ligjore në interpretimin e legjislacionit të fushës në çështje të kësaj natyre, Kolegji Civil ka evidentuar nevojën për njësimin e praktikës gjyqësore.

15. Në çmim të Kolegjit, paqartësia e vazhdueshme e praktikës gjyqësore, e shtrirë në një periudhë të zgjatur kohore, është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GjEDNj), në disa vendimmarrje të saj, ka vlerësuar uniformitetin dhe njëtrajtshmërinë në zbatimin e ligjit nga gjykatat, si një nga kërkesat dhe garancitë e lidhura me procesin e rregullt ligjor (neni 6 i KEDNj). Sipas GjEDNj-së, vazhdimësia e vendimmarrjeve kontradiktore të gjykatave mund të krijojë një gjendje pasigurie juridike, që mund të zvogëlojë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, i cili është një nga komponentët thelbësorë të një shteti të udhëhequr nga parimi i sundimit të ligjit (*shih çështjen “Vinčić dhe të tjerë k. Serbisë”, aplikimi nr. 44698/06, vendimi i GjEDNj, datë 1.12.2009*).

GjEDNj ka pranuar se disa divergjenca në interpretim mund të pranohen si një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor, i cili bazohet në



një rrjet gjykatash (*shih çështjen “Tomit dhe të tjerë k. Malit të Zi”, aplikimi nr. 18650/09, vendimi i GjEDNj, datë 17.4.2012*). Megjithatë, në rrethana të caktuara, vendimet kontradiktore të gjykatave, veçanërisht të gjykatave që përfaqësojnë autoritetin suprem në një sistem gjyqësor, mund të përbëjnë shkelje të kriterëve për gjykim të drejtë të parashikuara në nenin 6 të Konventës. Për këtë qëllim, GjEDNj ka evidentuar disa elemente, të cilët duhet të mbahen në konsideratë në vlerësimin e kundërshtive jurisprudenciale dhe efektin që kanë në raport me parimin e sigurisë juridike, ku përfshihen: *i.* ekzistenca e zgjatur në kohë e qëndrimeve të ndryshme në praktikën gjyqësore të gjykatave; *ii.* nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve jurisprudenciale; *iii.* nëse këto mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe cili ka qenë efekti në praktikën gjyqësore (*shih çështjen “Şahin dhe Şahin k. Turqisë”, aplikimi nr. 13279/05, vendimi i GjEDNj, datë 20.10.2011*).

16. Gjykata e Lartë, nëpërmjet ushtrimit të funksionit ligjor për të njëzuar dhe ndryshuar praktikën gjyqësore, ka për detyrë të sigurojë një raport të ngushtë midis uniformitetit dhe konsistencës së praktikës gjyqësore dhe së drejtës së individit për një gjykim të drejtë.

Për sa më sipër, në referim të nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile (*në vijim “KPC”*), Kolegji ka disponuar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 (pesë) gjyqtarësh, për arsye se evidentohen shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural të një rëndësie themelore për njësimin e praktikës gjyqësore.

17. Kolegji, me vendimin e ndërmjetëm të datës 10.7.2025, ka vendosur:

“Kalimin e çështjes civile me nr. 21001-00392-00-2025, datë regjistrimi 30.6.2025, për shqyrtim në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet:

“1. Në konsideratë të parashikimeve të ligjit nr. 10428/2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” dhe konventat ndërkombëtare në këtë fushë, shtrohen pyetjet:

a) A kanë gjykatat shqiptare juridiksion për të gjykuar çështjet me objekt “Zgjidhje martesë”, kur gjykata duhet të shprehet edhe për rregullimin e pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës në raport me bashkëshortët dhe

fëmijët e mitur të ardhur në jetë nga martesa, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri?

b) A kanë gjykatat shqiptare juridiksion për të gjykuar çështjet me objekt rregullimin ose ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së mitur, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri?

c) A kanë gjykatat shqiptare juridiksion për të gjykuar çështjet me objekt përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim për fëmijët e mitur, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri?

ç) A kanë gjykatat shqiptare juridiksion për të gjykuar çështjet me objekt lejimin e lëvizjes së fëmijës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri?

2. Si qëndron juridiksioni i gjykatave shqiptare për këto çështje, në raport me zbatimin e Konventës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”?

18. Kolegji planifikoi çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe vijoi me procedurën e posaçme të parashikuar në nenin 481 të KPC-së (të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021). Në këto kushte, u formua trupa gjykuese prej 5 (pesë) gjyqtarësh, sipas pikës 3 të kësaj dispozite dhe u procedua me njoftimin individual të palëve ndërgjyqëse dhe Avokaturës së Shtetit (sa kohë çështja përfshinte interes publik), sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, për sa i përket datës dhe orës së seancës gjyqësore, trupës gjykuese, çështjeve të shtruara për njësim, duke i garantuar afatin prej të paktën 15 ditësh midis njoftimit dhe datës së seancës. Po ashtu, vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ku u pasqyruan çështjet e shtruara për njësim, u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

19. Pas zhvillimit të disa seancave gjyqësore, Kolegji vendosi përfundimisht në lidhje me këtë çështje në seancën e datës 22.12.2025.

III. Vlerësimi i Kolegjit Civil

III.1. Konsiderata të përgjithshme mbi kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë fushë

20. Juridiksioni është pushteti i gjykatës për të shqyrtuar dhe vendosur mbi çështje të caktuara, në bazë të ligjit, brenda kufijve të përcaktuar territorialë,



lëndorë dhe funksionalë. Si i tillë, përcaktimi i tij i saktë është thelbësor për të garantuar zhvillimin e një procesi civil të rregullt dhe të vlefshëm. Kjo nevojë bëhet edhe më e theksuar në rastet kur marrëdhënia juridike paraqet elemente të huaja, çka imponon verifikimin e juridiksionit në plan ndërkombëtar. Juridiksioni i gjykatave shqiptare për të shqyrtuar mosmarrëveshje me elemente të huaja përcaktohet në përputhje me rregullat e së drejtës së brendshme dhe instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme.

Neni 37 i KPC-së parashikon, se: *“Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juridikë të huaj rregullohet me ligj. Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t’i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”*.

Sipas nenit 37§2 të KPC-së, si rregull, juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t’i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur evidentohet një nga përjashtimet e sanksionuara nga Kodi ose marrëveshjet ndërkombëtare. Marrëveshjet për juridiksionin ndërkombëtar prodhojnë një efekt të dyfishtë: nga njëra anë, i atribuojnë juridiksion gjykatës së zgjedhur (efekti i prorogimit) dhe nga ana tjetër, përjashtojnë juridiksionin e çdo gjykate tjetër që do të ishte kompetente (efekti i derogimit).

21. Në zbatim të këtij parashikimi të KPC-së, si dhe për të siguruar një rregullim të posaçëm, të plotë dhe sistematik të marrëdhënieve juridike me elemente të huaja, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 10428, datë 2.6.2011 “Për të Drejtën Ndërkombëtare Private” (në vijim “LDNP”). Ky ligj rregullon, ndër të tjera, juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare, ligjin e zbatueshëm, si edhe aspektet procedurale që udhëheqin shqyrtimin gjyqësor të marrëdhënieve civile me elemente të huaja. Sipas nenit 1§2 të LDNP, “elementi i huaj”, për qëllime të zbatimit të këtij ligji, nënkupton çdo rrethanë juridike që lidhet me subjektin, përmbajtjen ose objektin e një marrëdhënieje juridiko-civile dhe që bëhet shkak për lidhjen e kësaj marrëdhënieje me një sistem ligjor të caktuar.

Në parim, përcaktimi i juridiksionit gjyqësor duhet të mbështetet në garantimin e së drejtës për akses në drejtësi, çka nënkupton se juridiksioni duhet t’i atribuohet atij autoriteti gjyqësor me të cilin mosmarrëveshja paraqet lidhjen më të afërt dhe më të drejtpërdrejtë.

22. Sipas parashikimeve të LDNP-së, gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të shqyrtuar çështjet që lidhen me martesën, kur njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë shtetas shqiptar apo kur njëri prej tyre ka vendqëndrim të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe rastet kur njëri prej bashkëshortëve është pa shtetësi. Këto kritere përbëjnë bazën lidhëse për përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar në çështjet martesore. LDNP nuk parashikon shprehimisht kriterin mbi të cilin do të përcaktohet juridiksioni ndërkombëtar i gjykatave shqiptare në rastet kur, krahas kërkesës për zgjidhjen e martesës, gjykata duhet të shprehet edhe për pasojat që lidhen me fëmijët e mitur, ndërkohë që vendqëndrimi i zakonshëm i tyre ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kuadër, Kolegji vlerëson se në çështjet që përfshijnë, ndër të tjera, edhe përcaktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, pozicioni dhe interesi më i lartë i fëmijës gëzojnë përparësi ndaj interesit procedural të palëve ndërgjyqëse, zakonisht prindërve ose personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, për të siguruar akses në gjykatë.

23. Rritja e vëmendjes ndaj të drejtave të fëmijës, veçanërisht e së drejtës për t’u dëgjuar, e garantuar nga instrumente ndërkombëtare si Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës⁴ dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), kërkon një “zhvendosje” nga zbatimi thjesht teknik i rregullave të juridiksionit, drejt një qasjeje të orientuar nga fëmija. Republika e Shqipërisë, si shtet ratifikues i këtyre akteve ndërkombëtare, ka përafruar legjislacionin dhe praktikën gjyqësore me parime thelbësore si: interesi më i lartë i fëmijës, e drejta e fëmijës për t’u dëgjuar në të gjitha procedurat vendimmarrëse që lidhen me të, si dhe e drejta për të ruajtur marrëdhënie personale me secilin prind (nenet 3, 10 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës).

⁴ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991, “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”.



Megjithatë, edhe në rastin kur njëra nga palët është fëmijë, ligji shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private nuk parashikon kriter specifik të lidhur me të miturin, për efekt të përcaktimit të juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare.

24. Ky boshllëk normativ kërkon një interpretim sistematik dhe në përputhje me parimet që udhëheqin të drejtën ndërkombëtare private. Juridiksioni në çështjet me element ndërkombëtar nuk mund të interpretohet në mënyrë të izoluar, por në një sistem normativ të integruar.

Në nenin 2 të LDNP-së parashikohet, se: *“Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi dispozitat e këtij ligji, kur dispozitat e tij nuk pajtohen me to”*.

Dispozita parashikon epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare ndaj normave ligjore që bien në kundërshtim me to, parim i cili gjen mbështetje edhe në nenet 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, LDNP duhet të interpretohet dhe zbatohet në harmoni me instrumentet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, ndërsa në rast mospërputhjeje, përparësi u jepet këtyre të fundit. Kjo nënkupton se fusha e zbatimit dhe përmbajtja e LDNP-së duhen analizuar në raport me aktet ndërkombëtare me të cilat ligji është përafëruar, si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare që prodhojnë efekte në rendin juridik të brendshëm shqiptar.

Në këtë kuptim, ndër instrumentet ndërkombëtare që orientojnë interpretimin e normave të LDNP-së, në çështjet që lidhen me të miturit, përfshihet në radhë të parë Konventa e Hagës *“Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve”*⁵ (në vijim *“Konventa e Hagës”*).

25. Konventa e Hagës ka për qëllim të përmirësojë mbrojtjen e fëmijëve të ndodhur në

rrethana ndërshtetërore/ndërkombëtare (mos-marrëveshje me element të huaj) dhe synon shmangien e konflikteve midis sistemeve ligjore, lidhur me masat që duhen marrë për mbrojtjen e të miturve. Objektivi i parë i Konventës së Hagës është të përcaktojë autoritetet e një shteti që ka juridiksion për të marrë masat për të mbrojtur fëmijën ose pasurinë e tij. Konventa e Hagës aplikohet vetëm në ato shtete kontraktuale në të cilat ajo ka hyrë në fuqi.

Në nenin 1 të Konventës së Hagës përcaktohen objektivat e Konventës që lidhen me përcaktimin e shtetit, autoritetet e të cilit kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve ose pasurinë e tyre, ligjin e zbatueshëm nga këto autoritete në ushtrimin e juridiksionit të tyre, ligjin e zbatueshëm për përgjegjësinë prindërore, njohjen dhe zbatimin e këtyre masave mbrojtëse në të gjitha Shtetet Kontraktuese, si dhe vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të Shteteve Kontraktuese, sipas nevojës, në mënyrë që të përmbushen qëllimet e kësaj Konvente.

26. Konventa e Hagës përcakton vendqëndrimin e zakonshëm të të miturit si kriterin themelor dhe mbizotërues për përcaktimin e juridiksionit, duke i dhënë përparësi këtij elementi ndaj kriterit të shtetësisë. Përdorimi i kriterit të shtetësisë si bazë për caktimin e juridiksionit ka karakter përjashtimor dhe mund të vihet në zbatim vetëm në rrethanat e parashikuara shprehimisht nga Konventa, kur transferimi i juridiksionit tek autoritetet e shtetit të shtetësisë së fëmijës vlerësohet se i shërben më mirë interesit të tij më të lartë⁶.

Edhe në përputhje me parimet që burojnë nga *acquis communautaire*⁷, në çështjet që rregullojnë marrëdhëniet juridike ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të mitur, juridiksioni i gjykatës përcaktohet nisur nga vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit, si kriter themelor, i cili vlerësohet dhe zbatohet në dritën e interesit më të lartë të fëmijës⁸. *A priori* ai përbën faktorin vendimtar në përcaktimin e

⁵ Konventa është miratuar në datën 19 Tetor 1996 dhe ka hyrë në fuqi në datë 1 Janar 2002 dhe është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005 *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”*.

⁶ Nenet 8 dhe 9 të Konventës së Hagës.

⁷ Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 1215/2012 (Bruksel I) dhe Rregullorja Bruksel II nr.2201/2003, e zëvendësuar nga ajo nr. 2019/1111.

Faqe | 9088

⁸ Në çështjen *“PM kundër AH”* (CJEU, C-604/17 PM *v* AH [2018] ECLI:EU:C:2018:10), Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GjDBE) ka theksuar përparësinë e rregullit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës, duke e konsideruar atë si bazën kryesore të juridiksionit në çështjet prindërore. GjDBE ka sanksionuar se gjykata e cila merret me një pretendim për divorc midis dy bashkëshortëve që janë shtetas të atij Shteti Anëtar, nuk ka juridiksion për të vendosur mbi përgjegjësinë prindërore në lidhje me fëmijën e bashkëshortëve, kur fëmija është banor i zakonshëm në një Shtet tjetër Anëtar, edhe nëse ligji kombëtar i atij Shteti



juridiksionit të gjykatave në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të tilla.

27. Rregullorja nr. 1215/2012 “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore në Çështjet Civile dhe Tregtare” (Bruksel I), ka vendosur një sistem të unifikuar për përcaktimin e gjykatës kompetente dhe për njohjen automatike të vendimeve brenda BE-së. Kjo Rregullore zbatohet në të gjitha çështjet civile dhe tregtare dhe synon të garantojë siguri juridike përmes rregullave të qarta mbi juridiksionin, juridiksioneve të posaçme për kontratat, dëmet dhe mosmarrëveshjet tregtare, si edhe heqjes së “procedurës së ekzekutimit”, duke mundësuar që vendimet e një gjykate të një shteti anëtar të njihen dhe ekzekutohen menjëherë në çdo shtet tjetër anëtar. Në fushën e së drejtës familjare zbatohet Rregullorja Bruksel II “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve në çështjet martesore dhe të përgjegjësisë prindërore” (sot Bruksel II-ter)⁹, që mbulon çështjet martesore dhe përgjegjësinë prindërore, duke përcaktuar si kriter themelor të juridiksionit vendqëndrimin e zakonshëm të bashkëshortëve ose fëmijës dhe duke mundësuar njohjen automatike të vendimeve familjare në të gjithë BE-në.

Rregullorja Bruksel II (Bruksel II-a, sot Bruksel II-ter) është më specifike dhe rregullon juridiksionin në çështjet martesore dhe përgjegjësinë prindërore, ndërsa Rregullorja Bruksel I ka fushë zbatimi më të gjerë për shumicën e çështjeve civile dhe tregtare.

28. Në marrëdhëniet ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, ka përparësi Rregullorja Bruksel II (Bruksel II-a, sot Bruksel II-ter), si instrument me efekt të drejtpërdrejtë. Ndërsa Konventa e Hagës gjen zbatim në raportet me shtetet jo-anëtare të BE-së që janë palë në të, si p.sh. Shqipëria apo Zvicra.

Rregullorja e Brukselit, në nenin 61 të saj (sot neni 97 i Rregullores Bruksel II ter)¹⁰, ka parashikuar marrëdhënien me Konventën e Hagës të 19 tetorit 1996 mbi Juridiksionin, Ligjin e Zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve. Në parim Rregullorja e Brukselit do të zbatohet: a) kur fëmija përkatës ka vendqëndrimin e zakonshëm në territorin e një Shteti Anëtar; b) sa i përket njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Anëtar në territorin e një tjetër Shteti Anëtar, edhe nëse fëmija përkatës ka vendqëndrimin e zakonshëm në territorin e një shteti të tretë, i cili është palë kontraktuese në Konventën e sipërpërmendur.

29. Referuar parashikimeve të Rregullores, rezulton se Konventa e Hagës e vitit 1996, si rregull, do të gjejë zbatim në rastin kur vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës së mitur është në një shtet jo-anëtar të Bashkimit Evropian. Parashikimet e Rregullores së Brukselit do të duhet të merren në analizë në rastet kur vendqëndrimi i fëmijëve është në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (p.sh. në rastet kur përpara gjykatave shqiptare vijnë për zgjidhje situata ku fëmijët kanë vendqëndrimin e zakonshëm në shtete si Italia, Greqia, Belgjika etj., të cilat janë anëtare të BE-së). Në kuptim të Rregullores së Brukselit, duke qenë se fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm në një shtet anëtar të BE-së, si rregull do të gjejë zbatim rregullorja dhe jo Konventa. Për pasojë, gjykatat shqiptare të ndodhura përpara një fakti të tillë (kur konkludojnë që fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm në një shtet anëtar të BE-së), duhet të mbajnë në konsideratë këtë parashikim.

30. E drejta e Bashkimit Evropian (BE), *acquis communautaire*, aktualisht nuk zbatohet drejtpërdrejt në Shqipëri, sa kohë vendi nuk është ende shtet

Anëtar imponon detyrimin për të vendosur *ex officio* mbi përgjegjësin prindërore. GjDBE i ka dhënë përparësi rregullit në nenin 8(1) të Rregullores, sipas të cilit gjykatat e Shtetit Anëtar ku fëmija ka vendbanimin e tij/saj të zakonshëm në kohën kur gjykata merret me çështjen, kanë juridiksion në çështjet e përgjegjësive prindërore (përveç rasteve kur plotësohen kushtet e neneve 9, 10 ose 12, siç thuhet në nenin 8(2) të Rregullores).

⁹ Që prej 1 gushtit 2022, kjo rregullore është zëvendësuar nga Bruksel II-ter (2019/1111), e cila ka sjellë ndryshime të cilat lidhen kryesisht me: procedura më të shpejta dhe më efektive për çështjet e kujdestarisë, heqjen plotësisht të procedurës së ekzekutimit dhe forcimin e

garancisë për të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar, duke përmirësuar ndjeshëm trajtimin e rasteve të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve dhe ekzekutimin e vendimeve familjare, pa ndryshuar në thelb aspektet e përcaktimit të juridiksionit.

¹⁰ Neni 97 i Rregullores Bruksel II-ter, krahas parimit të zbatimit të Rregullores midis shteteve anëtare parashikon se, kur palët kanë zgjedhur juridiksionin e një shteti palë të Konventës së Hagës, ku Rregullorja e Brukselit nuk zbatohet, juridiksioni përcaktohet sipas neni 10 të Konventës së Hagës ose në rast transferimi të juridiksionit, sipas neneve 8 dhe 9 të Konventës.



anëtar i BE-së, megjithatë, procesi i negociatave të anëtarësimit është hapur dhe pas aderimit dhe ratifikimit të Traktatit të Aderimit, *acquis* do të bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik, duke u zbatuar drejtpërdrejt dhe duke pasur epërsi ndaj ligjeve të brendshme në rast mospërputhjeje.

Megjithatë *acquis communautaire* përbën një burim mjaft të rëndësishëm për efekt të interpretimit të legjislacionit shqiptar dhe kryesisht të asaj pjese të legjislacionit që është përafuar dhe që duhet të përafrohet me të.

Neni 5 i Kushtetutës parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Gjithashtu, sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara pozicionohen menjëherë pas Kushtetutës në hierarkinë e akteve ligjore të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë. Kushtetuta i rezervon një vend të rëndësishëm marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, të cilat, sipas nenit 122 të saj, bëjnë pjesë në sistemin e brendshëm juridik, pasi botohen në Fletoren Zyrtare. Ato zbatohen drejtpërdrejt, përveç kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi legjislacionin e vendit që nuk përputhet me to.

31. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) është një marrëveshje e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006. Një ndër detyrimet që parashikon MSA është edhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me të drejtën e BE-së (*acquis communautaire*).

Neni 70 i MSA-së parashikon, se: “Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektin e tij. Shqipëria do të përpaket të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis-in* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë se legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm do të zbatohet dhe implementohet siç duhet. 2. Ky përafrim fillon në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes, dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementet e *acquis-it* të Komunitetit të përmendura në këtë Marrëveshje brenda periudhës transitore të përcaktuar në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje. 3. Gjatë fazës së parë të përcaktuar në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësorë të *acquis-it* të Tregut të Brendshëm, ashtu

si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, transporti detar dhe tokësor, duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe standardeve mjedisore si dhe aspekteve sociale, ligji për kompanitë tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësi të barabarta. Gjatë fazës së dytë Shqipëria do të përqendrohet në pjesët e mbetura të *acquis*. Përafrimi do të kryhet në bazë të një programi, për të cilin do të bibet dakord, ndërmjet Komisionit Evropian dhe Shqipërisë. 4. Shqipëria, në pajtim me Komisionin e Komuniteteve Evropiane, do të përcaktojë modalitetet për monitorimin e zbatimit të veprimeve që ndërmerren për përafrimin e legjislacionit dhe imponimin e ligjeve.

32. Lidhur me vendin e *acquis communautaire* në legjislacionin shqiptar dhe zbatimin e tij nga gjykatat shqiptare, Gjykata e Lartë, në disa nga vendimet e saj, ka konkluduar se: “[...] Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 6 dhe 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Të gjitha fazat e procesit legjislativ, duke nisur me formulimin e politikave dhe përcaktimin e instrumentit rregullues (ligj) deri te hartimi i tekstit të aktit dhe miratimit të tij në Kuvend, janë pjesë e procesit të adresimit të kërkesave të *Acquis Communautaire* (EU) në legjislacionin shqiptar [...] Në vendet e Bashkimit Evropian gjykatat janë të autorizuar të marrin masat e nevojshme, përfshirë këtu masat për shmangien e gjyqvarësisë për çështje të cilat do të gjykohen nga gjykata e një shteti tjetër anëtar. Pavarësisht se Republika e Shqipërisë ende nuk është bërë anëtar i Bashkimit Evropian me të drejta të plota, rregulloret e miratuara prej tyre janë udhërrëfyese në praktikën tonë ligjore, por zbatimi i sistemit normativ të Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*) nga ana e një shteti jo anëtar si Republika e Shqipërisë, ndryshon nga i njëjti proces në shtetet anëtare. Aktualisht në fazën e paraanëtarësimit Republika e Shqipërisë nuk ka detyrimin për aplikimin e drejtpërdrejt të sistemit normativ të BE-së. Gjykatat kombëtare mund t’i referohen legjislacionit komunitar në rastet e ometimeve ligjore apo kolizionit (praeter legem), por në asnjë rast ky interpretim nuk duhet të jetë në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit të brendshëm kombëtar (contra legem)”¹¹.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e RSH ka analizuar rëndësinë e së drejtës komunitare, për efekt të interpretimit të legjislacionit shqiptar. Në

¹¹ Vendimet e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 81, datë 29.6.2017 dhe nr. 411, datë 25.1.2018.



disa nga vendimet e saj,¹² kjo gjykatë i është referuar legjislacionit të BE-së, si një autoritet bindës, i cili edhe pse nuk është i detyrueshëm për gjykatën për ta ndjekur ose për ta zbatuar gjatë marrjes së një vendimi, shërben si një orientues mjaft i mirë në interpretimin e legjislacionit.

33. Për më tepër që rregulloret e BE-së në fushën e së drejtës ndërkombëtare private dhe asaj procedurale ndërkombëtare kanë ushtruar një ndikim të konsiderueshëm në përmbajtjen e LDNP. Në pjesën që rregullon ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore dhe jokontraktore, LDNP është përafëruar me dy nga aktet e BE-së: 1. Rregulloren (EC) nr. 593/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore” (Roma I); dhe 2. Rregulloren (EC) nr. 864/2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet jashtëkontraktore” (Roma II). Duke qenë se LDNP është përafëruar konceptualisht dhe teknikisht me rregulloret e BE-së, ai nuk mund të konsiderohet një ligj i izoluar, por me orientim evropian, që kërkon interpretim konform *acquis*. Kjo nënkupton se normat e tij duhet të lexohen në harmoni me kuadrin juridik ndërkombëtar, duke siguruar koherencë dhe unitet të sistemit normativ. Pjesa e normave të LDNP, që përmban parashikime të cilat nuk vijnë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, do të konsiderohen të pazbatueshme dhe këto të fundit do të kenë epërsi.

III.2. Çështjet e shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore

1. Në konsideratë të parashikimeve të ligjit nr. 10428/2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” dhe konventat ndërkombëtare në këtë fushë, shtrohen pyetjet:

a) A kanë gjykatat shqiptare juridiksion për të gjykuar çështjet me objekt “zgjidhje martesë”, kur gjykata duhet të shprehet edhe për rregullimin e pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës në raport me bashkëshortët dhe fëmijët e mitur të ardhur në jetë nga martesa, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri?

34. Çështja e parë e shtruar për njësim nga Kolegji kërkon, para së gjithash, të sqarohet nëse zgjidhja e martesës dhe rregullimi i pasojave të saj në raport me fëmijët e mitur përbëjnë një tërësi të ndërruarur dhe unitare kërkimesh në kuadrin e të njëjtit proces gjyqësor. Në këtë kontekst, duhet vlerësuar nëse vendimmarrja mbi ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përcaktimin e vendbanimit të fëmijës, rregullimin e të drejtave të kontaktit dhe caktimin e detyrimit ushqimor përbën pjesë integrale të të njëjtit gjykim, si dhe nëse ky karakter i bashkëlidhur i kërkesave ndikon në shtrirjen e juridiksionit ndërkombëtar të gjykatës, veçanërisht në rastet kur fëmijët e mitur kanë vendqëndrimin e zakonshëm jashtë Republikës së Shqipërisë.

35. Martesa është parashikuar nga ligjvënësi shqiptar si një marrëdhënie juridike-civile e posaçme, e cila e ka të domosdoshëm konsensusin, jo vetëm në çastin e lidhjes së martesës, por edhe përgjatë ekzistencës së saj, si formë e konsumimit, që konsiston në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve martesore dhe familjare të parashikuara në Kodin e Familjes, si në raport me bashkëshortët, ashtu dhe me fëmijët.

Ligjvënësi, në raport me martesën që nuk përmbush misionin e saj social të përcaktuar në Kushtetutë dhe në Kodin e Familjes dhe që sjell probleme në radhë të parë për anëtarët e saj, ka parashikuar si një formë të mbarimit, zgjidhjen e martesës. Sikundër vullneti për lidhjen e bashkëshortëve në martesë, zgjidhja e martesës përligjet duke u bazuar në parimin e lirisë së individit.

36. Kodi i Familjes, nisur nga shkak i zgjidhjes së martesës, parashikon tri raste të ndryshme kur gjykata mund të disponojë përfundimin (zgjidhjen) e një martese të vlefshme:

i. *zgjidhja me kërkesë të njërit bashkëshort*, e rregulluar nga neni 132 i Kodit të Familjes, e cila vendoset nga gjykata nëse provohet shkak i ligjor dhe fakti se martesa ka humbur qëllimin e saj, duke u bërë e pamundur jetesa e përbashkët;

ii. *zgjidhja me pëlqim reciprok*, e parashikuar në nenet 125-127 të Kodit të Familjes, ku bashkëshortët paraqesin për miratim një aktmarrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës dhe gjykata

¹² Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 12.9.2007; nr. 3, datë 5.2.2010; nr. 48, datë 15.11.2013 dhe nr. 56, datë 27.7.2016.



miraton marrëveshjen së bashku me kërkesën për zgjidhje dhe

iii. *zgjidhja për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët*, e parashikuar në nenin 129 të Kodit të Familjes, e cila mund të kërkohej kur bashkëshortët kanë jetuar të ndarë faktikisht për të paktën 3 (tre) vjet dhe kërkuar duhet të përcaktojë në padi mënyrën e zbatimit të detyrimeve ndaj fëmijëve dhe bashkëshortit tjetër.

37. Edhe pse në kuptim të nenit 154 të Kodit të Familjes¹³, zgjidhja e martesës në vetvete nuk prek të drejtat dhe detyrimet që prindërit kanë karshi fëmijëve të tyre, pasi marrëdhënia prind fëmijë është e veçantë, sërish rregullimi i pasojave të zgjidhjes së martesës në raport me fëmijët, kushtëzohet nga fakti që martesa sjell disa detyrime për prindërit, që lidhen me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Nga një interpretim sistematik i dispozitave të Kodit të Familjes rezulton se sistemi i zgjidhjes së martesës dhe pasojave të saj mbi fëmijët është “i bashkuar”/“unitar”.

Kështu, në rastin e zgjidhjes së martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët, neni 129/2 i Kodit të Familjes parashikon se kur në martesë ka fëmijë të mitur, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës duhet të përcaktojë në kërkesëpadinë e tij edhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër. Si rezultat i këtij kërkimi, i cili në temat e përdorura nga vetë ligji “duhet të përcaktojë dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve”, është i detyrueshëm, atëherë edhe gjykata është e detyruar që në të njëjtin vendim që jep për zgjidhjen e martesës, të përcaktojë modalitetin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, vendbanimin e fëmijës, mënyrën e kontaktit me prindin tjetër, si dhe detyrimin e mbajtjes së fëmijës (detyrimin për ushqim).

38. Neni 125 i Kodit të Familjes parashikon se në rastin e zgjidhjes së martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve, parashikimi në marrëveshje i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore është kusht i domosdoshëm, mungesa e të cilit mund të çojë gjykatën në rrëzimin e kërkesës për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok.

Karakter i detyrueshëm (*sine qua non*) i marrëveshjes për përcaktimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, përforcohet edhe nga neni 127 i Kodit të Familjes, sipas të cilit: “Gjykata vendos zgjidhjen e martesës në rast se krijon bindjen se vullneti i secilës palë është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin e tij për zgjidhjen e martesës. Në të njëjtin vendim, gjykata miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Marrëveshja përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar, nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore”.

39. Ndërsa Kodi i Familjes parashikon një rregullim të detajuar për dy nga format e zgjidhjes së martesës, përkatësisht atë me pëlqim reciprok dhe atë për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët, për zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort nuk parashikon shprehimisht detyrimin që në kërkesëpadi të përfshihet edhe rregullimi i pasojave në raport me fëmijët e mitur. Në vlerësim të Kolegjit, duke qenë se përcaktimi i prindit të cilit i besohet fëmija për rritje dhe edukim është një nga pasojat thelbësore të zgjidhjes së martesës, kjo çështje duhet të shqyrtohet në të njëjtin gjykim.

Nëse do të pranohej veçimi i kërkimit për zgjidhjen e martesës nga kërkimi i rregullimit të pasojave për fëmijët e mitur, do të krijonte pasiguri juridike në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe mungesë mbrojtjeje të të drejtave të fëmijëve të mitur, sepse pas zgjidhjes së martesës nuk do të ishim në të njëjtën situatë si gjatë vazhdimin të saj, kur përgjegjësia prindërore ushtrohej bashkërisht nga dy prindërit.

Aq më tepër, kur vetë paditësi kërkon rregullimin e pasojave lidhur me fëmijën e mitur, gjykata nuk mund të veçojë vendimmarrjen për zgjidhjen e martesës nga vendimmarrja për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, të drejtat e kontaktit dhe detyrimin ushqimor.

40. Sipas nenit 161 të Kodit të Familjes, “*Në vendimin e zgjidhjes së martesës caktohet dhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën dhe për ish-bashkëshortin, nëse është rasti, sipas parashikimeve të kreut “detyrimi për ushqim” të këtij Kodi*”. Në po këtë frymë janë edhe

¹³ Neni 154 i Kodit të Familjes parashikon, se: “*Zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Kod*”.
Faqe | 9092



parashikimet e neneve 139, 154-162 të Kodit të Familjes, që rregullojnë pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët.

I njëjti parashikim sanksionohet nga neni 49 i Kodit të Familjes lidhur me pavlefshmërinë e martesës. Sipas këtij neni, *“Martesa që shpallet e pavlefshme me vendim të formës së prerë konsiderohet se nuk është lidhur. Për bashkëshortin që nuk ka ditur shkakun e pavlefshmërisë së martesës, pasojat fillojnë nga data që vendimi merr formë të prerë. Fëmijët e lindur nga një martesë që shpallet e pavlefshme, quhen si të lindur nga martesa dhe marrëdhëniet midis tyre dhe prindërve rregullohen si në rastet kur zgjidhet martesa”*.

I vetmi rast në të cilin Kodi i Familjes parashikon veçimin e kërtimeve të tjera të paraqitura bashkë me kërkimin për zgjidhjen e martesës, lidhet me regjimin pasuror dhe të drejtat pasurore midis bashkëshortëve, sipas nenit 138 të këtij kodi.

41. Nga analiza e këtyre dispozitave, Kolegji konkludon se gjykata nuk mund të kufizohet vetëm në dhënien e vendimit për zgjidhjen e martesës, duke shtyrë për një moment të mëvonshëm rregullimin e aspekteve të përgjegjësisë prindërore, pasi interesat e fëmijëve kërkojnë një shqyrtim dhe zgjidhje të njëkohshme, të plotë dhe të koordinuar.

Në frymën e Kodit të Familjes, është e detyrueshme që padia për zgjidhjen/pavlefshmërinë e martesës dhe rregullimi i pasojave sa i përket fëmijëve të mitur të shqyrtohen detyrimisht bashkë, si kërtime të ndërrarura në kuadër të një gjykimi, ku gjykata, krahas vlerësimit të shkaqeve të zgjidhjes së martesës midis bashkëshortëve, duhet të adresojë edhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve kundrejt fëmijëve.

Një interpretim i tillë buron nga nevoja për të garantuar interesin më të lartë të fëmijës në rastin kur prindërit vendosin të zgjidhin martesën. Pas dhënies së vendimit për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave në raport me fëmijët e mitur, ndryshimi i kushteve mbi mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore nga secili prej prindërve (qoftë ai të cilit i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, qoftë edhe prindi tjetër) mund të kërkohej me një padi të veçantë (p.sh. ndryshimi i vendbanimit të fëmijës, rritja/ulja e detyrimit për mbajtje etj.), por kjo është një fazë pasuese dhe nuk justifikon veçimin e kërimit lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në momentin e zgjidhjes së martesës.

42. Kolegji thekson se në momentin e paraqitjes së një padie ku kërkohej zgjidhja e martesës dhe rregullimi i pasojave të saj në raport me fëmijët e mitur, nuk legjitimohet ndarja e kërimit për zgjidhjen e martesës nga ai për caktimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në raport me fëmijët e mitur. Gjykata shqiptare është e detyruar t'i shqyrtojë dhe të vendosë lidhur me këto kërtime në një proces të vetëm, me një vendim të vetëm, pra gjykata ka detyrimin të shprehet, krahas zgjidhjes së martesës, edhe për pasojat e saj në raport me fëmijët.

Kjo për faktin se rregullat mbi përgjegjësinë prindërore, në praktikë, shpesh vihen në lëvizje në kuadër të proceseve gjyqësore për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave që rrjedhin prej saj. Ndërsa në rastet kur gjykata duhet të vendosë vetëm mbi mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj një fëmije të lindur jashtë martese, situata paraqitet më e qartë, pasi shqyrtimi orientohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të plotë nga interesi më i lartë i të miturit, pa u ndërthurur me të drejta apo pasoja që lidhen me marrëdhënien midis ish-bashkëshortëve.

43. Në vijim të analizës si më sipër, Kolegji çmon të analizojë se cili midis shtetësisë, vendqëndrimit të zakonshëm të bashkëshortëve apo vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës së mitur përbën kriterin lidhës vendimtar për të përcaktuar juridiksionin ndërkombëtar gjyqësor në të tilla mosmarrëveshje. Rregulli i përgjithshëm i juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare bazohet në vendqëndrimin e zakonshëm të të paditurit në Republikën e Shqipërisë dhe parashikohet në nenin 71 të LDNP, sipas të cilit: *“Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur rregullat e këtij kreu parashikojnë ndryshe”*.

44. Në varësi të natyrës së mosmarrëveshjes, si dhe lidhjes midis gjykatës dhe fakteve të çështjes, LDNP ka rregulluar edhe rastet e juridiksionit alternativ dhe atij ekskluziv ndërkombëtar.

Në nenin 72 të LDNP parashikohen rastet kur juridiksioni i gjykatave shqiptare është ekskluziv dhe si i tillë, ai nuk mund të derogohet apo prorogohet. Sipas kësaj dispozite, *“Pavarësisht nga rregullat e këtij ligji, gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv në çdo rast për gjykimin e: a) çështjeve me objekt të drejtën e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi sende të paluajtshme, si dhe qiranë dhe të drejtat që rrjedhin nga përdorimi i pasurive të*



paluajtshme kundrejt shpërblimit, kur këto ndodhen në Republikën e Shqipërisë; b) çështjeve me objekt vendimet e organeve të shoqërive tregtare, kur shoqëria ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë; c) çështjeve me objekt themelimin, mbarimin e personave juridikë, si dhe paditë me objekt vendimet e organeve të tyre, kur personi juridik ka selinë në Republikën e Shqipërisë; ç) çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit në regjistrat e gjykatave ose organeve shtetërore shqiptare; d) çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit të të drejtave intelektuale, për sa kohë që këto regjistrime ose kërkesa për këto regjistrime është bërë në Republikën e Shqipërisë; dh) çështjeve, të cilat lidhen me ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë të titujve ekzekutivë”.

45. Në ndryshim nga neni 72 i LDNP-së, i cili parashikon çështjet që justifikojnë juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare, neni 75 i këtij ligji sanksionon një rregull të posaçëm për përcaktimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare në gjykimin e çështjeve që lidhen me martesën (paditë për zgjidhjen dhe shpalljen e pavlefshmërisë së martesës, vërtetimin e lidhjes së martesës, paditë që lidhen me regjimet pasurore martesore). Kjo dispozitë parashikon, se: “Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve që lidhen me martesën kur: a) njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë në kohën e lidhjes së martesës shtetas shqiptar; b) bashkëshorti, kundër të cilit është ngritur padia, apo paditësi, në rastin për zgjidhjen e martesës, ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë; c) njëri nga bashkëshortët është pa shtetësi dhe ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë. 2. Paditë, që lidhen me martesën, sipas pikës 1 të këtij neni, janë paditë për zgjidhjen dhe shpalljen e pavlefshmërisë së martesës, vërtetimin e lidhjes së martesës, si dhe ato që lidhen me regjimet pasurore martesore. 3. Juridiksioni, sipas pikës 1 të këtij neni, shtrihet edhe mbi pasojat, që vijnë nga zgjidhja, shpallja e pavlefshmërisë së martesës, nga regjimet pasurore martesore, si dhe mbi masat e përkohshme, të cilat merren nga gjykata në këto raste”.

Ndërkohë, sipas nenit 76 të LDNP rezulton, se: “Gjykatat shqiptare kanë juridiksion të gjykojnë çështjet, që lidhen me të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga martesa midis prindërve dhe fëmijëve, njohjen apo kundërshtimin e atësisë dhe të amësisë, kur njëra nga palët ka shtetësinë shqiptare ose ka vendqëndrimin e saj në Republikën e Shqipërisë ...”.

46. Kolegji vëren se dispozitat e sipërcituara nuk parashikojnë rregulla të posaçme mbi juridiksionin për paditë për zgjidhjen e martesës, në ato raste kur gjykata duhet të shprehet detyrimisht edhe për pasojat që lidhen me fëmijët e mitur me vendqëndrim të zakonshëm jashtë Republikës së Shqipërisë.

Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se është e domosdoshme që çështja të analizohet në dritën e instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme¹⁴ dhe të normave përkatëse të Konventës së Hagës.

Neni 1 i Konventës së Hagës parashikon, ndër objektivat kryesore të saj, përcaktimin e shtetit, autoritetet e të cilit janë kompetente për të ushtruar juridiksion dhe për të marrë masa që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve dhe të pasurisë së tyre.

Ndërkohë, në nenin 3 të Konventës specifikohen aspektet që mbulojnë këto masa të lidhura me fëmijët dhe konkretisht, “Masat e referuara në nenin 1 do të kenë lidhje, në veçanti, me: a) dhënien, ushtrimin, përfundimin ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore, si dhe delegimin e saj; b) të drejtat e kujdestarisë, duke përfshirë të drejtat në lidhje me kujdesin për fëmijën dhe, në veçanti, të drejtën për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës, si dhe të drejtat e hyrjes, duke përfshirë të drejtën për ta marrë fëmijën për një periudhë të kufizuar kohe, në një vend tjetër nga ai i banesës së përhershme të fëmijës; c) kujdestarinë dhe institucionet e ngjashme; d) planifikimin dhe funksionet e çdo personi apo organi që përfaqëson apo ndihmon fëmijën, që është përgjegjës për fëmijën ose pasurinë e tij; e) vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare nën kujdesin institucional, sigurimin e kujdesit kafala apo të një institucioni të ngjashëm; f) mbikëqyrjen nga një autoritet publik për kujdesin e treguar ndaj fëmijës nga çdo person që ka fëmijën nën përgjegjësinë e vet; g) administrimin, ruajtjen ose eliminimin e pasurisë së fëmijës”.

47. Neni 5 i Konventës së Hagës sanksionon rregullin e përgjithshëm të juridiksionit ndërkombëtar, sipas të cilit, për çështjet që bien në fushën e zbatimit të saj, juridiksioni i takon gjykatës së shtetit ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm. Kjo dispozitë parashikon shprehimisht, se: “1. Autoritetet gjyqësore ose administrative të Shtetit Kontraktues, ku fëmija ka banesën e përhershme, kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës ose të pronës së tij. 2. Në bazë të nenit 7, në rast ndryshimi të banesës së përhershme të fëmijës në një Shtet tjetër

¹⁴ Të analizuar në pikën III.1 të këtij vendimi njësoj, § 25 e vijues.



Kontraktues, autoritetet e shtetit të banesës së re kanë juridiksion”.

Për të rregulluar situatat e veçanta që lidhen me zhvendosjen ndërkufitare të fëmijëve dhe pamundësinë e përcaktimit të banesës së tyre të përhershme, neni 6 i Konventës së Hagës parashikon, se: “1. Për fëmijët emigrantë dhe fëmijët të cilët, për shkak të problemeve të ndodhura në vendin e tyre, janë zhvendosur në një shtet tjetër, autoritetet e Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit ndodhen këta fëmijë si rezultat i zhvendosjes së tyre, kanë juridiksionin e parashikuar në nenin 5, paragrafi 1; 2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm zbatohen gjithashtu për fëmijët, banesa e përhershme e të cilëve nuk mund të përcaktohet”.

48. Në vijim të sa u trajtua më sipër dhe duke iu rikthyer përmbajtjes së nenit 3 të Konventës së Hagës, kjo dispozitë saktëson se “masat” e përmendura në nenin 1 përfshijnë, në mënyrë të veçantë, dhënien, ushtrimin, kufizimin ose përfundimin e përgjegjësisë prindërore, të drejtat e kujdestarisë, përcaktimin e vendbanimit dhe të drejtën e hyrjes dhe marrjes së fëmijës, vendosjen e tij në kujdestari ose në institucione, si dhe administrimin e pasurisë së fëmijës.

Vetë formulimi i dispozitës tregon se fusha materiale e Konventës është e gjerë dhe përfshin çdo masë mbrojtëse që ka për objekt statusin personal dhe pasuror të fëmijës, pa e kufizuar zbatimin e saj vetëm në masa të përkohshme apo urgjente. Kolegji çmon të evidentojë se termi “masa”, në kuptim të Konventës, nuk i referohet ekskluzivisht masave provizore, por çdo vendimmarrjeje të autoritetit kompetent që rregullon në mënyrë thelbësore përgjegjësinë prindërore dhe ushtrimin e saj. Kjo kuptohet edhe nga përfshirja e elementeve si “dhënia”, “përfundimi” apo “kufizimi” i përgjegjësisë prindërore, të cilat për nga natyra e tyre janë vendime me karakter përfundimtar dhe jo thjesht të përkohshëm.

Për rrjedhojë, Konventa gjen zbatim jo vetëm kur autoritetet marrin masa urgjente për mbrojtjen e fëmijës, por edhe kur ato vendosin mbi thelbin e përgjegjësisë prindërore.

Kjo do të thotë se, edhe kur çështja e përgjegjësisë prindërore paraqitet e lidhur me një kërkesë për zgjidhjen e martesës, ajo përfshihet në objektivat e Konventës së Hagës, për sa kohë ka të

integruar edhe kërkime lidhur me ushtrimin, kufizimin apo rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve ndaj fëmijës së mitur.

49. Referuar Udhëzuesit Praktik mbi zbatimin e Konventës së Hagës, publikuar nga Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, Byroja e Përhershme¹⁵ (në vijim “Udhëzuesi Praktik”), të drejtat dhe përgjegjësitë mund të lidhen me vendimmarrjet mbi kujdestarinë, edukimin, kujdesin shëndetësor, përcaktimin e vendbanimit të fëmijës ose të lëvizjes së tij nga një shtet në tjetrin. Në përputhje me nenin 5 dhe vijues të Konventës së Hagës, rregulli themelor i juridiksionit që ajo sanksionon dhe që duhet të udhëheqë gjykatat në përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar, lidhet me faktin se masat e mbrojtjes së fëmijës merren nga autoritetet gjyqësore ose administrative të Shtetit Kontraktues ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm. Sipas Udhëzuesit Praktik, ky koncept duhet të përcaktohet rast pas rasti nga autoriteti kompetent, mbi bazën e vlerësimit të rrethanave konkrete faktike.

Vendqëndrimi i zakonshëm përbën një koncept autonom dhe duhet të interpretohet në dritën e objektivave të Konventës dhe jo në bazë të kriterëve formale të legjislacionit të brendshëm të një shteti, si p.sh. adresa e regjistruar në certifikatën personale të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile.

50. Për të evidentuar mënyrën se si ky koncept është reflektuar edhe në legjislacionin e brendshëm, është e nevojshme t’i referohemi dispozitave përkatëse të së drejtës shqiptare ndërkombëtare private. Neni 12 i LDNP-së përkufizon nocionin e “vendqëndrimit të zakonshëm” të personit fizik në tërësi, duke parashikuar, se: “1. Për qëllime të këtij ligji, me “vendqëndrim të zakonshëm të një personi fizik” kuptohet vendi, në të cilin ai ka vendosur për të qëndruar në pjesën më të madhe të kohës, qoftë dhe në mungesë të regjistrimit dhe pavarësisht nga leja apo autorizimi për të qëndruar. Në përcaktimin e këtij vendi gjykata mban parasysh rrethanat e natyrës personale apo profesionale, që tregojnë lidhje të qëndrueshme me këtë vend, apo synimin e personit për të krijuar lidhje të tilla. 2. Për qëllime të këtij ligji, lidhja më e ngushtë përcaktohet nga gjykata, sipas rrethanave të faktit”. Dispozita përcakton “vendqëndrimin e zakonshëm” si koncept faktik dhe jo formal, duke e lidhur atë me vendin ku një person fizik ka vendosur

¹⁵ Publikuar në linkun vijues: [eca03d40-29c6-4cc4-ae52-edad337b6b86.pdf](https://www.e-justicia.gov.al/eca03d40-29c6-4cc4-ae52-edad337b6b86.pdf)



të jetojë në mënyrë reale dhe të qëndrueshme, pra në pjesën më të madhe të kohës. Theksi vihet te realiteti objektiv i jetës së personit dhe jo tek elemente formale si regjistrimi civil, leja e qëndrimit apo autorizime administrative.

Në përcaktimin e vendqëndrimit të zakonshëm, gjykata duhet të analizojë rrethanat personale dhe profesionale të individit (si familja, puna, integrimi social, kohëzgjatja e qëndrimit, lidhjet ekonomike etj.), të cilat tregojnë ekzistencën e lidhjeve të qëndrueshme dhe të stabilizuara me një shtet të caktuar. Përveç elementeve objektive, dispozita lejon që të merret parasysh edhe synimi i personit për të krijuar lidhje të tilla, duke reflektuar një element subjektiv, por gjithmonë të verifikueshëm përmes fakteve konkrete.

Paragrafi i dytë i dispozitës plotëson kuadrin duke parashikuar se, në rastet kur kërkohet përcaktimi i “lidhjes më të ngushtë”, ky vlerësim kryhet nga gjykata mbi bazën e rrethanave të faktit, pra përmes një analize krahasuese të elementeve lidhëse (familjare, sociale, profesionale, ekonomike etj.). Kjo nënkupton një vlerësim tërësor dhe konkret, ku gjykata identifikon intensitetin e lidhjeve me një vend të caktuar, për të përcaktuar juridiksionin.

51. Pavarësisht parashikimeve të nenit 12 të LDNP-së, në kuadrin e së drejtës shqiptare ndërkombëtare private nuk rezulton një përkufizim i drejtpërdrejtë dhe i plotë i konceptit të “vendqëndrimit të zakonshëm” të të miturit. Në praktikë dhe në doktrinë, për përcaktimin e këtij koncepti evidentohen dy qasje kryesore: *e para* lidhet me vullnetin dhe qëllimin e prindërve në raport me lëvizjen nga një shtet në tjetrin; ndërsa *e dyta* vendos në qendër fëmijën dhe mbështetet në realitetin faktik të jetës së tij. Kjo qasje e fundit merr në konsideratë elemente si: arsimimi, integrimi dhe ndërveprimi social, marrëdhëniet familjare dhe, në përgjithësi, organizimin e përditshmërisë së fëmijës. Në disa raste, për shkak të rrethanave konkrete, mund të rezultojë e nevojshme një vlerësim i kombinuar i të dyja qasjeve. Për të përcaktuar qasjen që duhet ndjekur, gjykata duhet të mbajë parasysh, ndër të tjera, moshën e fëmijës, duke i kushtuar kujdes të

veçantë rrethanave që lidhen me realitetin e tij të jetesës, sa më i rritur të jetë ai.

Në çdo rast, mungesa e përkohshme e fëmijës nga vendqëndrimi i zakonshëm, për arsye pushimesh, udhëtimesh shkollore apo për ushtrimin e të drejtave të kontaktit dhe takimit, nuk sjell ndryshimin e vendqëndrimit të zakonshëm.

52. Në vijim të analizës së legjislacionit të brendshëm dhe me qëllim sigurimin e një interpretimi të harmonizuar me standardet evropiane, Kolegji çmon të nevojshme të ndalet në trajtimin që i është bërë konceptit të vendqëndrimit të zakonshëm në jurisprudencën e GjDBE-së, në kuadër të interpretimit të Rregullores së Brukselit II-a (sot Bruksel II-ter). Rregullorja lidhet ngushtë me Konventën e Hagës, sepse të dyja trajtojnë çështje të ngjashme të mbrojtjes së fëmijëve në kontekste ndërkombëtare, por rregullorja synon të harmonizojë dhe të ketë përparësi brenda vendeve anëtare të BE-së, duke plotësuar konventën ndërkombëtare.

Koncepti i “vendqëndrimit të zakonshëm”, i interpretuar në mënyrë autonome dhe në dritën e objektivave të Rregullores, përfaqëson vendin që pasqyron një shkallë integrimi të fëmijës në një mjedis social dhe familjar, duke u bazuar në një vlerësim tërësor të rrethanave faktike (kohëzgjatja, rregullsia dhe arsyet e qëndrimit; lidhjet familjare e sociale; shkollimi; gjuha; integrimi). Thjesht prania fizike, në vetvete, nuk është e mjaftueshme¹⁶. Vendqëndrimi i zakonshëm kërkon qëndrueshmëri dhe synim për integrim të përhershëm të fëmijës. Në rastin e foshnjave, vendbanimi i zakonshëm i prindit që ushtron kujdesin real merr rëndësi të veçantë. Nuk ekziston një periudhë minimale kohore e paracaktuar dhe vlerësimi i përket gjykatës kombëtare, mbi bazën e të gjitha rrethanave konkrete¹⁷. Juridiksioni i gjykatave të shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm ruhet për çështje që lidhen me ndryshimin e vendimeve përfundimtare mbi përgjegjësinë prindërore, edhe nëse fëmija ka zhvendosur vendqëndrimin e tij të zakonshëm në një shtet tjetër. Vendqëndrimi i zakonshëm mbetet kriteri qendror për përcaktimin e juridiksionit sipas Rregullores, në funksion të interesit më të mirë të

¹⁶ Vendimi i GjDBE C-523/07 “A.” (CJEU Case C-523/07 A. [2009] ECR I-2805).

¹⁷ Vendimi i GjDBE C-497/10 “Mercredi kundër Chaffe” (CJEU, C-497/10 PPU Mercredi v Chaffe [2010] ECR I-14309).



fëmijës.¹⁸ Vendbanimi i zakonshëm përfaqëson qendrën faktike të jetës së fëmijës, duke theksuar se përcaktimi duhet të bazohet në një tërësi provash të qëndrueshme. Elementet përcaktuese përfshijnë vendin e jetesës së përditshme pas ndarjes së prindërve, stabilitetin e kujdesit prindëror dhe integrimin real social.

Në të kundërt, nuk janë vendimtare qëndrimet e përkohshme, origjina e prindit, lidhjet kulturore apo synimet e ardhshme të zhvendosjes.¹⁹

53. Për të përcaktuar vendqëndrimin e zakonshëm, nuk duhet të merret për bazë thjesht dhe vetëm prania fizike, e përkohshme dhe sporadike e fëmijës në një shtet, por kërkohet një shkallë integrimi në ambientin familjar dhe shoqëror, duke u mbajtur në konsideratë qëllimi i prindërve për t'u vendosur në mënyrë të përhershme me fëmijën në një shtet, kohëzgjatja e qëndrimit, rregullshmëria, kushtet dhe arsyet e qëndrimit në territorin e shtetit, zhvendosja e familjes në atë shtet, shtetësia e fëmijës, mosha e fëmijës, vendi dhe kushtet e ndjekjes së shkollës, njohuritë gjuhësore dhe marrëdhëniet familjare e shoqërore të fëmijës në këtë shtet. Gjithashtu, shtetësia e fëmijës nuk mjafton për të përcaktuar vendqëndrimin e zakonshëm, mbi të gjitha në rastin kur ndodh që fëmija të ketë lindur jashtë shtetit të shtetësisë.

Ajo që duhet të mbahet parasysh është shteti në të cilin mund të vlerësohet më së miri interesi i fëmijës. Kjo për faktin se, si rregull, gjykatat e këtij shteti janë në pozitën më të mirë për të hetuar dhe shqyrtuar kushtet konkrete ku fëmija banon, mjedisin social rrethues, lidhjet faktike dhe të vazhdueshme me njerëzit apo institucionet e përkujdesjes etj. (*shih vendimin nr. 00-2025-225, datë 22.1.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

Vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës është vendi që pasqyron qendrën reale dhe të qëndrueshme të jetës së tij, e përcaktuar mbi bazën e një vlerësimi tërësor të rrethanave faktike që tregojnë integrimin social dhe familjar; ai nuk varet nga formalitetet, as nga prania e thjeshtë fizike apo nga synimet e ardhshme, por nga stabiliteti objektiv i lidhjeve të fëmijës në momentin përkatës. Faktorë si origjina/shtetësia e fëmijës apo e prindërve të tij nuk

janë faktorë përcaktues lidhur me vendqëndrimin e zakonshëm të të miturit.

54. Sikundër u theksua më sipër, neni 5 i Konventës së Hagës përcakton rregullin e përgjithshëm, që për çështjet që rregullohen prej saj, juridiksioni i përket gjykatës së vendit ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm. Nga ky rregull ka edhe përjashtime, sikundër është neni 10 i Konventës së Hagës, i cili parashikon, se: *“1. Pa asnjë paragjykim në lidhje me dispozitat e neneve 5-9, autoritetet e një Shteti Kontraktues, që ushtrojnë juridiksionin për të vendosur në lidhje me një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të një fëmije që është banor i zakonshëm në një Shtet tjetër Kontraktues ose për anulimin e martesës së tyre, nëse e parashikon ligji i shtetit të tyre, mund të marrin masa për mbrojtjen e fëmijës apo të pasurisë së tij, nëse: a) në kohën e fillimit të procedimit, njëri nga prindërit e tij ose të saj ka pasur banesë të përhershme në këtë shtet dhe njëri prej tyre ka përgjegjësi ligjore në lidhje me fëmijën, dhe b) juridiksioni i këtyre autoriteteve për të marrë këto masa është pranuar nga prindërit, si dhe nga ndonjë person tjetër i cili ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën dhe kur është në interes të fëmijës”*.

55. Neni 10 i Konventës së Hagës parashikon një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i juridiksionit ndërkombëtar, duke lejuar që juridiksioni i gjykatave të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës të prorogohet (të kalohet me marrëveshje) në favor të gjykatave kompetente për shqyrtimin e padive për zgjidhjen ose pavlefshmërinë e martesës, por vetëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e përcaktuara nga kjo dispozitë. Nga analiza e nenit 10 të Konventës rezulton se autoritetet gjyqësore të një Shteti Kontraktues, të cilat ushtrojnë juridiksion për shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës ndërmjet prindërve të një fëmije me vendqëndrim të zakonshëm në një Shtet tjetër Kontraktues, mund të ushtrojnë juridiksion edhe për marrjen e masave në raport me fëmijën, për sa kohë që kjo lejohet nga ligji i atij shteti dhe përmbushen njëkohësisht kushtet e parashikuara nga dispozita në fjalë, që janë:

i. në kohën e fillimit të procesit gjyqësor për zgjidhjen e martesës, njëri nga prindërit e fëmijës ka pasur banesë të përhershme në këtë shtet dhe njëri

¹⁸ Vendimi i GjDBE C-499/15 “W. dhe V. kundër X.” (CJEU, C-499/15 W and V v. X [2017] ECLI:EU:C:2017:118).

¹⁹ Vendimi i GjDBE C-512/17, “HR kundër KO” (CJEU, Case C-512/17 HR C-512/17, ECLI:EU:C:2018:513).



prej tyre ka përgjegjësi ligjore në lidhje me fëmijën, dhe

ii. juridiksioni i këtyre autoriteteve për të marrë këto masa është pranuar nga prindërit, si dhe nga ndonjë person tjetër, i cili ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën dhe

iii. kur është në interes të fëmijës (që juridiksioni të ushtrohet mbi këtë bazë).

56. Duke qenë se rregulli themelor për përcaktimin e juridiksionit në çështjet që lidhen me të miturin bazohet në vendqëndrimin e zakonshëm të tij, pranimi i juridiksionit të gjykatës që shqyrton padinë për zgjidhjen e martesës edhe për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën me vendqëndrim të zakonshëm në një Shtet tjetër Kontraktues, përbën një përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm dhe gjen zbatim vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e parashikuara shprehimisht nga Konventa.

Fakti se këto kushte janë kumulative rezultojnë jo vetëm nga një interpretim gramatikor i tekstit të normës (pikat “a” dhe “b” të paragrafit 1, të nenit 10 të Konventës nuk janë lidhura me lidhëza veçuese), por edhe nga shpjegimi që i bëhet dispozitës në Udhëzuesin Praktik, nga i cili rezultojnë se, nëse autoriteti gjyqësor i një shteti mund të marrë vendim lidhur me fëmijët e mitur në kuadër të një gjykimi për zgjidhjen e martesës së prindërve, ata mund ta bëjnë këtë vetëm kur përmbushen kushtet e nenit 10(1) a) dhe b)²⁰.

57. Sipas Udhëzuesit Praktik, juridiksioni në rastet kur është në pritje një divorc ose ndarje ligjore e prindërve të fëmijës (neni 10 i Konventës) përcaktohet sipas skemës vijuese: Autoritetet e një Shteti Palë që ushtrojnë juridiksion në një kërkesë për divorc, ndarje ligjore ose shpallje të pavlefshmërisë së martesës së prindërve të një fëmije, i cili ka vendqëndrimin e zakonshëm në një tjetër Shtet Palë, mund të marrin masa që lidhen me personin dhe pasurinë e atij fëmije, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm në një tjetër Shtet Palë; dhe

ii. legjislacioni i Shtetit Palë të autoriteteve që ushtrojnë juridiksion u lejon atyre të marrin masa të tilla në rrethanat konkrete; dhe

iii. në momentin e fillimit të procedurës, të paktën njëri nga prindërit ka vendqëndrim të zakonshëm në atë Shtet Palë; dhe

iv. në momentin e fillimit të procedurës, të paktën njëri nga prindërit ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën; dhe

v. juridiksioni i autoriteteve për të marrë këto masa është pranuar nga prindërit, si dhe nga çdo person tjetër që ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën; dhe

vi. është në interesin më të mirë të fëmijës që juridiksioni të ushtrohet mbi këtë bazë.²¹

58. Nga analiza e mësipërme rezultojnë se kushtet e parashikuara në nenin 10 të Konventës së Hagës kanë natyrë kumulative, çka nënkupton se ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Neni 10 i Konventës, në pjesën që lejon prorogimin (kalimin me marrëveshje) e juridiksionit në favor të gjykatës që shqyrton padinë për zgjidhjen e martesës, në vend të asaj të vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit, përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm dhe gjen zbatim vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e parashikuara nga Konventa.

Në çdo rast, vlerësimi dhe respektimi i interesit më të lartë të fëmijës përbën kriterin thelbësor dhe mbizotërues, i cili duhet të verifikohet paralelisht me përmbushjen e të gjitha kushteve të tjera të përcaktuara. Gjithashtu, sipas nenit 10§2 të Konventës, “[...] 2. *Juridiksioni i parashikuar në paragrafin 1²² për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës ndërpritet nëse vendimi për të lejuar ose refuzuar kërkesën për divorc, ndarjen ligjore ose prishjen e martesës ka marrë formë të prerë, ose procedimi ka përfunduar për ndonjë arsye tjetër.* Kjo do të thotë se prorogimi vijon për sa kohë vijon gjykimi lidhur me zgjidhjen e martesës dhe përfundimi i këtij gjykimi i jep fund prorogimit. Neni 10§2 nuk duhet të kuptohet si mundësi e veçimit të kërtimeve, pasi një prerogativë e tillë nuk buron nga Konventa, por i përket rregullimit të legjislacionit procedural të brendshëm të secilit shtet.

59. Krahas mundësisë së prorogimit (kalimit me marrëveshje) të juridiksionit, Konventa e Hagës ka rregulluar edhe rastet e transferimit të tij. Në kuptim

²⁰ Udhëzuesi Praktik mbi Zbatimin e Konventës së Hagës 1996 për Mbrojtjen e Fëmijëve, 2014, f. 48, [eca03d40-29c6-4cc4-ae52-edad337b6b86.pdf](https://www.hcch.net/doc/publications-and-publications/2014-03-04-29c6-4cc4-ae52-edad337b6b86.pdf).
Faqe | 9098

²¹ Po aty.

²² Dispozita i referohet juridiksionit të gjykatës që shqyrton kërkesën për divorc.



të neneve 8²³ dhe 9²⁴ të Konventës, kërkesa për transferim të juridiksionit mund të bëhet në dy mënyra:

i. Një autoritet që ka juridiksion të përgjithshëm sipas Konventës, nëse vlerëson se një autoritet tjetër, i cili normalisht nuk ka juridiksion, do të ishte më i përshtatshëm në rastin konkret për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës, mund të kërkojë transferimin e juridiksionit tek ai autoritet (neni 8);

ii. Një autoritet që nuk ka juridiksion, por që beson se është më i përshtatshëm në rastin konkret për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës, mund të kërkojë leje për të ushtruar juridiksion (neni 9).

Këto dispozita lejojnë transferimin e juridiksionit kur autoriteti që aktualisht ka juridiksion nuk është më i përshtatshmi për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës. Interesi më i lartë i fëmijës duhet të vlerësohet “në rastin konkret”, pra “në momentin kur nevoja për mbrojtje ndjehet dhe me qëllim që t’i përgjigjet asaj nevoje”.

60. Por cilat janë kushtet që duhet të përmbushen përpara se të ndodhë një transferim juridiksioni? Sipas neneve 8 dhe 9 të Konventës, juridiksioni mund të transferohet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. *Lidhja mes fëmijës dhe shtetit palë ku lejohet transferimi i juridiksionit.* Shteti palë tek autoritetet e të cilit mund

të transferohet juridiksioni, ose që mund të kërkojë transferimin e tij, duhet të ketë një lidhje me fëmijën. Ky shtet palë duhet të jetë: një shtet ku fëmija ka shtetësinë; një shtet ku ndodhet pasuria e fëmijës; një shtet, autoritetet e të cilit po shqyrtojnë një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të fëmijës, ose për shpallje të pavlefshmërisë së martesës së tyre; një shtet me të cilin fëmija ka një lidhje të konsiderueshme.

ii. *Interesi më i mirë i fëmijës.* Autoriteti që paraqet kërkesën për transferimin e juridiksionit duhet të vlerësojë paraprakisht se një transferim i tillë garanton një shqyrtim më të përshtatshëm dhe më efektiv të interesit më të lartë të fëmijës. Nga ana tjetër, autoriteti të cilit i kërkohet të pranojë ose të heqë dorë nga juridiksioni mund të vendosë në këtë drejtim vetëm nëse, mbi bazën e një vlerësimi të arsyetuar, konstaton se transferimi i shërben interesit më të mirë të fëmijës së mitur. Në konkluzion, Kolegji çmon të theksojë se dispozitat e Konventës së Hagës që rregullojnë prorogimin dhe transferimin e juridiksionit e vendosin në qendër vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke e bërë atë kriterin themelor dhe orientues të çdo vendimmarrjeje në këtë drejtim.

61. Edhe Rregullorja e Brukselit (neni 12 i Bruksel II-a, sot neni 10 i Bruksel II-ter)²⁵, ka parashikuar një përjashtim të kufizuar nga rregulli i

²³ Neni 8 i Konventës së Hagës parashikon, se: “1. Me anë të përjashtimit, autoriteti i Shtetit Kontraktues që ka juridiksion sipas nenit 5 ose 6, nëse gjykon se autoriteti i një Shteti tjetër Kontraktues do të vendoset më mirë në një rast të veçantë për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës: - mund të kërkojë që autoriteti tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndihmën e autoritetit qendror të shtetit të tij, të marrë juridiksionin për të ndërmarrë këto masa mbrojtëse, si ta gjykojë të nevojshme; - mund të pezullojë shqyrtimin e çështjes dhe të ftojë palët të paraqesin këtë kërkesë para autoritetit të këtij shteti tjetër. 2. Shtetet Kontraktuese, autoritetet e të cilëve mund të adresohen siç parashikohet në paragrafin e mësipërm, janë: a) një shtet, shtetas i të cilit është ky fëmijë; b) një shtet, në të cilin ndodhet pasuria e fëmijës; c) një shtet, autoritetet e të cilit janë në shqyrtim e sipër të një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të fëmijës ose për anulimin e martesës së tyre; d) një shtet, me të cilin fëmija ka lidhje të ngushta. 3. Autoritetet e interesuara mund të procedojnë për një shkëmbim mendimesh. 4. Autoriteti i adresuar, siç parashikohet në paragrafin 1, mund të marrë juridiksionin në vend të autoritetit që ka juridiksion sipas nenit 5 ose 6, nëse e gjykon se kjo është në të mirën e fëmijës”.

²⁴ Neni 9 i Konventës së Hagës parashikon, se: “1. Nëse autoritetet e një Shteti Kontraktues të referuara në nenin 8 paragrafi 2, në rastin e veçantë gjykojnë se janë në pozitë më të mirë për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës: - mund t’i kërkojnë autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues të banesës së përbërshme të fëmijës,

në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndihmën e autoritetit qendror të këtij shteti, që të autorizohen për të ushtruar juridiksionin për të marrë masa mbrojtëse, të cilat i gjykojnë të nevojshme; - mund të ftojë palët të paraqesin këtë kërkesë para autoritetit të Shtetit Kontraktues të banesës së përbërshme të fëmijës. 2. Autoritetet e interesuara mund të procedojnë për një shkëmbim mendimesh. 3. Autoriteti që fillon bërjen e kërkesës mund të ushtrojë juridiksion në vend të Shtetit Kontraktues të banesës së përbërshme të fëmijës vetëm nëse ky autoritet e pranon kërkesën”.

²⁵ Neni 12 i Rregullores Bruksel II-a: “1. Gjykatat e një Shteti Anëtar, që ushtrojnë juridiksion në bazë të nenit 3 mbi një kërkesë për divorc, ndarje ligjore ose anulim martese, kanë juridiksion në çdo çështje që lidhet me përgjegjësinë prindërore të lidhur me atë kërkesë, kur: a) të paktën njëri prej bashkëshortëve ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën; dhe b) juridiksioni i gjykatave është pranuar shprehimisht ose në një mënyrë të pa ekuivok nga bashkëshortët dhe nga mbajtësit e përgjegjësisë prindërore, në momentin kur gjykata është vënë në lëvizje, dhe kjo është në interesin më të lartë të fëmijës. 2. Juridiksioni i dhënë në paragrafin 1 pushon sapo: a) vendimi që pranon ose refuzon kërkesën për divorc, ndarje ligjore ose anulim martese të ketë marrë formë të prerë; b) në ato raste kur procedurat që lidhen me përgjegjësinë prindërore janë ende në zhvillim në datën e përmendur në pikën (a), të jetë dhënë vendim përfundimtar në këto procedura; c) procedurat e përmendura në pikat (a) dhe (b) të jenë përfunduar për ndonjë arsye tjetër. 3. Gjykatat e një Shteti Anëtar



përgjithshëm i juridiksionit të bazuar në vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës, duke lejuar që gjykata që shqyrton një procedurë divorci, ndarje ligjore ose anulim martese të ushtrojë juridiksion edhe për çështjet e përgjegjesisë prindërore. Ky mekanizëm përbën një formë të kontrolluar të zgjedhjes së gjykatës (prorogim) dhe synon të balancojë parimin e afërsisë me nevojën për përqendrim procedural të çështjeve familjare në të njëjtën gjykatë. Prorogimi lejohet vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: i. të paktën njëri bashkëshort ka përgjegjësi prindërore, ii. nëse juridiksioni pranohet shprehimisht dhe pa ekuivok nga të gjithë mbajtësit e përgjegjesisë prindërore në momentin e fillimit të procesit; dhe iii. nëse një zgjidhje e tillë është në interesin më të lartë të fëmijës. Ky juridiksion pushon sapo vendimi për divorcin të marrë formë të prerë ose procedurat për përgjegjësinë prindërore të përfundojnë (*shih vendimin e GjDBE C-656/13, §42*).

Rregullorja ka parashikuar mundësinë e prorogimit edhe jashtë procedurave të divorcit, kur fëmija ka një lidhje të konsiderueshme me Shtetin Anëtar përkatës, juridiksioni pranohet nga të gjitha palët në mënyrë të qartë dhe një zgjidhje e tillë është në interesin më të lartë të fëmijës (*shih vendimin e GjDBE C-656/13, §45, 52*).

Në të dyja rastet, kushtet kumulative dhe thelbësore janë: i. pëlqimi i shprehur i palëve; dhe ii. respektimi i interesit më të lartë të fëmijës, duke e bërë prorogimin një zgjidhje përjashtimore që nuk zëvendëson rregullin kryesor të vendqëndrimit të zakonshëm, por krijon një “forum alternativ” të kufizuar në funksion të ekonomisë procedurale dhe koordinimit të mosmarrëveshjeve familjare.

kanë gjithashtu juridiksion lidhur me përgjegjësinë prindërore edhe në procese të tjera nga ato të përmendura në paragrafin 1, kur: a) fëmija ka një lidhje të konsiderueshme me atë Shtet Anëtar, veçanërisht për shkak se një nga mbajtësit e përgjegjesisë prindërore ka vendbanim të zakonshëm në atë Shtet Anëtar, ose se fëmija është shtetas i atij Shteti Anëtar; dhe b) juridiksioni i gjykatave është pranuar shprehimisht ose në një mënyrë të pa ekuivok nga të gjitha palët në procedurë, në momentin kur gjykata është vënë në lëvizje, dhe kjo është në interesin më të mirë të fëmijës. 4. Kur fëmija ka vendbanimin e tij/saj të zakonshëm në territorin e një Shteti të tretë, i cili nuk është palë kontraktuese e Konventës së Hagës të 19 tetorit 1996 mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin lidhur me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve, juridiksioni sipas këtij neni konsiderohet se është në interes të fëmijës, në veçanti nëse konkludohet se është e pamundur Faqe|9100

62. Prorogimi (kalimi me marrëveshje) i juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare gjen rregullim në nenin 73 të LDNP, ku parashikohet mundësia e zgjedhjes së juridiksionit me marrëveshje. Kjo dispozitë parashikon shprehimisht, se: “1. Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe kur palët caktojnë me marrëveshje juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare. 2. Një marrëveshje e tillë duhet: a) të lidhet me shkrim ose me gojë, por duke u vërtetuar kjo e fundit me shkrim; b) të jetë në përputhje me zakonet tregtare ndërkombëtare, të cilat janë ose konsiderohen të njohura nga palët. 3. Gjykata shqiptare, në të cilën është ngritur padia, ka juridiksion ndërkombëtar, nëse i padituri merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, megjithëse është i përfaqësuar në proces nga një avokat, ose gjykata e ka sqaruar për mundësinë e kundërshtimit të juridiksionit dhe ky sqarim është shënuar në procesverbalin e seancës gjyqësore”.

63. Marrëveshja e prorogimit të juridiksionit ndërkombëtar është e vlefshme vetëm nëse:

- i. është bërë në formë të shkruar midis palëve ose
- ii. është lidhur me gojë midis palëve, por provohet me shkrim ose
- iii. është në përputhje me zakonet tregtare ndërkombëtare të njohura ose të konsideruara si të njohura nga palët, çka synon të garantojë siguri juridike dhe parashikueshmëri në marrëdhëniet ndërkombëtare (veçanërisht në fushën tregtare) ose
- iv. rezulton nga paraqitja e palës së paditur në gjykim, e cila nuk ngre pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, edhe pse është përfaqësuar me avokat ose nga paraqitja e palës së paditur në gjykim, e cila nuk ngre pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, megjithëse gjykata e ka sqaruar për mundësinë e kundërshtimit

të zhvillohen procedura në atë Shtet të tretë”. Neni 10 i Rregullores Bruksel II ter: Gjykatat e një Shteti Anëtar kanë juridiksion në çështjet e përgjegjesisë prindërore kur plotësohen kushtet e mëposhtme: a) fëmija ka një lidhje të rëndësishme me atë Shtet Anëtar, veçanërisht për shkak se: i. të paktën një nga mbajtësit e përgjegjesisë prindërore ka vendbanimin e zakonshëm në atë Shtet Anëtar; ii. ai Shtet Anëtar është vendbanimi i mëparshëm i zakonshëm i fëmijës; ose iii. fëmija është shtetas i atij Shteti Anëtar; b) palët, si dhe çdo mbajtës tjetër i përgjegjesisë prindërore: i. kanë rënë dakord lirisht për juridiksionin, më së voni në momentin kur gjykata vihet në lëvizje; ose ii. e kanë pranuar shprehimisht juridiksionin gjatë procesit dhe gjykata është siguruar që të gjitha palët janë të informuara për të drejtën e tyre për të mos e pranuar juridiksionin; dhe c) ushtrimi i juridiksionit është në interesin më të mirë të fëmijës ...”.



të juridiksionit dhe ky sqarim është pasqyruar në procesverbalin e seancës gjyqësore.

64. Në kuptim të nenit 73§3 të LDNP, pjesëmarrja e të paditurit në proces pa ngritur kundërshtim ndaj juridiksionit ndërkombëtar sjell pranimin e tij në mënyrë të nënkuptuar, veçanërisht kur i padituri përfaqësohet nga avokat, çka përjashton nevojën që gjykata ta njoftojë apo ta pyesë posaçërisht për këtë çështje, pasi ai konsiderohet i përfaqësuar rregullisht në ushtrimin e të drejtave të tij procedurale. Në rastin kur i padituri nuk përfaqësohet nga një avokat dhe nuk ka ngritur kundërshtime për juridiksionin ndërkombëtar, juridiksioni konsiderohet i pranuar kur gjykata e ka informuar shprehimisht për të drejtën për të kundërshtuar juridiksionin dhe ky sqarim është pasqyruar në procesverbal. Kjo dispozitë synon të garantojë të drejtën e mbrojtjes së palës dhe të shmangë situatat e pranimin të pavetëdijshëm të juridiksionit. Pavarësisht se juridiksioni përbën një parakusht procedural që, në parim, mund të kundërshtohet në çdo fazë të gjykimit dhe madje mungesa e tij mund të konstatohet edhe kryesisht nga gjykata, në rastet e parashikuara nga neni 73 i LDNP bëhet fjalë për një juridiksion të bazuar në vullnetin e palëve, qoftë përmes marrëveshjes, qoftë përmes pranimin të tij sipas kushteve të dispozitës. Ky lloj juridiksioni i zgjedhur nuk mund të ketë karakter të pakufizuar në kohë nga pikëpamja procedurale, pasi pranimi ose zgjedhja e tij duhet të ushtrohet brenda një afati procedural të arsyeshëm, përndryshe konsiderohet i konsoliduar pranimi i juridiksionit dhe nuk mund të vihet më në diskutim.

65. Arsyetimi se kundërshtimi i juridiksionit duhet të bëhet në fazën më të hershme të paraqitjes në proces përforcohet edhe nga praktika e GjDBE, në interpretim të rregullave mbi prorogimin e heshtur të juridiksionit sipas instrumenteve të BE-së. GjDBE në çështjen “*Elefanten Schuh GmbH, Kleve, Federal Republic of Germany, and Pierre Jacqmain, Schoten, Belgium*”, ka arsyetuar, se: “[...] nëse kundërshtimi i juridiksionit nuk paraqitet paraprakisht ndaj çdo mbrojtjeje mbi themelin e çështjes, ai në asnjë rast nuk mund të bëhet pas paraqitjes së atyre pretendimeve që, sipas ligjit procedural kombëtar, konsiderohen si mbrojtja e parë e drejtuar gjykatës së vënë në lëvizje [...] neni 18 i Konventës duhet të interpretohet në kuptimin që rregulli mbi juridiksionin i parashikuar nga kjo dispozitë nuk zbatohet kur i padituri jo vetëm kundërshton juridiksionin e gjykatës, por gjithashtu paraqet pretendime mbi themelin e padisë, me kusht që, nëse

kundërshtimi i juridiksionit nuk është paraprak ndaj çdo mbrojtjeje mbi themelin, ai të mos bëhet pas paraqitjes së pretendimeve që, sipas ligjit procedural kombëtar, konsiderohen si mbrojtja e parë e paraqitur përpara gjykatës së vënë në lëvizje? (shih vendimin e GjDB-së E C-150/80, datë 24.6.1981, §16, 17).

66. Nisur nga përmbajtja e nenit 73 të LDNP-së (veçanërisht paragrafi 3), kundërshtimi i juridiksionit ndërkombëtar duhet të bëhet në momentin e parë të paraqitjes së të paditurit në proces (në seancën e pajtimit ose seancën përgatitore) apo në momentin procedural të paraqitjes së mbrojtjes së tij (depozitimi i deklaratës së mbrojtjes), pra në fazën fillestare të gjykimit, përpara se të kalohet në shqyrtimin e themelit të çështjes. Dispozita parashikon se, nëse i padituri merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, juridiksioni konsiderohet i pranuar.

67. Kolegji thekson se neni 73 i LDNP përbën një dispozitë të përgjithshme mbi prorogimin (kalimin me marrëveshje) e juridiksionit gjyqësor ndërkombëtar në favor të gjykatave shqiptare, e ndërtuar mbi pranimin e autonomisë së vullnetit të palëve dhe mbi pranimin e shprehur ose të heshtur të juridiksionit. Ai nuk bën dallim sipas natyrës së marrëdhënies juridike dhe, në parim, zbatohet për çdo çështje civile me element të huaj, për sa kohë respektohen kushtet formale dhe procedurale të parashikuara.

Në të kundërt, Konventa e Hagës vendos një regjim të posaçëm për çështjet që lidhen me përgjegjësinë prindërore dhe mbrojtjen e fëmijës, duke shtuar një kriter material kufizues: në çdo rast, çdo devijim nga rregulli i përgjithshëm i juridiksionit duhet të jetë në interesin më të lartë të fëmijës. Pra, edhe kur pranohet një formë prorogimi ose transferimi juridiksioni, ai kushtëzohet nga një vlerësim substancial dhe jo vetëm formal i interesit më të lartë të të miturit. Ndryshe nga neni 73 i LDNP, i cili mbështetet kryesisht në konsensusin e palëve, Konventa e Hagës e relativizon autonominë e vullnetit në çështjet që prekin të miturit, duke e nënshtruar atë ndaj kontrollit gjyqësor mbi përputhshmërinë me interesin më të lartë të fëmijës. Kjo tregon se në fushën e përgjegjësisë prindërore, juridiksioni nuk është vetëm çështje e disponimit të palëve, por mbi të gjitha e mbrojtjes së një interesi publik të veçantë. Bazat e juridiksionit në çështjet e përgjegjësisë prindërore përcaktohen në dritën e interesit më të lartë të fëmijës dhe mbi të gjitha, në



funksion të këtij interesi (*shih vendimin e GjDBE C-395/23, datë 6.3.2025, § 56*).

68. Kolegji vlerëson se, nga pikëpamja e hierarkisë dhe specialitetit normativ, dispozitat e Konventës së Hagës përbëjnë *lex specialis* në raport me normën e përgjithshme të nenit 73 të LDNP, kur çështja ka të bëjë me masa për mbrojtjen e fëmijës. ***Për rrjedhojë, në raste të tilla, nuk mjafton ekzistenca e një marrëveshjeje midis të dy prindërve për juridiksionin (qoftë e shkruar apo e pranuar përmes paraqitjes së palës së paditur), por është i domosdoshëm edhe verifikimi nga gjykata i kriterit thelbësor të interesit më të lartë të të miturit. Nëse në vlerësim të këtyre fakteve, gjykata shqiptare bindet se interesi më i lartë i të miturit vlerësohet para saj si dhe të dy prindërit janë dakord me këtë juridiksion, gjykata shqiptare ka juridiksion për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhjeje në raport me fëmijët.*** Në të kundërt, nëse gjykata shqiptare përcakton se “vendqëndrimi i zakonshëm” i fëmijës është jashtë Republikës së Shqipërisë, që nga ana tjetër përcakton vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës, duhet të deklarojë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të saj, pavarësisht vullnetit të të dy prindërve për zgjedhjen e juridiksionit.

69. Në rastet e zgjidhjes së martesës, kur duhet të vendosë edhe për pasojat mbi fëmijët e mitur me vendqëndrim të zakonshëm jashtë Shqipërisë, gjykata shqiptare nuk mund të disponojë *a priori* nëse ka apo jo juridiksion ndërkombëtar, por duhet të mbajë në konsideratë, vlerësojë dhe analizojë provueshmërinë e një grupi kriteresh faktike që tregojnë se cili shtet përbën “qendrën reale të jetës” së fëmijës. Konkretisht, gjykata duhet të analizojë:

- ***kohëzgjatjen, rregullsinë dhe arsyet e qëndrimit të fëmijës në një shtet të caktuar;***
- ***kushtet konkrete të jetesës dhe stabilitetin e tyre;***
- ***vendin e arsimimit dhe integrimin shkollor;***
- ***marrëdhëniet familjare dhe shoqërore;***
- ***njohuritë gjuhësore dhe integrimin kulturor;***
- ***në rastin e foshnjave apo fëmijëve shumë të vegjël, vendqëndrimin e zakonshëm të prindit që ushtron realisht kujdesin mbi fëmijën;***

- ***në rastin e fëmijëve të vendosur në kushte trajtimi specifik, rrethanat në të cilat përfitohet ky trajtim;***

- ***stabilitetin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas ndarjes së prindërve;***

- ***çdo rrethanë tjetër faktike relevante.. ...***

Në të kundërt, nuk përbëjnë elemente përcaktuese të vendqëndrimit të zakonshëm në raport me interesin më të lartë të të miturit: prania thjesht fizike, qëndrimet e përkohshme (pushime, vizita, ushtrim i së drejtës së takimit), origjina kombëtare e prindërve, lidhjet kulturore abstrakte apo synimet e ardhshme për t'u zhvendosur në një shtet të caktuar.

70. Në planin procedural, megjithëse juridiksioni është një nga parakushtet themelore të procesit civil dhe verifikohet kryesisht nga gjykata në çdo fazë të gjykimit, në çështjet që përfshijnë të miturit ai nuk mund të konstatohet në mënyrë formale apo abstrakte. Përkundrazi, përcaktimi i juridiksionit kërkon një vlerësim paraprak dhe të thelluar të elementeve faktike, mbi bazën e provave dhe dokumentacionit përkatës, që lidhen me vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës. Vetëm pasi të ketë identifikuar, mbi bazë provash, qendrën faktike të jetës së të miturit dhe shkallën e integritetit të tij social e familjar, gjykata mund të disponojë në mënyrë të arsyetuar mbi ekzistencën ose jo të juridiksionit të saj gjyqësor ndërkombëtar. Ky vlerësim duhet të udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, i cili përbën kriter orientues jo vetëm për zgjidhjen në themel të çështjes, por edhe për përcaktimin e “autoritetit më kompetent”.

71. Kolegji çmon të theksojë se, në çështjet që lidhen me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor ndërkombëtar mbi të miturit, rregullat mbi barrën e provës nuk kanë karakter absolut dhe të pandryshueshëm, por duhet të interpretohen në funksion të natyrës së çështjes dhe detyrimit të gjykatës për të garantuar mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të fëmijës.

Në këto raste, gjykata, në ushtrim të funksionit të saj drejtues të procesit, mund t'u kërkojë palëve të sqarojnë dhe të provojnë rrethanat faktike që lidhen me vendqëndrimin e zakonshëm dhe elementet e tjera përcaktuese të juridiksionit, pa u kufizuar në një qasje thjesht formaliste për shkak të mungesës së provave të paraqitura fillimisht prej tyre. Për më tepër, parimi i barrës së provës mund të pësojë zbutje në situata ku interesi publik dhe mbrojtja e të



miturit kërkojnë një hetim të plotë gjyqësor, veçanërisht kur ekzistojnë të dhëna që sugjerojnë lidhje juridiksionale me një shtet tjetër. Në këto rrethana, gjykata mund të marrë parasysh provat e disponueshme, deklaratimet e palëve dhe dokumentacionin e sjellë nga secila palë në proces, duke shmangur formalizmin e tepruar që do të pengonte verifikimin e juridiksionit.

Kolegji vlerëson se, në çështjet që prekin të miturit, përcaktimi i juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave nuk është një aspekt thjesht teknik, por një vlerësim substancial që lidhet drejtpërdrejt me garantimin e mbrojtjes efektive të fëmijës në mjedisin ku ai është realisht i integruar.

72. Edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), në çështjet që përfshijnë fëmijët e mitur me elemente të huaj, është trajtuar lidhja e drejtpërdrejtë midis nenit 8 të KEDNj (jeta private dhe familjare) dhe rregullave të juridiksionit ndërkombëtar, veçanërisht atyre që bazohen në vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës. GjEDNj nuk shqyrton drejtpërdrejt juridiksionin si çështje të *acquis* apo të konventave përkatëse, por vlerëson nëse mënyra se si gjykatat kombëtare kanë zbatuar rregullat e juridiksionit dhe të mbrojtjes ndërkombëtare, është ose jo në përputhje me nenin 8 të KEDNj-së dhe me parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Në disa prej vendimeve të saj, GjEDNj-ja ka evidentuar se gjykatat kombëtare kanë detyrimin të kryejnë një analizë faktike të plotë dhe të arsyetuar dhe të vendosin interesin më të lartë të fëmijës si kriter dominues në çdo vendimmarrje. Sipas GjEDNj-së, respektimi i rregullave të juridiksionit (si ato të Rregullores së Brukselit II-a ose të konventave ndërkombëtare) është në parim i pajtueshëm me nenin 8, për sa kohë nuk është arbitrar dhe siguron balancim proporcional të interesave²⁶.

73. Nisur nga sa më lart, lidhur me çështjen e parë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji konkludon, se:

Në gjykimet me objekt “Zgjidhjen e martesës”, kur nga kjo martesë ka fëmijë të mitur, gjykata, kur pranon padinë, ka detyrimin të shprehet krahas zgjidhjes së martesës edhe për rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhje në

raport me fëmijët. Në këto raste, për të gjithë gjykimin merr përparësi vlerësimi i interesit më të lartë të të miturit.

Kur i mituri jeton në një vend tjetër, jashtë Republikës së Shqipërisë, gjykata duhet të konstatojë, bindet dhe përcaktojë “vendqëndrimin e zakonshëm” të fëmijës, duke iu referuar kohëzgjatjes së qëndrimit në atë vend, arsyeve të zhvendosjes së familjes dhe kushteve social-ekonomike të fëmijës.

Nëse në vlerësim të këtyre fakteve, gjykata shqiptare bindet se interesi më i lartë i të miturit vlerësohet para saj si dhe të dy prindërit janë dakord me këtë juridiksion, gjykata shqiptare ka juridiksion për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhjeje në raport me fëmijët.

Në të kundërt, nëse referuar kriterëve të mësipërme, gjykata shqiptare përcakton se “vendqëndrimi i zakonshëm” i fëmijës është jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet të deklarojë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të saj.

Çështja e dytë e shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore:

b) A kanë gjykatat shqiptare juridiksion për të gjykuar çështjet me objekt rregullimin ose ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së mitur, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri?

74. Çështjet që kanë për objekt rregullimin ose ndryshimin e përgjegjësisë prindërore, përfshirë këtu aspektet e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, ndryshimit të saj, ndryshimit të modaliteteve të takimit me prindin të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim apo heqjen e përgjegjësisë prindërore, në analizë të neneve 1, 2, 3 dhe 4 të Konventës së Hagës, bien në fushën e zbatimit të saj.

Në nenin 3, shkronja “a” të Konventës sanksionohet, se: “Masat e referuara në nenin 1 do të kenë lidhje, në veçanti, me: a) dhënien, ushtrimin, përfundimin ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore, si dhe delegimin e saj [...]”. Referuar Udhëzuesit Praktik mbi zbatimin e Konventës së Hagës, koncepti i përgjegjësisë

²⁶ Shih vendimet e GjEDNj në çështjet: “*Giannakopoulos kundër Greqisë*” (Aplikimi nr. 20503/20, vendim i datës 3.12.2024); “*Spinelli kundër Rusisë*” (Aplikimi nr. 57777/17,

vendim i datës 19.10.2021 (final më 19.1.2022); “*R.S. kundër Polonisë*” (Aplikimi nr. 63777/09, vendim i datës 21.7.2015 (final më 21.10.2015).



prindërore i përcaktuar në nenin 1§2 të Konventës përfshin autoritetin prindëror ose çdo marrëdhënie analoge autoriteti që përcakton të drejtat, përgjegjësitë dhe pushtetet e prindërve, kujdestarëve ose përfaqësuesve të tjerë ligjorë lidhur me personin dhe pasurinë e fëmijës. Këto të drejta dhe përgjegjësi prindërore mund të përfshijnë vendimmarrjen mbi ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, organizimin e edukimit dhe arsimimit të fëmijës, çështjet që lidhen me kujdesin dhe trajtimin shëndetësor, përcaktimin e vendbanimit të tij, si dhe miratimin ose kufizimin e lëvizjes së fëmijës nga një shtet në tjetrin.²⁷

75. Për përcaktimin e juridiksionit gjyqësor ndërkombëtar në rastet me element të huaj që lidhen me masat për mbrojtjen e fëmijës, është primar dhe i domosdoshëm referimi nga ana e gjykatave shqiptare në parashikimet e Konventës së Hagës, si instrument i posaçëm që gëzon përparësi në rregullimin e kësaj fushe. Përparësia e saj qëndron në faktin se Konventa përcakton në mënyrë të unifikuar kriteret e juridiksionit, duke e lidhur atë kryesisht me vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës dhe me parimin e interesit më të lartë të tij, duke garantuar kështu një zbatim të koordinuar dhe efektiv të masave mbrojtëse në nivel ndërkombëtar.

Ndërkohë, LDNP nuk paraqet qartësi në këtë drejtim, pasi në nenin 76 parashikon, se: “Gjykatat shqiptare kanë juridiksion të gjykojnë çështjet, që lidhen me të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga martesat midis prindërve dhe fëmijëve, njohjen apo kundërshtimin e atësisë dhe të amësisë, kur njëra nga palët ka shtetësinë shqiptare ose ka vendqëndrimin e saj në Republikën e Shqipërisë”. Kolegji konstaton se neni 76 i LDNP përdor formulimin “të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesat midis prindërve dhe fëmijëve”, ndërkohë që martesat është marrëdhënie midis bashkëshortëve, jo midis prindërve dhe fëmijëve. Gjithashtu, dispozita nuk specifikon nëse në kuadër të juridiksionit të gjykatave shqiptare përfshihen edhe çështjet e përgjegjësisë prindërore, kujdestarisë, të drejtave të kontaktit apo detyrimit për ushqim, të cilat përfaqësojnë aspekte të përgjegjësisë prindërore (përtej marrëdhënies martesore).

76. Vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës është kriteri qendror për përcaktimin e juridiksionit në shumicën e çështjeve të përgjegjësisë prindërore.

Sikundër analizohet edhe më sipër në vendim, nga interpretimi i nenit 5 të Konventës së Hagës rezulton se rregulli bazë mbi të cilin përcaktohet juridiksioni i autoriteteve gjyqësore të një Shteti Kontraktues lidhet me vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës. Pra, autoritetet gjyqësore ose administrative të Shtetit Kontraktues, ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm²⁸, *in primis* kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës ose të pronës së tij. Qëllimi i këtij parimi është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, duke garantuar që vendimet mbi kujdesin prindëror dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore të merren nga gjykatat e vendit me të cilin fëmija ka lidhjen më të ngushtë faktike e sociale.

77. Në këtë kontekst, kur konstaton se i mituri ka vendqëndrimin e zakonshëm jashtë Republikës së Shqipërisë dhe çështja e paraqitur për gjykim lidhet me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ndaj tij, gjykata shqiptare duhet, në parim, të vlerësojë mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, për shkak se kriteri qendror lidhës është vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës. Nëse nuk rezulton ndonjë bazë përjashtimore e parashikuar nga ligji ose nga instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme, gjykata duhet të shpallë mungesën e juridiksionit dhe të mos vijojë shqyrtimin e themelit të çështjes. Ky vlerësim duhet të kryhet duke pasur në qendër interesin më të lartë të fëmijës dhe parimin e afërsisë, si kriteret udhëheqëse në përcaktimin e juridiksionit gjyqësor.

78. Në rastet e ndryshimit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës së mitur, neni 5§2 i Konventës së Hagës parashikon, se: “[...] 2. Në bazë të nenit 7, në rast ndryshimi të banesës së përbërshme të fëmijës në një Shtet tjetër Kontraktues, autoritetet e shtetit të banesës së re kanë juridiksion”. Në interpretim të dispozitës, juridiksioni ndjek vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës, në mënyrë që kur ky vendqëndrim ndryshon në një Shtet tjetër Kontraktues, autoritetet e shtetit të vendqëndrimit të ri të zakonshëm do të kenë juridiksion. Sa kohë Konventa nuk parashikon konceptin e “juridiksionit të vazhdueshëm”, duhet mbajtur parasysh se ndryshimi i vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës nuk sjell përfundimin e masave tashmë të marra. Këto masa mbeten në fuqi derisa, nëse rezulton e nevojshme, autoritetet e

²⁷ Udhëzuesi Praktik mbi Zbatimin e Konventës së Hagës 1996 për Mbrojtjen e Fëmijëve, 2014, §3.16, f. 27, [eca03d40-29c6-4cc4-ae52-edad337b6b86.pdf](https://www.eca03d40-29c6-4cc4-ae52-edad337b6b86.pdf).

²⁸ Përcaktimi i vendqëndrimit të zakonshëm udhëhiqet nga kriteret e përcaktuara në paragrafet 49-53 të këtij vendimi njësuës.



Shtetit Kontraktues të vendqëndrimit të ri të zakonshëm të fëmijës të marrin masa të tjera të përshtatshme.

79. Krahas situatës së ndryshimit të vendqëndrimit të zakonshëm, neni 7 i Konventës së Hagës rregullon situatat e largimit apo mbajtjes pa të drejtë të fëmijës nga vendqëndrimi i zakonshëm në një Shtet tjetër Kontraktues dhe mënyrën se si ruhet juridiksioni i autoriteteve të shtetit ku fëmija ka pasur vendqëndrimin e zakonshëm para largimit.

Kjo dispozitë parashikon shprehimisht, se: *“1. Në rast të ndonjë largimi apo mbajtjeje pa të drejtë të fëmijës, autoritetet e Shtetit Kontraktues në të cilin fëmija ka qenë banor i zakonshëm, menjëherë para largimit apo mbajtjes, ruajnë juridiksionin e tyre, derisa fëmija të ketë marrë një banesë të zakonshme në një shtet tjetër: a) çdo person, institut ose çdo organ tjetër që ka të drejtat e kujdestarisë, ka rënë dakord për largimin apo mbajtjen; ose b) fëmija ka banuar në këtë shtet tjetër për një periudhë prej jo më pak se një vit pasi personi, instituti apo organi tjetër që ka të drejtat e kujdestarisë, ka ose duhet të ketë pasur dijeni për vendndodhjen e fëmijës, asnjë kërkesë për kthimin e bërë brenda kësaj periudhe nuk është pezull, dhe fëmija është vendosur në ambientin e ri të tij/të saj. 2. Largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohen të gabuara në rastin kur: a) shkelin të drejtat e kujdestarisë që i jepen një personi, një institucioni apo ndonjë organi tjetër, kolektivisht ose individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i zakonshëm, menjëherë para largimit apo mbajtjes; b) në kohën e largimit apo mbajtjes, kur këto të drejta ushtrohen, kolektivisht ose individualisht, ose duhet të ishin ushtruar në këtë mënyrë, me përjashtim të largimit apo mbajtjes. Të drejtat e kujdestarisë të referuara në nënparagrafin (a) më sipër, mund të lindin veçanërisht përmes funksionimit të ligjit ose për shkak të një vendimi gjyqësor ose administrativ, apo një marrëveshjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të këtij shteti. 3. Për sa kohë që autoritetet e përmendura së pari në paragrafin 1 e ruajnë juridiksionin e tyre, autoritetet e Shtetit Kontraktues, tek i cili fëmija është larguar ose në të cilin ai ose ajo është mbajtur, mund të marrin vetëm ato masa urgjente që, sipas nenit 11, janë të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës ose pronës së fëmijës”.*

80. Në interpretim të kësaj dispozite, në rastin e largimit apo të mbajtjes pa të drejtë të një fëmije në një Shtet tjetër Kontraktues, do të jenë autoritetet e Shtetit kontraktues në të cilin fëmija ka pasur vendqëndrimin e zakonshëm përpara largimit apo mbajtjes, të cilat do të vazhdojnë të mbartin juridiksionin derisa fëmija të ketë një “vendqëndrim të zakonshëm” në një shtet tjetër. Dispozita në fjalë

gjen zbatim vetëm në rastet e mbajtjes apo largimit pa të drejtë të fëmijës dhe sanksionon parimin e vazhdimësisë së juridiksionit nëse plotësohet njëri nga dy kushtet:

a) çdo person, institut ose çdo organ tjetër që ka të drejtat e kujdestarisë, ka rënë dakord për largimin apo mbajtjen; ose

b) fëmija ka banuar në këtë shtet tjetër për një periudhë prej jo më pak se një vit pasi personi, instituti apo organi tjetër që ka të drejtat e kujdestarisë, ka ose duhet të ketë pasur dijeni për vendndodhjen e fëmijës, asnjë kërkesë për kthimin e bërë brenda kësaj periudhe nuk është pezull, dhe fëmija është vendosur në ambientin e ri të tij/të saj. Në çdo rast, gjykata udhëhiqet nga parimi i garantimit të interesit më të lartë të fëmijës së mitur.

81. Mbi këtë analizë, lidhur me çështjen e dytë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji konkludon, se:

Gjykimi për çështje me objekt “rregullimin ose ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore”, duhet të zhvillohet në vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës, konstatuar kjo referuar kriterëve të përcaktuara më lart.

Në rast se ky vendqëndrim i zakonshëm ka ndryshuar në raport me vendqëndrimin e mëparshëm dhe gjykatën që ka përcaktuar fillimisht mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, gjykimi për ndryshimin e saj duhet të zhvillohet në gjykatën e vendqëndrimit të zakonshëm të ri.

Kur gjykata shqiptare konstaton se vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës së mitur është jashtë Republikës së Shqipërisë, deklaron nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, përveç kur vlerëson se kjo bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës.

Çështja e tretë e shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore:

c) A kanë gjykatat shqiptare juridiksion për të gjykuar çështjet me objekt përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim për fëmijët e mitur, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri?

82. Lidhur me çështjet që kanë për objekt përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim, kur fëmija i mitur ka vendqëndrimin e zakonshëm jashtë Republikës së Shqipërisë, Kolegji evidenton se duhet bërë dallimi midis dy situatave:



i. Kur kërkohet vetëm caktimi i detyrimit për ushqim ose ndryshimi i një vendimmarrjeje të mëparshme, ku është njohur dhe përcaktuar masa e detyrimit ushqimor (*kërkesë autonome*);

ii. Kur detyrimi për ushqim kërkohet në kuadër të një padie për zgjidhjen e martesës dhe përcaktimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (*kërkesë e ndërruar*).

83. *Kërkimi autonom i detyrimit për ushqim*: Konventa e Hagës²⁹ ka përjashtuar nga fusha e zbatimit të saj “detyrimet për mbajtjen”, një ndër aspektet e të cilit është edhe “detyrimi për ushqim” i njohur nga Kodi i Familjes shqiptar. Nga kjo rezulton se juridiksioni për kërkesat autonome për detyrim ushqimor nuk mund përcaktohet duke iu referuar rregullave të Konventës së Hagës.

Me ligjin nr. 63/2012³⁰, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” të datës 23 nëntor 2007 (në vijim “Konventa për Detyrimin Ushqimor”). Ndërkohë, me ligjin nr. 43/2024³¹, Shqipëria ka ratifikuar Protokollin e Konventës së Hagës (të vitit 2007) “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”. Në nenin 1 të Konventës për Detyrimin Ushqimor përcaktohet se objektivi i konventës është të sigurojë realizimin efektiv, në plan ndërkombëtar, të detyrimeve ushqimore dhe të formave të tjera të mbështetjes financiare për anëtarët e familjes. Ky qëllim arrihet në veçanti përmes: (a) krijimit të një mekanizmi të strukturuar bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të Shteteve Kontraktuese; (b) mundësit të paraqitjes dhe shqyrtimit të kërkesave për përcaktimin e detyrimeve ushqimore; (c) garantimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve përkatëse; si dhe (d) sigurimit të masave efektive që mundësojnë ekzekutimin e shpejtë të këtyre vendimeve.

84. Sipas nenit 9 të Konventës për Detyrimin Ushqimor, “Një kërkesë sipas këtij kapitulli bëhet nëpërmjet autoritetit qendror të Shtetit Kontraktues në të cilin banon kërkuesi, për autoritetin qendror të shtetit të kërkuar. Për qëllimin e kësaj dispozite, vendbanimi përjashton praninë e thjeshtë”. Dispozita përcakton qartë se çdo kërkesë që lidhet me detyrimet ushqimore ndërkombëtare duhet të kalojë detyrimisht përmes autoriteteve

qendrore të dy Shteteve Kontraktuese: shtetit ku banon kërkuesi dhe shtetit të kërkuar.

Ky mekanizëm procedural nuk është thjesht formal. Ai garanton një sistem të centralizuar bashkëpunimi, me qëllim sigurimin e një procesi të shpejtë, të besueshëm dhe pa kosto për palët. Për më tepër, Konventa sqaron se “vendbanimi” i kërkuesit, nënkupton një lidhje të qëndrueshme dhe efektive juridike me shtetin ku paraqitet kërkesa, duke përjashtuar qëndrimet e përkohshme ose tranzitore. Kjo shmang abuzimet dhe krijon një bazë të qartë territoriale për administrimin dhe transmetimin e kërkesës.

85. Lidhur me juridiksionin ndërkombëtar, Konventa për Detyrimin Ushqimor përmban gjashtë rregulla të juridiksionit indirekt (neni 20) dhe një rregull negativ mbi juridiksionin e drejtpërdrejtë në rast të kërkesës për ndryshimin e një vendimi që ka përcaktuar detyrimin ushqimor (neni 18). Referuar nenit 20 të Konventës rezulton se: “1. Një vendim i marrë në një Shtet Kontraktues (shteti i origjinës) njihet dhe ekzekutohet në Shtete të tjera Kontraktuese, nëse: a) i padituri ka pasur vendbanimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur kanë filluar procedimet; b) i padituri i nënshtrohet juridiksionit ose shprehimisht, ose duke mbrojtur çështjen në themel pa kundërshtuar juridiksionin në rastin më të parë të mundshëm; c) kreditori ka pasur vendbanimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur kanë filluar procedimet; d) fëmija për të cilin është urdhëruar detyrimi ushqimor ka pasur vendbanimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur kanë filluar procedimet, me kusht që i padituri të ketë jetuar me fëmijën në atë shtet ose të ketë banuar në atë shtet dhe të ketë ofruar mbështetje për fëmijën atje; e) përveç rasteve të mosmarrëveshjeve mbi detyrimet e mbështetjes financiare në lidhje me fëmijët, ka pasur marrëveshje me shkrim për juridiksionin nga palët; ose f) vendimi është marrë nga një autoritet që ushtron juridiksion për një çështje me status personal ose përgjegjësi prindërore, nëse juridiksioni nuk është bazuar vetëm në kombësinë e një prej palëve”.

86. Neni 20 i Konventës për Detyrimin Ushqimor parashikon bazat alternative të mëposhtme të juridiksionit:

i. vendbanimi/vendqëndrimi i zakonshëm i të paditurit në kohën e fillimit të procedurës;

ii. nënshtrimi i të paditurit juridiksionit, qoftë në mënyrë të shprehur apo të nënkuptuar, duke marrë

²⁹ Neni 4 i Konventës së Hagës.

³⁰ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 28.6.2012.

³¹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 23.5.2024.



pjesë në proces pa kundërshtuar juridiksionin në mundësinë e parë;

iii. vendbanimi/vendqëndrimi i zakonshëm i kreditorit në kohën e fillimit të procedurës;

iv. vendbanimi/vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës për të cilin është caktuar ushqimi në kohën e fillimit të procesit;

v. prorogimi (kalimi i juridiksionit) përmes një marrëveshjeje me shkrim për juridiksion (përjashtuar çështjet e ushqimit për fëmijë);

vi. kërkesa për detyrimin për ushqim është e lidhur me procedime për status personal ose përgjegjësi prindërore, kur autoriteti ka ushtruar juridiksion sipas rregullave të së drejtës vendase, përveç rasteve kur juridiksioni bazohet vetëm në shtetësinë e njëres prej palëve.

I vetmi kufizim me karakter detyrues që Konventa për Detyrimin Ushqimor vendos lidhur me juridiksionin është ai i sanksionuar në nenin 18³², që parashikon se kur një vendim merret në shtetin e vendbanimit të zakonshëm të kreditorit, procedimet për ndryshimin e tij ose për marrjen e një vendimi të ri nuk mund të nisin nga debitori në asnjë shtet tjetër, për sa kohë kreditori vazhdon të ketë vendbanimin e zakonshëm në atë shtet.

87. Kolegji vlerëson se, megjithëse Konventa për Detyrimin Ushqimor nuk përmban një kapitull të posaçëm të titulluar “juridiksioni” dhe normon çështjet e juridiksionit kryesisht në momentin kur duhet të ndryshohet apo njihet një vendim që ka njohur dhe përcaktuar detyrimin për ushqim, neni 20 i Konventës e kryen këtë funksion duke: a) identifikuar alternativat e autoriteteve që shqyrtojnë dhe njohin kërkesën, duke e lidhur kryesisht me shtetin e investuar me kërkesë; b) kërkuar që të gjitha Shtetet e tjera Kontraktuese ta njohin dhe zbatojnë atë vendim, nëse ekziston një nga bazat e nenit 10 të Konventës.

88. Në nenin 10 të Konventës për Detyrimin Ushqimor parashikohet, se: “1. Kategoritë e mëposhtme të kërkesave i vihen në dispozicion një kreditori në një shtet

kërkuar, që synon të rivendosë mbështetjen financiare sipas kësaj Konvente.

a) njohja ose njohja dhe ekzekutimi i një vendimi;

b) zbatimi i një vendimi të marrë ose të njohur në shtetin e kërkuar;

c) marrja e një vendimi në shtetin e kërkuar ku nuk ka vendim ekzistues, duke përfshirë nëse është e nevojshme, përcaktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore;

d) marrja e një vendimi në shtetin e kërkuar kur njohja dhe zbatimi i një vendimi nuk është e mundur ose refuzohet për shkak të mungesës së një baze për njohjen dhe zbatimin sipas nenit 20 ose për arsye të përcaktuara në nenin 22 “b” ose “e”;

e) ndryshimi i një vendimi të marrë në shtetin e kërkuar;

f) ndryshimi i një vendimi të marrë në një shtet të ndryshëm nga shteti i kërkuar.

2. Kategoritë e mëposhtme të kërkesave i vihen në dispozicion një debitori në shtetin kërkuar kundër të cilit ka një vendim ekzistues për detyrim ushqimor:

a) njohja e një vendimi ose procedure të barasvlershme që çon në pezullimin ose kufizimin e zbatimit të një vendimi të mëparshëm në shtetin e kërkuar;

b) ndryshimi i një vendimi të marrë në shtetin e kërkuar;

c) ndryshimi i një vendimi të marrë në një shtet të ndryshëm nga shteti i kërkuar.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, kërkesat në paragrafët 1 dhe 2 përcaktohen sipas ligjit të shtetit të kërkuar dhe kërkesat në paragrafët 1 “c” deri “f” dhe 2 “b” dhe “e”, u nënshtrohen rregullave juridiksionale të zbatueshme në shtetin e kërkuar.

Nga analiza e kësaj dispozite deduktohet se, kur prindi dërgon një kërkesë për caktimin për herë të parë të detyrimit për ushqim për fëmijën e tij në shtetin “X”, gjykatat e shtetit “X” shqyrtojnë rregullat e tyre të brendshme të juridiksionit dhe rregullat e Konventës sipas nenit 10. Neni 10 i jep shtetit të kërkuar kompetencë të plotë për të vendosur nëse ka juridiksion, duke përdorur rregullat e tij të brendshme të juridiksionit dhe çdo rregull të zbatueshme të Konventës (p.sh. nenet 10 dhe 20). Kjo do të thotë se, nëse sipas ligjit të

³² Neni 18 i Konventës parashikon se: “1. Kur një vendim merret në një shtet kontraktues, ku kreditori ka vendbanimin e zakonshëm, procedimet për të ndryshuar vendimin ose për të marrë një vendim të ri, nuk mund të paraqiten nga debitori në një shtet tjetër kontraktues për aq kohë sa kreditori ka vendbanimin e zakonshëm në shtetin ku është marrë vendimi. 2. Paragrafi 1 nuk zbatohet: a) kur, përveç rasteve të mosmarrëveshjeve mbi detyrimet ushqimore në lidhje me fëmijët, ka marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve të juridiksionit të atij shteti tjetër kontraktues; b) kur kreditori i

nënshtrohet juridiksionit të atij shteti tjetër kontraktues ose shprehimisht, ose duke mbrojtur çështjen në themel pa kundërshtuar juridiksionin në rastin më të parë të mundshëm; c) kur autoriteti kompetent në shtetin e origjinës nuk mund ose refuzon të ushtrtojë juridiksion për të ndryshuar vendimin ose për të marrë një vendim të ri; ose d) kur vendimi i marrë në shtetin e origjinës nuk mund të njëbet ose shpallet i ekzekutueshëm në shtetin kontraktues ku shqyrtohen procedimet për ndryshimin e vendimit ose për marrjen e një vendimi të ri”.



brendshëm të shtetit “X” gjykata ka juridiksion sepse fëmija (kreditori) ka vendqëndrim të zakonshëm atje, atëherë gjykata e shtetit “X” mund të shqyrtojë kërkesën. Nëse ligji i brendshëm thotë se gjykata nuk ka juridiksion, atëherë gjykata duhet ta refuzojë juridiksionin.

89. Sipas kuadrit ligjor shqiptar dhe konkretisht nenit 80, shkronja “d” të LDNP-së: *“Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe në rastet e mëposhtme: [...] d) kur padia rrjedh nga detyrimi për ushqim që ka një person kundrejt një personi, i cili ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë [...]”*. Ky parashikim i njeh juridiksion gjykatave shqiptare për të shqyrtuar paditë që rrjedhin nga detyrimi për ushqim, në rastet kur personi që pretendon të drejtën për përfitimin e këtij detyrimi ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuptim, juridiksioni ndërkombëtar i gjykatës shqiptare bazohet në ekzistencën e një faktori lidhës territorial, konkretisht në vendqëndrimin e zakonshëm të kreditorit të detyrimit ushqimor.

I njëjti kriter zbatohet edhe në rastet kur padia për detyrim ushqimor ngrihet nga pala paguese kundër palës përfituese, me objekt zvogëlimin e masës së detyrimit. Në përputhje me frymën e Konventës për Detyrimet Ushqimore, ky faktor lidhës mbetet vendqëndrimi i zakonshëm i palës përfituese (kreditorit), edhe në rastet kur kërkohet rishikimi i masës së detyrimit nga pala paguese, pasi qëllimi i rregullimit është garantimi i mbrojtjes së interesave të palës që ndodhet në nevojë për mbështetje financiare, pavarësisht natyrës së kërkesës.

90. Në vijim të arsytimit të mësipërm, Kolegji arrin në përfundimin se kur kërkimi për detyrim ushqimor paraqitet si kërkim i pavarur, juridiksioni i gjykatave shqiptare përcaktohet në funksion të vendqëndrimit të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë të personit që pretendon këtë të drejtë. Ky vendqëndrim përcaktohet në përputhje me nenin 12 të LDNP-së. Në rastet kur kërkuesi është i mitur, gjykata duhet të vlerësojë me kujdes rrethanat konkrete që përcaktojnë vendqëndrimin e tij të zakonshëm, në përputhje me kriteret dhe interpretimin e dhënë më sipër në këtë vendim njësuës³³.

91. *Kërkimi i ndërruarur i detyrimit për ushqim*: Paditë që lidhen me detyrimin për ushqim mund të ngrihen edhe si kërkime të ndërruara, të kushtëzuara në paditë që lidhen me martesën, me të drejtat dhe detyrimet prind-fëmijë, mes bashkëshortëve etj. Kërkimi për caktimin e detyrimit ushqimor paraqet një lidhje të ngushtë me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, pasi përcaktimi i masës së kontributit ushqimor nuk mund të shkëputet nga forma e ushtrimit të kësaj përgjegjësie (e përbashkët apo e vetme), si dhe nga vendbanimi i fëmijës, pra me cilin prej prindërve ai jeton në mënyrë të zakonshme.

Juridiksioni gjyqësor ndërkombëtar, në rastet kur kërkohet caktimi i detyrimit ushqimor për fëmijën e mitur dhe ky kërkim paraqitet së bashku me kërkime që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore (si përcaktimi i prindit me të cilin do të jetojë fëmija, vendbanimi i tij apo rregullimi i takimeve), duhet të përcaktohet mbi bazën e parimit të vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit, si kriteri qendror i juridiksionit.

Në rastet kur në të njëjtën padë bashkohen kërkimet për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe për detyrimin ushqimor, juridiksioni përcaktohet në mënyrë unike nga vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit. Në këto rrethana, detyrimi ushqimor nuk trajtohet si çështje e veçantë për qëllime të përcaktimit të juridiksionit, por si kërkim aksesori ndaj rregullimit të përgjegjësisë prindërore.

92. Kriteret që përcaktojnë juridiksionin në këtë lloj kërkesash duhet të interpretohen në harmoni me rregullimin specifik që parashikon e drejta ndërkombëtare për këto marrëdhënie. Parimi i prorogimit të juridiksionit, në marrëdhënien ndërmjet kërkesave për detyrim ushqimor dhe çështjeve që lidhen me përgjegjësinë prindërore, gjen pasqyrim edhe në Rregulloren (EC) nr. 4/2009, datë 18 dhjetor 2008 *“Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe zbatimin e vendimeve dhe bashkëpunimin në çështjet e lidhura me detyrimin e mbajtjes”*. Sipas Rregullores, juridiksioni në çështjet që lidhen me detyrimet ushqimore i takon: i. gjykatës së vendit ku i padituri ose kreditori banon zakonisht; ose ii. gjykatës që ka juridiksion mbi statusin personal ose përgjegjësinë prindërore, nëse këto lidhen me kërkesën për ushqim (me kusht që juridiksioni të mos bazohet vetëm në shtetësinë e njërit prej

³³ Referuar paragrafëve 49-53 të këtij vendimi.



palëve). Palët, në rrethana të caktuara, mund të bien dakord për gjykatën ose gjykatat e një shteti anëtar të BE-së që do të kenë juridiksion për të zgjidhur mosmarrëveshjen, me përjashtim të rasteve që lidhen me detyrimin ushqimor ndaj një fëmije nën 18 vjeç. Sipas Rregullores nr. 4/2009, rregullat mbi juridiksionin synojnë të mbrojnë interesat e kreditorit të ushqimit, i cili konsiderohet pala më e dobët, duke parashikuar një juridiksion alternativ. Një nga veçoritë e kësaj Rregulloreje lidhet me mundësinë e zgjerimit të juridiksionit në çështjet që kanë të bëjnë me detyrimet ushqimore në favor të një fëmije të mitur, kur kërkesa për ushqim është aksesore ndaj një procedimi që lidhet me statusin personal të një personi ose ndaj një procedimi që lidhet me përgjegjësinë prindërore.

93. Një përfundim i tillë mbështetet edhe në interpretimin e nenit 1§2 të Konventës së Hagës, sipas të cilit termi “përgjegjësi prindërore” përfshin autoritetin prindëror ose çdo marrëdhënie të ngjashme autoriteti që përcakton të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e prindërve, kujdestarëve apo përfaqësuesve të tjerë ligjorë lidhur me personin dhe pasurinë e fëmijës. Nga kjo dispozitë rezulton se, megjithëse detyrimi për ushqim paraqitet si një detyrim financiar me natyrë të pavarur dhe rregullohet nga instrumente të posaçme, ai është i lidhur ngushtësisht në plan funksional me përgjegjësinë prindërore. Kjo për shkak se masa e detyrimit ushqimor varet nga mënyra e ushtrimit të kujdestarisë, lidhet me vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës dhe buron nga detyrimi i prindit që ushtron kujdesin faktik ndaj tij. Në këtë kuptim, detyrimi për ushqim përbën një rrjedhojë të drejtpërdrejtë të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore.

94. Mbi këtë analizë, lidhur me çështjen e tretë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji konkludon, se:

Përcaktimi apo ndryshimi i detyrimit për ushqim të fëmijës së mitur është pjesë e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe gjykimi mbi këtë kërkim bëhet nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit.

Në rastet kur ky vendqëndrim i zakonshëm është jashtë Republikës së Shqipërisë, gjykata shqiptare nuk ka juridiksion, përveç kur vlerëson se kjo bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës.

Gjykata shqiptare ka juridiksion kur kërkimet për përcaktimin apo ndryshimin e detyrimit për ushqim ngrihen si kërtime më vete, si masa mbrojtëse për të miturin, përpara gjykimit për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave, me efekt deri në rregullimin e tyre, kur prindi kërkesues e ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

Çështja e katërt e shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore:

ç. A kanë gjykatat shqiptare juridiksion për të gjykuar çështjet me objekt lejimin e lëvizjes së fëmijës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri?

95. Çështjet me objekt lejimin e lëvizjes ose udhëtimit të fëmijës jashtë territorit të një shteti janë pjesë e sferës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, pasi prekin drejtpërdrejt aspektet e kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijës. Për pasojë, Konventa e Hagës, krahas zbatimit lidhur me çështjet që kanë për objekt ushtrimin dhe ndryshimin e përgjegjësisë prindërore, gjen zbatim edhe në rastet kur kërkohet autorizimi për lëvizjen e fëmijës, e cila lidhet në themel me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, pasi prek të drejtën e takimit të të paktën njërit prind me fëmijën.

96. Elementi i huaj i lidhur me vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijëve të mitur jashtë Republikës së Shqipërisë ka relevancë dhe prevalencë për përcaktimin e juridiksionit, duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave shqiptare në gjykimin e padive me objekt lejimin e lëvizjes së fëmijëve jashtë shtetit pa autorizimin e njërit prej prindërve, edhe kur me një vendim të mëparshëm të gjykatave shqiptare është përcaktuar mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore nga secili prind pas zgjidhjes së martesës.

Gjykatat shqiptare nuk mund të vlerësojnë interesin më të lartë të fëmijëve të mitur, të cilët prej vitesh, kanë krijuar një socializim konstant me shtetin ku kanë vendqëndrimin e zakonshëm. Ndër të tjera, gjykatat shqiptare nuk përbëjnë autoritetin gjyqësor më të përshtatshëm për të vlerësuar dobishmërinë dhe bazueshmërinë e një kërkesë që lidhet me lëvizjen e fëmijëve brenda ose përtej hapësirës së Bashkimit Evropian. Autoritetet gjyqësore të shtetit në të cilin fëmija i mitur ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm janë më të



përshtatshëm për shqyrtimin e këtyre kërkesave dhe për vlerësimin nëse ekziston ose jo ndonjë kufizim i lëvizjes së të miturit nga shteti i banimit drejt shteteve të tjera.

97. Në vijim të analizës mbi juridiksionin në çështjet e përgjegjësisë prindërore dhe parimin e vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit si kriter qendror për përcaktimin e juridiksionit, Kolegji çmon të evidentojë dallimin midis situatave të largimit/mbajtjes pa të drejtë të fëmijës dhe rasteve kur lëvizja e tij jashtë shtetit kryhet me pëlqimin e titullarëve të përgjegjësisë prindërore ose në zbatim të një vendimmarrjeje gjyqësore.

Neni 7 i Konventës së Hagës parashikon parimin e vazhdimësisë së juridiksionit vetëm në rastet e largimit apo mbajtjes së paligjshme të fëmijës, duke synuar rikthimin e menjëhershëm të *status quo*-së dhe mbrojtjen e të drejtave të kujdestarisë. Ky parashikim ligjor nuk ka për qëllim të rregullojë autorizimin e zakonshëm për lëvizjen e fëmijës jashtë shtetit, por të adresojë situatat e cenimit të juridiksionit përmes veprimeve të njëanshme.

98. Në këtë kuptim, përcaktimi i natyrës së situatës konkrete është vendimtar për vlerësimin e juridiksionit të zbatueshëm. Kur paraqitet kërkesa për autorizim gjyqësor për daljen e fëmijës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai ndodhet përkohësisht në Shqipëri dhe synohet kthimi i tij në shtetin ku ka vendqëndrimin e zakonshëm, ose kur kërkohet autorizim për hyrjen e përkohshme të tij në territorin shqiptar, nuk ndodhemi përpara një situatë “largimi apo mbajtjeje pa të drejtë” në kuptim të nenit 7 të Konventës së Hagës. Përkundrazi, bëhet fjalë për një masë rregulluese ose parandaluese që lidhet me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe me garantimin e lëvizjes së ligjshme të fëmijës në përputhje me të drejtat e kujdestarisë.

Në këto rrethana, gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të vendosur mbi kërkesën për autorizim, pasi fëmija ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Juridiksioni ndërkombëtar justifikohet, në rastet kur situata paraqet nevojë për ndërhyrje të menjëhershme mbrojtëse, edhe në bazë të nenit 11 të Konventës së Hagës, i cili parashikon se: “1. Në të gjitha rastet emergjente, autoritetet e ndonjë Shteti Kontraktues, në territorin e të cilit ndodhet fëmija ose prona që i përket fëmijës, ka juridiksion për të marrë masat e

nevojshme mbrojtëse. 2. Masat e marra sipas paragrafit të mësipërm, për sa i përket një fëmije që është banor i përhershëm në Shtetin Kontraktues, do të shfuqizohen nëse autoritetet, të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5-10, kanë marrë masat që kërkohen sipas rrethanave. 3. Masat e marra sipas paragrafit 1 në lidhje me fëmijën që është banor i përhershëm në një shtet jokontraktues, do të shfuqizohen në secilin Shtet Kontraktues, nëse masat e kërkuara sipas rrethanave dhe ato të marra nga autoritetet e një shteti tjetër njihen në Shtetin Kontraktues në fjalë”.

99. Mbi këtë analizë, lidhur me çështjen e katërt të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji konkludon, se:

Lejimi i lëvizjes së fëmijës së mitur jashtë vendit, si pjesë e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, rregullohet nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit. Gjykata shqiptare nuk ka juridiksion nëse ky vendqëndrim është jashtë Republikës së Shqipërisë.

Gjykata shqiptare ka juridiksion në rastet kur fëmija i mitur, për arsye të ndryshme ndodhet përkohësisht në Republikën e Shqipërisë, për lëvizjen e tij drejt vendit ku ka vendqëndrimin e zakonshëm ose kur nga Republika e Shqipërisë nevojitet autorizim për hyrjen e tij përkohësisht në Republikën e Shqipërisë.

Pyetja e dytë e shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore:

2. Si qëndron juridiksioni i gjykatave shqiptare për këto çështje, në raport me zbatimin e Konventës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve?”

100. Me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005³⁴, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve” (1980). Si pjesë e rendit juridik të brendshëm, kjo Konventë është e detyrueshme për gjykatat shqiptare dhe duhet të zbatohet në përputhje me qëllimin dhe frymën e saj. Objektivi i Konventës është, nga njëra anë, të sigurojë kthimin e shpejtë të fëmijëve që largohen ose mbahen pa të drejtë në një shtet kontraktues dhe, nga ana tjetër, të garantojë respektimin efektiv të të drejtave të kujdestarisë dhe të kontaktit, sipas ligjit të një Shteti Kontraktues, në Shtetet e tjera Kontraktuese. Konventa synon të rivendosë menjëherë situatën faktike të fëmijës në

³⁴ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 97, datë 21.12.2005.



gjendjen e mëparshme, pa hyrë në shqyrtimin në themel të çështjes së përgjegjësisë prindërore.

101. Në kuptim të Konventës, largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet e padrejtë kur cenon të drejtat e kujdestarisë që i janë njohur një personi, institucioni ose organi tjetër, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka pasur vendqëndrimin e zakonshëm menjëherë para largimit apo mbajtjes dhe këto të drejta janë ushtruar ose do të ishin ushtruar në mungesë të largimit ose mbajtjes. Sipas nenit 4 të Konventës, ajo zbatohet për çdo fëmijë deri në moshën 16 vjeç, me kusht që ai të ketë pasur vendqëndrimin e zakonshëm në një shtet kontraktues menjëherë përpara shkeljes së pretenduar të të drejtave të kujdestarisë ose të kontaktit. Kjo do të thotë se kriteri përcaktues për zbatimin e Konventës është vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës në një Shtet Kontraktues në momentin para zhvendosjes ose mbajtjes së pretenduar pa të drejtë. Për zbatimin e Konventës nuk ka rëndësi shtetësia e fëmijës, as identiteti i personit që ka kryer largimin ose mbajtjen. Subjekt i shkeljes mund të jetë secili prind ose persona të tjerë të afërm, për sa kohë që veprimi përbën cenim të të drejtave të kujdestarisë sipas ligjit të shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës.

102. Kësisoj, Konventa ndërtohet mbi parimin e vendqëndrimit të zakonshëm si kriter qendror juridiksional dhe mbi mekanizmin e kthimit të menjëhershëm, me qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe parandalimin e ndryshimit të njëanshëm të situatës së tij faktike përmes largimit ose mbajtjes së padrejtë. Neni 3 i Konventës parashikon shprehimisht, se: *“Largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë kur: a) konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë që i janë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë kolektivisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i zakonshëm para largimit apo mbajtjes; dhe b) në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë kolektivisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes”*. Të drejtat e kujdestarisë, të përmendura në shkronjën “a” të dispozitës, mund të lindin veçanërisht nga funksionimi i ligjit ose për shkak të një vendimi gjyqësor apo administrativ, ose për shkak të një marrëveshjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të atij shteti. Nga ana tjetër, neni 19 i Konventës parashikon, se: *“Një vendim sipas kësaj Konvente në lidhje me kthimin e fëmijës, nuk do të merret si vendim që zgjidh në*

themel çështjet të përgjegjësisë ndaj fëmijës”. Pra një vendim i një autoriteti, nëpërmjet të cilit disponohen masa në raport me fëmijën (p.sh. kthimi i fëmijës), nuk do të shërbejë si një vendim i cili zgjidh në thelb aspekte të përgjegjësisë prindërore kundrejt fëmijës së mitur.

103. Marrëdhënia ndërmjet Konventës së Hagës *“Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”* (1980) dhe Konventës së Hagës *“Mbi Juridiksionin, Ligjin e Zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin, në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve”* (1996), rregullohet në mënyrë të posaçme nga Konventa e vitit 1996. Në zbatim të nenit 50 të Konventës së Hagës *“Mbi Juridiksionin, Ligjin e Zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin, në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve”*, rezulton, se: *“Kjo Konventë nuk cenon zbatimin e Konventës së 25 tetorit 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, ndërmjet palëve që janë pjesëmarrëse në të dyja Konventat. Megjithatë, asgjë nuk e pengon që dispozitat e kësaj Konvente të thirren për qëllimet e marrjes së kthimit të një fëmije që është larguar ose mbajtur padrejtësisht, ose për organizimin e të drejtave të vizitës”*.

104. Kjo do të thotë se në rastet kur të dyja instrumentet ndërkombëtare gjejnë zbatim, ato interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të koordinuar, duke ruajtur funksionet e tyre të veçanta dhe duke shmangur çdo konflikt normativ.

Konventa e Hagës *“Mbi Juridiksionin, Ligjin e Zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin, në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve”* nuk zëvendëson mekanizmin e kthimit të menjëhershëm të fëmijës të parashikuar nga Konventa e 25 tetorit 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, por përkundrazi, garanton që dispozitat e saj të mund të thirren në mbështetje të qëllimit të kthimit të fëmijës së larguar apo të mbajtur padrejtësisht, si dhe për rregullimin dhe organizimin e të drejtave të kontaktit apo të aksesit. Në këtë mënyrë, instrumentet ndërkombëtare veprojnë në mënyrë plotësuese, Konventa e vitit 1980 adreson situatën emergjente të zhvendosjes së paligjshme, ndërsa Konventa e Hagës *“Mbi Juridiksionin, Ligjin e Zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin, në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve”*, siguron kuadrin e përgjithshëm të juridiksionit dhe të masave mbrojtëse në lidhje me përgjegjësinë prindërore, gjithnjë në funksion të interesit më të lartë të fëmijës dhe të garantimit të stabilitetit të tij juridik dhe faktik.



105. Në kuadër të zbatimit të Konventës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, juridiksioni për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me përgjegjësinë prindërore i përket gjykatave të shtetit në të cilin fëmija ka pasur vendqëndrimin e zakonshëm përpara largimit ose mbajtjes së pretenduar si të paligjshme. Në dritën e këtij rregullimi të koordinuar përcaktohet edhe kufiri i juridiksionit të gjykatave shqiptare. Kjo nënkupton se kur fëmija është sjellë ose mbahet në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për të gjykuar mbi themelin e mosmarrëveshjes lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, por mund të ushtrojnë juridiksion vetëm për shqyrtimin e kërkesës për kthimin e menjëhershëm të fëmijës.

Juridiksioni i gjykatave shqiptare në këto raste ka karakter të kufizuar dhe funksional, duke synuar rivendosjen e gjendjes së mëparshme faktike, pa zgjidhur në thelb konfliktin prindëror. Vendimi për kthim nuk përbën vendim mbi të drejtat prindërore, por një masë procedurale që garanton që çështjet e përgjegjësisë prindërore të shqyrtohen nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës, si autoriteti me lidhjen më të ngushtë me situatën familjare.

Për më tepër, kërkesa për kthim nuk kushtëzohet nga ekzistenca e një procesi për zgjidhjen e martesës, por bazohet ekskluzivisht në faktin e largimit ose mbajtjes pa pëlqimin e prindit tjetër që ushtron të drejta kujdestarie. Në këtë kuptim, vendimet e gjykatave shqiptare që urdhërojnë kthimin e fëmijës nuk ndërhyjnë në përcaktimin e përgjegjësisë prindërore, por synojnë vetëm të rrikthejnë situatën në gjendjen ekzistuese para largimit, duke i lënë gjykatës kompetente të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës kompetencën për të marrë vendimin përfundimtar mbi çështjet e kujdestarisë dhe të drejtave prindërore.

106. Sa më sipër arsyetuar, lidhur me pyetjen e dytë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji konkludon, se:

Në zbatim të Konventës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, juridiksioni për çështjet e përgjegjësisë prindërore u takon gjykatave të shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës përpara largimit apo mbajtjes së paligjshme. Gjykatat e shtetit ku fëmija është sjellë, përfshirë ato shqiptare, kanë juridiksion të kufizuar vetëm për të vendosur mbi kthimin

e menjëhershëm të fëmijës, pa ndërhyrë në themelin e mosmarrëveshjes mbi përgjegjësinë prindërore, e cila zgjidhet nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm.

Kërkesa për kthimin e fëmijës nuk varet nga ekzistenca e një procesi zgjidhje martesës, por thjesht nga fakti i largimit pa pëlqimin e prindit tjetër që ushtron përgjegjësinë prindërore. Vendimet e autoriteteve që urdhërojnë kthimin e fëmijës nuk zgjidhin në themel aspektet e kujdestarisë apo të drejtave prindërore, por synojnë vetëm rivendosjen e status quo, në mënyrë që gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës të marrë vendimin përfundimtar mbi këto çështje.

IV. Sentencat njësuere

107. Në referim të nenit 485§2 të Kodit të Procedurës Civile, disponimi njësuere, për secilën prej çështjeve të shqyrtuara nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është si në vijim:

Në lidhje me pyetjen nr. 1 dhe nën pyetjet e saj, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, arrin në konkluzionet njësuere si më poshtë vijon:

a) Në gjykimet me objekt “Zgjidhjen e martesës”, kur nga kjo martesë ka fëmijë të mitur, gjykata, kur pranon padinë, ka detyrimin të shprehet krahas zgjidhjes së martesës edhe për rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhjeje në raport me fëmijët. Në këto raste, për të gjithë gjykimin merr përparësi vlerësimi i interesit më të lartë të të miturit.

Kur i mituri jeton në një vend tjetër, jashtë Republikës së Shqipërisë, gjykata duhet të konstatojë, bindet dhe përcaktojë “vendqëndrimin e zakonshëm” të fëmijës, duke iu referuar kohëzgjatjes së qëndrimit në atë vend, arsyeve të zhvendosjes së familjes dhe kushteve social-ekonomike të fëmijës.

Nëse në vlerësim të këtyre fakteve, gjykata shqiptare bindet se interesi më i lartë i të miturit vlerësohet para saj si dhe të dy prindërit janë dakord me këtë juridiksion, gjykata shqiptare ka juridiksion për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhjeje në raport me fëmijët.

Në të kundërt, nëse referuar kritereve të mësipërme, gjykata shqiptare përcakton se “vendqëndrimi i zakonshëm” i fëmijës është jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet të



deklarojë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të saj.

b) Gjykimi për çështje me objekt “rregullimin ose ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore”, duhet të zhvillohet në vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës, konstatuar kjo referuar kriterëve të përcaktuara më lart.

Në rast se ky vendqëndrim i zakonshëm ka ndryshuar në raport me vendqëndrimin e mëparshëm dhe gjykatën që ka përcaktuar fillimisht mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, gjykimi për ndryshimin e saj duhet të zhvillohet në gjykatën e vendqëndrimit të zakonshëm të ri.

Kur gjykata shqiptare konstaton se vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës së mitur është jashtë Republikës së Shqipërisë, deklaron nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, përveç kur vlerëson se kjo bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës.

c) Përcaktimi apo ndryshimi i detyrimit për ushqim të fëmijës së mitur është pjesë e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe gjykimi mbi këtë kërkim bëhet nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit.

Në rastet kur ky vendqëndrim i zakonshëm është jashtë Republikës së Shqipërisë, gjykata shqiptare nuk ka juridiksion, përveç kur vlerëson se kjo bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës.

Gjykata shqiptare ka juridiksion kur kërkesat për përcaktimin apo ndryshimin e detyrimit për ushqim ngrihen si kërtime më vete, si masa mbrojtëse për të miturin, përpara gjykimit për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave, me efekt deri në rregullimin e tyre, kur prindi kërkesë e ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

ç. Lejimi i lëvizjes së fëmijës së mitur jashtë vendit, si pjesë e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, rregullohet nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit.

Gjykata shqiptare nuk ka juridiksion nëse ky vendqëndrim është jashtë Republikës së Shqipërisë.

Gjykata shqiptare ka juridiksion në rastet kur fëmija i mitur, për arsye të ndryshme ndodhet përkohësisht në Republikën e Shqipërisë, për lëvizjen e tij drejt vendit ku ka vendqëndrimin e zakonshëm ose kur nga Republika e Shqipërisë nevojitet autorizim për hyrjen e tij përkohësisht në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me pyetjen nr. 2, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, arrin në konkluzionin njësoj si më poshtë vijon:

Në zbatim të Konventës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, juridiksioni për çështjet e përgjegjësisë prindërore u takon gjykatave të shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës përpara largimit apo mbajtjes së paligjshme. Gjykatat e shtetit ku fëmija është sjellë, përfshirë ato shqiptare, kanë juridiksion të kufizuar vetëm për të vendosur mbi kthimin e menjëhershëm të fëmijës, pa ndërhyrë në themelin e mosmarrëveshjes mbi përgjegjësinë prindërore, e cila zgjidhet nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm.

Kërkesa për kthimin e fëmijës nuk varet nga ekzistenca e një procesi zgjidhje martese, por thjesht nga fakti i largimit pa pëlqimin e prindit tjetër që ushtron përgjegjësinë prindërore. Vendimet e autoriteteve që urdhërojnë kthimin e fëmijës nuk zgjidhin në themel aspektet e kujdestarisë apo të drejtave prindërore, por synojnë vetëm rivendosjen e status quo, në mënyrë që gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës të marrë vendimin përfundimtar mbi këto çështje.

108. Një vendimmarrje njësoje e këtij karakteri nuk i mohon palëve të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, por unifikon rregullat e përcaktimit të juridiksionit ndërkombëtar dhe orienton shqyrtimin e çështjes të gjykatës, e cila ka juridiksion dhe që zakonisht është gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës. Në këtë mënyrë, aksesit në drejtësi³⁵ realizohet përpara gjykatës që ka lidhjen më të ngushtë me mosmarrëveshjen, duke garantuar siguri juridike, parashikueshmëri dhe zbatim të standardeve ndërkombëtare të pranuar mbi vendqëndrimin e zakonshëm si kriter qendror.

³⁵ GjEDNj “Markovic dhe të tjerë kundër Italisë”, nr. 1398/03, vendimi i 14.12.2006.



Gjithashtu, këto konkluzione njësuere nuk krijojnë boshllëk juridiksional, pasi kur gjykata shqiptare konstaton mungesën e juridiksionit për shkak të vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit jashtë territorit, juridiksioni i përket gjykatës së shtetit përkatës. Pra, juridiksioni transferohet në mënyrë funksionale, duke ruajtur të drejtën për gjykim efektiv. Për më tepër, vendimmarrja ruan një klauzolë përjashtimore të bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, e cila lejon ushtrimin e juridiksionit nga gjykatat shqiptare kur kjo rezulton e domosdoshme, duke garantuar që zbatimi i rregullave të mos ketë karakter formalist, por të mbetet në funksion të mbrojtjes efektive të të miturit.

V. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete.

109. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se konform neneve 1, 2, 3 të Konventës së Hagës, padia e ngritur nga paditësja D.V përkundrejt të paditurit A.V, lidhet jo vetëm me zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave midis bashkëshortëve, por edhe me përcaktimin e modalitetit të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesë, si dhe mënyrën e ushtrimit të të drejtave të takimit të prindit, të cilit nuk i lihen fëmijët e mitur për rritje dhe edukim. Pasojat të cilat pretendohen të zgjidhen nëpërmjet padisë objekt gjykimi prekin në thelb të drejtën e takimit dhe të kontaktit të të paktën njërit prej prindërve me fëmijët e mitur. Për pasojë, mosmarrëveshja objekt gjykimi bie në fushën e zbatimit të Konventës së Hagës.

110. Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pas vlerësimit dhe analizës së kuadrit provues, ka konstatuar faktin se fëmijët e mitur të bashkëshortëve V., kanë lindur dhe jetojnë në Greqi, si dhe vazhdojnë shkollimin në institucionet arsimore të këtij shteti. Gjithashtu, vetë bashkëshortët ndërgjyqës kanë vendqëndrimin e zakonshëm në Greqi, duke qenë tërësisht të integruar në këtë shtet. I vetmi element që i lidh palët ndërgjyqëse me Shqipërinë është shtetësia shqiptare, e cila vlerësohet e pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se interesi më i lartë i fëmijëve kërkon që gjykimin të zhvillohet në gjykatat shqiptare. Vendimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë ka zbatuar me rigorozitet kriterin e vendqëndrimit të zakonshëm si faktor përcaktues i juridiksionit ndërkombëtar në çështjet që lidhen me përgjegjësinë

prindërore. Në analizë të provave të administruara, gjykata ka konstatuar se fëmijët dhe prindërit jetojnë në mënyrë të qëndrueshme në Greqi, ku janë të integruar familjarisht, shoqërisht dhe ekonomikisht, duke arritur në përfundimin se vendqëndrimi i zakonshëm ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë. Ky vlerësim është bërë në përputhje me standardet e vendosura nga Konventa e Hagës dhe me parimin se juridiksioni i takon gjykatës së shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës, çka përbën thelbin e arsytimit njësuere.

111. Gjithashtu, gjykata ka analizuar në mënyrë të strukturuar ekzistencën e elementeve të huaja, ka verifikuar nëse ekziston mundësia e prorogimit të juridiksionit dhe ka vlerësuar interesin më të lartë të fëmijëve, duke arritur në përfundimin se gjykimi është më i përshtatshëm në shtetin e vendqëndrimit të zakonshëm. Në këtë mënyrë, vendimi pasqyron zbatimin e drejtpërdrejtë të parimeve të sigurisë juridike dhe interesit më të lartë të fëmijës, ashtu siç janë artikuluar në vendimin njësuere të Gjykatës së Lartë.

112. Sa më sipër arsyetuar, Kolegji vlerëson se vendimi nr. 1459 (13-2024-5077), datë 22.4.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me të cilin është vendosur nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor të gjykatave shqiptare është i bazuar në ligjin procedural dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenet 481 e vijues, 485, pika 1/e të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 1459 (13-2024-5077), datë 22.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

2. Ky vendim është njësuere dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë më, datë 22.12.2025.

Kryesues: Artur Kalaja

Anëtarë: Ervin Pupe, Valbon Çekrezi

Anëtarë (pjesërisht kundër): Margarita Buhali, Enton Dhimitri



MENDIM PAKICE

Për çështjen civile Nr. 21001-00392-00-2025

Ne gjyqtarët Margarita Buhali dhe Enton Dhimitri kemi votuar pjesërisht kundër vendimit të marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në çështjen civile me nr. 21001-00392-00-2025 që i përket:

PADITËSE: D.V (përfaqësuar nga av. Kadri Isufaj)

I PADITUR: A.V (në mungesë)

OBJEKTI: 1. Zgjidhja e martesës ligjore me të paditurin A.V.

2. Lënien për rritje dhe edukim të tre fëmijëve A.V, E.V dhe D.V paditëses D.V.

3. Detyrimin ushqimor në shumën 600 (gjashtëqind) euro në muaj, 200 (dyqind) euro për fëmijë, për të paditurin A.V, për fëmijët A.V, E.V dhe D.V.

4. Të drejtën e kthimit të mbiemrit të para martesës “Ç” për paditësen D.V.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 153, 154, 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile.

Nenet 129, 139, 143, 144, 146 e vijues të Kodit të Familjes.

Paraqesim mendimin tonë në pakicë për këtë çështje si më poshtë.

Duke pasur parasysh çështjen e shtruar për njësim nga kolegji civil si gjyqtare në pakicë kemi votuar që në përgjigje të pyetjeve së shtruara për diskutim përgjigja njësuere të bëhej njësimi i praktikës gjyqësore:

Për pyetjen e parë:

a) Në çështjet me objekt zgjidhje martese ose pavlefshmëri e martesës dhe rregullimin e pasojave të tyre gjykatat shqiptare kanë juridiksion për shqyrtimin e çështjes, kur ekziston një nga kriteret lidhëse të ligjit nr. 10428/ 2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” pavarësisht se vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri.

b) Në çështjen me objekt rregullimin ose ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së mitur gjykatat shqiptare kanë juridiksion sipas kriterëve lidhëse të përcaktuara në nenin 76 të ligjit nr. 10428/2011 pavarësisht se vendqëndrimi i të miturit nuk është në Shqipëri. Nëse rregullimi fillestar i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore është bërë me vendim të formës së prerë të gjykatës së huaj,

gjykata shqiptare ka juridiksion për tu shprehur lidhur me masat paraprake mbrojtëse ose për ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore kur fëmija i mitur ka vendqëndrimin në Shqipëri.

c) Në çështjet me objekt përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim gjykatat shqiptare kanë juridiksion për shqyrtimin e këtyre çështjeve kur ekzistojnë kriteret lidhëse të përcaktuara në nenet 75, 76 ose 80 të ligjit nr. 10428/2011.

i. Nëse e njëjta padi për çështjet e sipërcituara është duke u gjykuar në mënyrë të njëkohshme edhe nga gjykata e huaj, gjykata mund të disponojë për çështjen në shqyrtim në një nga mënyrat e parashikuara nga neni 38 i KPC-së.

Për pyetjen e dytë:

Nëse para Gjykatave shqiptare është në gjykim një çështje për kthimin e fëmijës në kuadër të Konventës ‘Për rrëmbimin civil të fëmijëve’, kjo situatë nuk cenon juridiksionin e gjykatave shqiptare për të shqyrtuar një çështje, që ka të bëjë me kujdestarinë ose mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore mbi të miturin. Megjithatë kur ka një vendim të gjykatave shqiptare për kthimin e fëmijës në shtetin e huaj në bazë të konventës “Për rrëmbimin civil të fëmijëve” dhe në shtetin e huaj është duke u gjykuar një çështje e kujdestarisë së fëmijës ose e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për fëmijën atëherë gjykata duhet të disponojë për çështjen e paraqitur para saj në një nga mënyrat e parashikuara nga neni 38 i KPC-së.

Ndërkohë shumica me vendimin njësuere të datës 22.12.2025 vendosi të njësojë praktikën gjyqësore me formulimet njësuere si më poshtë;

- Për pyetjen e parë:

a) Në gjykimet me objekt “Zgjidhjen e martesës”, kur nga kjo martesë ka fëmijë të mitur, gjykata, kur pranon padinë, ka detyrimin të shprehet krahas zgjidhjes së martesës edhe për rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhje në raport me fëmijët. Në këto raste, për të gjithë gjykimin merr përparësi vlerësimi i interesit më të lartë të të miturit.

Kur i mituri jeton në një vend tjetër, jashtë Republikës së Shqipërisë, gjykata duhet të konstatojë, bindet dhe përcaktojë “vend-



qëndrimin e zakonshëm” të fëmijës, duke iu referuar kohëzgjatjes së qëndrimit në atë vend, arsyeve të zhvendosjes së familjes dhe kushteve social-ekonomike të fëmijës.

Nëse në vlerësim të këtyre fakteve, gjykata shqiptare bindet se interesi më i lartë i të miturit vlerësohet para saj si dhe të dy prindërit janë dakord me këtë juridiksion, gjykata shqiptare ka juridiksion për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhjeje në raport me fëmijët.

Në të kundërt, nëse referuar kriterëve të mësipërme, gjykata shqiptare përcakton se “vendqëndrimi i zakonshëm” i fëmijës është jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet të deklarojë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të saj.

b) Gjykimi për çështje me objekt “rregullimin ose ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore”, duhet të zhvillohet në vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës, konstatuar kjo referuar kriterëve të përcaktuara më lart.

Në rast se ky vendqëndrim i zakonshëm ka ndryshuar në raport me vendqëndrimin e mëparshëm dhe gjykatën që ka përcaktuar fillimisht mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, gjykimi për ndryshimin e saj duhet të zhvillohet në gjykatën e vendqëndrimit të zakonshëm të ri.

Kur gjykata shqiptare konstaton se vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës së mitur është jashtë Republikës së Shqipërisë, deklaroi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, përveç kur vlerëson se kjo bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës.

c) Përcaktimi apo ndryshimi i detyrimit për ushqim të fëmijës së mitur është pjesë e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe gjykimi mbi këtë kërkim bëhet nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të të miturit.

Në rastet kur ky vendqëndrim i zakonshëm është jashtë Republikës së Shqipërisë, gjykata shqiptare nuk ka juridiksion, përveç kur vlerëson se kjo bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës.

Gjykata shqiptare ka juridiksion kur kërkimet për përcaktimin apo ndryshimin e detyrimit për ushqim ngrihen si kërtime më vete, si masa mbrojtëse për të miturin, përpara

gjykimit për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave, me efekt deri në rregullimin e tyre, kur prindi kërkes e ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me pyetjen e dytë:

Në zbatim të Konventës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, juridiksioni për çështjet e përgjegjësisë prindërore u takon gjykatave të shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës përpara largimit apo mbajtjes së paligjshme. Gjykatat e shtetit ku fëmija është sjellë, përfshirë ato shqiptare, kanë juridiksion të kufizuar vetëm për të vendosur mbi kthimin e menjëhershëm të fëmijës, pa ndërhyrë në themelin e mosmarrëveshjes mbi përgjegjësinë prindërore, e cila zgjidhet nga gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm.

Kërkesa për kthimin e fëmijës nuk varet nga ekzistenca e një procesi zgjidhje martese, por thjesht nga fakti i largimit pa pëlqimin e prindit tjetër që ushtron përgjegjësinë prindërore. Vendimet e autoriteteve që urdhërojnë kthimin e fëmijës nuk zgjidhin në themel aspektet e kujdestarisë apo të drejtave prindërore, por synojnë vetëm rivendosjen e status quo, në mënyrë që gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës të marrë vendimin përfundimtar mbi këto çështje.

I. Vlerësimi i gjyqtarëve në pakicë

Kolegji Civil (shumica) ka arritur në konkluzionet e mësipërme duke u përqendruar në një interpretim të kufizuar e kontradiktor të Konventës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve” në konsideratë kjo edhe të qasjeve të rregulloreve Këshillit (BE) nr. 1215/2012 dhe asaj të Brukselit Nr.II, të BE, ku Shqipëria synon të aderojë, megjithëse këto rregullore nuk kanë fuqi detyruese për zbatim në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu ky vendim cenon praktikën e konsoliduar gjyqësore në këtë fushë të ndjekur nga gjykatat për gjithë periudhën pas vitit 1991 ose më kryesisht edhe pas viteve 2005 kur është ratifikuar kjo Konventë. Mënyra e interpretimit të Konventës së Hagës nga shumica ka lënë pa fuqi zbatim ligjin nr. 10428/2011, madje edhe Konventa të tjera, që veprojnë në këtë fushë sic është ajo Për njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore”



dhe Konventa “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”. Ajo cenon të drejtën e shtetasve shqiptar që jetojnë jashtë vendit për akses në drejtësi, madje edhe të drejtën e shtetasve shqiptar që jetojnë në Shqipëri në rastin kur fëmija e tyre ka vendqëndrimin e zakonshëm jashtë shtetit, si dhe parimin e barazisë së tyre para ligjit në lidhje me ushtrimin e të drejtave të njohura nga ligji dhe Kushtetuta.

Si gjyqtarë në pakicë, më hollësisht paraqesim qëndrimin e kundër në raport me vendimin e marrë nga shumica për sa më poshtë:

Konsiderata të përgjithshme mbi kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë fushë.

1. Në lidhje me çështjet e pyetjes së parë të shtruar për njësim lidhur me juridiksionin e gjykatave shqiptare për gjykimin e çështjeve me objekt zgjidhje martese, rregullim i pasojave, rregullimi i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, detyrimi për ushqim, Kolegji Civil (shumica) nëpërmjet qëndrimit njësores të mbajtur kanë cenuar gjithë praktikën gjyqësore të mëparshme të mbajtur nga gjykatat e të gjitha shkallëve ndër vite. Ndryshimet e para të kësaj praktike ndodhen pas vitit 2022, në disa prej qëndrimeve të mbajtura nga një prej trupave gjyqësore të kolegjit civil, megjithëse Konventa e Hagës ishte ratifikuar nga Republika e Shqipërisë që në vitin 2005 dhe nuk kishte ndodhur asnjë ndryshim ligjor pas këtij viti. Përkundrazi në vitin 2011 u miratua ligji nr. 10428/2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” që vendosi kritere të qarta për njohjen në mënyrë të shprehur të juridiksionit të gjykatave shqiptare mbi bazën e kriterit “shtetësi” për çështjet e shtruara për njësim. Kjo qasje pozitive e legjislatorit në drejtëm të pranueshmërisë së juridiksionit, megjithëse ishte në fuqi Konventa e Hagës detyron gjyqësorin të bëjë interpretimin historik dhe harmonik të legjislacionit dhe të Konventës për t’i bërë ato të zbatueshme dhe jo për të përjashtuar njëra-tjetrën sikurse është interpretuar nga shumica.

2. Qëndrueshmëria e parashikimeve ligjore e konventore impononte Kolegjin që të justifikonte në mënyrë bindëse ndryshimin e një praktike gjyqësore të konsoliduar ndër vite, që megjithëse nuk ishte njësores kishte krijuar siguri juridike për akses në gjykatat shqiptare për të gjithë shtetasit

shqiptar, që jetonin jashtë shtetit, lidhur me gjykimin e çështjeve për zgjidhje martese e për rregullimin e çdo pasojë, që kishte të bënte me përgjegjësinë prindërore, detyrimin për ushqim, mbiemrin etj. Krijimi i kësaj pritshmërie legjitime për akses në drejtësi, nga mënyra uniforme se si praktika gjyqësore e kishte interpretuar ligjin, kërkonte që të tregohet një kujdes i shtuar në ndryshimin e mënyrës së interpretimit të ligjit, pasi një konkluzion i kundërt në kufizim të kësaj të drejte do të sillte një impakt të madh publik ndaj shtetasve shqiptar, që jetojnë jashtë vendit, ndërkohë që qasja aktuale legjislative dhe ajo kushtetuese po shkon në rritje të të drejtave të tyre dhe jo në përkeqësim. Shprehje më e qartë e kësaj fryme pozitive është njohja e së drejtës së shtetasve shqiptar që jetojnë jashtë shtetit për të votuar duke kontribuar kështu drejtpërdrejt me votën e tyre në zhvillimin e jetës politike të vendit.

3. Kolegji Civil ka për detyrë të ruajë qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore, pavarësisht nëse kjo qëndrueshmëri vinte apo jo nga një vendim unifikues i mëparshëm apo nga praktika e zakonshme e Kolegjit Civil ndër vite. Ndryshimi i praktikës gjyqësore nëpërmjet vendimeve njësores duhet të bëhet vetëm në rastin kur interpretimi i legjislacionit nga gjykatat ishte dukshëm i gabuar dhe kur mënyra e interpretimit nuk i përshtatej zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike e ndryshimeve të një pjese të legjislacionit. Njësimi i bërë aktualisht në përkeqësim të të drejtave të shtetasve shqiptar, që jetojnë jashtë vendit për akses në drejtësi në raport me praktikën e mëparshme gjyqësore dhe në kushtet, kur kuadri ligjor e konventor në fuqi nuk ka ndryshuar dhe Shqipëria ende nuk ka aderuar në BE është i pajustificuar.

4. Në vendimin njësores shumica mban në konsideratë për interpretimin e kritereve të Konventës së Hagës, rregulloren Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 1215/2012 “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore në Çështjet Civile dhe Tregtare” (Bruksel I) dhe Rregullorja nr. 2201/2003 “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve në çështjet martesore dhe të përgjegjësisë prindërore” ose rregulloren Bruksel II-ter (2019/1111), madje edhe praktikën e Gjykatës së Drejtësisë mbi raste që kanë të bëjnë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për juridiksionin midis vendeve anëtare të BE. Në vendimin njësores citohet se; *E drejta e Bashkimit Evropian (BE), acquis communautaire, aktualisht nuk*



zbatohet drejtpërdrejt në Shqipëri, sa kohë vendi nuk është ende shtet anëtar i BE-së, megjithatë, procesi i negociatave të anëtarësimit është hapur dhe pas aderimit dhe ratifikimit të Traktatit të Aderimit, acquis do të bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik, duke u zbatuar drejtpërdrejt dhe duke pasur epërsi ndaj ligjeve të brendshme në rast mospërputhjeje. Megjithatë acquis communautaire përbën një burim mjaft të rëndësishëm për efekt të interpretimit të legjislacionit shqiptar dhe kryesisht të asaj pjese të legjislacionit që është përafëruar dhe që duhet të përafërohet me të. Për mendimin tone, pranimi nga shumica i rregulloreve të BE si burime interpretimi i legjislacionit shqiptar, kur këto rregullore nuk janë të zbatueshme në Shqipëri dhe kur ende legjislacioni shqiptar nuk është përafëruar me atë të BE, përbën një shkelje të parimit të ligjshmërisë, pasi do të çonte në tjetërsim të qëllimit për të cilin ligji është miratuar.

5. E drejta e interpretimit të ligjit nga gjykatat, nuk mund të përbëjë një mekanizëm për të tejkaluar parashikimet e shprehura të ligjit kombëtar apo për më tepër për t'i zbatuar ato në mënyrë të ndryshme nga kuptimi literal i tyre. Në kushtet, kur vendi nuk është bërë anëtar i BE interpretimi i ligjit vendas nën frymën e rregulloreve të BE do të ishte i parakohshëm dhe në kundërshtim me qëllimin për të cilin kishin dalë rregulloret e BE. Duke qenë se BE ka si synim të krijojë një entit të vetëm ligjor në çështjet e së drejtës familjare dhe i ka bërë vendimet e secilit vend anëtar, të ekzekutueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendin tjetër anëtar, kuptohet se çështja e juridiksionit në BE ka një trajtim të ngjashëm me atë të kompetencës tokësore në Shqipëri. Ndërkohë, që situata në vendin tonë është e ndryshme pasi juridiksioni ndërkombëtar është ai që vendos rregulla nëse një vend ka të drejtë apo jo të shqyrtojë një çështje me element të huaj, e cila si e tillë do të kërkonte realizimin e procedurave të mëpasshme të njohjes së vendimit në vende të tjera për tu bërë e zbatueshme. Për rrjedhojë kriteret e vendosura për juridiksionin e vendeve anëtare të BE nuk mund të përdoren për analogji për juridiksionin ndërkombëtar në Shqipëri, pasi në thelb kanë të bëjnë me institute procedurale të ndryshme dhe për më tepër shtetasit Shqiptar jetojnë në çdo vend të botës, pra edhe jashtë vendeve të BE. Për rrjedhojë është e pamundur që rregulloret e BE të përdoren si burim interpretimi për ligjin vendas, kur Shqipëria si shtet nuk ka marrëdhënie juridiksionale me shtetet e huaja ashtu siç kanë shtetet e BE me njëri-tjetrin. Madje edhe vetë shtetet anëtare të BE nuk janë të

detyruara të zbatojnë këto rregullore, kur çështjet me element të huaj përfshijnë shtete jashtë BE.

6. Në kushtet kur rregulloret e BE nuk kanë asnjë fuqi juridike zbatuese në Shqipëri dhe për më tepër as mund të përdoren si bazë për marrëdhëniet juridiksionale me shtete jashtë BE, Kolegji mbetet të interpretonte ligjin vendas dhe Konventën e Hagës në përputhje kjo me konventa të tjera të Hagës që veprojnë në fushën e së drejtës familjare siç janë: “Për divorcin” “Për detyrimin për ushqim”, “Për njohjen e vendimeve të huaja” etj. Në vendimin njësuës këto akte ndërkombëtare nuk kanë marrë vëmendjen e duhur megjithëse janë të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe janë të zbatueshme në të njëjtën fuqi sikurse Konventa e Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”.

7. Rregulli bazë i pranuar nga Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut është garantimi i aksesit në drejtësi. Nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor përbën cenimin më flagrant të kësaj të drejte pasi faktikisht sjell mohimin e ushtrimit e saj. Ndalimi i ushtrimit të një të drejte duhet të bëhet në mënyrë të qartë vetëm me ligj, në përputhje kjo me parimin se “çfarë nuk ndalohet nga ligji, lejohet”. Duke qenë se Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës qëndron në shkallë hierarkike madje mbi Kushtetutën në mbrojtje të të drejtave të njeriut atëherë jo vetëm ligjet e brendshme por edhe Konventat e tjera ndërkombëtare duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që të mos cenojnë standardin e të drejtave të njohura në këtë të fundit. Në kuptim të nenit 122 të Kushtetutës, Konventat ndërkombëtare duhet të zbatohen në mënyrë prioritare mbi ligjin vendas vetëm kur ato njohin të drejta më pozitive për palët se ligji vendas ose marrëveshjet e tjera ndërkombëtare. Nëse ligji vendas lejon aksesin në gjykatë për shtetasit shqiptar që jetojnë jashtë shtetit për çështje familjare në një shkallë më të lartë se një konventë ndërkombëtare, atëherë kjo konventë nuk duhet të zbatohen apriori në sensin kufizues të kësaj të drejte, për më tepër kur asnjë nga palët nuk ka kundërshtim për juridiksionin e gjykatave shqiptare për gjykimin e çështjeve dhe madje kur asnjë prej palëve nuk pretendon se ka ushtruar në mënyrë të njëkohshme të drejtën e saj për t'iu drejtuar juridiksionit të huaj për të njëjtën çështje.



8. Nisur nga kuadri ligjor material dhe procedural i ndryshëm, që kanë shtetet e huaja, nuk mund të thuhet se e drejta e aksesit në drejtësi për çështje, që kanë të bëjnë me jetën familjare i garantohet shtetasve shqiptar që jetojnë jashtë vendit nga gjykatat e huaja sikurse arsyeton shumica. Për të arritur në një konkluzion të tillë pikë së pari duhet të bëhet një studim global i legjislacioneve të shteteve të huaja në përgjithësi dhe për më tepër në çdo rast konkret që paraqitet para gjykata shqiptare pasi në çështjet e së drejtës familjare shteteve i është lënë një marzh më i gjerë vlerësimi e rregullimi ligjor në mbështetje të ruajtjes e zhvillimit të kulturës së tyre tradicionale e familjes në raport me vendet e tjera. Nisur nga ky këndvështrim shumica nuk mund të mbante në vëmendje si stendat krahasimi vetëm rregullimet ligjore në vendet e BE për garantimin e të drejtave të shtetasve shqiptar për akses në drejtësi në këto vende, por gjithë vendet anëtare të Konventës së Hagës. Gjithashtu duhet të mbahen në konsideratë edhe mënyra se si këto vende ose dhe vendet anëtare të BE trajtonin juridiksionin ndërkombëtar për çështje të së drejtës familjare të shtetasve të tyre që jetonin jashtë vendeve të BE. Në vendimin njësuës nuk gjendet ndonjë praktikë të tillë.

9. Aksesit në drejtësi nuk ka të bëjë vetëm me njohjen e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe me mënyrën e realizimit të saj, duke u nisur që nga shpenzimet gjyqësore, të përfaqësimit me avokat, gjendjen ekonomike të palëve, faktin nëse legjislacioni i huaj krijon të njëjtat garanci për procedurën e gjyqimit e çështjet e shtruara si në Shqipëri, aftësitë gjuhësore të palëve për të marr pjesë në mënyrë efektive në proces etj. Të gjitha këto rrethana tregojnë se aksesit në drejtësi nuk mund të përketet vetëm në një të drejtë procedurale për t'iu drejtuar gjykatës por ka të bëjë me një sërë elementësh pa të cilat kjo e drejtë do të mbetej formale, për shkak të rëndësive ekonomike ose procedurale, që mund të krijonte për palët. Duke qenë se shtetasit shqiptar përgjithësisht në shumicën e rasteve kane statusin e emigrantëve në shtetet e huaja, ku ata qëndrojnë dhe këto shtete kanë legjislacione të ndryshme lidhur me realizimin e proceseve të zgjidhjes së martesës ose të kërtimeve të tjera, atëherë është e drejta e tyre që të përzgjedhin juridiksionin gjyqësor që i afroh një akses sa më real në ushtrimin objektiv të të drejtave për pjesëmarrje në gjykim, për aq kohë sa kriteri 'vendqëndrimi' nuk

përbën një juridiksion ekskluziv që përjashton aplikimin e kriterit shtetësi për përcaktimin e juridiksionit të gjyqimit të këtyre çështjeve.

10. Në rastin konkret në gjithë qëndrimin e mbajtur shumica jo vetëm ka interpretuar në mënyrë të gabuar si dispozitat konventore dhe ato ligjore, por ka cenuar të drejtat e shtetasve shqiptar për akses në juridiksionin gjyqësor shqiptar. Madje mënyra e formulimit në sentencat njësuës cenon të drejtat për akses në drejtësi, për çështjen e zgjidhjes së martesës, sidomos për ata bashkëshortë, që kanë vendqëndrimin e zakonshëm në Shqipëri e jetojnë të veçuar nga pjesa tjetër e familjes, vetëm për faktin se fëmijët e tyre të mitur jetojnë jashtë shtetit me bashkëshortin tjetër ose me një person tjetër kujdestar. Gjithashtu shumica nuk ka mbajtur në konsideratë dhe as ka lënë ndonjë hapësirë për zbatimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare edhe në rastet kur shtetasit shqiptar jetojnë në vende të ndryshme, duke sjellë kështu një rëndese të shtuar për këta shtetas që të detyrohen të realizojnë procedurat gjyqësore në vendin ku ndodhet prindi që jeton me fëmijën, megjithëse ata mund të kenë asnjë lidhje me atë shtet, madje asnjë mundësi reale të sigurojnë akses në atë shtet për shkak të kufizimit të lëvizjes, gjuhës etj. Vendosija e kriterëve kumulative "marrëveshje dhe interes i fëmijës", për akses në drejtësi për shtetasit shqiptar që jetojnë në Shqipëri ose në një vend të ndryshëm nga ai i vendqëndrimit të fëmijës, kufizon të drejtën e tyre për të realizuar procedurat e zgjidhjes së martesës në vendin e shtetësisë, duke cenuar të drejtën e tyre për jetën private, megjithëse mund të mos kenë asnjë pretendim për të cenuar në rrugë gjyqësore gjendjen faktike të jetesës së fëmijës në shtetin e huaj.

11. Mënyra e interpretimit të Konventës së Hagës nga shumica përbën një barrë të rënduar për bashkëshortët e prindërit duke i shndërruar ata nga mbajtës së së drejtës për zgjedhje të jetës private dhe të të drejtave kushtetute prindërore mbi fëmijët, në përputhje me nenin 8 të Konventës së të drejtave të njeriut, në subjekte vetëm të detyruar e të zhveshur nga e drejta e vlerësimit paraprak të "interesit të fëmijëve" për qasje në drejtësi, që sigurisht më pas vlerësohet edhe nga gjykata. Përgjegjësia prindërore përbëhet nga një gamë e madhe të drejtash e detyrimesh e prindërit konsiderohen mbrojtësit e të drejtave të fëmijëve. Gjykata në mënyrën e rregullimit të përgjegjësisë prindërore dhe në identifikimin e interesit të fëmijëve mban në



konsideratë edhe marrëveshjen ose sjelljen e prindërve. Mbi këtë bazë si rregull qasja e tyre në drejtësi për çështjet familjare prezumon ekzistencën e njëkohshme edhe të interesit të fëmijës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që kanë të bëjnë me përgjegjësinë prindërore, detyrimin për ushqim etj. pasi janë ata që përballojnë rritjen e edukimin e tyre. Nëpërmjet sentencave njësuere kolegji ka rrëzuar këtë prezumim duke bërë që “interesi i fëmijëve” të shihet i ndarë nga e drejta prindërore, madje të përbëjë një kriter që kufizon edhe të drejtën e bashkëshortëve për të kërkuar zgjidhjen e martesës në vendin e shtetësisë së tyre vetëm për faktin se ata janë bërë prindër.

12. Gjithashtu nga shumica nuk është mbajtur në konsideratë qëllim i miratimit të Konventës “Për juridiksionin e ligjin e zbatueshëm për përgjegjësinë prindërore e masat e mbrojtjes së fëmijëve” e cila ka të bëjë me sigurimin e marrjen e masave mbrojtëse ndaj fëmijëve dhe pasurisë së tyre duke mbajtur në konsideratë detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve gjatë ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose institucionet e tjera të përkujdesjes ndaj fëmijëve. Qëllimi mbrojtës i saj ka shërbyer si shkak për të pranuar juridiksionin e shtetit të vendqëndrimit të fëmijës duke i ardhur në ndihmë këtij të fundit për të realizuar të gjitha të drejtat e tij në një kohë sa më të shpejtë. Pikërisht Konventa i ka konsideruar vendimet e marra në favor të fëmijëve si masa mbrojtëse dhe jo si disponime, që rregullojnë në mënyrë përfundimtare marrëdhëniet prind fëmijë. Një gjë e tillë del e qartë dhe nga 14 i Konventës sipas së cilës masat e marra sipas neneve 5-10 të Konventës qëndrojnë në fuqi sipas afateve të tyre megjithëse mund të kenë ndryshuar rrethanat mbi bazën e së cilës është ngritur juridiksioni, për sa kohë që autoritetet që kanë juridiksion nuk kanë ndryshuar këto masa. Në konsideratë të këtyre parashikimeve kuptohet se masat mbrojtëse sipas kësaj konvente në fakt janë pjesërisht të ngjashme me masat e mbrojtjes që sipas legjislacionit tonë të brendshëm vendosen nëpërmjet urdhrave të mbrojtës sipas ligjit “Për marrjen e masave të mbrojtjes në marrëdhëniet familjare”. Si të tilla ato nuk mund të barazohen me rregullimin në mënyrë përfundimtare të marrëdhënieve prind fëmijë të parashikuara nga neni 4 i saj dhe nuk mund të përjashtojnë juridiksionin e gjykatës së vendit të shtetësisë për rregullimin e këtyre marrëdhënieve, për më tepër kur ky juridiksion garanton në mënyrë

të barabartë qasjet më të mirë të të gjitha palëve në drejtësi.

Lidhur me pyetjen e parë:

13. Lidhur me këtë çështje shumica në vendimin njësuere ka bërë mbajtur një stendat të dyfishtë në mënyrën se si e interpreton fuqinë e konventës së Hagës në raport me ligjin vendas. Kështu shumica referon si ligj të zbatueshëm Kodin e Familjes dhe mbi bazën e tij njësos se kërkimi i zgjidhjes së martesës duhet të shqyrtohet detyrimisht në mënyrë të përbashkët e të njëkohshme me atë të rregullimit të pasojave, pasi ligji shqiptar nuk njeh shqyrtimin e veçante të tyre, pra të zgjidhjes së martesës nga kërkimet për rregullimin e pasojave. Këtu Kolegji i jep prioriteti ligjit shqiptar. *Po si e trajton Konventa këtë çështje, meqenëse shumica e konsideron atë si aktin me fuqi më të lartë sipas neneve 116 e 122 të Kushtetutës?* Në nenin 10 të Konventës pranohet se masat mbrojtëse, ku përfshihet edhe përgjegjësia prindërore, parashikohet se gjykohen nga gjykata e zgjidhjes së martesës, kur plotësohen disa kushte. Po ashtu parashikohet se ky juridiksion përfundon kur mbaron gjykimi i zgjidhjes së martesës qoftë edhe pa u shprehur për to. Gjithashtu edhe sipas rregulloreve të BE juridiksioni i gjykimit për përgjegjësinë prindërore trajtohet në mënyrë të ndarë nga ai i zgjidhjes së martesës. Kjo do të thotë se Konventa dhe aktet, që referon shumica si bazë interpretimi në favor të juridiksionit të gjykatave të vendqëndrimit të të miturit, pranojnë një gjykim të mëvetshëm të zgjidhjes së martesës nga ato të kërtimeve të rregullimit të pasojave mbi fëmijët. Pra konventa njeh gjykimin në mënyrë të veçuar të padisë së zgjidhjes së martesës nga kërkimet e rregullimit të pasojave. Ky standard konventor nuk pranohet nga shumica duke i dhënë prioritet ligjit shqiptar për gjykimin e përbashkët të këtyre çështjeve. Në këtë rast shumica e ka shmangur nga zbatimi nenin 122 të Kushtetutës megjithëse e ka përdorur atë si bazë për zbatimin e Konventës mbi ligjin “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

14. Ndërkohë mban një qasje të kundërt lidhur me mënyrën e zbatimit të kriterëve të vendosura nga Konventa e nga ligji vendas për gjykimin e përbashkët të kërtimeve me objekt zgjidhje e martesës e rregullimin e pasojave. Këtu shumica nuk merr në konsideratë parashikimet ligjore të nenit 75 të ligjit nr. 10428/2011 që i japin juridiksion gjykata shqiptare për shqyrtimin e njëkohshëm të të dyja këtyre kërtimeve kur palët ndërgjyqëse janë shtetas



shqiptar, por pranon juridiksionin e gjykatave të huaja duke marrë për bazë disa dispozita të Konventës që rregullojnë juridiksionin e masave të mbrojtjes dhe duke e shtrirë zbatueshmërinë e tyre edhe për juridiksionin e zgjidhjes së martesës, megjithëse konventa nuk e parashikon një gjë të tillë. Madje që në titull të saj del e qartë se ajo nuk ka si qëllim të rregullojë juridiksionin e gjykimit të çështjeve me objekt zgjidhje martese. Kjo tregon se standardi se si është aplikuar konventa në raport me ligjin vendas në të dyja rastet e shtruara për diskutim si më sipër është i ndryshëm, gjë që tregon se shumica nuk ka ruajtur një zbatim uniformë të parimit të hierarkisë së normave sipas nenit 122 të Kushtetutës.

15. Kolegji civil (shumica) ka vendosur të njësojë praktikën gjyqësore se gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për gjykimin e çështjeve të zgjidhje martese kur të miturit që kanë ardhur në jetë nga martesa kanë vendqëndrimin jashtë shtetit, me përjashtim të rastit kur gjykata do të vlerësojë se gjykimi nga gjykatat shqiptare është në interes të të miturit. Në marrjen e këtij vendimi kolegji i është referuar elementit të huaj “vendqëndrimin e zakonshëm” të fëmijës në shtetin e huaj sipas ligjit nr. 10428/2011 e Konventës “*Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve*”. Sipas shumicës elementi i huaj “vendqëndrim i fëmijës” i jep ekskluzivitet juridiksionit të gjykatës së vendit të huaj, ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm për gjykimin e çështjes me objekt zgjidhje martese e rregullim i pasojave mbi fëmijën e lindur nga martesa.

16. Për mendimin tonë ky qëndrim vjen në kundërshtim me kriteret ligjore përcaktuese të juridiksionit dhe objektin e gjykimit në çështjen konkrete. Shumica e ka konsideruar juridiksionin gjyqësor të kërimit mbi mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore si një juridiksion ekskluziv të përcaktuar nga vendqëndrimi i të miturit. Ky qëndrim bie ndesh me të gjithë normat që rregullojnë të drejtën ndërkombëtare private në këtë fushë. Rastet e juridiksionit ekskluziv janë të përcaktuara në nenin 72 të ligjit nr. 10428/2011 dhe në nenin 5 të Konventës “*Për njohjen e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare*” duke e lidhur këtë kryesisht me çështje të së drejtës së përdorimit ose të të drejtave reale mbi pasuri të paluajtshme. Duke iu referuar këtyre dispozitave del se çështjet mbi

përgjegjësinë prindërore, ose të kujdestarisë mbi të miturit nuk përfshihen në rastet e juridiksionit ekskluziv.

17. Gjithashtu edhe sipas Konventës “*Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve*” nuk përcaktohet nëse një gjykatë ka juridiksion ekskluziv për shqyrtimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve në raport me një gjykatë tjetër. Në këtë konventë përcaktohen një sërë rregullash, të cilat individualizojnë juridiksionin e shqyrtimit të çështjes në varësi jo vetëm të kriterit “banesë e përhershme ose e zakonshme e fëmijës”, por edhe të zhvendosjes së tij si emigrant në një shtet tjetër, si dhe të natyrës së objektit të gjykimit. Madje, kjo konventë njeh institutin e transferimit të juridiksionit ose atë të përthithjes së juridiksioneve nga gjykata që gjykon zgjidhjen e martesës, institute që nuk vepron në rastet e një juridiksioni ekskluziv ndërkombëtar të një gjykate në raport me gjykatën e një vendi tjetër.

18. Çështja në gjykim rezulton se ka për objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave, që vijnë prej saj, ku përfshihet edhe mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për fëmijët e lindur nga martesa, detyrimi për ushqim etj. Në rastin konkret kolegji (shumica) ka konsideruar si kriter përcaktues relevant për çështjen “vendqëndrimin e fëmijës” duke e shtrirë zbatimin e këtij kriteri edhe për çështjen me objekt zgjidhje martese, ku rregullimi i marrëdhënieve prind -fëmijë qëndron si objekt dytësor , pra pasojë në raport me atë të zgjidhjes së martesës. Kolegji nuk ka përcaktuar se në cilin akt ligjor apo akt ndërkombëtar është bazuar në arritjen e një konkluzioni të tillë, por e nxjerr këtë konkluzion mbi interpretimin e interesit më të lartë të fëmijës si një konsideratë parësore që sipas saj është aq i rëndësishëm sa pengon zgjidhjen e martesës midis prindërve. Ky konkluzion bie ndesh me ligjin e aktet ndërkombëtare ku referon Kolegji.

19. Konventa “*Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve*”, ku bazohet gjykata e shkallës së parë dhe shumica për të përcaktuar juridiksionin e gjykatës së huaj nuk rregullon juridiksionin mbi çështjet me objekt zgjidhje martese. Përkundrazi kjo konventë përcakton qartë se shteti, që shqyrton kërkesën për divorc ka juridiksion **për masat mbrojtje** për fëmijën, pasi në nenin 10 të saj parashikohet



shprehimisht se; Pa asnjë paragjykim në lidhje me dispozitat e neneve 5-9, autoritetet e një Shteti Kontraktues, që ushtrojnë juridiksionin për të vendosur në lidhje me një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të një fëmijë që është banor i përhershëm në një Shtet tjetër Kontraktues ose për anulimin e martesës së tyre, nëse e parashikon ligji i shtetit të tyre, mund të marrin masa për mbrojtjen e fëmijës apo të pasurisë së tij, në rast e parashikuara nga neni 10. Pra, kjo konventë jo vetëm që nuk i jep prioritet juridiksionit të vendit, ku ka vendqëndrimin fëmija apo kërkohen masat mbrojtëse për fëmijën në raport me atë të juridiksionit të vendit, që shqyrton padinë e zgjidhjes së martesës, sikurse arsyeton Kolegji, por përkundrazi njeh e pranon të kundërtën.

20. Konkluzioni i mësipërm i Kolegjit gjen mbështetje dhe në nenin 13 të Konventës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”. Kështu kjo dispozitë parashikon se Autoritetet e një Shteti Kontraktues, të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5 deri në 10 për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së fëmijës, duhet të frenohen nga ushtrimi i këtij juridiksioni, nëse, në kohën e fillimit të procedimit, masat korresponduese janë kërkuar nga autoritetet e një Shteti tjetër Kontraktues që ka juridiksion sipas neneve 5-10 në kohën e kërkesës dhe janë akoma në proces shqyrtimi. Kjo dispozitë pengon ushtrimin e juridiksionit të njëkohshëm për marrjen e masave mbrojtëse duke i dhënë prioritet juridiksionit të vendit, ku është paraqitur më parë kërkesa për masat mbrojtëse.

21. Mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, si pasojë e zgjidhjes së martesës nuk mund të kufizojë e as të përjashtojë juridiksionin e gjykatave shqiptare për gjykimin e çështjeve me objekt zgjidhje martesë, pasi një gjë e tillë nuk njihet as nga ligji nr. 10428/2011 dhe as nga Konventa. Zgjidhja e martesës përbën objektin kryesor të padisë si pasojë e së cilës shqyrtohen edhe çështjet e varura prej saj siç është mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, detyrimi për ushqim etj. As në të drejtën procedurale civile shqiptare dhe as në atë ndërkombëtare nuk njihet që juridiksioni ose kompetenca e një çështje dytësore të jetë përcaktuese për kompetencën ose juridiksionin e gjykimit të çështjes kryesore. Përkundrazi, vlen parimi i kundërt, që gjykata kompetente ose juridiksioni i gjykatës për çështjen kryesore përfshin dhe atë të çështjeve dytësore të varura prej kësaj të fundit. Një gjë e tillë është e reflektuar në mënyrë të

shprehur në nenin 75 të ligjit nr. 10428/2011 në të cilit parashikohet se: 1. Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve, që lidhen me martesën kur: a) njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë në kohën e lidhjes së martesës shtetas shqiptar; 3. Juridiksioni, sipas pikës 1 të këtij neni, shtribet edhe mbi pasojat, që vijnë nga zgjidhja, shpallja e pavlefshmërisë së martesës, nga regjimet pasurore martesore, si dhe mbi masat e përkohshme, të cilat merren nga gjykata në këto raste. Referuar këtij parashikimi del se gjykata shqiptare, që ka juridiksion për zgjidhjen e martesës ka juridiksion edhe për rregullimin e pasojave të saj, ku përfshihen edhe ato për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore e detyrimit për ushqim mbi fëmijët etj. Ky përcaktim garanton mbrojtjen *ipso jure* në shkallën më të lartë interesit e fëmijëve, pasi gjykata merr rol aktiv të rregullojë pasojat e zgjidhjes së martesës mbi fëmijët pavarësisht vullnetit të palëve për të kërkuar ose jo një gjë e tillë në mënyrë të shprehur.

22. Duke qenë se zgjidhja e martesës midis prindërve të fëmijës sjell pasoja të padiskutueshme mbi mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore mbi fëmijës, të drejtën e mbajtjes, detyrimit për ushqim, të drejtën e takimit, përcaktimit të vendbanimit të fëmijës, zhvendosjes së tij, procesit të edukimit, ndjekjes mjekësore, përfaqësimit e përpilimit e çdo dokumentacioni në interes të fëmijës etj. ligji shqiptar “Për të drejtën ndërkombëtare private” dhe Konventa e sipërcituar i ka dhënë prioritet shqyrtimit të çështjes me objekt zgjidhje martesë pjesë e së cilës është dhe rregullimi i pasojave të zgjidhjes së martesës duke u gjykuar bashkërisht këto çështje nga gjykata e vendit të juridiksionit të zgjidhjes së martesës, kur ligji i shtetësisë së prindërve e njeh gjykimin e përbashkët të këtyre çështjeve. Disponimi i shumicës për konstatimin e mungesës së juridiksionit si për sa i kërkit për zgjidhjen e martesës dhe atë të rregullimit të pasojave të saj, bie ndesh me parashikimet konventore e ligjore.

23. Sikurse u sipërcitua, në asnjë rast nuk parashikohet mungesa e juridiksionit të gjykatave shqiptare për çështjet e zgjidhjes së martesave midis shtetasve shqiptar, pavarësisht vendit ku ata jetojnë e për më tepër as parashikohet transferimi i këtij juridiksioni një gjykate të huaj mbi bazën e elementit “lidhës” “vendqëndrim i fëmijës”. Elementet lidhës që njohin juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare për gjykimin e çështjes me objekt zgjidhje martesë janë; 1-shtetësia e bashkëshortëve ose 2-



vendqëndrimi i tyre. Ky i fundit vepron për çështjet me objekt zgjidhje martesë kur bashkëshortët nuk kanë shtetësinë shqiptare. Në kushtet, kur bashkëshortët kanë shtetësinë shqiptare gjykata shqiptare ka juridiksion të padiskutueshëm për të shqyrtuar çështjen e zgjidhjes së martesës, pavarësisht vendqëndrimit të tyre.

24. Ligji nr. 10428/2011 nuk përcakton si element të huaj lidhës “vendqëndrimin e fëmijës” për përcaktimin e juridiksionit mbi çështjet me objekt zgjidhje martesë, ku referon Kolegji. Në këtë mënyrë shumica nëpërmjet vendimit njësoes kanë krijuar një kriter të ri për juridiksionin e gjykimit të çështjeve me objekt zgjidhje martesë megjithëse një kriter i tillë nuk është i parashikuar as nga ligji dhe as nga Konventa. Si ligji shqiptar “Për të drejtën ndërkombëtare private” ashtu edhe Konventa *”Për Juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”* nuk e njeh ekskluzivitetin e prioritetin e juridiksionit të çështjeve mbi përgjegjësinë prindërore në raport me atë të zgjidhjes së martesës pjesë e së cilës janë edhe rregullimi i përgjegjësisë si pasojë e zgjidhjes së martesës dhe as mbi detyrimin për ushqim. Përkundrazi këto akte njohin prioritetin juridiksional të gjykatave që shqyrtojnë çështjet e zgjidhjes së martesës edhe mbi pasojat e saj, ose parashikojnë në mënyrë të posaçme rregullat për përcaktimin e juridiksionit për çështjet e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore kur këto të fundit paraqiten si kërtime kryesore. Në rastin konkret nuk gjejnë zbatim këto të fundit, pasi kërkimet për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore vijnë si pasojë e zgjidhjes së martesës dhe juridiksioni i shqyrtimit të tyre përthithet nga gjykata e juridiksionit të zgjidhjes së martesës, dhe jo e kundërta sikurse arsyeton shumica.

25. Gjykata shqiptare para se të nxjerr një çështje jashtë juridiksionit duhet të verifikojnë jo vetëm faktin nëse gjykata shqiptare ka apo jo juridiksion për çështjen, por edhe faktin nëse vendimi, që mund të jepet nga gjykata e huaj do të jetë apo jo i ekzekutueshëm në Shqipëri. Nëse një vendim i tillë do të jetë objekt ekzekutimi në Shqipëri qoftë pjesërisht apo tërësisht atëherë gjykatat shqiptare duhet të kenë normalisht juridiksion për të gjykuar çështjen në themel. Një konkluzion i tillë rrjedh nga neni 38 dhe 394 i KPC-së. Në përputhje me nenin 38 të KPC-së parashikohet si rast i pushimit të

gjykimit rrethana kur një mosmarrëveshje është zgjidhur me vendim të formës së prerë të gjykatës së huaj që mund të njihet në Shqipëri. Nga ana tjetër gjykata e Apelit refuzon njohjen e vendimit të huaj në rastet kur juridiksioni i shqyrtimit të çështjes i përkiste gjykatave shqiptare ose ishte dhënë një vendim tjetër për të njëjtën mosmarrëveshje në Shqipëri. Njohja e një vendimi të huaj bëhet me qëllim që vendimi të krijojë efekte zbatuese në Republikën e Shqipërisë sipas nenit 393 të KPC-së. Duke i parë të lidhura ngushtë këto dispozita me njëra-tjetrën, për atë kohë sa vendimi i zgjidhjes së mosmarrëveshjes, qoftë kjo zgjidhje martesë e rregullim i pasojave, është i ekzekutueshëm në Shqipëri, atëherë gjykatat shqiptare normalisht kanë juridiksion ndërkombëtar për shqyrtimin një çështje gjyqësore, që mund të jetë objekt kërkitimi për njohje, me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

26. Në çështjen konkrete, objekti i gjykimit është zgjidhja e martesës dhe rregullimi i pasojave të saj. Shumica nuk ka mbajtur në konsideratë konventën e posaçme të miratuar nga Shqipëria lidhur me divorcet, megjithëse ajo ka të njëjtën fuqi hierarkike si ajo e Hagës” Për juridiksionin e ligjin e zbatueshëm...”. Sipas nenit 1 të Konventës: “Për njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore”, ku Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 109/2012 parashikohet se *ky konventë zbatohet për njohjen në një shtet kontraktues të divorceve dhe ndarjeve ligjore të marra në një shtet tjetër kontraktues, të cilat ndjekin procedurat gjyqësore ose të tjera të njohura zyrtarisht dhe që janë ligjërish në fuqi në këtë shtet*. Në ligjin nr. 109/2012 me të cilin Shqipëria ka aderuar në këtë Konventë, konkretisht në nenin 1 të ligjit nr. 109/2012 përcaktohet, se: “Në kontekst të konventës, termi “divorc” ka të njëjtin kuptim me termin “zgjidhje e martesës”, të parashikuar në ligjin shqiptar.” Ky përcaktim identifikon jo vetëm kuptimin e termit “divorc” të Konventës, por konkretizon institutin për të cilin do të gjej zbatim Konventa në Shqipëri, duke referuar për këtë qëllim te ligji shqiptar. Në këtë mënyrë Konventa e posaçme “Për divorcet” jo vetëm nuk përjashton zbatimin e ligjit të brendshëm, por që në momentin e aderimit Republika e Shqipërisë i ka dhënë prioritet këtij ligji duke përcaktuar llojin e institutit për të cilin do të gjej zbatim konventa, që është zgjidhja e martesës sipas parashikimit të ligjit shqiptar. Gjithashtu në këtë konventë parashikohet se; *Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 19 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të refuzojë njohjen e një*



divorci ose të një ndarjeje ligjore ndërmjet dy bashkëshortëve, të cilët, në kohën e divorcit ose të ndarjes ligjore, kanë qenë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe të asnjë shteti tjetër, në rast se është aplikuar një ligj i ndryshëm nga ligji që referon legjislacioni shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private, përveçse kur rezultati i arritur është i njëjtë me atë që është arritur duke zbatuar ligjin e referuar prej tij. Ndërsa në nenin 4 të Konventës përcaktohet se “Në përputhje me nenin 21 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën për të refuzuar njohjen e një ndarjeje ligjore kur, në kohën që ajo është marrë, njëri nga bashkëshortët ishte shtetas shqiptar ose i një shteti kontraktues, ligji i të cilit nuk e parashikonte ndarjen ligjore.”. Pra Shqipëria ka bërë rezervë për mosnjohjen e ndarjeve ligjore (vendime të marra jashtë procedurave gjyqësore të zgjidhjes së martesës) të dhëna në shtetet e tjera kontraktuese të konventës, ndaj shtetasve shqiptar. Në unitet të parashikimeve të kësaj konvente rezulton se shteti shqiptar jo vetëm ka bërë rezervë për njohjen e ndarjeve ligjore, por edhe për njohjen e atyre vendimeve gjyqësore, të cilat nuk janë bazuar në ligjin shqiptar “Për të drejtën ndërkombëtare private”, me disa përjashtime. Megjithëse, kjo konventë ka të bëjë me njohjen e vendimit për zgjidhjet e martesës të dhëna nga gjykatat e huaja nëpërmjet saj kuptohet se Shqipëria jo vetëm ka ruajtur juridiksionin e saj për gjykimin e çështjeve për zgjidhjen e martesës midis shtetasve shqiptar pavarësisht vendit ku ata qëndrojnë, pasi nuk njih vendimet e dhëna nga gjykatat e huaja kur shtetasve shqiptar nuk i garantohen të njëjtat të drejta si në ligjin shqiptar, por ka bërë rezervë kundër njohjeve të ndarjeve ligjore, pra ato që nuk konsiderohen divorce ose zgjidhje martesë. **Nisur nga këto rezerva del se gjykatat shqiptare kanë juridiksion të padiskutueshëm për zgjidhjen e martesës midis shtetasve shqiptar ose kur edhe një prej bashkëshortëve është shtetas shqiptar, pavarësisht vendit ku ato jetojnë.**

27. Duke mbajtur në konsideratë lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptar jashtë shtetit, qëndrimin e tyre në vende të ndryshme, faktin se këto të fundit mund të pranojnë ose jo divorcin sipas ligjeve të tyre, ose parashikojnë procedura veçimi ose ndarje ligjore që nuk njihen në Shqipëri, atëherë marrja e vendimeve nga gjykatat shqiptare për nxjerrjen jashtë juridiksionit të çështjes me objekt zgjidhje martesë midis shtetasve shqiptar do të cenonte në thelb të drejtën e shtetasve jo vetëm për akses në drejtësi dhe

parimin kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit, por dhe të drejtën për jetë private pasi do të ishin në pamundësi të realizonin të njëjtat të drejta në vendin tjetër. Shtetasit shqiptar, që jetojnë jashtë shtetit gëzojnë të njëjtat të drejta për akses në gjykatat shqiptare sikurse edhe ata, që jetojnë në Shqipëri për çështje, që ka lidhje me mosmarrëveshje midis tyre, një prej të cilave është dhe zgjidhja e martesës e rregullimi i pasojave të saj.

28. Veç sa më sipër, nxjerrja jashtë juridiksionin e çështjes me objekt zgjidhje martesë do i vinte në pamundësi shtetasit shqiptar që të ngrenë padi rishtazi në vendin e tyre, kur një gjë e tillë i refuzohej nga juridiksioni i huaj ose në rast se legjislacioni i huaj nuk e njeh institutin e zgjidhjes e martesës, ose ai ka vendosur “ndarje ligjore” (p.sh. zgjidhje martesë te noteri ose zyrtar e gjendjes civile), e cila nuk njihet si institut në Shqipëri. Një situatë e tillë do i detyronte shtetasit shqiptar të bënin disa procese gjyqësore si atë të zgjidhjes së martesës në vendin e huaj dhe në Shqipëri për njohjen e vendimit, pa vënë në diskutim këtu situatat penguese që vetë shtetasi shqiptar mund të ketë për paraqitjen e padisë në çdo vend të botës, ku mund të ndodhet fëmija ndërkohë që ai personalisht jeton në një vend tjetër apo jeton në Shqipëri dhe mund të mos ketë vizë-leje për lëvizje ose mundësi ekonomike të përballojë shpenzimet gjyqësore në këto vende, në raport me lehtësitë që i afon shteti i tij.

29. Mënyra e formulimit të sentencës njëseuse ashtu edhe arsyetimi i shumicës cenon për më tepër të drejtën për akses në drejtësi për bashkëshortin shqiptar që ka vendqëndrimin në Shqipëri duke e detyruar këtë të fundit të ngrejë padi për zgjidhjen e martesës në vendin e huaj, ku jeton fëmija me bashkëshortin tjetër ose të kushtëzohet në ngritjen e padisë para gjykatës shqiptare nga dakordësia e prindit tjetër dhe për më tepër nga vlerësimi nëse gjykata do ta gjej vetëm juridiksionale për të vlerësuar kriterin “interes i fëmijës”. Një gjë e tillë cenon në mënyrë thelbësore të drejtën e aksesit në drejtësi për këta shtetas pasi megjithëse jetojnë në Shqipëri ata nuk gëzojnë të njëjtat garanci për akses në gjykatë si shtetasit e tjerë. E për më tepër ata mund të jenë në pamundësi për të ushtruar të njëjtën të drejtë në shtetin e huaj jo vetëm për shkak të kufizimeve në regjimin e vizave, kohës së qëndrimit, gjuhës, shpenzimeve etj.

30. Nisur nga të drejtat, që gëzojnë shtetasit shqiptar me Kushtetutë, parashikimi i juridiksionit



shqiptar për gjykimin e çështjes së kësaj kategorie, ndalimi i transferimit të juridiksionit të huaj për çështje në juridiksionin e gjykatave shqiptare, kolegji nuk duhet të kishte njëzuar nxjerrjen e këtyre çështjeve jashtë juridiksionit duke vendosur si kritere përjashtuese dakordësinë e bashkëshortëve e interesin e fëmijës. Kodi i Familjes dhe Konventat e Divorcit ose ajo e Juridiksionit të sipërcituar nuk kushtëzon juridiksionin e gjykimit të zgjidhjes së martesës e rregullimit të pasojave mbi këto kritere. Për më tepër, çështja e interesit të fëmijës është një gjendje fakti, vlerësimi i së cilës nuk pengohet të realizohet në të njëjtat kushte nga gjykata e gjykimit të zgjidhjes së martesës ashtu si dhe nga gjykata e huaj, pasi gjykatat shqiptare kanë të gjitha mundësitë ligjore e procedurale të sigurojnë marrjen e vlerësimin e çdo lloj prove të lëshuar nga vendi i huaj qoftë nëpërmjet paraqitjes nga palët ashtu edhe nëpërmjet letërporosive.

31. Transferimi i juridiksionit të gjykatave shqiptare një gjykatë të huaj është parashikuar në nenin 37 të Kodit të Procedurës Civile i cili citon; *Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.* Komponenti “I huaj”, si shkak për transferimin e juridiksionit ka të bëjë kryesisht me dy element; a) shtetësia ose b) vendqëndrimi dhe c-në raste përjashtimore me parashikimet e marrëveshjeve ndërkombëtare.

32. Sipas nenit 1 parag. 2 i ligjit nr. 10428/2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” *“Elementi i huaj”, për qëllime të zbatimit të këtij ligji, nënkupton çdo rrethanë juridike që lidhet me subjektin, përmbajtjen ose objektin e një marrëdhënieje juridiko-civile dhe që bëhet shkak për lidhjen e kësaj marrëdhënieje me një sistem ligjor të caktuar. Nga kjo dispozitë konstatohet se elementi i huaj vendqëndrimin të fëmijës nuk ka relevancë për të përjashtuar juridiksionin e gjykatës shqiptare në gjykimin e kërtimeve për mënyrën e ushtrimit e përgjegjësisë prindërore dhe detyrimin për ushqim si pasojë e zgjidhjes së martesës. Palët ndërgjyqëse dhe fëmija janë me shtetësi shqiptare. Vendbanimet zyrtare sipas akteve të dosjes janë në Shqipëri, (E), pavarësisht vendqëndrimit të palëve, i cili në këtë rast nuk ka relevancë për të ndryshuar*

juridiksionin, pasi ligji është shumë i qartë se në cilin rast ‘element i huaj’ çon në nxjerrjen jashtë juridiksioni të gjykatave shqiptare. Sipas nenit 75/3 të ligjit 10428/2011 gjykata shqiptare që ka juridiksion për të shqyrtuar padinë e zgjidhjes së martesës ka juridiksion edhe për të shqyrtuar pasojat e saj.

33. Gjithashtu juridiksioni i gjykatave shqiptare për marrëdhëniet prind-fëmijë dhe detyrimin për ushqim veç nenit 75/3 të sipërcituar bazohet edhe në nenin 76 të ligjit nr. 10428/2011, ku parashikohet se *Gjykatat shqiptare kanë juridiksion të gjykojnë çështjet, që lidhen me të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga martesa midis prindërve dhe fëmijëve, njohjen apo kundërshtimin e atësisë dhe të amësisë, kur njëra nga palët ka shtetësinë shqiptare ose ka vendqëndrimin e saj në Republikën e Shqipërisë.* Pra, në unitet të të gjitha dispozitave ligjore kuptohet se gjykata shqiptare ka juridiksion si për zgjidhjen e martesës ashtu edhe për rregullimin e pasojave të saj si mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe detyrimi për ushqim.

34. Konventa e Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” nuk gjen zbatim për detyrimin për ushqim. Duke qenë se kërkitimi për zgjidhjen e martesës shoqërohet edhe me shqyrtimin e pasojave për përgjegjësinë prindërore e detyrimin për ushqim, atëherë elementi përgjegjësi prindërore nuk mund të ketë asnjë vlerë mbizotëruese për përcaktimin e juridiksionit në raport me kërkesën kryesore të zgjidhjes së martesës dhe të pasojës tjetër detyrim për ushqim. Për më tepër sipas Konventës së Hagës kjo çështje nuk i përket në mënyrë ekskluzive për gjykim vetëm gjykatës së vendqëndrimit të të miturit. Arsyeimi i shumicës se çështja e përgjegjësisë prindërore përfshin edhe detyrimin për ushqim tejkalon parashikimet konventore, pasi vetë Konventa e ka kufizuar zbatimin e saj mbi këtë kërkim në nenin 4 të saj.

35. Në përputhje me nenin 37 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 116 të Kushtetutës, gjykatat shqiptare kanë të drejtë të zbatojnë drejtpërdrejtë marrëveshjet ndërkombëtare, pasi ato konsiderohet pjesë e legjislacionit të brendshëm. Pakica vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka kuptuar e zbatuar drejtë rregullat për përcaktimin e juridiksionin të parashikuara nga Konventa “Për juridiksionin e ligjin e zbatueshëm, njohjen zbatimin e bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat



e mbrojtjes së fëmijëve”. Kështu, në zbatim të nenit 5 dhe 6 të Konventës juridiksioni për të vendosur marrjen e masave të mbrojtjes së fëmijës dhe pasurisë së tij i përket vendqëndrimit të fëmijës dhe nëse është emigrant ose zhvendosur për shkak të problemeve të vendit të tij, në një vend tjetër, atëherë juridiksioni i përket vendit ku ndodhet fëmija. Ndërsa nenet 8 e 9 të Konventës rregullojnë rastet kur shteti i divorcit nuk ka juridiksion për të vendosur për fëmijët, por i përcillet ky juridiksion nga autoriteti i shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës. Në rastin konkret, mungon kjo situatë pasi gjykata shqiptare ka juridiksion për të vendosur si për zgjidhjen e martesës edhe për çështjen e marrëdhënieve prind-fëmijë si pasojë e zgjidhjes së martesës. Ky vendim është i ekzekutueshëm në Shqipëri jo vetëm si vendbanimin i përhershëm i prezumuar të prindërve të fëmijës për shkak të shtetësisë shqiptare, por edhe për efekt të mënyrës së regjistrimit të familjes në regjistrat e gjendjes civile pas zgjidhjes së martesës dhe të subjektit që ka të drejtë të realizojë veprimet e zakonshme në interes të fëmijës si plotësimi të çdo dokumentacioni ligjor në interes të fëmijës, siç është ndër të tjera aplikimi për kartë identifikimi, pasaporta pa të cilat ai kufizohet në të drejtën e lëvizjes së tij, kërkesat për lëshimin e autorizimit për prona të paluajtshme në emër të tij etj. Nëse me zgjidhjen e martesës nuk do të rregulloheshin pasojat e saj mbi fëmijët, atëherë të dy prindërit do të prezumoheshin njëkohësisht përgjegjës e përfaqësues të të miturve në çdo rast, gjë që do të vështirësonte veprimet në emër e për llogari të të miturit duke mbajtur në konsideratë mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis prindërve në raste të tilla. Për shkak të lidhjes së ngushtë që ekziston midis kërimit të zgjidhjes së martesës dhe rregullimit të pasojave të saj, gjykata shqiptare ka juridiksion të shqyrtojë të dyja këto çështje.

36. Konventa **“Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”** përcakton qartë se shteti që shqyrton kërkesën për divorc ka juridiksion për masat mbrojtje për fëmijën pasi në nenin 10 të saj parashikohet shprehimisht se; Pa asnjë paragjykim në lidhje me dispozitat e neneve 5-9, autoritetet e një Shteti Kontraktues, që ushtrojnë juridiksionin për të vendosur në lidhje me një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të një fëmije që është banor i përhershëm në një Shtet tjetër Kontraktues ose për anulimin e martesës së tyre, nëse e parashikon ligji i shtetit të tyre, mund të marrin

masa për mbrojtjen e fëmijës apo të pasurisë së tij, nëse: a) në kohën e fillimit të procedimit, njëri nga prindërit e tij ose të saj ka pasur banesë të përhershme në këtë shtet dhe njëri prej tyre ka përgjegjësi ligjore në lidhje me fëmijën; b) juridiksioni i këtyre autoriteteve për të marrë këto masa është pranuar nga prindërit, si dhe nga ndonjë person tjetër i cili ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën dhe kur është në interes të fëmijës. Në përputhje me këtë dispozitë del se shteti kontraktues, që ka juridiksion për të vendosur për divorcin e prindërve ka juridiksion për të marr masa për mbrojtjen e fëmijës nëse e parashikon ligji i shtetit të tyre dhe kur ekzistojnë ndonjë nga kushtet e parashikuara nga pikat “a” ose “b”. Këto të fundit citohen në nenin 10 të Konventës në mënyrë numëruese dhe jokumulative. Udhëzuesi praktik i zbatimit të konventës ku referon shumica nuk mund të zëvendësoj vetë Konventën dhe as interpretimin e saj jashtë kuadrit ligjor të brendshëm përderisa referimi të ligji i brendshëm bëhet nga vetë neni 10 i Konventës. Për me tepër masat mbrojtëse nuk mund të barazohen me pasojat e zgjidhjes së martesës dhe si të tilla nuk mund të kufizojnë juridiksionin e gjykimit për këto të fundit.

37. Kolegji (shumica) i ka vlerësuar se të gjitha këto kushte të parashikuara nga neni 10 duhet të jenë kumulative, gjë që nuk qëndron pasi secila nga pikat a ose b nëse ekziston i jep juridiksion gjykatës, që shqyrton kërkesën për zgjidhjen e martesës për të shqyrtuar edhe masat e mbrojtjes. Një gjë e tillë del më e qartë duke mbajtur në konsideratë si ligjin për të drejtën ndërkombëtare private nr. 10428/2011 neni 73 të tij, ashtu edhe nenet 37 e vijuese të KPC-së, ku pranimi i juridiksionit me marrëveshje të palëve në rastin konkret i prindërve përbën shkak për fitimin e juridiksionit edhe kur nuk parashikohet në ligj. Të njëjtën logjikë ndjek edhe Konventa duke mbajtur në konsideratë se palët e përfshira në mosmarrëveshje ndaj të cilëve vendoset masat mbrojtëse kanë të bëjnë pikërisht me prindërit ose personin, që ushtron një përgjegjësi ndaj fëmijës. I vetmi verifikim i veçantë që bën gjykata është interesi i fëmijës në ato raste kur juridiksioni pranohet nga bashkëshortët, pasi nëse juridiksioni është pranuar nga ligji i shtetit atëherë interesi i fëmijës prezumohet se ekziston. Gjithashtu edhe kriteri i banesës së përhershme i prindit në kohën e ngritjes së padisë në shtetin ku është ngritur padia, është ngushtësisht i lidhur me faktin se vendqëndrimi i jep juridiksion gjykatës për sa kohë masat mbrojtëse kanë lidhje me të dyja palët.



38. Kolegji (shumica) nuk ka mbajtur në konsideratë se parashikimet e nenit 10 të konventës kanë të bëjnë me situatën, kur vendi i shqyrtimit të kërkesës për divorc është i ndryshëm nga vendi, shtetësinë e të cilit kanë prindërit. Që vendi i divorcit të fitojë juridiksion për shqyrtimin e masave të mbrojtjes duhet që ligji i shtetësisë së tyre të parashikoj marrjen e këtyre masave kur ekziston një nga rastet a ose b të nenit 10. Ndërsa në rast se padia e zgjidhjes së martesës është ngritur në vendin shtetësinë e të cilit kanë prindërit dhe fëmija, atëherë shtetësia përbën një kriter, që jep juridiksion për shqyrtimin e përbashkët të zgjidhjes së martesës dhe të pasojave pa qenë e nevojshme të ekzistojë kushti i fitimit të juridiksionit nga kriteri vendqëndrimi i përhershëm i njërit prind në kohën e ngritjes së padisë ose juridiksioni i pranuar me marrëveshje sipas nenit 10/a ose b të Konventës. Një gjë e tillë del edhe nga neni 8 i Konventës, ku kriteri shtetësia e fëmijës konsiderohet si kriter për transferimin e juridiksionit për shqyrtimin e çështjes tek ai shtet sipas nenit 5 e 6 të Konventës në mënyrë të veçantë nga ai i vendit të divorcit. Kjo do të thotë se vetë konventa e konsideron vendin e shtetësisë së të miturit si një juridiksion që krijon të njëjtën pritshmëri për vlerësimin e interesit të të miturit dhe të marrjes së masave mbrojtëse, ashtu si dhe ai i vendqëndrimit. Madje arrin deri atje sa edhe në rast se është paraqitur një çështje për masa mbrojtëse para tij t'i ftoj palët ti paraqesin ato në vendin e shtetësisë.

39. Ligji ynë nr. 10428/2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” parashikon shprehimisht se gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të vendosur jo vetëm për zgjidhjen e martesës, por edhe për pasojat e zgjidhjes së martesës, ku në konsideratë parësore qëndron mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës dhe detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve. Kriteri lidhës që ka prioritet për përcaktimin e juridiksionit në këtë rast është shtetësia shqiptare qoftë edhe e njërit prej bashkëshorteve. Ndërkohë, që vendqëndrimi në kohën e ngritjes së padisë vlen si kriter kur bashkëshortët njëkohësisht edhe prindër të fëmijës nuk janë shtetas shqiptar. Në unitet me këtë parashikim duhen kuptuar edhe parashikimet e nenit 10 të Konventës, që i japin juridiksion gjykatës së divorcit për marrjen e masës mbrojtëse mbi bazën e vendit të qëndrimit të përhershëm të njërit prind, gjë që nuk përjashton por përkundrazi lejon

juridiksionin e shtetit të shtetësisë së prindërve si për të vendosur për zgjidhjen e martesës dhe marrjen e masave mbrojtëse pasi kriteri përcaktues i juridiksionit në këtë rast është shtetësia dhe jo vendqëndrimi ose juridiksioni i pranuar me marrëveshje.

40. Kolegji (shumica) ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit duke interpretuar në mënyrë shumë të ngushtë nenin 5 e 6 të Konventës **“Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”** pa mbajtur në konsideratë jo vetëm kërkimin bazë për zgjidhjen e martesës, por edhe natyrën e pasojave të saj të cilat nuk konsistojnë vetëm në mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore por edhe në përcaktimin e detyrimit për ushqim, pasojë kjo e cila nuk bie nën fushën e zbatimit të kësaj konvente por rregullohet nga Konventa **“Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”**, bërë në Hagë më 23 nëntor 2007 e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 63/2012.

41. Kështu neni 4 i Konventës së Hagës **„Për Juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”** e ka përjashtuar nga fusha e zbatimit të kësaj konvente **“detyrimin për mbajtjen”** që ka të bëjë me pasojën ose kërkimin **“Detyrim për ushqim për fëmijën e mitur”**. Përkthimi që i është bërë konventës lidhur me këtë term ligjor **“maintenance obligations”** në **“detyrimi për mbajtjen”** nuk rezulton të jetë përshtatur me kuptimin e duhur, që ky përcaktim rezulton të ketë në kontekstin ligjor. Duke analizuar në mënyrë sistematike përcaktimet e Konventës së Hagës, nuk rezulton të ketë parashikime në asnjë dispozitë tjetër që të përfshijnë detyrimin për ushqim në fushën e zbatimit ekskluziv të kësaj konvente. Një gjë e tillë bëhet me e qartë duke analizuar konventën **“Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”**. Kështu, në krye të kësaj konvente shtetet kanë parashikuar qëllimin e nënshkrimit të saj që ka të bëjë me angazhimin e shteteve palë për marrjen e të gjitha masave të duhura, duke përfshirë nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, për të siguruar rivendosjen e detyrimit të mbështetjes financiare për fëmijën nga prindi (prindërit) ose persona të tjerë përgjegjës, në veçanti kur këta persona jetojnë në një shtet të ndryshëm nga ai i fëmijës. Pra, në



konsideratë të kësaj Konvente qëllimi është të sigurohet vendosja e ekzekutimi i detyrimit për ushqim ndaj personave, që jetojnë në vende të ndryshme nga fëmija. Një prej objektivave të kësaj konvente sipas nenit 1 të saj është vënia në dispozicion e kërkesave për marrjen e vendimeve për detyrimin për ushqim, ose për njohjen e tyre etj. Po në nenin 9 të saj parashikohet se; *Një kërkesë sipas këtij kapitulli bëhet nëpërmjet autoritetit qendror të shtetit kontraktues në të cilin banon kërkuuesi, për autoritetin qendror të shtetit të kërkuar.* Kërkuuesi në kuptim të konventës është personi, që gëzon një të drejtë kërkitimi për detyrimin për ushqim ndaj personit tjetër përgjegjës. Pra, në kuptim të kësaj konvente vendbanimi i fëmijës, i cili normalisht është subjekti, që gëzon të drejtën e ushqimit përbën një rrethanë që përcakton autoritetin, që vë në lëvizje procedurën e sigurimit të detyrimit për ushqim pranë autoritetit qëndron të shtetit të kërkuar, ku ndodhet personi përgjegjës për detyrimin. Kjo do të thotë se shteti, ku ndodhet fëmija në rastet e kërtimeve për detyrimin për ushqim nuk gëzon ndonjë juridiksion ekskluziv për të vendosur për detyrimin për ushqim, por përkundrazi ai gëzon të drejtën t'i drejtohet për përcaktimin e njohjen e detyrimit për ushqim autoritetit të vendit, ku ndodhet personi përgjegjës, pra prindi i fëmijës që ngarkohet me një detyrim të tillë.

42. Në vijim në nenin 10 të kësaj konvente janë të parashikuara rregullat e kërkesave që i vihen në dispozicion kreditorit, pra personit që ka të drejtën. Më konkretisht neni 10 parashikon se; Kategoritë e mëposhtme të kërkesave i vihen në dispozicion një kreditori në një shtet kërkuar, që synon të rivendosë mbështetjen financiare sipas kësaj Konvente. *a) njohja ose njohja dhe ekzekutimi i një vendimi; b) zbatimi i një vendimi të marrë ose të njohur në shtetin e kërkuar; c) marrja e një vendimi në shtetin e kërkuar ku nuk ka vendim ekzistues, duke përfshirë nëse është e nevojshme, përcaktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore; d) marrja e një vendimi në shtetin e kërkuar kur njohja dhe zbatimi i një vendimi nuk është e mundur ose refuzohet për shkak të mungesës së një baze për njohjen dhe zbatimin sipas nenit 20 ose për arsye të përcaktuara në nenin 22 “b” ose “e”; e) ndryshimi i një vendimi të marrë në shtetin e kërkuar; f) ndryshimi i një vendimi të marrë në një shtet të ndryshëm nga shteti i kërkuar.* Po në paragrafin e tretë të kësaj dispozite parashikohet se; *Përveç rasteve, kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, kërkesat në*

paragrafët 1 dhe 2 përvaktohen sipas ligjit të shtetit të kërkuar, dhe kërkesat në paragrafët 1 “c” deri “f” dhe 2 “b” dhe “c”, u nënshtrohen rregullave juridiksionale të zbatueshme në shtetin e kërkuar. Në referim të kësaj dispozite del e qartë se kërkesat për të marrë një vendim detyrimi për ushqim i nënshtrohen rregullave juridiksionale të shtetit të kërkuar, pra të atij ku dorëzohet kërkesa për gjykimin e një çështje me objekt detyrimi për ushqim dhe jo juridiksionit të shtetit kërkuar, pra të atij, ku ndodhet fëmija. Nëse do të ndiqej një logjikë e tillë atëherë shteti i vendbanimit të fëmijës do t'i drejtohej shtetit tjetër vetëm për njohjen e vendimit të dhënë në shtetin kërkuar, ndërkohë që konventa është e zbatueshme jo vetëm për njohjen, por edhe për kërkimin e hapjen e një procesi gjyqësor në shtetin e kërkuar për të siguruar një vendim gjyqësor përcaktues e njohës së detyrimit për ushqim. Përderisa shtetet në rastin e detyrimit për ushqim kanë marrë përsipër të ndërhyjnë e të realizojnë procedurat gjyqësore mbi bazën e një kërkesë të formuluar nga personi i interesuar, atëherë është e padiskutueshme, që rregullat e kësaj konvente mbi juridiksionin janë të zbatueshme edhe kur vetë personi i interesuar si fëmija ose prindi që e mban fëmijën i drejtohet gjykatës së vendit, ku jeton personi përgjegjës për detyrimin për ushqim ose ku ndodhet pasuria e tij.

43. Referuar nenit 10/3 të Konventës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve ..” del se juridiksioni mbi kërkesat për detyrimin për ushqim e për pasojë edhe mbi përgjegjësisë prindërore, kur kjo e fundit është ngushtësisht e lidhur me detyrimin për ushqim, përcaktohet nga rregullat e shtetit të kërkuar, pra të atij që ka lidhje me personin që do të ngarkohet me detyrimin për ushqim dhe jo i atij të vendqëndrimit të fëmijës. Kështu që njësimi i shumicës së juridiksioni i gjykimit të kërkesës për detyrimin për ushqim i përket gjykatës së vendit të qëndrimit të fëmijës ose të personit kërkuar është në kundërshtim me Konventën “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit për ushqim” që ka në konsideratë parësore gjykimin në gjykatën e vendit ku ndodhet personi i detyruar. Edhe ligji nr. 10428/2011 në nenin 80 pika d të tij parashikon qartazi gjykata shqiptare ka juridiksion për çështjet e detyrimit për ushqim kur i detyruari ka vendqëndrimin në Shqipëri, ndërkohë që e zgjeron këtë juridiksion në rastet kur detyrimi vjen si pasojë e marrëdhënieve prind -fëmijë edhe



mbi bazën e kriterit të shtetësisë sipas nenit 76 të ligjit.

44. Në analizë të kësaj konvente rezulton se pranohet juridiksioni i një shteti të ndryshëm nga ai i vendbanimit ose vendqëndrimit të fëmijës, madje edhe për kërkimet e përgjegjësisë prindërore, kur objekt i kërkimit është detyrimi për ushqim në favor të fëmijëve. Ky juridiksion nuk është i lidhur vetëm me vendqëndrimin e personit përgjegjës por edhe me vendin, ku ky i fundit ka vendbanimin e përhershëm e lidhur kjo me shtetësinë, ose mund të ketë si rregull pasuri të tij, që mund të jetë objekt ekzekutimi i detyrimit për ushqim. Pra rezulton se në konsideratë të kësaj konvente detyrimi për ushqim si kërkim primar ose si pasojë e zgjidhjes së martesës gëzon një konsideratë më parësore për përcaktimin e juridiksionit se kërkimi për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në kundërshtim me atë që arsyetohet shumica. Ky konkluzion veç nenit 10 të sipërcituar gjenden edhe në nenin 6 të Konventës, ku thuhet se autoritetet *marrin masa b) për të siguruar ndihmë në përcaktimin e përgjegjësisë prindërore, kur është e nevojshme, për rivendosjen e detyrimit ushqimor*. Nisur nga këto konstatime konventa “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” nuk mund të ketë prioritet për përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar të mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, në raport me rregullat e përcaktimit të juridiksionit të Konventës *Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes*” kur në gjykimin e çështjes shqyrtohen bashkërisht si detyrimi për ushqim dhe mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose kur këto kërkime vijnë si pasojë e çështjes kryesore të zgjidhjes së martesës.

45. Duke mbajtur në konsideratë parashikimet specifike të të dyja konventave dhe ligjin shqiptar “Për të drejtën ndërkombëtare private” del se gjykata shqiptare ka juridiksion të shqyrtojë çështjet me objekt zgjidhje martese e rregullim i pasojave të saj të njohura nga Kodi i Familjes kur njëri nga palët ka shtetësi shqiptare pasi;

a) sipas nenit 10 të Konventës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” pranohet juridiksioni i shtetit që shqyrton zgjidhjen e martesës edhe për të shqyrtuar pasojat e

zgjidhjes së martesës kur e parashikon ligji i shtetit të palëve,

b) pasojat për zgjidhjen e martesës nuk përfshijnë vetëm mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore por edhe detyrimin për ushqim që gëzon konsideratë parësore për përcaktimin e juridiksionit në raport me atë që rregullon mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore e masat e tjera mbrojtëse. Kërkimi i detyrimit për ushqim si pjesë e pasojave të zgjidhjes së martesës përjashton kufizimet e përcaktuara në nenin 10 pika a e b të konventës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” duke e shtrirë juridiksionin e vendit të zgjidhjes së martesës edhe për shqyrtimin e pasojave si për përgjegjësinë prindërore e detyrimin për ushqim. Në këtë rast fiton prioritet juridiksioni i vendit të zgjidhjes së martesës që të shqyrtojë bashkërisht të gjitha pasojat e zgjidhjes së martesës,

c) është në interesin më të lartë të fëmijës që të gjitha të drejtat e tij, që vijnë si pasojë e zgjidhjes së martesës të shqyrtohen në një gjykim të përbashkët, pasi vetëm në këtë mënyrë sigurohet të gjitha të drejtat si ekonomike por edhe ato juridike jo vetëm të prindërve të fëmijës por edhe të fëmijës ndaj secilit prej prindërve. Çdo ndarje e juridiksioneve nuk do i shërbente qëllimit të krijimit të lehtësirave për fëmijët, por do i vinte këta të fundit dhe prindërit e tyre para proceseve pa fund për të siguruar njohjen e ekzekutimin e të drejtave të veçuara në secilin rast.

46. Vendimi i gjykatës shqiptare sjell menjëherë efekte zbatuese në Shqipëri lidhur me regjistrin e gjendjes civile të shtetasve duke ndryshuar përbërjen familjare dhe të drejtat e prindërve si kryefamiljar të familjes në raport me njëri-tjetrin dhe me fëmijën. Fakti se ky vendim mund t'i nënshtrohet një procedure njohje në shtetin e huaj nuk përbën shkak për të konstatuar mungesën e juridiksionit e gjykatës shqiptare në shqyrtimin e kërkimit të zgjidhjes së martesës dhe pasojave të zgjidhjes së martesës.

47. Referuar nenit 76 të ligjit nr. 10428/2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, rezulton se: “Gjykatat shqiptare kanë juridiksion të gjykojnë çështjet, që lidhen me të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga martesa midis prindërve dhe fëmijëve, njohjen apo kundërshtimin e atësisë dhe të amësisë, kur njëra nga palët ka shtetësinë shqiptare ose ka vendqëndrimin e saj në Republikën e Shqipërisë”. Referuar këtij parashikimi, gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të vendosur edhe për



pasojat e zgjidhjes së martesës (të cilat mund të shtrihen në kohë edhe pas zgjidhjes gjyqësisht të martesës), ku në konsideratë parësore qëndron mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas kësaj zgjidhje, sikundër në rastin objekt gjykimi. Ky juridiksion i gjykatave shqiptare, i cili ka përcaktuar jo vetëm zgjidhjen e martesës midis bashkëshortëve shtetas shqiptar por edhe pasojat e saj në raport me fëmijën dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, do vijojë të mbartet nga gjykatat shqiptare, të cilat verifikojnë “ecurinë” e përgjegjësisë prindërore apo nevojat e ndryshimit të kësaj përgjegjësie të përcaktuar me vendim të formës së prerë. Vendimi që ka vendosur rregullimin e pasojave të mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe detyrimit për ushqim konsiderohet se ka fuqi detyruese për palët por edhe për gjykatën. Duke pasur një cilësi të tillë secila nga palët gëzon të drejtën për të kërkuar njohjen e tij në shtetin e huaj. Po ashtu gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të vendosur ndryshimin e disponimeve të dhëna në një vendim të saj in edhe pse fëmija mund të ketë ndryshuar vendqëndrimin. Ndërsa në rast se vendimi për rregullimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore është dhënë nga një shtet i huaj atëherë gjykata shqiptare fiton juridiksion vetëm në rastin kur fëmija vendoset me vendqëndrim në Shqipëri.

48. Në unitet me gjithë shpjegimet e mësipërme del se gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të vendosur jo vetëm për zgjidhjen e martesës, por edhe për çështje të përgjegjësisë prindërore, detyrimit për ushqim edhe kur fëmija jeton jashtë vendit kjo për faktin se ligji për të drejtën ndërkombëtare private përmirëson të drejtën e aksesit për shtetasit shqiptar në këtë fushë dhe nuk ka asnjë kufizim ndalues nga Konventa e Hagës që këto çështje të shqyrtohen nga gjykata e vendit të shtetësisë së fëmijës ose të prindërve por përkundrazi Konventa pranon edhe transferimin e juridiksionit në favor të vendit të shtetësisë e drejtë kjo që nuk kushtëzohet nga fakti nëse gjykata e huaj ia bën palëve prezent një të drejtë të tillë por edhe kur ata e ushtrojnë vetë kërkesën drejtpërdrejt në vendin e shtetësisë.

49. Në kuadër të qëllimit parësor të mbrojtjes së të drejtës së fëmijëve dhe të familjes, detyra e shteteve është t'i shqyrtojnë këto çështje dhe jo të shmangin gjykimin e tyre nëpërmjet diskutimit kryesisht të juridiksionit për më tepër kur palët nuk

kanë asnjë kundërshtim. Për më tepër situata e përgjegjësisë prindërore është objekt i shqyrtimit në gjykatë në tri situata konkretisht si pasojë e zgjidhjes së martesës, si kërkim për ndryshimin e përgjegjësisë së njohur me një vendim të formës së prerë dhe në rastet kur ajo është pasojë e krijimit të marrëdhënies prind fëmijë për fëmijën e lindur jashtë martese të njohur apo jo. Për dy rastet e para si gjyqtarë në pakicë kemi bërë analizën si më sipër. Duke qenë se në rastin e tretë vetë Konventa e Hagës (e Juridiksioni) në nenin 4 parashikon se vendosja e marrëdhënieve prind fëmijë nuk bie në fushën e zbatimit të saj, atëherë vendosja e kësaj marrëdhënie si pasojë e njohjes së atësisë ose për fëmijët e lindur jashtë martese nuk rregullohet në mënyrë eksplicite nga dispozitat e kësaj konvente, duke u rregulluar nga dispozitat e ligjit nr. 10428/2011. Për rrjedhojë, juridiksioni i gjykatave shqiptare është i pranishëm edhe në këto situata.

50. Kodi i Procedurës Civile ka zgjidhur situatat kur e njëjta çështja është paraqitur për shqyrtim nga palët edhe në juridiksionin e huaj. Kështu në nenin 38 të KPC-së parashikohet, se: *gjykata shqiptare mund të pezullojë gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje kur: a) padia është paraqitur më parë në kohë në gjykatën e shtetit të huaj; b) vendimi i gjykatës së shtetit të huaj është i mundshëm për t'u njohur dhe/ose ekzekutuar në Republikën e Shqipërisë; c) gjykata shqiptare bindet se pezullimi është i nevojshëm për administrimin e dubur të drejtësisë.* Në zbatim të kësaj dispozite gjykatat shqiptare ka diskrecion që të vlerësojnë nëse një çështje do të zgjidhet më mirë prej saj apo nga gjykata e huaj. Ky parashikim tregon se vetëm paraqitja e të njëjtës çështje në gjykatën e huaj mund të sjellë pezullimin e gjykimin në rastin e juridiksionit të njëkohshëm midis dy vendeve. Për aq kohë sa nuk kemi të bëjmë me juridiksion ekskluziv atëherë secili nga shtetet ka juridiksion të shqyrtojë çështjen për aq kohë sa e ka të parashikuar në ligjin e brendshëm dhe pranohet po nga Konventa e Hagës. Gjykata nuk mund të nxjerr çështjen jashtë juridiksionit kur ka juridiksion për gjykimin e çështjes thjeshtë duke vlerësuar se gjykata tjetër është ajo që vlerëson më mirë interesin e fëmijës. Kjo rrethanë përbën shkak për pezullimin e gjykimin të çështjes dhe jo për nxjerrje jashtë juridiksionit. Nëse ekziston një situatë e tillë atëherë gjykata shqiptare ka të drejtë të vendosë pezullimin e gjykimin. Nëse asnjë nga palët nuk ka paraqitur asnjë kërkesë në gjykatën e huaj atëherë gjykata shqiptare nuk mund të imponojë palët, nëpërmjet



nxjerrjes se çështjes jashtë juridiksionit, për të ndjekur një juridiksion alternativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së tyre duke e konsideruar atë si juridiksion ekskluziv megjithëse ligji ose konventa nuk ia kanë dhënë një cilësi të tillë. I takon asaj të përdor të gjitha mjetet procedurale për të bërë të mundur dëgjimin e fëmijës dhe marrjen e provave të tjera duke vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës jo thjeshtë në aspektin procedural, por atë substancial në funksion të zgjidhjes sa më të drejtë të çështjeve për të drejtën e takimit, kujdestarinë e detyrimin për ushqim ndaj tij.

Në unitet nga sa më sipër përgjigja për të gjitha çështjet e shtruar në pyetjen e parë duhet të ishte:

a) Në çështjet me objekt zgjidhje martesë ose pavlefshmëri e martesës dhe rregullimin e pasojave të tyre gjykatat shqiptare kanë juridiksion për shqyrtimin e çështjes, kur ekziston një nga kriteret lidhëse të ligjit nr. 10428/2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private” pavarësisht se vendqëndrimi i zakonshëm i të miturit nuk është në Shqipëri.

b) Në çështjen me objekt rregullimin ose ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së mitur gjykatat shqiptare kanë juridiksion sipas kriterëve lidhëse të përcaktuara në nenin 76 të ligjit nr. 10428/2011 pavarësisht se vendqëndrimi i të miturit nuk është në Shqipëri. Nëse rregullimi fillestar i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore është bërë me vendim të formës së prerë të gjykatës së huaj, gjykata shqiptare ka juridiksion për tu shprehur lidhur me masat paraprake mbrojtëse ose për ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore kur fëmija i mitur ka vendqëndrimin në Shqipëri.

c) Në çështjet me objekt përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim gjykatat shqiptare kanë juridiksion për shqyrtimin e këtyre çështjeve kur ekzistojnë kriteret lidhëse të përcaktuara në nenet 75, 76 ose 80 të ligjit nr. 10428/2011.

i. Nëse e njëjta padi për çështjet e sipërcituara është duke u gjykuar në mënyrë të njëkohshme edhe nga gjykata e huaj, gjykata mund të disponojë për çështjen në shqyrtim në një nga mënyrat e parashikuara nga neni 38 i KPC-së.

II. Lidhur me pyetjen e dytë: ***Si qëndron juridiksioni i gjykatave shqiptare për këto çështje, në raport me zbatimin e Konventës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”?***

51. Lidhur me këtë çështje sipas nenit 16 të Konventës parashikohet se *Pas marrjes së njoftimit për një largim apo mbajtje të padrejtë të fëmijës në kuptimin e nenit 3, autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit kontraktues, nga i cili fëmija është larguar apo mbajtur, nuk do të vendosin në themel për të drejtave të kujdestarisë, derisa të vendoset se fëmija nuk do të kthehet sipas kësaj Konvente ose nëse nuk bëhet një kërkesë sipas kësaj Konvente, brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së njoftimit.* Referuar kësaj dispozite shqyrtimi i kërkesës për kthimin e fëmijës në rast të marrjes së tij të padrejtë gëzon prioritet në shqyrtim në raport me gjykimin e çdo çështje që ka të bëjë me kujdestarinë. Një detyrim i tillë rëndon si mbi autoritetin e shtetit nga i cili është larguar fëmija i cili nuk do e përfundojë një gjykim të tillë derisa të vendoset nëse fëmija do të kthehet, po ashtu edhe ndaj autoritetit të shtetit ku mbahet fëmija që nuk do të vendos derisa të mos bëhet një kërkesë brenda një kohe të arsyeshme pas ardhjes në dijeni.

52. Qëllimi i Konventës është të rikthejë të njëjtën gjendje të status-quo të jetesës së fëmijës pranë të njëjtit ambient sikurse ka ekzistuar para largimit të padrejtë që ka cenuar një të drejtë kujdestarie ose mbajtje të fëmijës të njohur ligjërish. Megjithatë kthimi i fëmijës nuk do të thotë se ky është një vendim që barazohet me zgjidhjen në themel të çështjes së kujdestarisë dhe as e paragjykon një vendimmarrje të tillë. Edhe fakti se në shtetin e kërkuar mund të jetë dhënë apo do të njihet një vendim për rregullimin e çështjes së kujdestarisë nuk mund të përbëjë shkak për refuzimin apriori të kërkesës por gjykata mund të mbajë në konsideratë shkaqet për të cilat është dhënë një vendim i tillë.

53. Neni 3 i Konventës parashikon shprehimisht, se: *“Largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë ... kur: a) konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë që i janë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë kolektivisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i zakonshëm para largimit apo mbajtjes; dhe b) në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë kolektivisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes”.* Pra në përputhje me këtë dispozitë largimi i padrejtë i fëmijës nuk ka të bëjë vetëm me situatën,



kur janë shkelur të drejtat e kujdestarisë së njohur në një vendim gjyqësor në favor të prindit ose të një institucioni tjetër, por edhe kur janë shkelur ato që i njihen ligjërisht. Fakti, që fëmija mbahet pa të drejtë në një vend të ndryshëm nga vendi prej të cilit u largua nuk do të thotë se juridiksioni i këtij të fundit është i kufizuar vetëm te shqyrtimi i kërkesës për kthimin e fëmijës. Gjykatat e vendit ku mbahet fëmija mund të gëzojnë juridiksion për shqyrtimin e çështjeve të kujdestarisë kur ekzistojnë kriteret lidhëse, qoftë edhe ai i vendqëndrimit. Megjithatë ky i fundit nuk përbën një kriter përcaktues për juridiksionin e gjyqimit të kujdestarisë në kushtet kur ky vendqëndrim ka ardhur si rezultat i vendosjes së padrejtë të fëmijës në këtë vendqëndrim. Me largimin e fëmijës në zbatim të vendimit të kthimit të fëmijës, gjykata e vendit të qëndrimit do të humbte juridiksionin.

54. Megjithatë, mund të ndodh që gjykata e vendit, ku mbahet fëmija pa të drejtë mund të ketë juridiksion për një shkak tjetër siç është shtetësia e fëmijëve ose e prindërve, gjë që do t'i jepte juridiksion gjykatës për të shqyrtuar në themel çështjen e kujdestarisë, pavarësisht se është marrë një vendim për kthimin e fëmijës në vendin e qëndrimit të tij fillestar. Pavarësisht nga kjo, gjykimi i një çështje të tillë nga gjykata e vendit të shtetësisë, kur ky është vendi ku ishte vendosur pa të drejtë fëmija, varet edhe nga fakti nëse ishte në shqyrtim ndonjë kërkesë kujdestarie në vendin ku duhet të kthehet apo u kthye fëmija. Nëse po, atëherë gjykimi i çështjes për kujdestarinë e fëmijës në vendin e shtetësisë nuk mund të vazhdojë duke u pezulluar në bazë të nenit 38 të KPC-së. Në të kundërt gjykimi mund të vazhdojë për aq sa gjykata gëzon juridiksion lidhur me gjykimin e çështjes sipas kriterit të shtetësisë.

Në rezume përgjigja për çështjen e dytë të shtruar për njësim është;

Nëse para Gjykatave shqiptare është në gjykim një çështje për kthimin e fëmijës në kuadër të Konventës “Për rrëmbimin civil të fëmijëve”, kjo situatë nuk cenon juridiksionin e gjykatave shqiptare për të shqyrtuar një çështje, që ka të bëjë me kujdestarinë ose mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore mbi të miturin. Megjithatë kur ka një vendim të gjykatave shqiptare për kthimin e fëmijës në shtetin e huaj në bazë të konventës “Për rrëmbimin civil të fëmijëve” dhe në shtetin e

huaj është duke u gjykuar një çështje e kujdestarisë së fëmijës ose e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për fëmijën atëherë gjykata duhet të disponojë për çështjen e paraqitur para saj në një nga mënyrat e parashikuara nga neni 38 i KPC-së.

II. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

55. Në çështjen konkrete, Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka pasur juridiksion për gjykimin e çështjes kjo për faktin se paditësja ka kërkuar zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj për fëmijët e lindur nga martesa. Të dyja palët janë shtetas shqiptar dhe fëmijët e tyre po ashtu gëzojnë shtetësinë shqiptare. Palët ndërgjyqësie jetojnë në shtetin grek së bashku me fëmijët e tyre. Në rastin konkret, të dy prindërit kanë pranuar juridiksionin e gjykatave shqiptare, duke mos shprehur asnjë kundërshtim për juridiksionin por përkundrazi kanë dhënë qëndrimet e tyre mbi mënyrën se si do të rregullohen pasojat e zgjidhjes së martesës lidhur me fëmijën. Pranimi i juridiksionit mund të jetë i shprehur ose i heshtur në përputhje kjo me nenin 73 të ligjit nr. 10428/2011, kusht që në rastin konkret konsiderohet i ezauruar.

56. Gjykata e faktit nuk ka analizuar asnjë rrethanë që sipas saj i jep do i jepte prioritet vlerësimit të interesit më të lartë të fëmijëve nga gjykata e huaj në raport me të. Gjykata i ka të gjitha mundësitë të jap autorizimet e duhura për paraqitjen e fëmijëve për tu dëgjuar para saj. Po ashtu gjuha nuk mund të përbëjë një pengesë për shqyrtimin e çështjes për aq kohë sa fëmijët janë të rritur nga shtetas shqiptar dhe jo vetëm janë të familjarizuar me gjuhën shqipe por edhe me kulturën shqiptare. Për sa i përket atashimit faktik, që ata kanë me secilin prind secili prej palëve ka detyrimin për ti paraqitur prova gjykatës dhe vetë kjo e fundit ka të gjitha mundësitë të marr dhe mendimin e një psikologu.

57. Prindërit si njohës të interesit më të lartë të fëmijës nuk kanë kundërshtuar juridiksionin e saj. Gjithashtu padia për zgjidhjen e martesës e rregullimin e pasojave të saj është ngritur nga prindi që faktikisht mban dhe kujdeset drejtpërdrejt për fëmijët edhe pas ndërprerjes së bashkëjetesës së palëve. Është ky prind i cili i ofron fëmijës kushtet për plotësimin e interesave të tij si fëmijë gjatë periudhës kur ende nuk është zgjidhur martesa ligjërisht, rrethanë kjo që në mënyrë indirekte pranohet edhe nga prindi tjetër. Ngritja e padisë nga



ky prind para gjykatave shqiptare të padisë për zgjidhjen e martesës e rregullimin e pasojave mbështet ekzistencën e njëkohshme të interesit më të lartë të fëmijës që gjykimi të realizohet nga gjykata shqiptare.

58. Kështu, prindërit e fëmijës si mbartës së detyrimeve ndaj fëmijëve për ti krijuar atyre kushteve sa më të mira social-ekonomike nëpërmjet pranimi të juridiksionit pranojnë njëkohësisht se gjykata shqiptare është ajo që ofron më shumë lehtësi për ta dhe për rrjedhojë edhe për realizimin e interesave të fëmijëve pas zgjidhjes së martesës. Ky qëndrim është në përputhje me nenin 10/b të Konventës *‘Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, bazimin e bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat e mbrojtjes së fëmijëve’*. Marrëdhënia prindërore të prindërve shqiptar me fëmijën ruan të qenësishme traditën e kulturën shqiptare të familjes, megjithëse fëmija jeton në shtet të huaj. Rritja e fëmijës në një ambient të tillë familjar mban të fortë lidhjen e fëmijës me vendin e shtetësisë së tij, megjithëse ambienti social i jashtëm është i ndryshëm. Gjithashtu mundësitë ekonomike të prindërve shqiptar emigrant në vendin e huaj dhe mundësia e aksesit të tyre pranë gjykatave të vendit të huaj nuk garantohet në të njëjtën shkallë si në gjykatat shqiptare për shkak të kufizimeve të tyre lidhur me gjuhën e vendit dhe të të ardhurave të siguruara, shpenzimet gjyqësore në ato vende ndërkohë që shpenzimet gjyqësore në Shqipëri janë shumë më të vogla.

59. Nisur nga këto konsiderata, në mbështetje të së drejtës së aksesit në drejtësi dhe të detyrimit që ka shteti shqiptar për ti siguruar realizimin e të drejtave e interesave të shtetasve të vetë pavarësisht nga vendet ku ata ndodhen në të njëjtat kushte me shtetasit që jetojnë në Shqipëri, si gjyqtare në pakicë vlerësoj se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, i cili ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, është i pabazuar.

60. Në përfundim, disponimi i gjykatës së shkallës së parë për nxjerrjen jashtë juridiksionit të çështjes, si për zgjidhjen e martesës ashtu edhe për rregullimin e pasojave të saj, është në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe konventore, sikurse janë arsyetuar më sipër. Për sa kohë të dy bashkëshortët janë shtetas shqiptarë, gjykata shqiptare ka juridiksion për të shqyrtuar çështjen e zgjidhjes së martesës dhe pasojat e saj, përfshirë edhe çështjet që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

Për sa më sipër,

Në bazë të nenit 308/1 të K. Pr. Civile,

Mendimi i gjyqtarëve në pakicë për zgjidhjen e çështjes është;

Prishjen e vendimit nr. 1459 (13-2024-5077), datë 22.4.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë.

Gjyqtarë: Enton Dhimitri, Margarita Buhali

VENDIM

Nr. 21, datë 15.5.2026

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe të nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlëra “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore, që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime



tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 186 lekë/litri për gazoilin;
- 173 lekë/litri për benzinën.

b. Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 198 lekë/litri për gazoilin;
- 185 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoil është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë, sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t’i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë është i lirë t’i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 15.5.2026, ora 13:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Sezar Beqaj, Enea Karakaci, Nimet Veliq, Arjana Dyrishi, Dritan Basha, Ilir Binaj, Arlind Fida, Besmir Beja, Klaudio Gega, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu

VENDIM

Nr. 22, datë 16.5.2026

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe të nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018, dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në Bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë



edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 190 lekë/litri për gazoilin;
- 176 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 202 lekë/litri për gazoilin;
- 188 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoili është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 16.5.2026, ora 13:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Sezar Beqaj, Enea Karakaci, Nimet Veliaj, Arjana Dymishi, Dritan Basha, Ilir Binaj, Arlind Fida, Besmir Beja, Klaudio Gega, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 592 lekë

